

الله  
رسول  
محمد

HARUN JAHJA  
(ADNAN OKTAR)

# FRANKMASONERIA GLOBALE

PE EMËR TË ALLAHUT,  
MËSHIRVESIT,  
MËSHIRËBËRËSIT



**F**rankmasoneria është një subjekt që ka ngjallur shumë diskutime për shekuj me radhë. Disa e kanë akuzuar Masonerinë për krime makabre dhe veprave të këqija. Megjithatë, në vend që të përpiqeshin për ta kuptuar "Vëllazërinë" dhe për ta kritikuar atë në mënyrë objektive, kritikët kanë qenë tepër armiqtësorë me organizatën.

Ky libër e paraqet Masonerinë si një shkollë mendimi. Ndikimi më i rëndësishëm në bashkimin mes Masonëve, është filozofia e tyre, e cilat mund të përshkruhet më mirë në bazë termave të tilla si "materializëm" dhe "humanizëm laik". Por, kjo është një filozofi e gabuar, e bazuar në supozime të rreme dhe teori të meta, siç ju do t'i shihni në këtë libër.

Në këtë libër, lexuesit do t'i paraqitet një përmbledhje e historisë së luftës së Masonëve kundër feve monoteiste. Frankmasonët kanë luajtur një rol të rëndësishëm në distancimin e Europës nga vlerat morale fetare dhe në vendin e tyre themeluan një rend të ri bazuar në filozofitë e materializmit dhe humanizmit laik. Lexuesi do të shikojë gjithashtu sesi Masoneria ka ndikuar tek qytetërimet joperëndimore për imponimin e këtyre dogmave dhe të një rendi shoqëror të bazuar në to.

Pas leximit të këtij libri, lexuesi do të jetë në gjendje vlerësojë shumë aspekte, që nga shkollat e filozofisë deri tek titujt kryesorë të gazetave, nga këngët e muzikës rrok deri tek ideologjitë politike, duke kuptuar më thellë dhe duke dalluar më mirë kuptimin dhe qëlimet që fshihen pas këtyre ngjarjeve dhe faktorëve.



## DY FJALË RRETH AUTORIT

I njohur me emrin HARUN JAHJA, Adnan Oktar, u lind në Ankara në vitin 1956. Pasi kreu studimet fillore dhe të mesme në Ankara, ai studioi për arte në Universitetin Mimar Sinan në Stamboll dhe filozofi në universitetin e Stambollit. Që nga viti 1980, ai ka botuar mjaft libra në lidhje me çështje politike, shkencore, dhe fetare. Duke qenë mjaft të vlerësuara në të gjithë botën, këto vepra kanë shërbyer për shumë njerëz si mjet për të gjetur besimin në Zot dhe për të arritur një njohje më të thellë për besimin e tyre. Librat e Harun Jahjasë u drejtohen të gjithë lexuesve, pa marrë parasysh moshën, racën, apo kombësinë e tyre, sepse ata përqendrohen në një synim: të hapin horizontin e lexuesit duke nxitur atë të mendojë për disa çështje të rëndësishme, si qenia e Allahut dhe Njëshmëria e Tij dhe të jetuarit sipas vlerave që Ai ka përcaktuar për ne.



بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

اللَّهُ  
رَسُولُ  
مُحَمَّدٍ

## DY FJALË RRETH AUTORIT DHE VEPRAVE TË TIJ

I njohur me emrin HARUN JAHJA, Adnan Oktar, u lind në Ankara në vitin 1956. Pasi kreu studimet fillore dhe të mesme në Ankara, ai studioi për arte në Universitetin Mimar Sinan në Stamboll dhe filozofi në universitetin e Stambollit. Që nga viti 1980, ai ka botuar mjaft libra në lidhje me çështje politike, shkencore, dhe fetare. Harun Jahja është njohur mirë si autor i veprave të rëndësishme, të cilat zbulojnë mashtrimin e evolucionistëve, pohimet e tyre të pavërteta dhe lidhjet e errëta midis Darwinizmit dhe ideologjive gjakësore, të tilla si: fashizmi dhe komunizmi.

Veprat e Harun Jahjasë, të përkthyer në 57 gjuhë të ndryshme, përbëjnë një koleksion prej mëse 45,000 faqesh me 30,000 ilustrime. Pseudonimi i tij është një ndërthurje e emrave të Harunit (Aaron) dhe Jahja (John), në kujtim të dy Profetëve të nderuar, të cilët luftuan kundër mohimit të besimit. Vula e Profetit në librat e tij është një simbol i cili është i lidhur me përmbajtjen e tyre. Ky simbol paraqet Kur'anin (Shpalljen e Fundit) dhe Profetin Muhamed (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), Profetin e fundit. Nën dritën e udhëzimit të Kur'anit dhe Sunnetit (traditës dhe mësimëve të Profetit), autori i ve vetes si qëllim të hedhë poshtë çdo ngrehinë të ideologjive që mohojnë fenë dhe të thotë "fjalën e fundit" në mënyrë që ta bëjë të heshtë çdo kundërshtim ngritur kundër fesë. Ai e përdor vulën e Profetit të fundit (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), i cili arriti urtësinë më të lartë dhe përsosmërinë morale, si një shenjë të qëllimit të tij për të ofruar fjalën e fundit.

Të gjitha veprat e Harun Jahja kanë një qëllim të përbashkët: të japin mesazhin e Kur'anit, të inkurajojnë lexuesit për të menduar mbi çështje që kanë të bëjnë me besimin, si për shembull, ekzistenca e Allahut dhe njëshmëria e Tij dhe besimi në Botën Tjetër dhe njëkohësisht të nxjerrë në pah rrënjët e kalburave të sistemeve antifetare dhe ideologjive të devijuara.

Harun Jahja



gëzon një rang të gjerë lexuesish në shumë vende të botës, që nga India në Amerikë, nga Anglia në Indonezi, Poloni, e deri në Bosnjë, Spanjë, Brazil, Malajzi, Itali, Francë, Bullgari, e deri në Rusi. Disa nga librat e tij mund të gjenden në gjuhën Angleze, Frënge, Gjermane, Spanjolle, Italiane, Portugeze, Urdu, Arabe, Shqipe, Kineze, Dhivehi (folur në ishujt Mauritius) Ruse, Serbo-Croate (Boshnjake), Polake, Malaje, Turke, Uygur, Indoneziane, Bengali, Daneze dhe Suedeze.

Duke qënë mjaft të vlerësuar në të gjithë botën, këto vepra kanë shërbyer për shumë njerëz si mjet për të gjetur besimin në Zot dhe për të arritur një depërtim më të thellë në besimin e tyre. Mençuria dhe sinqeriteti që i karakterizon librat e tij, së bashku me një stil të veçantë që është i lehtë për t'u kuptuar, ndikon drejtpërdrejt çdokënd që i lexon. Ata që i studiojnë me kujdes këta libra, nuk mund të mbrojnë më ateizmin apo ndonjë ideologji tjetër të devijuar apo filozofi materialiste, sepse këta libra karakterizohen nga një ndikim i shpejtë, përfundime të qarta dhe janë të pakundërshtueshëm. Edhe nëse këta njerëz do të vazhdojnë të këmbëngulin në të tyren, nuk do të jetë gjë tjetër veçse një këmbëngulje të kotë, sepse këta libra përmbysin ideologji të tilla që nga themelet. Të gjitha lëvizjet bashkëkohore antifetare tashmë mbrohen ideologjikisht, falë librave të shkruar nga Harun Jahja.

Kjo është, pa dyshim, një rezultat i urtësisë dhe dritës së Kur'anit. Autori në mënyrë modeste dëshiron të shërbejë si një mjet në kërkimin njerëzor të rugës së drejtë të Allahut. Prej botimit të këtyre materialeve nuk kërkohet asnjë përfitim material.

Ata njerëz që inkurajojnë të tjerët për të lexuar këto libra, për të hapur mendjet dhe zemrat e tyre dhe për t'i udhëzuar ata të bëhen robër të devotshëm të Allahut, kryejnë një shërbim të paçmuar.

Njëkohësisht, do të ishte një humbje kohe dhe energjie për të reklamua libra të tjerë, të cilët krijojnë çoroditje në mendjet e njerëzve, i shpien ata në kaos ideologjik dhe që nuk kanë një ndikim të fortë dhe preçiz në largimin e dyshimit prej mendjeve të njerëzve, siç është vërtetuar nga përvoja e përparshme. Për librat që janë shkruar vetëm e vetëm për të nxjerrë në pah fuqinë letrare të shkrimtarit se sa qëllimin fisnik për t'i shpëtuar njerëzit nga mungesa e besimit është e pamundur që të kenë një ndikim kaq të madh. Ata që e venë në dyshim këtë mund të shohin qartë se qëllimi i vetëm i librave të Harun Jahjasë është të mposhtë mosbesimin dhe, njëkohësisht, të përhapë vlerat morale të Kur'anit. Suksesi dhe ndikimi i këtij shërbimi shfaqen qartë në bindjen e lexuesve.

Një gjë duhet të mbahet parasysh: Arsyeja kryesore për vazhdimin e mizorisë, konflikteve dhe telasheve të tjera që po përjetojnë shumica e njerëzve sot është mbi-zotërimi ideologjik i mosbesimit. Kësaj mund t'i jepet fund vetëm me mposhtjen ideologjike të tij dhe, njëkohësisht, duke transmetuar mrekullitë e krijimit dhe moralin e Kur'anit, në mënyrë që njerëzit të jetojnë sipas tij. Duke patur parasysh gjendjen e botës sot, që po precipiton në një spirale dhune, korrupsioni dhe lufte, është e qartë se ky shërbim duhet të jepet shpejt dhe në mënyrë të suksesshme, përndryshe, do të jetë tepër vonë.

Në këtë drejtim, librat e Harun Jahjasë marrin një rol udhëheqës. Me lejen e Allahut, këto libra do të jenë një mjet, nëpërmjet të cilit njerëzit në shekullin e XXI do të gjejnë paqen, drejtësinë, dhe lumturinë e premtuar në Kur'an.



# FRANKMASONERIA GLOBALE

PE EMËR TË ALLAHUT,  
MËSHIRYESIT,  
MËSHIRËBËRËSIT



Harun Jahja  
(Adnan Oktar)



ISBN 975-6426-00-4

Publisher : GLOBAL PUBLISHING  
Talatpaşa Mah. Emirgazi Caddesi  
İbrahim Elmas İş Merkezi  
A Blok Kat 4 Okmeydanı - İstanbul  
Tel: (+90 212) 222 00 88

Printed by: Seçil Ofset  
100. Yıl Mahallesi MAS-SİT Matbaacılar Sitesi  
4. Cadde No: 77 Bağcılar-İstanbul  
Tel: (+90 212) 629 06 15

All translations from the Qur'an are from  
*The Noble Qur'an: a New Rendering of its Meaning in English*  
by Hajj Abdalhaqq and Aisha Bewley, published by Bookwork,  
Norwich, UK. 1420 CE/1999AH.

---

**www.harunyahya.com/albanian**  
**en.harunyahya.tv**



# FRANKMASONERIA GLOBALE



**HARUN JAHJA  
(ADNAN OKTAR)**

2010

# PËR LEXUESIN

● Një kapitull i veçantë i është kushtuar rrëzimit të teorisë së evolucionit, sepse kjo teori përbën bazën e filozofive të gjitha filozofive anti-shpirtërore. Që para 140 viteve, kur Darwinizmi kundërshtoi faktin e krijimit - dhe për këtë arsye, ekzistencën e Zotit – teoria e evolucionit ka bërë që shumë njerëz ta braktisin besimin e tyre ose të bien në dyshim. Prandaj është një shërbim i domosdoshëm, një detyrë shumë e rëndësishme, që t'iu bëhet e ditur të gjithëve se kjo teori është një mashtrim. Duke qenë se disa lexues kanë gjetur mundësinë për të lexuar librat tanë, ne mendojmë se është e përshtatshme që t'i kushtojmë një kapitull të përmbledhur kësaj teme.

● Në të gjitha librat e autorit Harun Jahja, çështjet që kanë të bëjnë me fenë janë shpjeguar nën dritën e ajeteve Kur'anore, kështu që njerëzit janë të ftuar, të mësojnë fjalët e Allahut dhe të jetojnë sipas tyre. Të gjitha temat që kanë të bëjnë me ajetet Kur'anore janë shpjeguar në një mënyrë të tillë që nuk lënë vend për dyshim apo paqartësi në mendjen e lexuesit. Stili i sinqertë, i çiltër dhe i rrjedhshëm, i përdorur nga ky autor, bën që çdo njeri, i çfarëdo moshe dhe i çfarëdo grupi shoqëror, t'i kuptojë librat e tij me shumë lehtësi. Tregimi efektiv dhe i kthjellët bën që librat të lexohen me një frymë. Bile edhe ata që e kanë mohuar në mënyrë rigorozë natyrën shpirtërore të njeriut, janë ndikuar nga faktet që paraqiten në këto libra, pasi nuk kanë mundur ta hedhin poshtë të vërtetën e përmbajtjes së tyre.

● Ky libër dhe të gjitha veprat e autorit Harun Jahja mund të lexohen individualisht apo të diskutohen në grup.

● Ata lexues që dëshirojnë të përfitojnë nga këto libra dhe të bëjnë debat të frytshëm mund t'ua tregojnë mendimet dhe përjetimet e veta edhe të tjerëve.

● Përveç kësaj, prezantimi dhe shpërndarja e këtyre librave, të cilat janë shkruar vetëm e vetëm për të ftuar kënaqësinë e Zotit, është një shërbim i madh ndaj fesë. Të gjitha librat e autorit janë tepër bindës, kështu që për ata që dëshirojnë që t'ua komunikojnë fenë njerëzve të tjerë, një ndër metodat më efektive është që t'i inkurajojnë ata për leximin e këtyre librave.

● Shpresojmë se lexuesi do të ketë kohë që të shohë prezantimet e shkurtra të librave të tjerë në faqet e fundit të këtij libri dhe të vlerësojë burimin e pasur të çështjeve, që kanë të bëjnë me fenë, të cilat janë shumë të dobishme dhe lexohen me kënaqësi.

● Në këto libra, askush nuk mund të gjejë pikëpamjet personale të autorit, siç ndodh në disa libra të tjerë, apo shpjegime të bazuara në burime të dyshimta, stile jorespektuese dhe jonderuese për sa i përket temave të shenjta, vlerësime të pashpresa, apo krijimin e dyshimit dhe të pesimizmit që shkaktojnë vetëm devijime në zemër.





# СОПТЕНТЪС

INTRODUCTION	8
I. ПГА ТЕМПЛАРËТ ДЕРИ ТЕК ЕГЈИПТИ И ВЈЕТËР...	10
II. HISTORIA E FSHEHTË E KABALAS	34
III. RISHQYRTIMI I HUMANIZMIT	52
IV. RISHQYRTIMI I MATERIALIZMIT	80
V. TEORIA E EVOLUCIONIT	118
VI. LUFTA MASONIKE KUNDËR FESË	155
PËRFUNDIM	185
SHËNIME	188





**F**rancmasoneria është një temë që ka ngjallur diskutime të shumta gjatë shekujve. Disa e kanë akuzuar Masonerinë për krime dhe poshtërsi të jashtëzakonshme. Disa autorë, në vend që të përpiqen për ta kuptuar “vëllazërinë” dhe ta kritikojnë atë në mënyrë objektive, e kanë ashpërsuar kritikën ndaj organizatës deri në armiqësi. Masonët, nga ana e tyre, e kanë thelluar edhe më shumë heshtjen e tyre tradicionale ndaj këtyre akuzave, duke preferuar që ta prezantojnë veten e tyre si një klub të zakonshëm shoqëror, gjë që nuk është e vërtetë.

Ky libër ofron një shpjegim korrekt të masonerisë si një shkollë filozofike, në të cilën ndikimi më i rëndësishëm për bashkim ndërmjet masonëve është filozofia e tyre që më së miri mund të përkufizohet me termat “materializëm” dhe “humanizëm laik”. Por, në të vërtetë, kjo është një filozofi e çoroditur, e bazuar në supozime false dhe në teori difektoze. Kjo është pika fillestare, themelore nga e cila duhet të kritikohet masonizmi.

Është e nevojshme të përmendet që në fillim se një kritikë e tillë është e rëndësishme, jo vetëm që të informohen jo-masonët mbi këtë çështje, por gjithashtu edhe për t’i ftuar vetë masonët që të shohin të vërtetën. Natyrisht, masonët, si çdokush tjetër, janë të lirë të zgjedhin



për veten e tyre dhe mund të përvetësojnë cilëndo pikëpamje globale që dëshirojnë dhe të jetojnë në përputhje me të. Kjo është e drejta e tyre natyrale. Por gjithashtu, edhe të tjerët kanë të drejtë të vënë në dukje gabimet e tyre dhe t'i kritikojnë ata dhe pikërisht kjo është ajo, që përpiket të paraqesë libri që keni në dorë.

Ne gjithashtu, kemi ndjekur të njëjtën mënyrë kritikimi edhe për bashkësitë e tjera si p.sh. ndaj çifutëve. Ky libër, gjithashtu, shqyrton pjesërisht edhe historinë e çifutëve dhe paraqet edhe për ta një kritikë mjaft të rëndësishme. Duhet të përmendet, se kjo nuk ka të bëjë fare me antisemitizmin apo me teoritë komplotiste "judeo-masoniste". Në të vërtetë, antisemitizmi është gjë e huaj për një musliman të vërtetë. Çifutët janë një popull, që për një kohë kanë qenë të zgjedhur nga Zoti dhe u janë dërguar shumë profetë. Gjatë historisë atyre u janë bërë shumë mizori, madje kanë qenë të ekspozuar edhe ndaj genocidit, por ata kurrë nuk e braktisën identitetin e tyre. Në Kur'an, së bashku me të krishterët, Zoti i quan "Njerëzit e Librit" dhe i urdhëron muslimanët që të jenë të sjellshëm dhe të drejtë me ta. Por, një pjesë e domosdoshme e kësaj drejtësie është, që të kritikohen besimet dhe veprimet e gabuara të disave prej tyre, me qëllim që t'u tregohet atyre rruga për tek drejtësia e vërtetë. Por natyrisht, e drejta për të jetuar në përputhje me atë që ata besojnë dhe dëshirojnë, është përtej çdo diskutimi.

Libri *Frankmasoneria Globale* shpalos dhe heton në mënyrë kritike rrënjët e masonerisë, si dhe qëllimet e aktivitetet e saj. Në këtë libër, lexuesi do të gjejë gjithashtu një përmbledhje të historisë së luftës së masonëve kundër parimeve morale të besimeve fetare. Masonët luajtën një rol të rëndësishëm në distancimin e Evropës nga vlerat morale fetare dhe në vend të tyre, formuan një rend të ri të bazuar në filozofitë e materializmit dhe humanizmit laik. Gjithashtu, do të shohim se masoneria ka ndikuar në imponimin e këtyre dogmave



edhe në qytetërimet joperëndimore.

Më në fund, do të diskutojmë për metodat që janë përdorur nga masoneria për të ndihmuar themelimin dhe përjetësimin e një rregulli shoqëror të bazuar mbi këto dogma. Filozofia dhe metodat, që ata përdorin për të themeluar këtë filozofi, do të nxirren në shesh dhe do të kritikohen.

Në shqyrtimin e filozofisë ateiste, materialiste dhe darviniste të Frankmasonerisë, janë përfshirë në referencë edhe citate nga punimet e masonëve. Arsyeja për përfshirjen e këtyre shprehjeve, të cilat janë të papajtueshme me respektin ndaj Zotit, engjëjve, librave të shenjtë, profetëve dhe të vlerave morale fetare, është se ata paraqesin prova të rëndësishme për të zbuluar fytyrën e vërtetë të Frankmasonerisë. Me të vërtetë Zoti, engjëjt, librat e shenjtë, të dërguarit e Tij, dhe të gjitha vlerat shpirtërore janë përtej shprehjeve të shkëputura nga fragmente të tilla.

Shpresohet se faktet e rëndësishme, që gjenden në këtë libër, do të jetë një mjet, me të cilin shumë njerëz, duke përfshirë edhe masonët, do të jenë në gjendje ta shikojnë botën më me vetëdije. Pas leximit të këtij libri, lexuesi do të jetë në gjendje vlerësojë shumë aspekte, që nga shkollat e filozofisë deri tek titujt kryesorë të gazetave, nga këngët e muzikës rok deri tek ideologjitë politike, duke kuptuar më thellë dhe duke dalluar më mirë kuptimin dhe qëlimet që fshihen pas këtyre ngjarjeve dhe faktorëve.



# - I -

## NGA TEMPLARËT PË EGJIPTIN E VJETËR

### KRYQËZATAT

*M*endimi i përbashkët i shumicës së historianëve të frankmasonerisë është se origjina e organizatës rrjedh nga kryqëzatat. Në fakt, edhe pse mazonizmi ishte themeluar dhe pranuar zyrtarisht vetëm në Angli, në fillim të shekullit XVIII, rrënjët e organizatës zënë fill që në kohën e kryqëzatave të shekullit XII. Në qendër të kësaj ngjarjeje të njohur është rendi i kryqëzatave, i quajtur **Kalorësit Templarë** ose **Templarët**.

Gjashtë vjet para prezantimit të këtij libri, libri ynë i titulluar “Rendi i ri i masonëve”, e ka shtjelluar historinë e templarëve me mjaft hollësi. Për këtë arsye, tani do të japim vetëm një përmbledhje të shkurtër. Duke analizuar rrënjët e masonerisë dhe ndikimin e saj në botë, ne zbulojmë kuptimin e fjalës “Frankmasoneria globale”.

Pavarësisht se dikush mund të këmbëngulë se kryqëzatat ishin në





The roots of Masonry date back to the Crusades against Muslims initiated by Pope Urban II

të vërtetë ekspedita ushtarake që bëheshin në emër të fesë së krishterë, e vërteta është se ato ishin ndërmarrë për përfitime materiale. Në kohën kur Europa po përjetonte skamjen dhe mjerimin më të madh gjatë gjithë historisë së saj, në Lindje lulëzonte mirëqenia dhe bollëku, sidomos te muslimanët e Lindjes së Mesme, që shërbyen si karrem për europianët. Kjo tendencë mori pamje fetare dhe u zbukurua me simbole të krishtërimit; edhe pse, në të vërtetë, ideja e kryqëzatave lindi nga dëshira për përfitime të kësaj bote. Kjo ishte arsyeja për ndryshimin e papritur mes të krishterëve europianë, nga politikat e mëparshme paqësore të tyre në drejtim të agresionit ushtarak.

Themelues i kryqëzatave ishte Papa Urbani II. Ai thirri Këshillin e Klermontit, në vitin 1095, në të cilin doktrina e mëparshme pacifiste e krishterë u la mënjanë. Lufta e shenjtë ishte shpallur, me qëllim që të



rrëmbeheshin tokat e shenjta nga duart e muslimanëve. Pas mbledhjes së Këshillit, u formua një armatë e madhe e luftëtarëve të kryqëzatave, që përbëhej nga ushtarë profesionistë dhe nga dhjetëra mijëra njerëz të zakonshëm.

Historianët besojnë se aventura e Papa Urbanit II kishte lindur nga dëshira e tij që të pengonte konsolidimin e kundërshtarit të tij për Papë. Përveç kësaj, ndonëse mbretërit europianë, princat, aristokratët dhe të tjerët e përshëndetën thirrjen e Papës me kënaqësi, qëllimet e tyre, kryesisht, ishin të rëndomta. Ashtu siç shprehet Donald Queller nga Universiteti në Illinois: “Kalorësit francezë dëshironin më shumë hapësira toke, tregtarët italianë shpresonin ta zgjeronin tregtinë edhe në portet e Lindjes së Mesme, një numër i madh të varfërisht iu bashkëngjiten ekspeditave për arsyen e vetme, që të largoheshin nga jeta e vështirë e tyre.”<sup>1</sup> Gjatë rrugës, kjo masë lakmitare priste kokat e shumë muslimanëve, madje edhe të çifutëve, me shpresë se do të gjente ar dhe stoli. Madje luftëtarët e kryqëzatave ua çanin barkun atyre që i vrisnin me qëllim që të gjenin arin dhe gurët e çmuar, që viktimat mund t’i kishin gëlltitur para se të vdisnin. Lakmia materiale ishte aq e madhe saqë, në Kryqëzatën e Katërt, gjatë plaçkitjes së Kostandinopojës (Stambollit të sotëm), që atëherë ishte qytet i krishterë, ata nuk i vrau fare ndërgjegjia kur zhveshën shtresën e arit nga afresket e krishtera në Hagia Sophi.

Pas një udhëtimi të gjatë dhe të vështirë, pas shumë plaçkitjeve dhe masakrave ndaj muslimanëve, këto hordhi të egra të quajtura “Luftëtarët e Kryqëzatave” arritën në Jeruzalem në vitin 1099. Pas rrethimit prej afro 5 javësh, qyteti u mposht dhe luftëtarët e kryqëzatave arritën të hynin brenda në të. Ata treguan një egërsi të tmerrshme që bota kurrë ndonjëherë nuk kishte pasur rastin ta shihte. Të gjithë muslimanët dhe çifutët u vunë nën tehun e shpatës. Sipas fjalëve të një historiani, thuhet se: **“Ata vranë të gjithë saraçenët**





The Crusaders wreaked havoc in Jerusalem. The Mediaeval engraving shown above depicts certain scenes of the horror.

(arabët) dhe turqit që gjetën... si meshkujt ashtu edhe femrat.”<sup>2</sup> Madje, njëri nga luftëtarët e kryqëzatave, Raymond of Aguiles, mburret me këtë dhunë të paparë:

“Aty mund të shiheshin pamje të bukura. Disa nga njerëzit tanë (e kjo ishte gjëja më e mëshirshme) ua kishin këputur kokat armiqve të tyre; të tjerët i kishin gjuajtur me shigjeta dhe ata binin nga kështjellat; të tjerët i torturonin më gjatë duke i hedhur në flakë. **Grumbuj të masive kokash, duarsh dhe këmbësh mund të viheshin re nëpër rrugët e qytetit.** Ishte e pamundur që të gjeje ndonjë rrugë të kalueshme nga trupat e njerëzve dhe kuajve. Por këto ishin gjëra të papërfillshme në krahasim me atë që ndodhi në Tempullin e Solomonit, vendi ku shërbimet fetare zhvilloheshin normalisht... Në Tempullin dhe oborrin e Solomonit, **njerëzit laheshin në gjakun, që arrinte nga gjuri deri tek kapistrat e kuajve.**”<sup>3</sup>



The Crusaders put to sword all those living in the lands they conquered.

Brenda dy ditësh, armata e kryqëzatave vrau 40.000 muslimanë në mënyrën më barbare.<sup>4</sup> Më pas luftëtarët e kryqëzatave e bënë Jeruzalemin kryeqytetin e tyre dhe themeluan Mbretërinë Latine që shtrihej nga kufiri me Palestinën deri në Antiok.

Më vonë, luftëtarët e kryqëzatave nisën një luftë, me qëllim që të mbanin pozitën e tyre në Lindjen e Mesme. Për të mbajtur shtetin që formuan, ata e panë të nevojshme, që të bënin një organizim. Në fund, ata themeluan njësinë ushtarake, që nuk kishte ekzistuar kurrë më parë. Anëtarët e këtyre njësiteve vinin nga Europa në Palestinë dhe jetonin në një lloj manastiri, në të cilin bënin trajnime ushtarake dhe përgatiteshin për të luftuar kundër muslimanëve.

Një njësi e kësaj ushtrie, ishte në mënyrë të veçantë e ndryshme nga të tjerat. Ajo pësoi një transformim që do të ndikonte dukshëm edhe në rrjedhën e historisë. Ky rend (njësi) ishin **Templarët**.



Templars developed a pagan faith in Christian guise.

## TEMLARËT

Templarët, apo emri i tyre i plotë **“Bashkëluftëtarët e varfër të Jezu Krishtit dhe Tempullit të Solomonit”** u formuan në vitin 1118, apo 20 vjet pasi luftëtarët e kryqëzatave pushtuan Jeruzalemin. Themeluesit e rendit ishin dy kalorës francezë: Hugh de Payens dhe Godfrey de Saint-Omer. Në fillim ishin 9 anëtarë, por rendi rritej vazhdimisht. Arsyeja pse ata e emëruan veten sipas Tempullit të Solomonit, ishte për shkak se, vendi që zgjodhën si bazë ishte tempulli i ndërtuar mbi themelet, ku besohet të ketë qenë ndërtuar tempulli i Profetit Solomon (Sulejman a.s). Ky vend ishte aty ku gjendej edhe Kubeja e Shkëmbit (‘Qubbet as-Sakhrah’).

Templarët u vetëquajtën “luftëtarë të varfër”, por për një kohë shumë të shkurtër u bënë shumë të pasur. Pelegrinët e krishterë, që vinin nga Europa në Palestinë, ishin nën kontrollin e plotë të këtij rendi dhe me të hollat e tyre templarët u bënë shumë të pasur. Përveç kësaj, ata për herë të parë vendosën sistemin e çeqeve dhe kreditimit, të ngjashëm me sistemin e sotëm bankar. Sipas autorëve britanikë,




**Templars fleeing the Church were given refuge by the Scottish king, Robert the Bruce .**

Michael Baigent dhe Richard Leigh, ata themeluan një tip kapitalizmi mesjetar dhe ishin nismëtarë në modernizimin e veprimtarisë bankare përmes transaksioneve të tyre me bazë interesi edhe pse kjo binte në kundërshtim me besimin e tyre.<sup>5</sup>

Templarët mbanin përgjegjësinë më të madhe për sulmet e luftëtarëve të kryqëzatave ndaj muslimanëve dhe vrasjen e tyre. Për këtë shkak, komandanti i madh musliman, Salahudini, i cili e mposhti armatën e kryqëzatave më 1187, në betejën e Hittinit dhe që çliroi edhe Jeruzalemin, i dënoi me vdekje templarët për krimet e bëra, edhe pse, nga ana tjetër, ai fali një numër të madh të krishterësh.

Edhe pse e humbën Jeruzalemin dhe pësuan dëme të mëdha, templarët vazhduan të ekzistonin dhe me zvogëlimin e pranisë së të krishterëve në Palestinë, ata e shtuan fuqinë e tyre në Europë, së pari



*The Warriors and the Bankers: A book about the Templars*

në Francë e pastaj edhe në vendet e tjera, duke u bërë shtet brenda shtetit.

Nuk ka dyshim se fuqia e tyre politike bëri, që të shqetësoheshin monarkët e Europës, por ishte edhe një aspekt tjetër i templarëve që gjithashtu, shqetësoi edhe klerin: rendi, gradualisht, po hiqte dorë nga feja e krishterë dhe ndërkohë që ishin në Jeruzalem, ata adoptuan një varg doktrinash të çuditshme mistike. Flitej se ata organizonin edhe rituale të çuditshme në mënyrë që t'u jepnin formë këtyre doktrinave.

Më në fund, më 1307, mbreti francez Philip Le Bel vendosi që t'i arrestojë anëtarët e rendit. Disa nga ata arritën të iknin, por shumica e tyre u kapën. Papa Klementi V, gjithashtu, iu bashkëngjiti spastrimit. Pas një kohe të gjatë hetimi dhe gjykimi, shumë templarë pranuan se ishin heretikë, se e kishin refuzuar fenë e krishterë dhe se e kishin ofenduar Jezusin në meshat e tyre. Përfundimisht, udhëheqësit e templarëve, që e quanin veten "Mjeshtrit e mëdhenj", duke filluar që nga më i rëndësishmi prej tyre, Jacques de Molay, u ekzekutuan më 1314 me urdhrer të Kishës dhe të mbretit. Shumica e tyre u futën në burg, kështu që rendi u shpërbë dhe zyrtarisht pushoi së ekzistuari.

Disa historianë kanë tentuar që ta paraqesin gjykimin dhe ekzekutimin e templarëve si një komplot nga ana e mbretit të Francës duke i përshkruar kalorësit si të pafajshëm ndaj akuzave. Por, ky lloj interpretimi dështon në disa aspekte.

Nesta H. Webster, historiane e famshme britanike me njohuri të mëdha për historinë okulte, i analizon këto aspekte në librin e saj

*“Shoqëritë sekrete dhe lëvizjet armiqësore”.*

Sipas Webster-it, tentativa për të shfajësuar templarët nga herezia, që ata e kishin pranuar gjatë kohës së gjykimit është e pajustificueshme. Së pari, gjatë marrjes në pyetje, pavarësisht pohimeve, që janë bërë, jo të gjithë templarët janë torturuar.

Sidoqoftë, a mund të jetë rezultat i imagjinatës, që njeriu nën ndikimin e torturës të shpikë, apo të pranojë fajin?

Është e vështirë të besohet, që shpjegimet e ritualeve, të treguara me detaje nga njerëz në vende të ndryshme, të kenë ngjashmëri aq të

madhe me njëri - tjetrin edhe pse me frazeologji të ndryshme, të mund të jenë thjesht trillime. Nëse viktimat do të nxiteshin nga akuzuesit, që të trillonin, sigurisht që thëniet e tyre do të binin në kundërshtim me njëra - tjetrën dhe ata do të ulërisnin në agoni se të gjitha llojet e ritualeve të egra dhe të pabesueshme ishin bërë me qëllimin e vetëm që të kënaqnin kërkesat e akuzuesve të tyre. Por kjo nuk është e vërtetë, sepse secila thënie përshkruan të njëjtën ceremoni, në mënyrë pak a shumë kompakte, me hollësi karakteristike që tregonin personalitetin e folësit dhe kryesisht, të gjitha historitë përputheshin me njëra tjetrën.<sup>6</sup>

Sidoqoftë, gjykimi i templarëve përfundoi me shkatërrimin e rendit. Por, edhe pse rendi “zyrtarisht” pushoi së ekzistuari, në të vërtetë, ai nuk u zhduk tërësisht. Gjatë arrestimit të papritur më 1307, disa templarë arritën të arratiseshin dhe t’i fshihnin gjurmët e tyre. Sipas një teze të bazuar në dokumente të ndryshme historike, një numër i konsiderueshëm i tyre u shpërngul në mbretërinë e vetme në Europë që në shekullin XIV nuk e njihnte autoritetin e Kishës Katolike,



**The magazine *Mimar Sinan*, a private Turkish Masonic publication intended for its own members.**

në Skoci. Atje, ata u riorganizuan nën mbrojtjen e mbretit të Skocisë, Robert the Bruce. Pak kohë më vonë ata gjetën një metodë të përshtatshme maskimi, nëpërmjet së cilës ata vazhduan ekzistencën e tyre klandestine: ata u infiltruan në shoqërinë më të rëndësishme të ishujve Britanikë të Mesjetës, lozhën e muratorëve dhe morën përfundimisht kontrollin e plotë të saj.<sup>7</sup>

Lozha e muratorëve e ndërroi emrin në fillim të periudhës moderne, duke e quajtur veten "**lozha masonike**". Ritualin skocez, që është dega më e vjetër e Masonerisë e cila daton në fillim të shekullit XIV, u formua nga templarët që u strehuan në Skoci në këtë shekull. Kështu që emrat, që iu jepen gradave më të larta në Ritualin Skocez, janë titujt që shekuj më parë u atriboheshin kalorësve të Rendit të Templarëve. Këta tituj përdoren edhe në ditët e sotme.

Shkurtimisht, templarët u zhdukën, por filozofia, besimi dhe ritualet e tyre, ende vazhdojnë nën maskën e Frankmasonerisë. Kjo tezë mbështetet në shumë fakte historike dhe është e pranueshme edhe sot e kësaj dite nga një numër i madh historianësh perëndimorë, pa marrë parasysh nëse janë apo nuk janë frankmasonë. Në librin tonë "*Rendi i ri masonik*", e kemi shtjelluar në detaje këtë çështje.

Teza që shtjellon rrënjët e masonëve deri tek templarët, shpesh iu referohet revistave të publikuara nga vetë masonët për anëtarët e tyre, ku ata e pranojnë fuqishëm këtë ide. Një revistë e tillë e quajtur '*Mimar Sinan*' (një publikim i masonëve turq), e shpjegon marrëdhënien mes Rendit të Templarëve dhe masonëve me këto fjalë:

Në vitin 1312, kur mbreti francez, nën presionin e Kishës, e mbylli Rendin e Templarëve dhe ua dha pasurinë e tyre kalorësve të Shën Xhonit në Jeruzalem, **aktivitetet e templarëve nuk u ndërprejnë. Shumica e templarëve ikën në lozhat e frankmasonëve që ishin aktive në Europë në atë kohë.** Udhëheqësi i templarëve, Mebeignac, me disa anëtarë të tjerë, gjetën strehim në Skoci, nën maskën e një





muratori me emrin Mac Benach. Mbreti skocez, Robert the Bruce, i mirëpriti ata dhe **i lejoi që të ushtronin ndikim të madh mbi lozhat masonike në Skoci.** Si rrjedhim, lozhat skoceze fituan rëndësi të madhe nga pikëpamja e mjeshtërisë dhe e ideve të tyre.

Sot masonët e përdorin me respekt të madh emrin Mac Benach. Masonët skocezë, që vazhduan trashëgiminë e templarëve, u kthyen në Francë shumë vjet më vonë dhe themeluan atje bazën e ritualit të njohur si Rituali Skocez.”<sup>8</sup>

Përsëri, “*Mimar Sinan*” paraqet shumë informata rreth marrëdhënieve mes templarëve dhe masonëve. Në një artikull të titulluar, “Templarët dhe Masonët”, konstatohet se **“ritualet e pranimit në Rendin e Templarëve janë të ngjashme me ato të frankmasonëve të sotëm.”**<sup>9</sup> Sipas të njëjtit artikull, ashtu sikurse në Masoneri, edhe anëtarët e Rendit të Templarëve e thërrasin njëri-tjetrin **“vëlla”**.<sup>10</sup> Nga fundi i artikullit, thuhet:

Rendi i Templarëve dhe organizatat e masonerisë kanë ndikuar tek njëri-tjetri në një masë të konsiderueshme. Madje edhe ritualet e tyre janë aq të ngjashme në këtë aspekt, si të ishin kopjuar nga templarët. Masonët, në masë të konsiderueshme, e identifikojnë veten si templarë dhe mund të thuhet se çdo gjë që shihet si **fshehtësi origjinale masonike është trashëguar, në një masë të rëndësishme, nga templarët.** E shprehur shkurtimisht, siç thamë në titullin e këtij eseje, mund të themi se pikënisja e artit mbretëror masonik dhe **vija sekrete e pranimit i takonte templarëve dhe pika përfundimtare i takonte frankmasonëve.**<sup>11</sup>

Përfundimisht themi, se është e qartë, që rrënjët e Frankmasonerisë shtrihen deri tek Rendi i Templarëve dhe se masonët kanë adoptuar filozofinë e këtij rendi. Vetë masonët e kanë pranuar këtë. Por sigurisht, çështja kryesore për shqyrtimin tonë është karakteri i kësaj filozofie. Pse templarët e lanë anash krishtërimin dhe u bënë një rend heretik? Çfarë i drejtoi ata drejt kësaj? Pse ata pësuan




një ndryshim të tillë në Jeruzalem? Çfarë ndikimi ka pasur në botë kjo filozofi, e marrë nga templarët, e cila duket qartë nëpërmjet veprimtarisë së Masonerisë?

## TEMLARËT DHE KABALA

Libri i shkruar nga dy masonë, Christopher Knight dhe Robert Lomas, me titull "*Çelësi i Hiramit*" shpalos disa fakte të rëndësishme mbi rrënjët e Frankmasonerisë. Sipas këtyre autorëve, është e dukshme që masoneria është vazhdimësi e templarëve. Veç kësaj, autorët gjithashtu ekzaminojnë edhe origjinën e templarëve.

Sipas tezës së tyre, templarët pësuan një ndryshim të madh, gjatë kohës që ishin në Jeruzalem. Në vend të krishtërit, ata adoptuan doktrina të tjera. Në zanafillën e kësaj gjendet një e fshehtë që ata e zbuluan në Tempullin e Solomonit në Jeruzalem, nën gërmadhat e të cilat ata kryenin kërkime.



*The Hiram Key: Pharaohs, Freemasons, and the Discovery of the Secret Scrolls of Jesus*

Shkrimtarët shpjegojnë se templarët përdornin si pretekst rolin e tyre si mbrojtës të pelegrinëve të krishterë që vizitonin Palestinën, por qëllimi i tyre i vërtetë ishte krejtësisht tjetër.

...Nuk ka fakte që templarët t'i kenë mbrojtur ndonjëherë pelegrinët, madje nga ana tjetër shumë shpejt u gjetën provat përfundimtare se ata kishin bërë gërmime masive nën gërmadhat e Tempullit të Herodit...<sup>12</sup>

Autorët e librit "*Çelësit të Hiramit*" nuk ishin të vetmit që kishin gjetur dëshmi për këtë gjë. Historiani francez Geatan Delaforge bën një pohim të ngjashëm:



“Detyra e vërtetë e nëntë kalorësve ishte, që të bënin hulumtimin e rajonit, në mënyrë që të fusnin në dorë reliktet dhe dorëshkrimet origjinale që përmbanin thelbin e traditave sekrete të judaizmit dhe të Egjiptit të Lashtë”.<sup>13</sup>

Nga fundi i shekullit XIX, Charles Wilson, një nga Inxhinierët Mbretërorë, filloi kërkimet arkeologjike në Jeruzalem. Ai arriti në mendimin se templarët kishin shkuar në Jeruzalem, që të studionin gërmadhat e tempullit. Wilsoni gjeti gjurmët e gërmimeve nën themelet e tempullit dhe arriti në përfundimin se këto gërmime ishin bërë me vegla që iu përkisnin templarëve. Këto vegla janë ende në koleksionin e Robert Brydonit, i cili zotëron një arkiv të gjerë informacioni në lidhje me templarët.<sup>14</sup>

Autorët e “Çelësit të Hiramit” sjellin dëshmi se gërmimet e templarëve nuk kanë qenë pa rezultate: se rendi zbuloi në Jeruzalem disa relike, gjë që ndryshoi pikëpamjet e tyre për botën. Veç kësaj, shumë hulumtues janë të njëjtë mendim, që ka patur diçka, e cila i ka çuar templarët, të adoptojnë një sistem besimi dhe filozofie krejtësisht tjetër nga ai i Krishtërit dhe të mbajnë mesha heretike e të kryejnë rituale të magjisë së zezë, pavarësisht nga fakti se ata më herët ishin të krishterë dhe të ardhur nga pjesa e krishterë e botës.

Sipas mendimeve të shumë hulumtuesve, kjo “diçka” ishte **KABALA**. Enciklopeditë dhe fjalorët e përkufizojnë Kabalan si një degë mistike dhe sekrete të fesë çifute. Sipas këtij përkufizimi, Kabala shqyrton domethënien e fshehtë të Torës (Teuratit) dhe shkrimeve të tjera fetare çifute. Por, kur e shqyrtojmë çështjen më nga afër, dalin në shesh fakte që tregojnë plotësisht diçka tjetër. Këto fakte na shpjen në përfundimin se në Kabala ishin përfshirë, **burimet e mësimeve të idhujtarisë pagane, që kanë ekzistuar para Teuratit dhe që janë përhapur në Judaizëm pasi u shpall Teurati.**


## A TEMPLAR-MASON TEMPLE: ROSSLYN CHAPEL


The church known as "Rosslyn Chapel" near Edinburgh in Scotland is recognized as a symbol of the heretical pagan beliefs of the Templars. In the course of the construction of this edifice, Masons and Rosicrucians, the successors of the Templars, were employed, and decorated the whole chapel with symbols representative of their pagan philosophy.

In a publication of Turkish Masonry, the magazine *Mimar Sinan*, the Masonic origins and the pagan elements of the chapel are described in these words:

The most convincing proof of the unity of the Templars and the Masons in Scotland is the castle and chapel in the village of Roslin, 10 km. south of Edinburgh and 15 km. from the ancient Templar center at Balantrodach. The Templars lived in this region and in this castle especially after 1312 under the protection of the Barons of St. Clair.

...The chapel was built between 1446-48 by Sir William St. Clair who was one of the most prominent nobles of the time in Scotland and even in Europe. Masons and Rosicrucians worked on the construction. The chief architect of the work was the Templar Grand Master, Sir William St. Clair who brought itinerant mason architects and stone masons from every part of Europe. New houses were built in the near-by village of Roslin and a lodge was opened...





Rosslyn Şapeli'nin günümüzdeki hali ve Şapel'deki pagan (putperest) sembollerden bir örnek.

The plan and decoration of the chapel is unique. There is no other such example in Scotland or even Europe. It captured the atmosphere of Herod's temple very well and every part of it was decorated

with Masonic symbols. Among the symbols were reliefs on the walls and arches depicting the heads of Hiram and his murderer, a relief of an initiation ceremony, the keystones of the arches, and compasses. Apart from the fact that the chapel was constructed in a marked pagan style with Egyptian, Hebrew, Gothic, Norman, Celtic, Scandinavian, Templar and Masonic architectural elements, and that it contains very rich examples of stone work, one of the most interesting aspects of it is that the tops of the columns are decorated with cactus and corn motifs, besides various other plants figures. ...

There are so many pagan decorative elements inside the chapel that a priest, writing an account of the baptism he performed of the Baron of Rosslyn in 1589 complained, "because the chapel is filled with pagan idols, there is no place appropriate to administer the Sacrament. In August 31, 1592, as a result of pressure exerted on Baron Oliver St.Claire of Rosslyn, the chapel's pagan-style altar was destroyed. (Tamer Ayan, "The Oldest Known Masonic Institution-the Scottish Royal Order," *Mimar Sinan*, 1998, No.110, pp.18-19)



15	10	5	0	5	10	15	20
1	5	10	15	20	25	30	35
10	20	30	40	50	60	70	80
15	30	45	60	75	90	105	120
20	40	60	80	100	120	140	160
25	50	75	100	125	150	175	200
30	60	90	120	150	180	210	240
35	70	105	140	175	210	245	280
40	80	120	160	200	240	280	320
45	90	135	180	225	270	315	360
50	100	150	200	250	300	350	400
55	110	165	220	275	330	375	420
60	120	180	240	300	360	400	440
65	130	195	260	325	390	430	480
70	140	210	280	350	420	460	520
75	150	225	300	375	450	490	560

Rama, hujus metalli species  
est, qualem, nunci nos  
non videmus in ista regione  
ferrulita, dicitur hic videtur  
inhibita, est 259, et numerus  
non 9, quam emittit in  
inhibitis referunt, etiam in  
nihilis metallis fuerit, quod  
iam Cheli vel beniginitas  
de eternum Sub 106 et Roch, allegorice capere

Page 477

Sicut animalia venunt naturaliter, coloris et nomini in pueris  
applicatis metallis ipsis, ad naturam mineralitatis, et propri-  
etantibus, qui hic naturam humanam in se habent, ita non sunt  
hujus rei, sed sunt filii columbae Genesij 14. 22. 23. 24.  
25. 26. 27. 28. 29. 30. 31. 32. 33. 34. 35. 36. 37. 38. 39. 40.  
31. 32. 33. 34. 35. 36. 37. 38. 39. 40. 41. 42. 43. 44. 45. 46. 47. 48. 49. 50.  
et verum calcatus nam, dicitur in capite ad huc  
et intelligentia tur opta. In facie ut in oculis, oculis  
etiam et ipsis non est, ad huc in oculis, in oculis  
faciat, qui alius, et rural agitata videtur, ut hic dicitur  
mineralium, colorum Rom. 23. 4. 5. et dicitur, allegorice capere

Page 477



Alcabat

*Alcabat*

Oracion

Divine

*Divine*

Oracion

Traces remain in the Kabbalah, external to Judaism. These stem from the pagan beliefs of Ancient Egypt and Mesopotamia.



Ky fakt interesant për Kabalan është gjetur nga një burim mjaft interesant. Murat Ozgen, një mason turk, jep shpjegimin pasues në librin e tij “Çfarë është Masoneria dhe kujt i ngjan ajo?”

Nuk e dimë me qartësi se nga erdhi Kabala, apo si u zhvillua ajo. Por është emri i përgjithshëm për një filozofi unike, sekrete e mistike, e formuar në mënyrë metafizike dhe e lidhur veçanërisht me besimin fetar çifut. **Ajo pranohet si misticizëm çifut, por disa elemente përbërës të saj tregojnë se është përpiluar shumë më herët se Teurati.**<sup>15</sup>

Historiani francez Gougenot des Mousseaux shpjegon, se disa dogma që i përkasin Kabalas janë shumë më të vjetra se Judaizmi.<sup>16</sup>

Historiani çifut, Theodore Reinach, thotë se Kabala është “**një helm tinzar që depërton në damarët e judaizmit dhe e pllakos atë të tërin**”.<sup>17</sup> Salomon Reinach e përkufizon Kabalan si “një ndër lajthitjet më të dëmshme të mendjes njerëzore”.<sup>18</sup>

Arsyeja që Reinach pohon, se “**Kabala** është një ndër lajthitjet më të dëmshme të mendjes njerëzore”, vjen për shkak se një pjesë e madhe e kësaj doktrine përdoret nga njerëz të lidhur me magjinë. Për mijëra vite, Kabala ka qenë një nga gurët e themelit për çdo lloj rituali magjik. Besohet se disa rabinë që studiojnë Kabalan, posedojnë fuqi të mëdha magjike. Gjithashtu, shumë joçifutë kanë qenë të ndikuar nga Kabala dhe janë përpjekur, që të praktikojnë magjinë duke përdorur doktrinat e saj.

Tendencat e fshehta, që mbretëronin në Europë gjatë mesjetës së vonë, të praktikuar veçanërisht nga alkimistët, në pjesën më të madhe të tyre, i kanë rrënjët tek Kabala.

Gjëja e çuditshme këtu është se “Judaizmi është fe monoteiste, e cila ka filluar me shpalljen e Teuratis tek profeti Moisi (Musa) (paqja qoftë mbi të), por disa janë përpjekur të përfshijnë në këtë fe, një sistem i cili përdor praktikën bazë të magjisë, gjë që në fakt bie në



kundërshtim me moralin fetar. Faktet që paraqitëm më lart, demonstronë se disa paraqitje të Kabalas, faktikisht janë elemente që kanë hyrë në Judaizëm nga jashtë.

Por, cili është burimi i këtij elementi?

Historiani çifut Fabre d'Olivet thotë se Kabala ka ardhur nga Egjipti i lashtë. Sipas këtij shkrintari, **“rrënjët e disa paraqitjeve të Kabalas shtrihen deri tek Egjipti i Lashtë”**. Disa pjesë të mësimëve të Kabalas janë një traditë e mësuar nga disa prej udhëheqësve të izraelitëve në Egjiptin e Lashtë dhe janë transmetuar si traditë gojore nga gjenerata në gjeneratë.<sup>19</sup>

Për këtë shkak, duhet të shohim në Egjiptin e Lashtë, me qëllim që të gjejmë origjinën themelore të zinxhirit Kabala-Templarë-Frankmasonë.

## **MAGJISTARËT E EGJIPTIT TË LASHTË**

Egjipti i Lashtë i faraonëve ishte një ndër qytetërimet më të lashta në botë dhe gjithashtu një ndër qytetërimet më shtypëse. Monumentet përrallore - piramidat, sfinksat dhe obeliskët - që kanë mbetur ende që nga koha e Egjiptit të Lashtë janë ndërtuar nga qindra mijëra skllëvër, të cilët kanë punuar deri në prag të vdekjes, nën fshikullimat e kamzhikëve dhe kërcënimit të vdekjes nga uria. Faraonët, si sundues absolutë në Egjipt, dëshironin ta paraqisnin veten si hyjni dhe të adhuroheshin nga njerëzit. (Padyshim Allahu është mbi gjithçka).

Një ndër burimet tona për Egjiptin e Lashtë janë vetë mbishkrimet e tyre. Këta u zbuluan në shekullin XIX dhe pas një pune intensive u deshifrua alfabeti egjiptian, duke nxjerrë në dritë informacion të shumtë për këtë vend. Por për arsye se mbishkrimet ishin shkruar nga historianët zyrtarë të shtetit, ato ishin të mbushura me të dhëna të njëanshme të planifikuara për të lavdëruar shtetin.

Për ne, natyrisht, burimi më i sigurt për këtë çështje është Kur'ani.







An Ancient Egyptian hieroglyphic script

Në Kur'an, në tregimin mbi Moisiun jepen të dhëna të rëndësishme për sistemin e Egjiptit. Ajetet zbulojnë se në Egjipt ishin dy pika qendrore qeverisjeje: Faraoni dhe Këshilli i tij i Brendshëm. Ky këshill ushtronte një ndikim të fortë mbi faraonin, pasi faraoni shpesh këshillohej me ta dhe kohë pas kohe ai ndiqte sugjerimet e tyre. Ajetet e mëposhtme tregojnë ndikimin që ky Këshill kishte mbi faraonin dhe Allahu e di më mirë:

**Musai tha: O faraon, s'ka dyshim, unë jam i dërguar prej Zotit të botëve".**

**Është dinjitet për mua ta them për All-llahun vetëm të vërtetën. Unë u kam ardhur me argumente nga Zoti juaj, lejoi pra beni israilët të vijnë me mua!"**

**Ai (faraoni) tha: "Nëse ke ardhur me ndonjë argument, dhe nëse je ai që thua, na trego pra atë argument".**

**Ai (Musai) e hodhi shkopin e vet, kur ja, u shfaq gjarpër i vërtetë.**

**Dhe e nxori dorën e vet, kur qe, për shikuesit dritë e bardhë.**

**Rrethi i parisë nga populli i faraonit tha: "Ky nuk është tjetër pos magjistar i përsosur". Ai dëshiron t'ju nxjerrë prej tokës suaj: "E**



The most important supporters of Pharaoh's regime in Ancient Egypt was the priestly class (magicians). Their beliefs later formed the roots of the Kabbalah and were transmitted from there to Masonry.

çka më urdhëroni (propozoni ju)?" Ata (krerët) thanë: "Ndale atë dhe vëllanë e tij, e dërgo nëpër qytete tubues (të magjistarëve). Të sjellin çdo magjistarë të dijshtëm (të aftë). Kur'an (7: 104-112)

Këtu mund të vërehet qartë se referimi është për një këshill që këshillon faraonin dhe i rekomandon atij metoda të caktuara, që e nxitin atë kundër Moisiut. Nëse shqyrtojmë dokumentet e historisë egjiptiane, vërejmë se dy komponentët themelorë të këtij këshilli ishin ushtria egjiptiane e kohës dhe priftërinjtë.

Pozita e zënë nga kleri, njëri prej këtyre dy blloqeve të fuqishme, kishte një rëndësi shumë të madhe në rendin shoqëror të Egjiptit të atëhershëm.

Priftërinjtë në Egjiptin e Lashtë ishin një klasë, së cilës Kur'ani iu

referohet si magjistarë. Ata përfaqësonin kultin, i cili përkrahte regjimin. Besohej se ata kishin fuqi të veçantë dhe se posedonin njohuri të fshehta. Me këtë autoritet, ata kishin ndikim tek populli i Egjiptit dhe siguronin pozitën e tyre brenda administratës së faraonëve. Kjo klasë, e njohur nga dokumentet egjiptiane si “Priftërinjtë e Amonit”, e përqëndronte vëmendjen në praktikimin e magjisë dhe në administrimin e kultit të tyre pagan; veç kësaj, ata gjithashtu studionin edhe shkencë të ndryshme, si: astronominë, matematikën dhe gjeometrinë.

Kjo klasë e priftërinjve ishte një rend i mbyllur që posedonte (siç mendonin ata) dituri të veçantë. Rende të tilla njihen përgjithësisht si organizata të fshehta. Sipas një reviste të quajtur “Revista e masonëve”, publikim që shpërndahet ndërmjet masonëve turq, tregohet se rrënjët e frankmasonizmit e kanë origjinën tek këto lloj rendesh sekrete dhe bëhet një referencë e veçantë për priftërinjtë e Egjiptit të Lashtë:

Ndërkohë që tek qeniet njerëzore, krahas mendimit zhvillohet njëkohësisht edhe shkencë e me zhvillimin e shkencës **rritet edhe numri i fshehtësive brenda njohurive të një sistemi sekret**. Në këtë zhvillim, kjo iniciativë e fshehtë, e cila formonte bazën e njohurive të klerit, nisi fillimisht në Lindje, në Kinë e Tibet dhe më pas **u përhap në Indi, Mesopotami dhe Egjipt, ku u praktikua për mijëra vjet dhe krijoi themelin e fuqisë së priftërinjve të Egjiptit.**<sup>20</sup>

Por si mund të ekzistojë atëherë një lidhje mes filozofisë sekrete të priftërinjve të Egjiptit të Lashtë dhe frankmasonëve të sotëm? A mundet Egjipti i Lashtë, i cili është zhdukur para mijëra vjetëve dhe siç shpjegohet në Kur’an ai është një shembull klasik i një sistemi ateist politik, të ketë ndonjë ndikim në ditët e sotme.

Për të gjetur përgjigjet e këtyre pyetjeve, duhet të hedhim një vështrim të vëmendshëm në besimin e priftërinjve të Egjiptit të Lashtë mbi origjinën e universit dhe të jetës.



The "world-view" of Ancient Egypt did not remain buried with these statues, but was carried down to the present day. By those secret societies that see themselves as the heirs of Ancient Egypt...

## BESIMI I EGJIPTIANËVE TË LASHTË NË EVOLU- CIONIN MATERIALIST

Në librin e tyre *"Çelësi i Hiramit"*, autorët anglezë Christopher Knight dhe Robert Lomas, argumentojnë se Egjipti i Lashtë luan një rol shumë të rëndësishëm përse i përket origjinës së Masonerisë. Sipas këtyre autorëve, ideja më e rëndësishme dhe e gabuar që u përhap nga Egjipti i Lashtë në masonerinë moderne është se gjithësia ekziston vetvetiu dhe se ajo evoluon rastësisht. Ata e shpjegojnë këtë këndvështrim me këto fjalë:

Egjiptianët besonin se materia kishte ekzistuar gjithmonë dhe për ta ishte e palogjikshme të mendonin për një Zot, i Cili mund të krijonte diçka nga asgjëja absolute. Pikëpamja e tyre ishte, se bota filloi të ekzistonte, kur nisi të ndahej rregulli nga kaosi dhe që prej atëherë ka patur një betejë të vazhdueshme mes forcave të organizimit dhe të shkatërrimit... Kjo gjendje kaotike quhej Nun dhe sipas përshkrimeve sumeriane..., "gjithçka ishte një errësirë totale, një humnerë e lëngët, pa diell, që zotëronte një fuqi, një forcë kreative brenda saj, që e urdhëroi rregullin të krijohet. Kjo forcë e heshtur që ishte brenda substancës së kaosit, nuk e dinte që ekzistonte; ajo

**ishte një probabilitet, një potencial që ishte ndërthurur brenda rastësisë së kësaj parregullsie.** <sup>21</sup>

Do të shihet se besimet e përshkruara këtu janë në harmoni me pohimet e gabuara të rendit të sotëm materialist, që promovohen nga programet e komunitetit shkencor, me terma të tillë si “teoria e evolucionit”, “teoria e kaosit” dhe “organizimi thelbësor i materies”. Knight dhe Lomas vazhdojnë diskutimin e tyre të mëparshëm duke thënë:

Për çudi, ky përshkrim i krijimit, përshkruan në mënyrë të përsosur pikëpamjet që mbron shkencë bashkëkohore, e posaçërisht “teorinë e kaosit”, e cila paraqet modele të ndërlikuara që evoluojnë dhe përsëriten matematikisht brenda ngjarjeve krejtësisht të pastrukturuara. <sup>22</sup>

Knight dhe Lomas pohojnë se ka një harmoni mes besimeve të gabuara të egjiptianëve të lashtë dhe shkencës moderne, por ajo që nënkuptojnë ata me shkencë moderne janë disa koncepte materialiste të gabuara si Teoria e Evolucionit dhe ajo e Kaosit. Pavarësisht nga fakti se këto teori të gabuara nuk kanë bazë shkencore, ato i janë imponuar me forcë fushës së shkencës gjatë dy shekujve të kaluar dhe janë paraqitur si të vërtetuara shkencërisht. (Në paragrafët e ardhshëm do të shqyrtojmë personat që ia imponuan këto teori botës shkencore).



Tani, në këtë stad të librit, kemi arritur në një pikë të rëndësishme. Le të përmbledhim shkurtimisht çfarë kemi zbuluar deri më tani:

E filluam debatin me Rendin e Templarëve që mendohet të jetë origjina e Masonerisë. Pamë se, edhe pse Rendi i Templarëve u themelua si një rend i krishterë, templarët u ndikuan nga disa doktrina sekrete që i zbuluan në Jeruzalem dhe u shndërruan në një organizatë antifetare që praktikonte rite heretike, duke e braktisur plotësisht krishtërimin.

Kur pyetëm se cila ishte doktrina që ndikoi tek templarët, zbuluam se në parim kjo doktrinë ishte Kabala.

Kur shqyrtuam Kabalan, gjetëm prova, se pavarësisht faktit që ajo mund t'i ngjajë misticizmit çifut, ajo përmban gjurmë të një doktrine pagane më të vjetër se Judaizmi, e cila hyri më vonë në këtë fe dhe rrënjët e vërteta të saj janë gjetur në Egjiptin e Lashtë.

Egjipti i Lashtë qeverisej nga sistemi pagan i faraonëve dhe aty gjejmë idenë e gabuar, e cila përbën themelin e filozofisë ateiste moderne: **që gjithësia ekziston vetvetiu dhe se ajo evoluon rastësisht.**

E gjithë kjo, sigurisht, paraqet një këndvështrim interesant. A është e rastësishme që filozofia e priftërinjve të Egjiptit të Lashtë lulëzon ende dhe se pikërisht aty gjenden gjurmët e zinxhirit (Kabala-Templarë-Masoneri), që kanë qenë përgjegjës për ruajtjen e superioritetit të kësaj filozofie deri në ditët e sotme?

A është e mundur që masonët, të cilët kanë lënë gjurmët e tyre në historinë botërore që nga shekulli XVIII, duke nxitur revolucione, duke promovuar filozofi dhe sisteme politike, të jenë njëkohësisht trashëgimtarë të magjistarëve të Egjiptit të Lashtë?

Me qëllim që t'u jepet një përgjigje sa më e qartë këtyre pyetjeve, së pari, duhet të shqyrtojmë më nga afër ngjarjet historike që deri tani i kemi përmendur shkurtimisht.



## -II-

# HISTORIA E FSHEHTË E KABALAS

“E

ksodi” është titulli i librit të dytë të Teuratit. Ky libër përshkruan se si izraelitët të udhëhequr nga Moisiu, u larguan nga Egjipti dhe shpëtuan nga tirania e Faraonit. Faraoni i kishte shfrytëzuar izraelitët si robër dhe nuk do të lejonte t’i linte të lirë ata. Por, kur u ballafaqua me mrekullitë e Zotit, të sjella nëpërmjet Moisiut dhe shkatërrimet, që Ai u shkaktoi njerëzve të tij, Faraoni lëshoi pe. Kështu, një natë izraelitët u bashkuan në grup dhe filluan emigrimin e tyre nga Egjipti. Më vonë, faraoni sulmoi izraelitët, por Zoti i shpëtoi ata me mrekullitë e mëtejshme, që solli nëpërmjet Moisiut.

Por është Kur’ani, ai në të cilin ne gjejmë të dhënat më të sakta të eksodit nga Egjipti, pasi Teurati ka pësuar ndryshime të mëdha në tekst, që nga koha kur i është shpallur Moisiut. Një provë e rëndësishme për këtë është, se në 5 librat e Teuratit: Gjenezja, Eksodi,



The statue that the Jews worshipped when they departed from their true religion was, according to many researchers, was an Egyptian idol made of gold in the form of a calf.

Levitikusi, Numrat dhe Deuteronomi, ka mjaft kundërthënie. Fakti që libri i Deuteronomisë përfundon me tregimin e vdekjes dhe varrimit të Moisiut është dëshmi e padiskutueshme se ajo pjesë duhet të jetë shtuar pas vdekjes së Moisiut.

Në Kur'an, tregimi për eksodin e izraelitëve nga Egjipti, është treguar me detaje dhe me shumë saktësi. Ashtu si edhe në të gjitha historitë e tjera të Kur'anit Zoti zbulon shumë urtësi dhe sekrete gjatë rrëfimit. Për këtë arsye, kur besimtarët i shqyrtojnë me hollësi këto histori, mund të nxjerrin prej tyre një sërë mësimesh.

## VIÇI I ARTË

Një nga faktet më të rëndësishme, siç tregohet në Kur'an, përsa i përket eksodit të izraelitëve nga Egjipti, është se disa prej tyre kundërshtuan fenë që u shpall atyre nga Zoti, pavarësisht nga fakti se Zoti, nëpërmjet Moisiut, i kishte shpëtuar ata nga tirania e Faraonit. Disa nga Izraelitët nuk ishin të aftë ta kuptonin monoteizmin që Moisiu u transmetoi atyre dhe vazhdimisht ishin të prirur në drejtim të idhujtarisë.

Kur'ani e përshkruan kështu këtë prirje të çuditshme:

**Beni israilët i kaluam përtej detit, e ata u takuan me një popull që adhuronte disa statuja të tyre dhe thanë: "O Musa, na e bëj edhe ne një zot (statujë) si zotat që kanë ata (ai popull)". Ai (Musai) tha: "Ju jeni popull që nuk dini". Vërtet, ai popull (që po adhuron idhuj)**



**është i shkatërruar në atë (adhurim) dhe ajo që vepruan është e asgjësuar (s'ka dobi). Kur'an ( 7: 138-139)**

Pavarësisht paralajmërimit të Moisiut, disa izrealitë vazhduan në këtë kokëfortësi dhe kur Moisiu i la, për t'u ngjitur në malin Sinai, ata e shfaqën haptazi mosbesimin e tyre në një Zot. Duke përfitur nga mungesa e Moisiut, një burrë i quajtur Samiri mori komandën. Ai shfrytëzoi prirjen e disa izraelitëve drejt idhujtarisë dhe i bindi të ndërtonin statujën e një viçi dhe ta adhuronin atë.

**Musai u kthye te populli i vet i hidhëruar e i pikëlluar dhe tha: "O populli im, a nuk u premtoi juve Zoti juaj premtim të mirë. A mos u bë kohë e gjatë e ju e harruat premtimin, ose dëshiruat t'iu godasë hidhërimi nga Zoti juaj, prandaj e thyes besën që ma keni dhënë?" Ata thanë: "Ne nuk e thyem besën tënde me dëshirën tonë, por ne ishim ngarkuar me barrë të rënda nga stilitë e popullit e i hodhëm ato (në zjarr), e ashtu i hodhi edhe Samirija".**

**E ai (Samirija) ua mbaroi atyre një viç me trup që pëlliste, e ata thanë: "Ky është zoti juaj dhe Zoti i Musait, po ai (Musai) e ka harruar". Kur'an ( 20: 86- 88)**

Por pse ekzistonte kjo prirje për devijim në mesin e Izraelitëve dhe përse ata kishin tendencë, që të ndërtonin idhuj e t'i adhuronin ata? Cili ishte burimi i kësaj prirjeje?

Kjo është shumë e qartë, pasi një shoqëri që nuk ka besuar asnjëherë tek idhujt, nuk mundet që papritur të përvetësojë në sjellje kaq të pakuptimtë, siç është ndërtimi i një idhulli dhe adhurimi i tij. Vetëm ata, për të cilët idhujtaria ishte një prirje natyrore, mund të besonin marrëzira të tilla. Megjithatë, izraelitët ishin popull që kishin besuar në një Zot, që nga ditët e paraardhësit të tyre Abrahamit. Emri "Izraelitë" apo "Bijtë e Izraelit", së pari, iu dha djemve të Jakobit, nipit të Abrahamit e më vonë të gjithë çifutëve që kanë rrjedhur nga ai. Izraelitët e kishin ruajtur besimin monoteist, që kishin trashëguar nga paraardhësit e tyre: Abrahami, Isaku dhe Jakobi (paqja qoftë mbi ta).





**Another Ancient Egyptian idol: Hathor, the golden calf.**

Së bashku me Jozefin (paqja qoftë mbi të), ata shkuan në Egjipt dhe e ruajtën monoteizmin e tyre për një kohë të gjatë, pavarësisht nga fakti se ata kishin jetuar në mesin e idhujtarëve egjiptianë. Nga tregimet që gjenden në Kur'an, na bëhet e qartë, se kur Moisiu erdhi tek izraelitët, ata ishin një popull që besonin në një Zot.

Shpjegimi i vetëm për këtë është, se pavarësisht faktit, që izraelitët përkrahnin besimin monoteist, disa prej tyre u ndikuan nga paganët që jetonin mes tyre dhe filluan t'i imitonin ata, duke e zëvendësuar fenë e zgjedhur për ta nga Zoti me idhujtarinë e popujve të tjerë.

Po ta hetojmë këtë çështje, nën dritën e fakteve historike, shohim se kulti pagan që ndikoi tek izraelitët ishte ai i Egjiptit të Lashtë. Një dëshmi e rëndësishme, që mbështet këtë përfundim, është se **viçi i**

artë, që izraelitët e adhuruan, ndërkohë që Moisiu ishte në malin Sinai, ishte në të vërtetë një imitim i idhujve egjiptianë Hator dhe Afis. Në librin e tij: *“Shumë gjatë nën diell”*, autori i krishterë Richard Rives, shkruan:

Hatori dhe Afisi, zotat egjiptianë në formën e lopës dhe të kaut, ishin pjesë e adhurimit të diellit. Adhurimi i tyre ishte vetëm një periudhë e historisë së gjatë egjiptiane të adhurimit të diellit. Viçi i artë në malin Sinai është një dëshmi më se e mjaftueshme, që tregon se festa fetare ishte e lidhur me adhurimin e diellit...<sup>23</sup>



An Ancient Egyptian statue of Hator.

Ndikimi i fesë pagane egjiptiane tek disa izraelitë ndodhi në etapa të ndryshme. Sapo i takuan paganët, tek izraelitët filloi të shfaqej prirja drejt besimit heretik, ashtu siç thuhet edhe në këta ajete: **"O Musa, na e bën edhe ne një zot (statujë) si zotat që kanë ata (ai popull)"**. (Kur'an 7:138). Padituria e tyre në kërkesën që i bënë profetit: **"O Musa, ne nuk të besojmë ty derisa ta shohim All-llahun haptazi"** (Kur'an 2:55), tregon se ata ishin të prirur të adhuronin një qenie materiale, të cilën mund ta shihnin, të njëjtën gjë që dhe feja pagane u ofronte egjiptianëve.

Siç u vu në dukje, prirja e izraelitëve drejt paganizmit të Egjiptit të Lashtë, është e rëndësishme për të kuptuar dhe për të hedhur pak dritë mbi devijimin e tekstit të Teuratit dhe origjinës së Kabalas. Kur i shqyrtojmë me kujdes këto dy çështje, shohim se në zanafillën e tyre gjendet paganizmi i Egjiptit të Lashtë dhe filozofia materialiste.

## NGA EGJIPTI I LASHTË DERI TEK KABALA

Në kohën që Moisiu ishte ende gjallë, disa izraelitë filluan të krijonin idhuj të ngjashëm me ata që kishin parë në Egjipt dhe filluan t'i adhuronin ata. Pas vdekjes së Moisiut, ishte e vështirë të frenohej rrëshqitja e mëtejshme drejt zvetënimit. Natyrisht, që nuk mund të thuhet e njëjta gjë për të gjithë çifutët, por disa prej tyre pranuan paganizmin egjiptian. Në të vërtetë, ata vazhduan të zbatonin doktrinat e rreme të magjistarëve të faraonit, që u vunë në themel të besimeve të shoqërisë dhe e devijuan fenë e tyre me futjen e këtyre doktrinave në të.

Doktrina e rreme që u përhap nga Egjipti i Lashtë në Judaizëm, u fut gjithashtu edhe në Kabala. Kabala ishte një sistem sekret, ashtu siç ishte sistemi i priftërinjve egjiptianë, që bazohej në praktikimin e magjisë. Është interesant fakti, se Kabala jep të dhëna të ndryshme, nga ato të gjendura në Teurat. Është një vlerësim materialist, bazuar në idenë e gabuar të Egjiptit të Lashtë për ekzistencën e përhershme të materies. Murat Ozgen, një frankmason turk, flet kështu për këtë çështje:

Është mëse e qartë, se Kabala ishte formuluar shumë vjet para se të ekzistonte Teurati. Kapitulli më i rëndësishëm në Kabala është teoria mbi krijimin e gjithësisë. Kjo teori është shumë e ndryshme nga historitë mbi krijimin, të pranuar nga fetë monoteiste. Sipas Kabalas, në fillim të krijimit, erdhën në jetë krijesat e quajtura Sefiroth, që kanë kuptimin "rrathë" apo "orbita", me karakteristika materiale dhe shpirtërore. Numri i përgjithshëm i tyre ishte 32. Dhjetë të parat përfaqësonin sistemin diellor, ndërsa tjerat përfaqësonin grumbullin e yjeve në gjithësi. Kjo veçori e Kabalas tregon se ajo është e lidhur ngushtë me sistemin e lashtë astrologjik të besimit. Prandaj, Kabala është shumë larg besimit çifut dhe shumë më afër besimeve të lashta e misterioze të Lindjes.<sup>24</sup>



Çifutët, duke adoptuar këto doktrinave të fshehta dhe materialiste nga Egjipti i Lashtë, të cilat ishin të bazuara mbi magjinë, injoruan ndalesat e bëra në Teurat. Ata morën ritualet magjike nga popujt e tjerë paganë dhe në këtë mënyrë, Kabala u bë një doktrinë mistike brenda Judaizmit, por që binte në kundërshtim me Teuratin. Në librin e saj *"Shoqëritë sekrete dhe lëvizjet armiqësore"*, shkrimtarja angleze Nesta H. Webster thotë:

Magjia, siç e dimë, ka qenë e praktikuar nga kananitët para pushtimit të Palestinës nga izraelitët; Egjipti, India dhe Greqia gjithashtu kishin fallxhorët dhe parashikuesit e tyre të fatit. Pavarësisht mallkimeve kundër magjisë, që përmbante Ligji i Moisiut, **çifutët** duke mos i përfillur këto vërejtje, zunë të infektonin dhe të **përzienin traditën e tyre të shenjtë, të trashëguar brez pas brezi, me idetë për magjinë, të huazuara pjesërisht nga popujt e tjerë dhe pjesërisht të sajua nga vetë ata.** Në të njëjtën kohë, ana teorike e kabalas çifute, u huazua nga filozofia e Magive persianë, Neo-Platonistëve dhe Neo-Pitagoreanëve. Ja ku janë pra, disa arsye për pretendimet anti-kabaliste, se ajo që njohim ne në ditët e sotme si kabala nuk është krejtësisht me origjinë çifute.<sup>25</sup>

Ka një ajet në Kur'an që i referohet kësaj çështjeje. Zoti thotë se disa izraelitë, i mësuuan ritualet e magjisë satanike nga burime jashtë fesë së tyre.

...(e hodhën librin e Zotit) E ndoqën atë që thoshin djajtë në kohën e sundimit të Sulejmanit. Por Sulejmani nuk ishte i pafé, djajtë ishin të pafé, sepse u mësonin njerëzve magjinë. (Ndoqën) Edhe çka u zbriti në Babil dy engjëjve, Harutit dhe Marutit. E ata të dy nuk i mësonin askujt (magjinë) para se t'i thoshin: "Ne jemi vetëm sprovë, pra mos u bëj i pafé!" E mësonin (njerëzit) prej atyre të dyve atë (magji) me çka ndanin burrin prej gruas së vet, por pa lejen e All-llahut me atë askujt nuk mund t'i bënin dëm dhe ashtu mësonin çka u sillte dëm e nuk u sillte dobi atyre. E ata (jehuditë) e



**kanë ditur, se ai që (hodhi librin) e zgjodhi atë (magjinë), ai në botën tjetër nuk ka ndonjë të drejtë (në mëshirën e Zotit). Po ta dinin, ata se për ç'ka e shitën vetveten, ajo është shumë e keqe. (Kur'an 2: 102)**

Ky ajet tregon se disa çifutë, edhe pse e dinin se do ta humbnin veten në jetën e përtejme, e mësuan dhe e adoptuan praktikimin e magjisë. Kështu, ata iu shmangën Ligjit, që Zoti u kishte shpallur dhe duke shitur shpirtin e tyre, ranë në paganizëm (doktrinën magjike). “Ata e shitën vetveten” për një gjë të ligë, me fjalë të tjera, ata e braktisën fenë e tyre.

Faktet e rrëfyera me këtë ajet tregojnë veçoritë kryesore të një konflikti të rëndësishëm në historinë çifute. Kjo luftë ishte nga njëra anë, mes profetëve që Zoti u dërgoi çifutëve dhe çifutëve që u besuan atyre dhe nga ana tjetër, mes atyre çifutëve të zvetënuar që u rebeluan ndaj urdhrave të Zotit, duke imituar kulturën pagane të njerëzve që i rrethonin dhe duke ndjekur praktikën e tyre kulturore në vend të ligjeve të Zotit.

## **DOKTRINAT PAGANE TË SHTUARA NË TEURAT**

Gabimet e këtyre çifutëve të devijuar nga rruga e vërtetë, janë vënë shpesh në dukje edhe në vetë librin e tyre të shenjtë - Dhiatën e Vjetër. Në librin e Nehemias, një lloj libri historik brenda Dhiatës së Vjetër, çifutët pranojnë mëkatet dhe pendimin e tyre:

Pastaj, ata që kishin prejardhje izraelite e ndanë veten nga të gjithë të huajt; dhe qëndruan e pranuan mëkatet dhe ligësitë e paraardhësve të tyre. Ata mbajtën vendin e tyre dhe lexuan Librin e Ligjit të Zotit të tyre (për një të katërtën) e ditës; dhe të katërtën (tjetër) ata u lutën dhe adhuruan Zotin e tyre. Pastaj Jeshua, Bani, Kadmieli, Shebaniah, Buni, Sherebiah, Bani (dhe) Çenani qëndruan në shkallët e Levites dhe thirrën me zë të lartë Zotin e tyre.

...(Ata thanë:) “...ata (paraardhësit tanë) ishin të pabindur dhe



**mohues ndaj Teje, e flakën ligjin Tënd pas shpine dhe i vranë profetët e Tu, që dëshmuan kundër tyre për t'i kthyer ata tek Ti; dhe ata bënë provokime të shumta.** Prandaj Ti i dorëzove ata në duart e armiqve që i shtypën ata; dhe në kohë vështirësie, kur ata të thirrën Ty, Ti i dëgjove nga qielli; dhe prej Mëshirës Tënde të madhe, Ti iu dhe atyre lajmëtarë, që i shpëtuan nga duart e armiqve të tyre. Por edhe pas kësaj, ata prapë bënë ligësi para syve të Tu. Prandaj Ti i le ata në duart e armiqve të tyre, kështu armiqtë do të sundonin mbi ta; më vonë, kur ata u penduan dhe kërkuan ndihmën Tënde, Ti i dëgjove nga qielli dhe shumë herë i çlirove me mëshirën Tënde dhe dëshmove kundër tyre, që të mund t'i ktheje prapë në ligjin Tënd. Pastaj, ata përsëri vepruan me kryelartësi dhe nuk i përfillën urdhrat e Tua, e vazhduan të mëkatojnë ndaj vendimeve të Tua, të cilat nëse njeriu i bën, atëherë do të jetojë me ta. Dhe ata rrudhën supet e tyre, u bënë kokëfortë dhe nuk dëgjuan.

...Prapëseprapë, me Mëshirën Tënde të madhe, nuk i ke shkatërruar krejtësisht ata dhe as nuk i ke braktisur, sepse Ti je Zoti, I Larti, Mëshirëploti.

Dhe për këtë, Zoti ynë, I Larti, I Fuqishmi! I Madhëruari Zot!... Ti (je) në gjithçka që na ka paraprirë neve. Ti ke vepruar besnikërisht, por ne kemi bërë punë të liga. **As mbretërit, as princat tanë, as priftërinjtë dhe as etërit tanë, nuk iu përmbajtën ligjit Tënd, as nuk i përfillën urdhrat e dëshmitë e Tua, të cilat i shfaqe kundër tyre.** Duke qenë se ata nuk të shërbyen Ty në mbretërinë e tyre, apo në gjithë gjërat e mira që Ti ua fale, apo në tokën e gjerë dhe të pasur që Ti ua caktove atyre; ata nuk u larguan nga punët e tyre të mbrapshta.“ (Nehemia 9: 2-4, 26-29, 31-35)

Ky fragment shpreh dëshirën që patën një numër çifutësh të cilët iu rikthyen besimit tek Zoti, por në rrjedhën e historisë së çifutëve, herë pas here fitonte forcë një tjetër segment, që filloi të dominonte mbi çifutët dhe që më pas, në një farë mase e shndërroi edhe vetë fenë. Për



këtë arsye, në Teurat dhe në librat e tjerë të Dhiatës së Vjetër, ekzistojnë elemente që e kanë prejardhjen nga doktrinat heretike pagane, si edhe të lartpërmendurit që synonin kthimin në fenë e vërtetë. Për shembull, (Zoti sigurisht e di më mirë, për gjithë këto shprehje): Në librin e parë të Teuratit, thuhet se Zoti e krijoi tërë gjithësinë për 6 ditë nga asgjëja. Kjo është e saktë dhe rrjedh nga shpallja origjinale. Por, pastaj thuhet se në ditën e shtatë Zoti pushoi, pohim që është krejtësisht i shpikur. Kjo është një ide e mbrapshtë që rrjedh nga paganizmi, e cila i atribuon Zotit veti njerëzore.

Në një ajet Kuranor, Zoti thotë:

**Ne krijuam qiejt e tokën dhe gjithçka ka ndërmjet tyre brenda gjashtë ditësh dhe Ne nuk ndiem lodhje. (Kur'an 50: 38).**

I Në pjesët e tjera të Teuratit, ekziston një stil të shkruari që nuk e respekton madhërinë e Zotit, sidomos në ato vende ku Atij në mënyrë të gabuar i atribuohen dobësi njerëzore. (Zoti, sigurisht, është larg asaj). Këto antropomorfizma janë bërë me qëllim që t'i atriboheshin Zotit dobësitë njerëzore, që paganët ua kishin mveshur zotave të tyre imagjinarë.

INjë blasfemi e tillë e ngjashme, është një deklaratë tjetër ku thuhet se Jakobi, paraardhësi i izraelitëve, luftoi me Zotin dhe fitoi. Kjo duket haptazi që është një histori e shpikur me qëllim që t'iu japë izraelitëve një superioritet racial, në rivalitet me ndjenjat raciste të përhapura mes paganëve (ose sipas fjalëve të Kur'anit "inatit fanatik").

I Në Dhiatën e Vjetër ka një tendencë për ta paraqitur Zotin, si një Zot kombëtar, se Ai është vetëm Zot i izraelitëve. Megjithatë, Zoti është Zot i gjithësisë dhe i gjithë qenieve njerëzore. Termi "fe kombëtare" në Dhjatën e Vjetër i korrespondon prirjes për paganizëm, ku çdo fis adhuronte zotin e vet.

I Në disa libra të Dhiatës së Vjetër (p.sh. Xhoshua), janë dhënë





urdhra që të ushtrohet dhunë e tmerrshme kundër njerëzve që nuk janë çifutë. Urdhërohet për vrasje masive, duke mos kursyer as femrat, as fëmijët dhe as të moshuarit. Kjo egërsi e pamëshirshme bie krejtësisht në kundërshtim me drejtësinë e Zotit dhe të kujton barbarizmat e kulturave pagane, që adhuronin zotat mistikë të luftës.

Këto ide pagane, që u futën në Teurat, duhet të kenë një origjinë. Mesa duket kanë qenë çifutët ata që kishin adoptuar, nderuar dhe lartësuar një traditë që ishte e huaj për Teuratin duke e ndërruar më vonë atë dhe duke shtuar në të ide, të cilat rridhnin nga tradita që ata përqafulan. Origjina e kësaj tradite i ka rrënjët tek priftërinjtë e Egjiptit të Lashtë (magjistarët e regjimit të faraonëve). Kjo, në të vërtetë, ishte Kabala, e cila kishte arritur deri atje nga disa çifutë. Kabala mori një pamje, që i mundësoi doktrinës së Egjiptit të Lashtë dhe doktrinave të tjera pagane, të futeshin pa u diktuar në Judaizëm dhe të zhvilloheshin brenda tij. Kabalistët, natyrisht, pohojnë se Kabala thjesht shpjegon me më shumë detaje sekretet e fshehura të Teuratit, por në realitet, siç thotë një historian çifut i Kabalës, Theodore Reinach: Kabala përmban “një helm tinëzar që hyn në damarët e Judaizmit dhe e pllakos të tërin.”<sup>26</sup>


Atëherë është e mundur, që në Kabala të gjenden gjurmë të qarta të ideologjisë materialiste të Egjiptit të Lashtë.

## **DOKTRINA E RREME E KABALËS QË KUNDËRSH- TON FAKTET E KRIJIMIT**

Zoti në Kur'an tregon, se Teurati origjinal është një libër hyjnor që u dërgua si dritë për njerëzimin:

Ne e zbritëm Tevratin, në të cilin është udhëzimi i drejtë dhe drita. Sipas tij gjykuan pejgamberët që ishin të bindur, ndaj atyre që ishin jehudi, gjykuan edhe dijetarët e devotshëm e paria fetare, sepse ishin të obliguar ta ruanin librin e Allahut dhe ishin mbrojtës të tij... (Kuran 5: 44)





The Kabbalah's teaching about the origins of the universe and living things is a story replete with myths totally contrary to the facts of Creation revealed in holy books.

Prandaj, Teurati, sikurse Kur'ani, përmban njohuri dhe urdhëresa në lidhje me çështjet si: ekzistenca e Zotit, njëshmëria e Tij, cilësitë e Tij, krijimi i universit, qëllimi i krijimit të njeriut dhe dispozitat morale të Zotit për njerëzimin. (Por Teurati origjinal sot nuk është i ruajtur. Ajo çfarë kemi sot është një version "i ndryshuar" i Teuratis, nga dora njerëzore).

Ekziston një pikë e rëndësishme, ku që të dy, Teurati i vërtetë dhe Kur'ani e kanë të përbashkët: Zoti njihet si Krijues. Zoti është absolut dhe ka ekzistuar që nga fillimi i kohës. Çdo gjë tjetër, përveç Zotit është krijim i Tij, e krijuar prej Tij nga asgjëja. Ai ka krijuar tërë gjithësinë, trupat qiellorë, materien jo të gjallë, qeniet njerëzore dhe të gjitha qeniet e gjalla. Zoti është Një. Ai është i vetëm!

Edhe pse kjo është e vërteta, në Kabala është gjetur një interpretim shumë i ndryshëm, në atë "helm tinzar që hyn në damarët e Judaizmit dhe e pllakos të tërin". Doktrina e saj mbi Zotin i kundërvihet totalisht "faktit të krijimit" që gjendet në Teuratin e vërtetë dhe në Kur'an. Në një nga punimet mbi Kabalën, hulumtuesi amerikan, Lance S. Owens, paraqet pikëpamjet e tij në lidhje me origjinat e mundshme të kësaj doktrine (Zoti sigurisht e di më mirë për shprehjet në pjesën e mëposhtme):

Nga përvoja kabalistike kanë lindur shumë perceptime mbi hyjnoren, shumica e të cilave vijnë nga pikëpamjet ortodokse. Doktrina kryesore e besimit çifut ka qenë shpallja se "Zoti ynë është Një". Por Kabala pohon se derisa Zoti ekziston në formën më të lartë si njësi e pakrahasueshme - e quajtur nga Kabala "*Ein Sof - I paskajshmi*", kjo veçori e panjohur e kishte prejardhjen nga një numër i madh formash hyjnore; një shumicë zotash. Kabalistët e quajtën këtë Sefiroth, apo fytyrat e Zotit. Mënyra se si Zoti rrodhi nga një njësi e paimagjinueshme në shumicë, ishte një mister, të cilit kabalistët i kushtonin shumë meditime dhe spekulime. Siç duket qartë, ky imazh shumëfytyrësh i Zotit i pranon akuzat e të qenit politeist, akuza që ishin kundërshtuar me forcë nga kabalistët, edhe pse jo plotësisht me sukses.

Në filozofinë teologjike kabaliste, problemi nuk qëndron vetëm në hyjnitë e shumta, por sipas kësaj filozofie, në zanafillën e parë të saj, nga njësia e panjohur, Zoti kishte marrë formë të dyfishtë: si mashkull dhe si femër, baba dhe nënë hyjnore, *Hokhmah dhe Binah*, të

cilat ishin format e para të Zotit. Kabalistët përdorën metaforat e drejtpërdrejta gjinore për të shpjeguar se si marrëdhënia krijuese e *Hakmahut dhe Binahut* prodhoi krijimin e mëtejshëm...<sup>27</sup>

Një veçori interesante e kësaj teologjie mistike është se, sipas saj, qeniet njerëzore nuk janë të krijuara, por janë në një farë mënyre hyjnore. Owens e shpjegon kështu këtë legjendë:

Pasqyrimi kompleks i Hyjnisë... ishte gjithashtu e përshkruar nga Kabala si diçka që ka një formë unike, antropomorfe. Sipas një recensioni kabalist, Zoti ishte Adam Kadmon: prototipi i parë i njeriut primitiv. **Njeriu ndante së bashku me Zotin një shkëndijë hyjnore të pakrijuar të brendshme dhe një formë organike komplekse.** Ky ekuacion i cuditshëm i Adamit si Zot, mbështetej në shifra kabaliste: vlera numerike në hebraisht e emrave Adam dhe Jehova (Tetragramatoni, Yod he vav he), së bashku, ishte 45. Prandaj në interpretimin kabalist, Jehova barazohet me Adamin: Adami ishte Zot. Me këtë konfirmim zhvillohet edhe mendimi se e gjithë njerëzia, në kuptimin më të lartë, ishte si Zoti.<sup>28</sup>

Kjo teologji e shturur përbëhej nga një mitologji pagane dhe formonte bazën e degjenerimit të Judazimit. Disa çifutë kabalistë i thyen kufijtë e arsyes së zakonshme deri në atë masë, sa që u përpoqën t'i paraqisnin njerëzit si hyjni. Veç kësaj, sipas kësaj teologjie, jo i gjithë njerëzimi ishte hyjnor, por vetëm çifutët ishin të tillë; ndërsa popujt e tjerë nuk konsideroheshin njerëz. Si rrjedhojë, besimi tek një Zot i Vetëm e i Plotfuqishëm dhe shërbimi ndaj Tij, u zëvendësuan nga praktikat dhe besimet pagane. Këto besime të rreme çuan më vonë në ndryshimin e Teuratit dhe përfshirjes brenda tij të ideve të ndryshme, që ishin në kundërshtim me vlerat e vërteta morale fetare.

Çështja tjetër interesante, rreth doktrinave të ndryshuara në Kabala, është ngjashmëria e saj me idetë pagane të Egjiptit të Lashtë. Siç është diskutuar edhe më lart, egjiptianët e lashtë gabimisht besonin se materia ka ekzistuar gjithmonë: me fjalë të tjera, ata e mohonin

idenë se materia ishte krijuar nga asgjëja. Disa kapituj të Kabalas pohojnë të njëjtën gjë në lidhje me qeniet njerëzore. Ajo në mënyrë të gabuar pohon se qeniet njerëzore nuk janë të krijuara dhe se ato janë përgjegjëse për ekzistencën e tyre.

Për ta thënë në terma modernë: egjiptianët e lashtë ishin materialistë dhe doktrina e disa kapitujve të Kabalas, mund të quhet **HUMANIZËM LAIK** (jofetar).

Është interesant të theksohet se këto dy koncepte të gabuara - materializmi dhe humanizmi laik - përshkruajnë ideologjinë që ka dominuar pjesën më të madhe të botës në dy shekujt e fundit.

Është provokative të pyesësh nëse ekzistojnë forca që i kanë transmetuar doktrinat e Egjiptit të Lashtë dhe Kabalën, përgjatë historisë së vjetër deri në ditët e sotme.

## NGA TEMPLARËT TEK MASONËT

Kur përmendëm templarët, më lart, theksuam se ky rend i veçantë i luftëtarëve të kryqëzatave u ndikua nga një "e fshehtë" e zbuluar në Jeruzalem, si rezultat i së cilës ata braktisën krishtërimin dhe filluan të praktikojnë ritualet magjike. Thamë se shumë hulumtues ishin të mendimit se ky sekret ishte i lidhur me Kabalën. Për shembull shkrintari francez, Eliphaz Lévi, në librin e tij "*Historia e magjisë*" paraqet dëshmi të hollësishme, se templarët filluan të përdornin doktrinat misterioze të Kabalës pasi ata u trajnuan fshehurazi për këtë doktrinë.<sup>29</sup> Kështu, një doktrinë që i kishte rrënjët në Egjiptin e Lashtë u transmetua, tek templarët, përmes Kabalës.

Në librin "*Foucault's Pendulum*", novelisti i famshëm italian, Umberto Eco, në rrjedhën e komplotit rrëfen disa fakte. Gjatë gjithë novelës, ai përmes fjalëve të personazheve të tij, tregon se si templarët u ndikuan nga Kabala dhe se kabalistët, posedonin një sekret, gjurmët e të cilit të dërgonin tek faraonët e Egjiptit të Lashtë. Sipas Eco-s, disa



prej çifutëve më të spikatur i mësuan këta sekrete të marra nga egjiptianët e lashtë dhe më vonë, i futën ata në pesë librat e parë të Dhiatës së Vjetër (Pentateuch). Por ky sekret, që ishte transmetuar fshehurazi, mund të kuptohej vetëm nga kabalistët. (Zohari, i shkruar më vonë në Spanjë dhe që përbënte librin themelor të Kabalës, bie dakord me të fshehtat e këtyre 5 librave). Pasi u deklararua se kabalistët e lexuan këtë sekret të egjiptianëve të lashtë edhe në matjet gjeometrike të Tempullit të Solomonit, Eco shkruan se ky sekret u është mësuar templarëve nga rabinët kabalistë të Jerusalemit:

**E fshehta - çfarë thoshte Tempulli në tërësinë e tij – dyshohet se dihej vetëm nga një grup rabinësh që mbetën në Palestinë... dhe templarët e mësuan atë prej tyre.<sup>30</sup>**

Kur templarët e përvetësuan këtë doktrinë egjipto-kabaliste, natyrisht, ata hynë në konflikt me institucionin e krishterë që dominonte Europën. Këtë konflikt ata e ndanin me një forcë tjetër të rëndësishme - çifutët. Pasi templarët u arrestuan, me urdhrin e përbashkët të mbretit të Francës dhe të Papës më 1307, rendi kaloi në ilegalitet, por ndikimi i tij vazhdoi në mënyrë më të vendosur dhe më radikal.

Siç thamë më lart, një numër i konsiderueshëm templarësh arritën t'i shmangeshin arrestit dhe ata i bënë apel mbretit të Skocisë që të strehoheshin atje, pasi në atë kohë Skocia ishte e vetmja mbretëri që nuk e kishte pranuar autoritetin e Papës. Në Skoci, ata u infiltruan në shoqatën e muratorëve dhe me kalimin e kohës, e morën nën pushtetin e tyre.

Shoqatat adoptuan traditën e templarëve dhe në këtë mënyrë, në Skoci u mboll fara e Masonizmit. Ende në ditët e sotme, vija kryesore e Masonerisë është "Riti i lashtë dhe i pranuar skocez".

Siç e kemi shqyrtuar me hollësi në librin "*Rendi i ri masonik*", gjurmët e templarëve mund të vërehen që nga fillimi i shekullit XIV





**A model of Solomon's Temple. The Templars and Masons, because of their superstitious beliefs concerning the Prophet Solomon (pbuh), believe that there is a "secret" in this temple passed down from ancient pagan civilizations. It is for this reason that Masonic literature places so much emphasis on the temple of Solomon.**

dhe disa çifutë në etapa të ndryshme të historisë evropiane iu bashkëngjitën atyre. Pa hyrë thellë në detaje, po vëmë në dukje disa fakte nëpërmjet të cilave shqyrtojmë këtë çështje:

- Në Provencë, në Francë, gjendej një strehim i rëndësishëm i templarëve. Gjatë arrestimeve, shumë prej tyre u fshehën aty. Një veçori tjetër e rëndësishme e kësaj zone është se ajo është një ndër qendrat më të njohura të kabalizmit në Europë. Provenca është vendi ku tradita gojore e Kabalës u shkruajt si libër.

- Kryengritja fshatare në Angli, më 1381, sipas disa historianëve, ishte e nxitur nga një organizatë sekrete. Ekspertët që studiojnë historinë e Maserisë kanë rënë dakord se kjo organizatë sekrete ishin Templarët. Ajo ishte më shumë se një kryengritje e zakonshme fshatare, ishte një sulm i planifikuar mbi Kishën Katolike.<sup>31</sup>

- Gjysmë shekulli pas kësaj kryengritjeje, një klerik nga Bohemia,

i quajtur John Huss, filloi një kryengritje kundër Kishës Katolike. Prapa skenës së kësaj kryengritjeje ishin përsëri templarët. Për më tepër, Huss ishte shumë i interesuar për Kabalën. Avigdor Ben Isaac Kara ishte një ndër emrat më të rëndësishëm që kishte ndikuar në zhvillimin e doktrinave të tij. Kara ishte një rabin i komunitetit çifut në Pragë dhe një kabalist.<sup>32</sup>

Shembuj të tillë janë shenja të qarta se aleanca mes templarëve dhe kabalistëve kishte për synim që të ndryshonte rendin shoqëror të Europës. Ky ndryshim përfshinte një modifikim të kulturës themelore të krishterë të Europës dhe zëvendësimin e saj me një kulturë të bazuar në doktrinat pagane, siç ishte Kabala. Pas këtij transformimi kulturor, do të pasonin edhe ndryshimet në politikë. P.sh. revolucionet në Francë dhe Itali...

Në kapitujt e ardhshëm do të hedhim një sy mbi disa nga pikat më të rëndësishme që kanë bërë kthesë në historinë evropiane. Në çdo periudhë, fakti që do të na kundërvihet është se ekzistonte një forcë që dëshironte t'ia tjetërsonte Europës trashëgiminë e saj të krishterë dhe ta zëvendësonte atë me një ideologji laike; dhe me këtë program në mendje, të largonte njerëzit nga morali fetar. Kjo forcë tentonte që ta bënte Europën të pranonte një doktrinë që u transmetua nga Egjipti i Lashtë deri te Kabala. Siç kemi theksuar edhe më parë, bazë e kësaj doktrine ishin dy koncepte të rëndësishme: humanizmi dhe materializmi.

Së pari, të shqyrtojmë çështjen e humanizmit.






## -III-

### RISHQYRTIMI I HUMANIZMIT

"H

umanizmi" konsiderohet si një ide pozitive nga shumica e njerëzve. Ai të sjell ndërmend shprehje si: dashuria e njerëzimit, paqja dhe vëllazëria. Por, kuptimi filozofik i humanizmit është shumë më domethënës: humanizmi është mënyrë të menduari që e parashtron konceptin e humanitetit, si fokusin dhe qëllimin e tij të vetëm. Me fjalë të tjera, ai i thërret qeniet njerëzore që t'i largohen Zotit, Krijuesit të tyre dhe të shqetësohen për ekzistencën dhe identitetin e tyre. Një fjalor i zakonshëm e përkufizon humanizmin si: "Sistemi i mendimit që bazohet në vlerat, karakteristikat dhe sjelljen, që besohet të jenë më të mirat për qeniet njerëzore, sesa çdo autoritet mbinatyror".

Sidoqoftë, përkufizimi më i qartë i humanizmit, është paraqitur nga ata që e mbështetën atë. Një nga përfaqësuesit më të spikatur të humanizmit modern është Corliss Lamont. Në librin e tij *"Filozofia e humanizmit"*, ai shkruan:



**Today, humanism has become another name for atheism. One example of this is the enthusiasm for Darwin typical in the American magazine, *The Humanist*.**

Humanizmi beson se natyra ... përbën shumën totale të realitetit, se binomi materie-energji dhe jo mendja, është lënda bazë e universit dhe se qeniet e mbinatyrshme thjesht nuk ekzistojnë. Kjo mosekzistencë e të mbinatyrshmes, në nivel njerëzor, do të thotë se njerëzit nuk posedojnë shpirta të mbinatyrshëm e të pavdekshëm dhe në nivelin e gjithësisë si tërësi, se kozmosi ynë nuk posedon një Zot të mbinatyrshëm dhe të përjetshëm.<sup>34</sup>

Siç shihet, humanizmi është pothuajse i njëjtë me ateizmin. Këto pretendime ateiste përbëhen nga gabime dhe mashtrime të cilat, gjithashtu, janë kundërshtuar edhe nga shkenca.

Në shekullin e fundit, nga humanistët, u botuan dy manifeste të rëndësishme. I pari u publikua më 1933 dhe u nënshkrua nga disa personalitete të rëndësishme të asaj kohe. Dyzet vjet më vonë, më 1973, një manifest i dytë humanist u botua, si konfirmim i të parit, por që përmbante disa shtesa në lidhje me zhvillimet që kishin ndodhur ndërkohë. Shumë mendimtarë, shkencëtarë, shkrimtarë dhe anëtarë të mediave nënshkruan manifestin e dytë, i cili u përkrah nga Shoqata Amerikane e Humanistëve.

Kur shqyrtojmë këto manifeste, ne gjejmë të njëjtin themel bazë në secilin prej tyre: dogma ateiste dhe ide të gabuara si ato, që gjithësia dhe qeniet njerëzore nuk janë të krijuara por ekzistojnë në mënyrë të pavarur, që qeniet njerëzore nuk janë përgjegjës ndaj asnjë autoriteti tjetër përveç vetes së tyre, dhe se besimi në Zot e kishte vonuar zhvillimin e individëve dhe

shoqërive. Për shembull, gjashtë pikat e para të manifestit të parë humanist janë si më poshtë:

**E para:** Humanistët fetarë e konsiderojnë gjithësinë si vetë-ekzistuese e jo të krijuar.

**E dyta:** Humanizmi beson se njeriu është pjesë e natyrës dhe se ai është shfaqur si rezultat i një procesi të vazhdueshëm.

**E treta:** Duke patur një pikëpamje organike mbi jetën, humanistët konstatojnë se dualizmi tradicional i mendjes dhe trupit duhet të hidhet poshtë.

**E katërta:** Humanizmi pranon se kultura dhe civilizimi fetar i njeriut, siç është përshkruar qartë në antropologji dhe histori, janë produkt i një zhvillimi gradual që vjen si rrjedhojë e bashkëveprimit të tij me ambientin natyror ku jeton dhe me trashëgiminë e tij shoqërore. Individu i lindur në një kulturë të caktuar është i modeluar kryesisht nga ajo kulturë.

**E pesta:** Humanizmi pohon se natyra e universit e përshkruar nga shkencë bashkëkohore e bën të papranueshme çdo garanci mbinatyrore apo kozmike të vlerave njerëzore...

**E gjashta:** Ne jemi të bindur se ka kaluar koha e teizmit, deizmit, modernizmit dhe varieteteve të ndryshme të “mendimit të ri”.<sup>35</sup>

Në pikat e mësipërme, vërejmë shprehjen e një filozofie të përbashkët të rreme, që manifeston vetveten nën emra të tillë si materializëm, darvinizëm, ateizëm dhe agnosticizëm. Në pikën e parë, është parashtruar dogma materialiste e ekzistencës së përjetshme të gjithësisë. Pika e dytë, sikurse teoria e evolucionit, konstaton se njerëzit nuk janë të krijuar. Pika e tretë mohon ekzistencën e shpirtit të njeriut duke pohuar se qeniet njerëzore janë të përbëra nga materia. Pika e katërt propozon një “evolucion kulturor” dhe mohon ekzistencën e një natyre njerëzore, të paracaktuar në mënyrë hyjnor. Pika e pestë e hedh poshtë sovranitetin e Zotit mbi gjithësinë dhe njerëzimin

dhe e gjashta thotë se është koha që të refuzohet “teizmi”, që është besimi në Zot.

Do të vërehet se këto pohime janë mashtrime stereotipike, tipike e atyre qarqeve që janë armiqësorë kundrejt moralit të vërtetë fetar. Arsyeja për këtë është se humanizmi është themeli kryesor i mendimit antifetar. Kjo është për shkak se humanizmi është një shprehje e **“vlerësimit të njeriut, se ai do të lejohet që të kalojë pa u kontrolluar”** e cila ka qenë një nga bazat kryesore, gjatë gjithë historisë, për mohimin e Zotit. Në një ajet të Kur’anit, Zoti thotë:

**A mos mendon njeriu se do të lihet pa kurrfarë përgjegjësie. A nuk ka qenë ai një pikë sperme që derdhet. E pastaj u bë gjak i trashë, e Ai e krijoi dhe e përsosi? Dhe prej tij Ai i bëri dy lloje: mashkullin dhe femrën. A nuk është Ai (Zot) i fuqishëm që i ngjall të vdekurit? (Kur’an 75: 36-40)**

Zoti thotë se njerëzit nuk do të “lejojnë të shkojnë pa dhënë llogari” dhe i përkujton ata menjëherë se janë krijesa të Tij. Kjo pasi, kur një person e kupton, që është krijesë e Zotit, ai e kupton se nuk është i "pakontrolluar", por është përgjegjës para Tij.

Për këtë arsye, ideja e gabuar se qeniet njerëzore nuk janë krijuar është bërë doktrina themelore e filozofisë humaniste. Dy pikat e para të manifestit të parë humanist japin një pasqyrim të kësaj doktrine. Për më tepër, humanistët janë të mendimit se shkenca i mbështet pretendimet e tyre.

Sidoqoftë, ata e kanë gabim. Që nga koha kur u botua Manifesti i Parë, dy kushtet paraprake që humanistët i paraqitën të supozuara si fakte shkencore kanë dështuar:

**Ideja e gabuar që universi është i përjetshëm u shfuqizua nga një seri zbulimesh astronomike që u bënë pas shkrimit të Manifestit të Parë Humanist.**

Zbulime të tilla si fakti, që universi po zgjerohet, e rrezatimit të errësirave kozmike dhe llogaritja e raportit të hidrogjenit në helium, treguan



se gjithësia kishte një fillim, dhe se ajo erdhi në jetë nga asgjëja para 15-17 miliardë vjetësh nga një shpërthim gjigand i quajtur "Big Beng. Edhe pse ata që e përkrahnin filozofinë humaniste dhe materialiste nuk ishin të gatshëm ta pranonin teorinë e Big Bengut, përfundimisht s'mbeti veçse të bindeshin për këtë. Si rezultat i të dhënave shkencore që dolën në dritë, komuniteti shkencor e pranoi përfundimisht teorinë e Big Bengut, d.m.th, se gjithësia kishte një fillim dhe si rrjedhim humanistëve nuk u mbeteshin më argumente për këtë. Kjo vihet re edhe në fjalët e filozofit britanik Antony Flew:

... Ateistët Stratonicianë duhet ta ndjejnë veten në siklet nga konsensusi bashkëkohor kozmologjik. Për këtë, duket se kozmologët janë duke siguruar një provë shkencore për atë që Shën Thomasi pretendonte se nuk mund të provohej filozofikisht, pra se gjithësia kishte një fillim...<sup>36</sup>

**2. Teoria e evolucionit, e ashtuquajtura arsytim shkencor pas Manifestit të Parë Humanist, filloi ta humbasë terren disa dekada pasi u shkruajt.** Është i njohur në ditët e sotme fakti, se skenari i propozuar mbi origjinën e jetës nga evolucionistët ateistë (pa dyshim edhe humanistë), siç ishte A. I. Oparin dhe J. B. S. Haldane në vitin 1930, nuk ka vlerë shkencore; pasi qeniet e gjalla nuk mund të lindin spontanisht nga materia jo e gjallë, siç ishte propozuar nga ky skenar. Të dhënat mbi fosilet tregojnë se qeniet e gjalla nuk u zhvilluan përmes një procesi ndryshimesh të vogla kumulative, por u shfaqën menjëherë me karakteristikat e tyre dalluese dhe ky fakt ishte përkrahur nga vetë paleontologët evolucionistë që në vitet '70. Biologjia moderne ka treguar se qeniet e gjalla nuk janë rezultat i rastit dhe ligjeve natyrore, por se në çdo organizëm ekzistojnë sisteme komplekse që janë dëshmi të krijimit. (Për më shumë detaje shihni librin e Harun Yahya-së "Përgënjeshtrimi i Darwinizmit: Si rrënohet teoria e evolucionit nën dritën e shkencës moderne").

Për më tepër, pretendimi i gabuar se besimi fetar ishte faktori që





pengoi njerëzimin nga përparimi dhe që e udhëhoqi në konflikt, është përgënjeshtuar nga përvoja historike. Humanistët pretendonin se distancimi nga besimi fetar do t'i bënte njerëzit të lumtur dhe të lirë, e megjithatë është dëshmuar të jetë e kundërta. Gjashtë vjet pas botimit të Manifestit të Parë Humanist, filloi Lufta e Dytë Botërore dhe katastrofa të paimagjinuara u bënë në botë nga ideologjia laike fashiste. Ideologjia humaniste e komunizmit u shfry me një egërsi të pashembullt, së pari në Bashkimin Sovjetik, e pastaj në Kinë, Kamboxhia, Vietnam, Korenë e Veriut, Kubë dhe në vende të ndryshme afrikane dhe latino-amerikane. Një total prej 120 milion njerëzish u vranë nga regjimet dhe organizatat komuniste. Gjithashtu është e dukshme se edhe tipi perëndimor i humanizmit (sistemet kapitaliste) nuk kanë rezultuar të suksesshme për vendosjen e paqes dhe lumturisë në shoqëritë e veta apo në vendet e tjera të botës.

Dështimi i argumentit humanist ndaj fesë është manifestuar gjithashtu edhe në fushën e psikologjisë. Miti frojdian, një gur themeli i dogmës ateiste që në fillimin e shekullit të njëzetë, u zhvlerësua nga të dhënat empirike. Patrick Glynn, nga Universiteti George Washington, e shpjegon këtë fakt në librin e tij të titulluar *"Zoti: Evidenca, pajtimi i besimit dhe arsyes në botën post-laikë"*.


Çereku i fundit i shekullit XX nuk është treguar i butë ndaj vizioneve psikoanalitike. Shumë domethënës ka qenë ekspozimi i pikëpamjeve të Frojdit ndaj fesë (për të mos përmendur një sërë

çështjesh të tjera), si krejtësisht të pasakta. Në mënyrë mjaft ironike, kërkimet shkencore të 25 viteveve të fundit kanë treguar se, larg nga të qenit një neurozë apo burim neurozash, siç pohonte Freud dhe pasuesit e tij, besimi fetar është një nga lidhjet më të qëndrueshme që përfshin shëndetin mendor dhe lumturinë. Studim pas studimi është treguar se ekziston një marrëdhënie e fuqishme mes besimit fetar dhe praktikës në njërën anë dhe sjelljeve të shëndosha në lidhje me probleme të tilla si vetëvraska, alkooli dhe përdorimi i drogës, divorci, depresioni, e madje, ndoshta çuditërisht, niveli i kënaqësisë seksuale në martesë, në anën tjetër.<sup>37</sup>

Me pak fjalë, arsytimi i supozuar shkencor i fshehur pas humanizmit është provuar si i pavlerë dhe premtimet e tij si të kota. Megjithatë, humanistët nuk e kanë braktisur filozofinë e tyre, por në fakt përkundrazi, janë përpjekur ta përhapin atë në të gjithë botën përmes metodave të propagandës në masë. Veçanërisht, në periudhën e pas luftës janë bërë propaganda humaniste intensive në fushat e shkencës, filozofisë, muzikës, letërsisë, artit dhe filmit. Mesazhet tërheqëse, por të zbrazëta, të krijuara nga ideologët humanistë u janë imponuar me këmbëngulje masave. Kënga "Imagine" (imagjino) e John Lennon, solist i njërit grupeve më të popullarizuara të të gjitha kohërave "The Beatles", është një shembull i kësaj:

**Imagjino që parajsa nuk ekziston  
Është lehtë nëse përpiqesh pak  
As ferri nën tokë  
E lart vetëm qielli qëndron  
Imagjino të gjithë njerëzit  
Të jetojnë vetëm për të sotmen...  
Imagjino se as shtetet nuk ekzistojnë  
As kjo nuk është shumë e vështirë**





John Lennon, by his lyrics, "Imagine [there is] no religion," was one of the most prominent propagandists of humanist philosophy in the twentieth century.

**As ndonjë gjë për të cilën të vdesësh apo të vrasësh**

**Gjithashtu as fe...**

**Mund të thuash se jam vetëm një ëndërrimtar**

**Por nuk jam i vetmi**

**Shpresoj se një ditë do të na bashkëngjitesh**

**Dhe bota do të jetë e tëra njësuar.**

Kjo këngë është një tregues i mirë i sentimentalizmit me të cilin humanizmi, në mungesë të çdo lloj baze shkencore apo racionale, i është imponuar masës. Humanizmi nuk prodhon, dhe nuk mund të



prodhojë kundërshtime të arsyeshme ndaj fesë apo të vërtetës që ajo mëson, por tenton të përdorë metoda të tilla, të cilat i konsideron si efikase.

Kur premtimet e vitit 1933 të Manifestit të Parë Humanist u deklaruan të kota, pas 40 vitesh, humanistët prezantuan draftin e dytë. Në fillim të tekstit tentohej të shpjegohej, se përse premtimet e para nuk sollën rezultat. Përveç faktit se ky shpjegim ishte tejet i dobët, ai demonstronte lidhjen e qëndrueshme të humanistëve ndaj filozofisë së tyre ateiste. Karakteristika më e dallueshme e Manifestit ishte ruajtja e vijës antifetare të Manifestit të vitit 1933: (sigurisht Zoti është përtej të gjitha shprehjeve të thëna më poshtë)

Sikurse në vitin 1933, humanistët ende besojnë se teizmi tradicional, veçanërisht besimi në Zotin lutje-dëgjues, që ka marrë përsipër të jetojë dhe të kujdeset për njerëzit, të dëgjojë dhe të kuptojë lutjet e tyre dhe të jetë në gjendje të bëjë diçka për ta, është një besimi i pavërtetuar dhe i dalë nga moda... Ne besojmë... se fetë tradicionale dogmatike apo autoritare që e vendosin shpalljen, Zotin, ritualin apo besimin mbi nevojat dhe përvojat e njeriut, i shkaktojnë dëmtime qenieve njerëzore... Si ateistë, ne fillojmë me njerëzit e jo me Zotin, me natyrën e jo adhurimin.<sup>38</sup>

Këto deklarata përbëjnë absurditetin humanist dhe paraqesin një shpjegim tepër sipërfaqësor. Në mënyrë që të kuptohet feja, njeriut së pari i nevojitet inteligjenca dhe gjykimi për të qenë i aftë të kuptojë ide të thella. Si kusht paraprak duhet të jetë sinqeriteti dhe distancimi nga paragjykimet. Apo më mirë të themi, humanizmi nuk është më shumë se sa përpjekja e disa individëve ateistë dhe antifetarë të pasionuar, të cilët në sytë e tyre, që nga fillimi kanë dashur ta paraqesin këtë paragjykim si të arsyeshëm. Këto përpjekje nuk janë dënuar kurrë, për frytet që kanë dhënë.

Megjithatë, pretendimet irracionale dhe jologjike në lidhje me besimin në Zot dhe fetë monoteiste, nuk janë asgjë e re, veçse një rikonfirmim i



pretendimeve të gabuara, që janë bërë për mijëra vjet nga ata që mohuan Zotin. Në Kur'an, Zoti shpjegon këtë argument të vjetër të parashtruar nga jobesimtarët:


**Zoti juaj (që meriton adhurim) është një Zot. E ata që nuk e besojnë botën tjetër, zemrat e tyre janë mohuese (të njësisë së Zotit) dhe ata janë kryelartë. Është e vërtetë se All-llahu e di atë që e fshehin dhe atë që e shfaqin haptazi dhe se Ai nuk i do arrogantët. Kur atyre (mohuesve) u thuhet: "Ç'është ajo që shpalli Zoti juaj?", ata thonë:**



**"Mite të popujve të hershëm!" (Kur'an 16: 22-24)**

Siç tregohet në këto ajete, arsyeja e vërtetë e mohimit të fesë nga jobesimtarët është arroganca e fshehur në zemrat e tyre. Filozofia e quajtur humanizëm është thjesht mënyra e jashtme me të cilën ata mohojnë Zotin. Me fjalë të tjera, humanizmi nuk është një mënyrë e re

**Hümanist felsefenin vaatlerinin aksine, ateizm ve dinsizlik 20. yüzyılda dünyaya sadece savaş, çatışma, acı ve zulüm getirmiştir.**



e të menduarit, siç pretendojnë përkrahësit e tij, por është një pikëpamje e lashtë dhe e vjetëruar, e zakonshme për ata që e mohuan Zotin për shkak të arrogancës.


Nëse shqyrtojmë përparimin e humanizmit, përgjatë historisë evropiane, do të gjejmë shumë fakte të forta për këtë pohim.

## RRËNJËT E HUMANIZMIT NË KABALA

Ne kemi parë se disa terma të Kabalas përmbajnë një doktrinë të rreme, e cila daton që nga koha e Egjiptit të Lashtë dhe që më vonë u përfshi në fenë e vërtetë që Zoti u kishte shpallur izraelitëve. Gjithashtu, kemi parë se në themelin e saj qëndron një mënyrë e gabuar e të kuptuarit: që i sheh qeniet njerëzore si jo të krijuara, pavarësisht se konsiderohen si krijesa hyjnore që kanë ekzistuar përjetësisht.

Humanizmi në Europë hyri nga ky burim. Besimi i krishterë ishte i bazuar në ekzistencën e Zotit dhe besimin se njerëzit ishin shërbëtorë të varur prej Tij dhe të krijuar nga Ai. Por me përhapjen e traditës templare në Europë, Kabala filloi të tërheqë një numër filozofësh. Kështu, në shekullin XV, u përhap një rrymë e humanizmit, që la një shenjë të pashlyer në botën ideore evropiane.

Kjo lidhje mes humanizmit dhe Kabalës është theksuar në disa burime. Një nga këto burime është libri i autorit të famshëm Malachi Martin, "Çelësat e këtij gjaku" (*The Keys of This Blood*). Martin është profesor i historisë në



As Vatican University historian Malachi Martin has shown, there is a close relationship between the rise of humanism in Europe and the Kabbalah....

Institutin e Biblës Papnore të Vatikanit. Ai thotë se ndikimi i Kabalas mund të vërehet shumë qartë në mesin e humanistëve.

Në këtë klimë të pazakontë të paqartësisë dhe sfidës, që erdhi për t'i vënë vulën Italisë së Rilindjes së hershme, lindi rrjeti i shoqatave humaniste, që aspironin t'i shmangeshin kontrollit të përgjithshëm të rendit të themeluar. Me aspirata të tilla, këto shoqata duhej të ekzistonin duke ruajtur fshehtësinë, të paktën në fillimet e tyre. Por pavarësisht fshehtësisë së tyre, këto grupe humanistësh dalloheshin nga dy karakteristika të tjera kryesore.

E para, siç pohohej nga autoritetet klerike civile ishte, se ata u revoltuan kundër interpretimit tradicional të Biblës dhe mendimeve filozofike e teologjike të përforcuara nga Kisha për jetën civile dhe politike...

Nuk është për t'u befasuar se pas kësaj armiqësie, këto shoqata kishin konceptimin e tyre të mesazhit origjinal të Biblës dhe të shpalljes së Zotit. Ata kapeshin pas asaj që ata e konsideronin se ishte një trup ultra-sekret i njohurisë, një "gnosis", të cilin e bazonin pjesërisht në linjat e kulteve dhe mistereve me prejardhje nga Afrika Veriore – veçanërisht, Egjipti - dhe një pjesë nga Kabala e çifutëve...

**Humanistët italianë e ndryshuan idenë e Kabalas, përtej asaj që njihej.** Ata rindërtuan konceptin e "gnosis" dhe e transferuan krejtësisht në nivelin e kësaj fjale. "Gnosi" i veçantë që ata synonin, ishte një njohuri e fshehtë se si të zotëronin forcat e errëta të natyrës për një qëllim socio-politik.<sup>39</sup>

Me pak fjalë, shoqatat humaniste të formuara në atë kohë dëshironin që ta zëvendësonin kulturën katolike europiane me një kulturë të re që i kishte rrënjët tek Kabala. Për t'ia arritur këtij qëllimi, ata synonin të krijonin një ndryshim socio-politik. Është interesante se përveç Kabalas, në origjinën e kësaj kulture të re ishin doktrinat e Egjiptit të Lashtë. Profesor Martin shkruan:

Nismëtarë të këtyre shoqatave të hershme humaniste ishin fanatikët

e Forcës së Madhe - Arkitektit të Madh të Gjithësisë - që e paraqitnin nën formën e Tetragramatonit të Shenjtë YHWH... Humanistët huazuan simbolet të tjera - Piramidën dhe Syrin Gjithëpamës - kryesisht me origjinë egjiptiane.<sup>40</sup>

Është mjaft interesant fakti që humanistët filluan të përdornin konceptin “Arkitekti i Madh i Gjithësisë”, shprehje që përdoret ende sot tek masonët. Kjo tregon se duhet të ketë një lidhje të ngushtë mes humanistëve dhe masonëve. Profesori Martin shkruan:

Ndërkohë, në vendet e tjera veriore, bashkë me humanistët, zuri vend një bashkim shumë më i rëndësishëm. Një shoqatë që askush nuk e kishte pritur.


Ndërkohë që shoqatat kabaliste-humaniste në vitet 1300 sapo kishin filluar të gjenin orientimin e tyre, ato kishin kohë që ekzistonin si shoqëri mesjetare punëtorësh, veçanërisht në Angli, Skoci dhe Francë...

Askush në vitet 1300 nuk mund ta kishte parashikuar një shkrirje të tillë intelektesh mes shoqërive masone dhe humanistëve italianë...

Masoneria e re u vendos larg çdo besnikërie ndaj klerit të krishterë romak. Përsëri, ashtu si për humanistët okultë italianë, fshehtësia e garantuar nga tradita e lozhës, ishte thelbësore në këto rrethana. E megjithatë, dy grupet kishin më shumë të përbashkëta sesa fshehtësinë. Nga shkrimet dhe të dhënat e Masonerisë teorike është e qartë, se parimi qëndror fetar u bë besimi tek Arkitekti i Madh i Gjithësisë, një figurë tashmë familjare, si pasojë e ndikimit të humanistëve italianë... Arkitekti i Madh, një produkt i mendjes së “ndritur”, ishte në brendësi të kozmosit material dhe në thelb një pjesë e tij.

Nuk kishte bazë konceptuale, me të cilin një besim i tillë të mund të pajtohej me krishtërimin. Për t’u përjashtuar ishin të gjitha idetë si: mëkati, ferri për dënim dhe parajsja për shpërblim, sakrificat e përjetshme e masës, shenjtoret dhe engjëjt, prifti dhe papa.<sup>41</sup>





Some Masonic symbols.

Shkurt, në Evropë, në shekullin XIV, lindi një organizatë humaniste dhe masonike që i kishte rrënjët tek Kabala. Kjo organizatë nuk e konsideronte Zotin si Krijues dhe Sundues të gjithësisë dhe si të vetmin Zot të njerëzimit siç bënin çifutët, të krishterët dhe muslimanët, por në vend të kësaj, përdorej një koncept të ndryshëm si “Arkitekti i Madh i Gjithësisë”, që ata e perceptonin si “pjesë të gjithësisë materiale”.

Me fjalë të tjera, kjo organizatë sekrete, që u shfaq në Europë në shekullin XIV, e mohoi Zotin, por nën konceptin e “Arkitektit të Madh të Gjithësisë” e pranoi universin material si hyjni. (S'ka dyshim se Zoti është përtej kësaj)

Për një përkufizim më të qartë të këtij besimi të gabuar, mund të rikthehemi në shekullin XX dhe të shikojmë në literaturën masonike. Për shembull, një nga masonët më të vjetër turq, Selami Isindag, ka botuar një libër të titulluar “*Masonluktan Esinmeleler*” (*Inspirime nga masonët*). Qëllimi i këtij libri është që të trajtojë masonët e rinj. Në lidhje me besimin e masonëve tek “Arkitekti i Madh i Gjithësisë”, ai thotë:

Masoneria nuk është e pa fe. Por koncepti i Zotit që ata kanë adoptuar është i ndryshëm nga ai fetar. **Zoti i Masonerisë është një princip madhështor. Është në majë të evolucionit.** Duke kritikuar qenien tonë të brendshme, duke njohur vetveten dhe duke ecur me maturi në rrugën e shkencës, inteligjencës dhe virtytit, mund të zvogëlohet këndvështrimi mes tij dhe nesh. Pastaj, ky Zot nuk zotëron karakteristikat e mira dhe të këqija të qenieve njerëzore. Nuk është i personifikuar. **Ai nuk është menduar si udhërrëfyes i natyrës apo njerëzimit.** Ai është arkitekti i punës madhështore të gjithësisë, unitetit dhe harmonisë së saj. **Ai është tërësia e gjithë krijesave, një fuqi absolute që përfshin çdo gjë, një energji.** Pavarësisht nga e gjithë kjo, nuk mund të pranohet se ai është fillimi... ky është një mister i madh. <sup>42</sup>





Në të njëjtin libër, është e qartë se kur masonët flasin për “Arkitektin e Madh” ata kanë në mendje natyrën, pra ata adhurojnë natyrën:

**Përveç natyrës nuk mund të ketë ndonjë fuqi që është përgjegjëse për mendimet apo veprimet tona... Principet dhe doktrinat e Masonerisë janë fakte shkencore të bazuara në shkencë dhe inteligjencë. Zoti është evolucioni. Element i Tij është fuqia e natyrës. Kështu pra, realiteti absolut është vetë evolucioni dhe energjia që e rrethon.** <sup>43</sup>

Revista “*Mimar Sinan*”, organizatë botuese ekskluzivisht për frankmasonët turq, gjithashtu, për të njëjtën filozofi masone shprehet kështu:

**“Arkitekti i Madh i Gjithësisë” është një prirje drejt përjetësisë. Është një derë për në përjetësi.** Për ne, ai është shtegu. Ai përfshin kërkimin e vazhdueshëm për përsosmëri absolute në përjetësi. Ai krijon një largësi mes çastit të tanishëm dhe të të menduarit mason, apo vetëdijes. <sup>44</sup>

Ky është besimi që nënkuptojnë masonët kur thonë: “Ne besojmë në Zot. Ne, absolutisht ,nuk pranojmë ateistë në radhët tona”. Sipas besimeve të zvetënuara të Masonerisë, nuk është Zoti që shihet si hyjnor, por konceptet natyraliste dhe humaniste si natyra, evolucioni dhe humanizmi.

Nëse hedhim një shikim të shkurtër në literaturën masonike, mund të shohim se kjo organizatë nuk është gjë tjetër veçse humanizëm i organizuar. Gjithashtu arrijmë të identifikojmë se qëllimi i saj është krijimi i një rendi laik dhe humanist në gjithë botën. Këto ide lindën në mesin e humanistëve të Europës së shekullit XIV dhe masonët e sotëm ende i propozojnë dhe i mbrojnë ato.



## HUMANIZMI MASONIK: ADHURIMI I NJERËZIMIT

Botimet e brendshme të masonëve e përshkruajnë me hollësi filozofinë humaniste të organizatës dhe armiqësinë e tyre ndaj monoteizmit. Aty ofrohen shpjegime të panumërta, interpretime, citime dhe alegori që kanë të bëjnë me këtë çështje.


Siç thamë në fillim, humanizmi i ka kthyer shpinën Krijuesit të njerëzimit dhe gabon duke e konsideruar njeriun si “forma më e lartë e qenieve në univers”.

Në të vërtetë, kjo nënkupton adhurimin e njerëzimit. Ky besim, që fillon me humanistët kabalistë në shekujt XIV dhe XV, vazhdon në mënyrë po kaq irracionale edhe në ditët e sotme në masonerinë moderne.

Njëri ndër humanistët më të mëdhenj të shekullit XIV ishte Pico della Mirandola. Vepra e tij “*Conclusiones philosophicae, cabalisticae, et theologicae*” (Konkluzionet filozofike, kabaliste dhe teologjike) u dënua në 1489 nga Papa Innocent-i i VIII, pasi përmbante ide heretike. Mirandola shkroi se nuk kishte asgjë më të lartë në botë se madhështia e njerëzimit. Kisha e pa këtë, si një ide heretike që s’ishte asgjë më pak se adhurim i njerëzimit. Në të vërtetë, kjo ishte ide heretike, pasi nuk ka hyjni tjetër që mund të madhërohet përveç Zotit. Njerëzimi është thjesht një krijim i Tij.

Sot, masonët e shfaqin shumë më haptazi idenë heretike të Miradolas. Për shembull, në një broshurë lokale masonike thuhet:

**Shoqëritë primitive ishin të dobëta, dhe për shkak të kësaj dobësie, ata hyjnizuan fuqitë dhe fenomenet përreth tyre. Por**



Pico della Mirandola, a Kabbalist humanist.

**Masoneria hyjnizon vetëm njerëzimin.** <sup>45</sup>

Në librin *“The Lost Keys of Freemasonry”* (Çelësat e humbur të Frankmasonerisë) Manly P. Hall shpjegon se kjo doktrinë masonike humaniste kthehet prapa në Egjiptin e Lashtë:

**Njeriu është Zot në përbërje, dhe sikurse mitet mistike të Egjiptit, ai po formëzohet në rrotën e poçarit. Kur drita e tij ndriçon, për t’i ngritur dhe ruajtur të gjitha gjërat, ai merr kurorën e trefishtë të hyjnisë dhe i bashkohet turmës së Mjeshtreve Masonë, të cilët me veshjen e tyre me ngjyrë të kaltër dhe të artë, kërkojnë që të largojnë errësirën e natës me dritën e trefishtë të Lozhës Masonike.** <sup>46</sup>

Sipas besimit të gabuar të Masonerisë, njerëzit janë zota, por vetëm një mjeshtër i madh e arrin plotësisht këtë hyjni (S’ka dyshim se Zoti është përtej kësaj). Mënyra për t’u bërë një mjeshtër i madh është që të mohohet plotësisht besimi në Zot dhe fakti se njerëzit janë shërbëtorë të Zotit. Ky fakt preket pak edhe nga një shkrimtar tjetër, J. D. Buck në librin e tij *“Mystic Masonry”* (Masoneria mistike):

**I vetmi zot që Frankmasoneria pranon është njerëzimi në tërësi...**

**Pra njerëzimi është i vetmi zot personal që ekziston.** <sup>47</sup>

Në mënyrë të dukshme, Masoneria, është një lloj feje. Por, nuk është fe monoteiste, është një fe humaniste dhe si rrjedhim një fe e rreme. Është një shtrembërim të cilit i pëlqen të adhurojë njerëzimin dhe jo Zotin. Shkrimet masonike insistojnë në këtë çështje. Në një artikull të revistës turke *“Türk Mason”* (Masoni turk), shkruhet: **“Ne gjithmonë pranojmë se ideali i lartë i Masonerisë qëndron në “doktrinën e humanizmit”.** <sup>48</sup>

Një publikim tjetër turk shpjegon se humanizmi është fe.

Larg nga predikimet e thata të dogmave fetare, dhe një fe e vërtetë.

**Humanizmi ynë, në të cilin i ka rrënjët kuptimi i jetës, do të plotësojë dëshirat për të cilat rinia nuk është e vetëdijshme.** <sup>49</sup>

Si e servirin masonët këtë fe të rreme të cilës i besojnë? Për ta kuptuar këtë duhet të shikojmë më nga afër mesazhet që ata shpërndajnë në shoqëri.



## TEORIA MORALE HUMANISTE

Sot, masonët në shumë vende janë të angazhuar në përpjekjen për t'ia prezantuar veten pjesës tjetër të shoqërisë. Duke përdorur: konferenca shtypi, faqe interneti, njoftime dhe deklarata në gazeta, ata e prezantojnë veten si një organizatë e dedikuar vetëm për të mirën e shoqërisë. Madje, në disa vende, ka edhe organizata bamirëse të financuara nga masonët.

E njëjta gjë është thënë edhe nga organizatat e Rotary dhe Lion's Club, që janë versione më të "lehta" të Masonerisë. Të gjitha këto organizata insistojnë në faktin se po punojnë për të mirën e shoqërisë.

Pa dyshim, të punuarit për të mirën e shoqërisë nuk është një ndërmarrje për t'u kundërshtuar dhe nuk kemi vërejtje për këtë. Por, pas deklaratave të tyre ka një mesazh mashtrues. Masonët pohojnë se mund të ketë moral edhe pa fe dhe se ky moral mund të vendoset në botë pa ndihmën e fesë. Dhe qëllimi në sfondin e gjithë punës së tyre bamirëse është që të përhapet ky mesazh në shoqëri.

Së shpejti do të shohim pse ky pohim është kaq mashtrues. Por, para kësaj, do të ishte mirë që të merrnim në konsideratë pikëpamjet e masonëve në lidhje me këtë çështje. Në faqen e internetit të masonëve, mundësia e "moralit pa fe" është përshkruar në këtë mënyrë:

Çfarë është njeriu? Nga erdhi ai dhe ku po shkon?... **Si jeton një njeri? Si duhet të jetojë ai? Fetë përpiqen t'u përgjigjen këtyre pyetjeve me ndihmën e parimeve morale që ata kanë vendosur. Mirëpo ata i lidhin parimet e tyre me koncepte metafizike si Zoti, parajsa, ferri, adhurimi ndërsa njerëzit duhet t'i gjejnë parimet e tyre për jetën pa u përfshirë në çështjet metafizike, të cilave ata duhet t'u besojnë pa i kuptuar.**

Frankmasoneria i ka deklaruar për shekuj me radhë këto parime si: liri, barazi, vëllazëri, dashuri ndaj punës dhe paqes, demokraci, etj. Kjo e liron njeriun krejtësisht nga besimi në fe, por përsëri paraqet një





The Masonic theory of "humanist morality" is extremely deceptive. History shows that, in societies where religion has been destroyed, there is no morality and only strife and disorder. The picture on the left shows the savagery of the French Revolution and portrays the real results of humanism.

parim jetese. Ata nuk i kërkojnë bazat e tyre në konceptin metafizik, por në brendësi të një personi të pjekur që jeton në këtë botë.<sup>50</sup>

Masonët, që mendojnë në këtë mënyrë, i kundërvihen tërësisht një njeriu që beson tek Zoti dhe që kryen akte bamirësie me qëllim që të fitojë pëlqimin e Tij. Për ta, çdo gjë duhet të bëhet vetëm për hir të njerëzimit. Ne mund ta shohim qartë këtë mënyrë të menduari në një libër të botuar nga lozhat turke:

**Morali masonik është i bazuar në dashurinë për njerëzimin dhe e hedh poshtë tërësisht mundësinë e të qenit i mirë përmes të shpresuarit në të ardhmen, në një përfitim, një shpërblim apo në parajsë nga frika e dikujt tjetër, qoftë ai një institucion fetar, politik apo fuqi të mbinatyreshme të panjohura... Ai vetëm e përkrah dhe e lavdëron të qenit i mirë në lidhje me dashurinë për familjen, vendin, qeniet njerëzore dhe njerëzimin. Ky është një nga qëllimet më**

domethënëse të evolucionit masonik. Të duash njerëzit dhe të jesh i mirë pa pritur diçka në këmbim dhe arritja e këtij niveli është evolucioni më i madh.<sup>51</sup>

Pohimet në citatin e mësipërm janë shumë çorientuese. Pa disiplinën morale të fesë nuk mund të ketë kuptim vetëflijimi për pjesën tjetër të shoqërisë. Dhe, aty ku kontributi dhe sakrifica do të shfaqen në mënyrë jo të përkryer, marrëdhëniet do të jenë vetëm sipërfaqësore. Ata që nuk e kanë idenë e moralit fetar, nuk i frikësohen Zotit dhe nuk e respektojnë Atë. Pa dyshim se në ato vende ku nuk ekziston frika ndaj Zotit, njerëzit shqetësohen vetëm për përfitimin personal. Kur njerëzit mendojnë se interesat e tyre personale janë në rrezik, ata nuk mund ta shprehin dashurinë, besnikërinë apo dhembshurinë e vërtetë. Ata shfaqin dashuri dhe respekt vetëm ndaj atyre prej të cilëve mund të kenë përfitime. Kjo ndodh sepse, sipas konceptimit të tyre të gabuar, ata jetojnë vetëm njëherë në këtë botë dhe për këtë arsye ata do të marrin nga ajo sa më shumë që të jetë e mundur. Për më tepër, sipas këtij besimi të rremë, nuk ka ndëshkim për çfarëdo lloj pandershmërie apo ligësie që ata bëjnë në këtë botë.

Literatura masonike është e mbushur plot me predikime morale me të cilat përpiqet ta errësojë këtë fakt. **Por, në të vërtetë, ky moral pa religjion nuk është gjë tjetër veçse një retorikë e shtirur.** Historia është plot me shembuj, që tregojnë, se pa vetëdisiplinën që akordon feja mbi shpirtin e njeriut dhe pa ligjin hyjnor, morali i vërtetë nuk mund të vendoset në asnjë mënyrë.

Një shembull i mahnitshëm për këtë ishte Revolucioni i Madh Francez, më 1789. Masonët, që nxitën revolucionin, dolën përpara me parulla duke bërë titur për idealet morale të “lirisë, barazisë dhe vëllazërisë”. E megjithatë, me dhjetëra mijëra njerëz të pafajshëm u dërguan në gjyotinë, dhe vendi u mbulua nga gjaku. Madje as vetë udhëheqësit e revolucionit nuk arritën t’i shpëtonin kësaj egërsie, duke



u dërguar në gijotinë, njëri pas tjetrit.

Në shekullin XIX, nga ideja e mundësisë së ekzistencës së moralit pa fe, lindi komunizmi që pati rezultate akoma më katastrofike. Komunizmi me sa shihej kërkonte një shoqëri të drejtë dhe të barabartë, në të cilën nuk do të kishte shfrytëzim dhe si përfundim, ai propozoi zhdukjen e fesë. Mirëpo, në shekullin XX, në vende si: Bashkimi Sovjetik, Blloku Lindor, Kinë, Indokinë, në disa vende në Afrikë dhe në Amerikën Qendrore, ai i nënshtroi njerëzit ndaj një mjerimi të tmerrshëm.

Regjimet komuniste vranë një numër të jashtëzakonshëm njerëzish, numri i përgjithshëm i të cilëve arrin në rreth 120 milionë.<sup>52</sup> Për më tepër, në kundërshtim me atë që deklarohet, drejtësia dhe barazia nuk u vendosën kurrë në asnjë prej regjimeve komuniste. Udhëheqësit komunistë në krye të shtetit përfshinin një klasë elite. (Në librin klasik të titulluar *"The New Class" (Klasa e re)*, mendimtari jugosllav, Milovan Djilas, shpjegon se udhëheqësit komunistë, të njohur si "nomenklatura", formuan një "klasë të privilegjuar" gjë që ishte në kundërshtim me pohimet e socializmit).

Gjithashtu, edhe sot, kur shohim në brendësi të Masonizmit, i cili vazhdimisht deklaron idetë e tij "të shërbimit ndaj shoqërisë" dhe "sakrificës për njerëzimin", nuk gjejmë të dhëna krejt të pastra. Në shumë vende, Masoneria ka qenë në qendër të marrëdhënieve përfitimet e pandershme



The guillotine, the French Revolution's implement of brutality.



Another violent scene of the French Revolution.



materiale. Nga skandali në lozhën masonike P2 në Itali, më 1980, doli në dritë se masonët mbanin lidhje të ngushta me mafian dhe se drejtorët e lozhave ishin të angazhuar në aktivitete të tilla si kontrabanda e armëve, tregtia e drogës apo pastrimi i parave. Gjithashtu, u bë e ditur se kishin organizuar sulme ndaj rivalëve të tyre dhe ndaj atyre që i kishin tradhëtuar. Në "Skandalin e madh të lozhës lindore", në Francë më 1992 dhe në operacionin "Duart e pastra" në Angli, u raportuan nga shtypi anglez i 1995-sës aktivitetet e lozhave masonike dhe interesi për përfitim ilegal u bë i qartë. Ideja masonike e "moralit humanist" është vetëm një mashtrim.

Ishte e paevitueshme që të mos ndodhte një gjë e tillë, pasi siç thamë në fillim, morali në shoqëri vendoset vetëm nga disiplina morale e fesë. Në bazën e moralit qëndron mungesa e arrogancës dhe e egoizmit dhe të vetmit që mund ta arrijnë këtë nivel janë ata që e kuptojnë përgjegjësinë e tyre para Zotit. Në Kur'an, Zoti pasi na tregon për vetëflijimin e besimtarëve, thotë: **"...Kush është i ruajtur prej lakmisë së vet, të tillët janë të shpëtuar. Kur'an (59: 9).** Kjo është baza e vërtetë e moralit.

Në suren Furkan të Kur'anit, natyra e moralit të besimtarëve të vërtetë përshkruhet në këtë mënyrë:

**E robërit e Zotit janë ata që ecin nëpër tokë të qetë, e kur atyre u drejtohen injorantët me fjalë, ata thonë: "Paqe!"**

**Dhe që për hir të Zotit të tyre natën e kalojnë duke i bërë sexhde dhe duke qëndruar në këmbë (falen).**

**Edhe ata që thonë: "Zoti ynë, largoje prej nesh vuajtjen e xhehennemit, e s'ka dyshim se vuajtja në të është gjëja më e rëndë".**

**Ai, vërtet është vendqëndrim dhe vendbanim i keq.**

**Edhe ata që kur shpenzojnë nuk e teprojnë e as nuk janë dorështrënguar, por mbajnë mesataren e janë të matur.**

**Edhe ata që përveç All-llahut, nuk lusin zot tjetër dhe nuk mbysin**



njeriun që ka ndaluar All-llahu, por vetëm kur e meriton në bazë të drejtësisë, dhe që nuk bëjnë kurvëri, ndërsa kush i punon këto, ai gjen ndëshkimin.

Atij i dyfishohet dënimi ditën e kiametit dhe aty mbetet i përbuzur përgjithmonë.

Përveç atij që është penduar dhe ka bërë vepër të mirë, të tillëve All-llahu të këqijat ua shndërron në të mira. All-llahu është mëshirues, ndaj Ai fal shumë.

Ai që është penduar dhe ka bërë mirë, në të vërtetë, ai është kthyer te All-llahu dhe është i pranishëm.

(Robërit e Zotit janë) Edhe ata që nuk dëshmojnë rrejshëm dhe kur (rastësisht) kalojnë pranë së keqes, kalojnë duke e ruajtur karakterin e vet.

Edhe ata që kur këshillohen me ajetet e Kur'anit të Zotit të tyre, nuk ua kthejnë shpinën si të shurdhët e të verbër. (Kur'an 25: 63-73)

Kjo pra është edhe detyra themelore e besimtarëve, që t'i binden Zotit me përpulje, "jo t'i kthejnë shpinën, sikur të ishin të shurdhër dhe të verbër kur u paraqiten argumentet e Tij". Për shkak të kësaj detyre, njeriu është i ruajtur nga egoizmi, kënaqësitë e kësaj bote, si dhe nga ambiciet e shqetësimet për ta bërë veten të pëlqehet nga të tjerët. Lloji i moralit të përmendur në ajetet e mësipërme arrihet vetëm në këtë mënyrë. Për këtë arsye, në një shoqëri ku mungon dashuria e frika ndaj Zotit dhe besimi tek Ai, aty nuk ka moral. Pasi, meqë asgjë nuk mund të përcaktohet në mënyrë absolute, secili e llogarit sipas dëshirave të veta se çfarë është e drejtë apo e gabuar.

Në të vërtetë, qëllimi primar i filozofisë morale laike-humaniste masonike nuk është që të themelojë një botë të moralshme, por një botë laike. Me fjalë të tjera, masonët nuk e përqafojnë filozofinë humaniste për shkak se ata i japin një rëndësi të madhe moralit, por vetëm për të transmetuar në shoqëri konceptin e tyre se feja nuk është e domosdoshme.



## QËLLIMI I MASONËVE: THEMELIMI I NJË BOTE HUMANISTE

Siç e kemi parë tashmë, Masonët janë të lidhur me filozofinë humaniste. Kjo është arsyeja pse ata e mohuan Zotin, dhe adhuruan qeniet njerëzore, apo hyjnizuan "njerëzimin" në vend të Tij (s'ka dyshim se Zoti është përtej kësaj). Por kjo shtron një pyetje të rëndësishme: a e ruajnë masonët këtë besim vetëm për vete, apo dëshirojnë që ky besim të përqafohet gjithashtu edhe nga të tjerët?

Kur u hedhim një shikim shkrimeve masonike, mund ta shohim qartë përgjigjen e kësaj pyetjeje: qëllimi i kësaj organizate është që të përhapë filozofinë humaniste në tërë botën dhe të çrrënjosë fetë monoteiste (islamizmin, krishterizmin dhe judaizmin).

Për shembull, në një artikull të botuar në revistën e masonëve *Mimar Sinan*, thuhet: "Masonët **nuk kërkojnë** origjinën e ideve të së keqes, drejtësisë dhe ndershmërisë **përtej botës fizike**, por ata besojnë se këto gjëra lindin nga kushtet shoqërore të njeriut, nga marrëdhëniet shoqërore dhe atë për të cilën lufton gjatë jetës së tij, dhe shtohet, se **"Masoneria po përpiqet që t'i përhapë këto ide anë e mbanë rruzullit tokësor"**.<sup>53</sup>

Selami Isindag, një mason i vjetër turk, shkruan:

Sipas Masonerisë, **në mënyrë që të shpëtohet njerëzimi nga një moral i mbinatyrshëm i bazuar në burime fetare**, është e domosdoshme që të vendoset një moral, që bazohet në dashurinë për njerëzimin, e cila nuk është relative. Në parimet e saj morale tradicionale, Masoneria ka marrë në konsideratë prirjen e organizmit njerëzor, nevojat dhe kënaqësitë e tij, rregullat e jetës shoqërore dhe organizimin e tyre, vetëdijen, lirinë e mendimit dhe të fjalës dhe në fund, të gjitha gjërat që marrin pjesë në formimin e jetës natyrale. Për këtë shkak, **qëllimi i tij është që të vendosë dhe të nxisë moralin njerëzor në të gjitha shoqëritë**.<sup>54</sup>



Ajo çfarë nënkupton mjeshtri mason Isindag me "shpëtimin e genieve njerëzore nga një moral i bazuar në burime fetare" është largimi i të gjithë njerëzve nga feja. Në të njëjtin libër, Isindag shpjegon këtë qëllim dhe "parimet - e supozuara të tij - për vendosjen e një qytetërimi të përparuar":

Parimet pozitive të Masonerisë janë të domosdoshme dhe të mjaftueshme për vendosjen e një qytetërimi të avancuar. Këto parime janë:

- Pranimi se Zoti objektiv (Arkitekti i Madh i Gjithësisë) është vetë evolucioni;

- Mohimi i besimit tek shpalljet, misticizmi dhe besimet e kota;

- Superioriteti i humanizmit racional dhe punës.

E para nga tre pikat e mësipërme përfshin mohimin e ekzistencës së Zotit. (Masonët nuk besojnë në Zot, por në Arkitektin e Madh të Gjithësisë, dhe citati më lart tregon se me këtë term, ata nënkuptojnë evolucionin.) Pika e dytë mohon shpalljet nga Zoti dhe njohuritë fetare të bazuar në të. (Vetë Isindag i përkufizon këto si "besime të kota".) Dhe pika e tretë në mënyrë absurde lartëson humanizmin dhe konceptin humanist të "punës" (si në komunizëm).

Nëse marrim parasysh mënyrën se si këto ide të shtrembëruara nguliten sot në botë, mund edhe ta çmojmë ndikimin masonik në të.

Por ka dhe një gjë tjetër të rëndësishme që duhet komentuar: Si e ka vënë në lëvizje Masoneria misionin e vet kundër fesë? Kur shohim shkrimet masone, kuptojmë, se ata imagjinojnë se mund ta shkatërrojnë fenë, veçanërisht në nivelin shoqëror, me anë të "propagandës" në masë. Mjeshtri mason Isindag hedh mjaft dritë mbi këtë çështje në këtë paragraf të librit të tij:

**...Madje edhe regjimet më shtypëse nuk kanë qenë të suksesshme në përpjekjet e tyre për t'i shkatërruar institucionet fetare. Në të vërtetë, tejkalimet e ashpra të metodave politike, në përpjekje për të**



shpëtuar shoqërinë dogmat dhe besimet e kota fetare, kanë prodhuar një reaksion të kundërt: vendet e adhurimit që ata dëshironin t'i mbyllnin, sot janë më plot se kurrë më parë dhe besimi e dogmat që ata i shpallën të jashtëligjshme kanë madje edhe më shumë pasues. Në një leksion tjetër, ne theksuam se në çështjet që prekin zemrën dhe ndjenjat, **ndalimi dhe forca nuk kanë efekt**. E vetmja mënyrë për t'i nxjerrë njerëzit nga errësira në dritë është shkencë e vërtetë, si dhe parimet e logjikës e të urtësisë. **Nëse njerëzit edukohen sipas kësaj mënyre, ata do të respektojnë njerëzimin dhe anët pozitive të fesë, por edhe do të shpëtojnë veten nga dogmat dhe besimet e kota.**<sup>55</sup>

Me qëllim që ta kuptojmë atë që është thënë këtu, duhet që ta analizojmë me kujdes. Isindag thotë se shtypja e fesë do t'i bëjë më të motivuar njerëzit, të cilët besojnë dhe do ta forcojnë fenë. Prandaj, në mënyrë që të parandalohet forcimi i fesë, Isindag mendon se masonët duhet ta shkatërrojnë fenë në nivelin intelektual. Ajo që nënkupton ai me “shkencën e vërtetë dhe parimet e logjikës e urtësisë”, nuk është në të vërtetë shkencë, logjika dhe urtësia, por vetëm një filozofi humaniste dhe materialiste që përdor këto thënie si kamuflim, si në rastin e darvinizmit. Isindag pohon, se kur këto ide të shpërndahen në shoqëri atëherë “vetëm elementet humaniste do të fitojnë respekt në fe”, që do të thotë se ajo që do mbetet nga feja do të jenë vetëm ato elemente që janë miratuar nga filozofia humaniste. Me fjalë të tjera, ata hedhin poshtë të vërtetat themelore që qëndrojnë në themel të fesë monoteiste (Isindag këto i quan dogma dhe besime të kota). Këto të vërteta, pra që njeriu është krijuar nga Zoti dhe është përgjegjës ndaj Tij, janë realitetet e fundit.

Është e qartë se Isindag dhe Masonët, që ndajnë idetë e tij gabohen rëndë. Shkurtimisht, qëllimi i masonëve është shkatërrimi i elementeve të besimit, që përbëjnë esencën e fesë. Ata duan ta reduktojnë rolin e fesë në një element thjesht kulturor që sipas





**G. E. Lessing and E. Renan. The Masons wanted to realize the dream of these two atheist writers in eradicating religion from the face of the earth.**

pikëpamjes së tyre duhet t'i shprehë idetë e saj në një numër të përgjithshëm çështjesh morale. Sipas masonëve, mënyra për ta realizuar këtë, është imponimi i ateizmit në shoqëri nën maskën e shkencës dhe arsyes. Në fund të fundit, qëllimi i tyre është që ta largojnë fenë nga pozita e saj, madje edhe si një element kulturor, dhe të krijojnë një botë tërësisht ateiste.

Në një artikull të tij në revistën *"Mason"*, të titulluar *"Shkenca e vërtetë - pengesat e mendjes dhe Masoneria"*, Isindag thotë:

Si rezultat i gjithë kësaj, dëshiroj të them se detyra më e rëndësishme humaniste dhe masonike e të gjithëve ne, nuk është të largohemi nga shkencë dhe arsyeja, për të kuptuar që kjo është mënyra e vetme më e mirë sipas evolucionit, por të përhapim besimin tonë në mesin e njerëzve dhe t'i edukojmë ata me shkencën e vërtetë. Fjalët e Ernest Renan janë shumë të rëndësishme: "Nëse njerëzit janë edukuar dhe shkolluar sipas shkencës dhe arsyes së vërtetë, besimet e kota të fesë do të shkatërrohen vetvetiu." Fjalët e Lessingut e mbështesin këtë pikëpamje: "Nëse njerëzit janë të edukuar dhe shkolluar me

**shkencën dhe arsyen e vërtetë, një ditë feja nuk do të jetë më e nevojshme.”<sup>56</sup>**

Ky është qëllimi përfundimtar i Masonerisë. Ata duan të shkatërrojnë plotësisht fenë dhe të vendosin një botë humaniste të bazuar në “shenjtërinë” e humanitetit. Kështu pra, ata duan të vendosin një rend të ri injorance, në të cilin njerëzit e mohojnë Zotin i cili i krijoi dhe ta konsiderojnë veten hyjnorë... Ky është edhe qëllimi i ekzistencës së Masonerisë. Në revistën masone të quajtur “Ayna” (Pasqyra), ky quhet “tempulli i ideve”.

Masonët modernë e kanë ndryshuar qëllimin e masonëve të vjetër, për të ndërtuar një tempull fizik mbi idenë e ndërtimit të “Tempullit të Ideve”. **Ndërtimi i Tempullit të Ideve do të bëhet i mundur atëherë kur të vendosen parimet dhe virtytet masone dhe kur në tokë të shtohen njerëzit e tillë të mençur.**<sup>57</sup>

Për ta përçuar më tej këtë synim, masonët punojnë pa u lodhur në shumë vende të botës. Organizata masone ka ndikim në universitete dhe në institucione të tjera edukative, në media, në botën e artit dhe ideve. Përpjekjet e saj, për të shpërndarë filozofinë humaniste në shoqëri dhe për të diskredituar të vërtetat e besimit, që janë baza e fesë, nuk pushojnë asnjëherë. Më vonë do të shohim, se teoria e evolucionit është një nga mjetet themelore të propagandës masone. Për më tepër, ata synojnë të ndërtojnë një shoqëri e cila të mos e përmendë fare emrin e Zotit apo të fesë, por që kujdeset vetëm për të plotësuar kënaqësitë njerëzore, dëshirat dhe ambiciet e kësaj bote. Kjo do të jetë një shoqëri e formuar nga njerëz që e kanë **“kthyer (Zotin) në diçka, të cilën e hedhin me përçmim prapa shpine” (Kur’an 11: 92)**, të ngjashëm me popullin e Medjenit të përmendur në Kur’an. Në këtë kulturë të mbytur nga injoranca nuk ka vend për frikë apo dashuri ndaj Zotit, për të plotësuar vullnetin e Tij, për të kryer ritet e adhurimit, apo për të patur ndonjë mendim për botën tjetër. Në fakt, këto ide mendohet të jenë të dala nga moda dhe karakteristikë e njerëzve të paarsimuar. Ky



mesazh mashtrues po përdoret vazhdimisht si sugjerim në filmat artistikë, filmat vizatimorë, komikë dhe në novela.

Në këtë ndërmarrje të madhe mashtrimi, masonët vazhdimisht luajnë rolin e udhëheqësve. Por, gjithashtu, ka edhe shumë grupime dhe individë të tjerë të angazhuar në të njëjtën punë. Masonët i pranojnë ata si “masonë nderi” dhe i llogarisin ata si aleatë të tyre, pasi të gjithë përkrahin të njëjtën filozofi humaniste. Selami Isindag shkruan:

Masoneria gjithashtu pranon këtë fakt: **në botën e jashtme ka njerëz të mençur, që, edhe pse nuk janë masonë, e përkrahin ideologjinë masone.** Kjo ndodh pasi kjo është një ideologji krejtësisht njerëzore dhe për njerëzimin.<sup>58</sup>

Kjo luftë e vazhdueshme kundër fesë mbështetet në dy argumente apo arsyetime bazë: filozofia materialiste dhe teoria darviniste e evolucionit.

Në kapitujt në vijim ne do t'i shqyrtojmë këto dy arsyetime, origjinën dhe marrëdhëniet e tyre me Masonerinë. Pastaj, ne do të jemi në gjendje të kuptojmë më qartë prapaskenat e këtyre gënjeshtreve që kanë ushtruar ndikimin e tyre në botë që nga shekulli XIX.



# -IV-

## MATERIALISM REVISITED

**N**ë kapitullin e parë të këtij libri, i hodhëm një sy regjimit të faraonit në Egjiptin e Lashtë dhe arritëm në disa përfundime të rëndësishme rreth përforcimit të filozofisë së tij. Siç kemi thënë, karakteristika më interesante e mendimit në Egjiptin e Lashtë, është se ai ishte materialist, që do të thotë se parashtron besimin se materia është e përjetshme dhe e pakrijuar. Në librin e tyre, *“Çelësi i Hiramit”*, Christopher Knight dhe Robert Lomas, kanë disa gjëra të rëndësishme për të thënë në lidhje me këtë çështje, që ia vlen të përsëriten:

Egjiptianët besonin se materia kishte ekzistuar gjithmonë dhe për ta ishte e palogjikshme të mendonin për një Zot, i cili mund të krijonte diçka nga asgjëja absolute. Pikëpamja e tyre ishte, se bota kishte filluar të ekzistonte kur rregulli nisi të ndahej nga kaosi dhe që atëherë ka patur një betejë të vazhdueshme mes forcave të organizimit dhe të shkatërrimit... Kjo gjendje kaotike quhej Nun dhe

sipas përshkrimeve sumeriane..., “gjithçka ishte një errësirë totale, një humnerë e lëngët, pa diell, ku zotëronte një fuqi, një forcë krijuese brenda saj, që e urdhëroi rregullin të fillonte. **Kjo forcë e heshtur që ishte brenda substancës së kaosit nuk e dinte që ekzistonte; ajo ishte një probabilitet, një potencial që ishte ndërthurur brenda rastësisë së kësaj parregullsie.**<sup>59</sup>

Ekziston një ngjashmëri e habitshme mes miteve të Egjiptit të Lashtë dhe mendimit modern materialist. Një arsye e fshehtë për këtë fakt interesant është, se ekziston një organizatë bashkëkohore, që i adoptoi këto besime të Egjiptit të Lashtë dhe synon t’i vendosë në të gjithë botën. Kjo organizatë është Masoneria...

## **MASONËT DHE EGJIPTI I LASHTË**

Filozofia materialiste e egjiptianëve të lashtë vazhdoi të ekzistonte edhe pasi ky civilizim u zhduk. Ajo u adoptua nga disa çifutë dhe u mbajt gjallë brenda doktrinës kabaliste. Nga ana tjetër, një numër mendimtarësh grekë adoptuan të njëjtën filozofi dhe e riinterpretuan duke e përjetësuar në formën e shkollës së mendimit, të njohur si “Hermeticizëm”.

Fjala “Hermeticizëm” vjen nga emri i Hermesit, zotit grek që ishte homologu i zotit të Egjiptit të Lashtë me emrin “Thoth”. Me fjalë tjera hermeticizmi është versioni i filozofisë së egjiptianëve nga grekët e lashtë.

Mjeshtri mason Isindag shpjegon origjinën e kësaj filozofie dhe vendin e saj në masonerinë moderne:

**Në Egjiptin e Lashtë ekzistonte një shoqëri fetare që i la si trashëgim hermeticizmit një sistem mendimi dhe besimi. Edhe Masoneria zhvilloi diçka të ngjashme me këtë. Për shembull, ata që kishin arritur në një nivel të caktuar, merrnin pjesë në ceremonitë e shoqërisë, i shpallnin mendimet dhe ndjenjat e tyre shpirtërore dhe trajnonin ata që ishin në nivel më të ulët. Pitagora ishte një**





The Ancient Egyptians believed in the myth that matter was eternal, and that the order of the universe arose due to a mythical "self-organizational" power of matter.

Hermeticist që u trajnua në mesin tyre. Veç kësaj, organizata dhe sistemet filozofike të shkollës së Aleksandrisë dhe Neoplatonizmit e kishin origjinën e tyre në Egjiptin e Lashtë dhe po ashtu, ka disa ngjashmëri të rëndësishme mes tyre dhe riteve masonike.<sup>60</sup>

Isindag është shumë i hapur në lidhje me ndikimin e Egjiptit të Lashtë në origjinën e Masonerisë kur deklaron: **“Frankmasoneria është një organizatë shoqërore dhe ritualiste që i ka fillimet në Egjiptin e Lashtë.”**<sup>61</sup>

Shumë autoritete të tjera masonë thonë se origjina e Masonerisë i ka fillimet në shoqëritë sekrete të kulturave të lashta pagane, siç janë ato të Egjiptit dhe Greqisë së Lashtë. Një mason i vjetër turk, Celil Layiketez, në revistën *“Mimar Sinan”*, në artikullin me titull *“Sekreti mason: Çfarë është e fshehtë dhe çfarë nuk është?”* shkruan:

**Në civilizimet e lashta greke, egjiptiane dhe romake ekzistonin shkolla mistike që haseshin në kontekstin e një shkence, njohurie, apo sekreti të caktuar. Anëtarët e këtyre shkollave mistike pranoheshin aty vetëm pas një periudhe të gjatë studimesh dhe ceremonish pranimi. Ajo që mendohet të ketë qenë e para, në mesin e**

këtyre shkollave, është shkolla e “Ozirisit” që bazohej në etapat e lindjes së këtij zoti: rinisë, luftës kundër errësirës, vdekjes dhe ringjalljes. Këto çështje dramatizoheshin nga ana rituale në ceremonitë e kryera nga kleri për shkak të njerëzve të panishëm aty dhe në këtë mënyrë, ritet dhe simbolet që paraqiteshin ishin shumë më të efektshme...

**Vite më vonë, këto rite formuan qarqet e para të një serie vëllazërisht rishtare që do të vijonin nën emrin e Masonerisë.** Vëllazëri të tilla gjithmonë vendosnin të njëjtat ideale dhe, kur ishin të shtypur, ishin në gjendje ta drejtonin aktivitetin e tyre në fshehtësi. Ata kanë qenë në gjendje të mbijetojnë deri në ditët e sotme pasi **ata vazhdimisht i kanë ndërruar emrat dhe format e tyre. Por ata i mbetën besnikë simbolizmit të lashtë dhe karakterit të tyre të veçantë duke ia pasuar si trashëgimi njëri-tjetrit, idetë e tyre.** Në mënyrë që idetë e vendosura prej tyre, të mos çënonin rendin fetar ekzistues, ata vendosën ligje të fshehta mes njëri-tjetrit. Në mënyrë që të mbronin veten nga tërbimi i njerëzve injorantë, ata kërkuan strehim tek Masoneria Operative, e cila përmbante rregullat diskrete të vetë tregtisë së tyre. Ata e mbillnin këtë me idetë e tyre, të cilat më vonë ndikuan në formimin e Masonerisë Moderne Teorike, që njohim sot.<sup>62</sup>

Në citatin e mësipërm, Layiktez lavdëron shoqëritë, të cilat ishin origjina e Masonerisë dhe pohon se ata qëndruan të fshehura, që të mbronin veten nga “njerëzit injorantë”. Nëse, për një çast, e lemë anash këtë pohim, nga citati i mësipërm do të kuptojmë se Masoneria është një ripërfaqësim, në ditët e sotme, i shoqërive që u themeluan nga qytetërimet pagane të Egjiptit, Greqisë dhe Romës së Lashtë. Nga këto tri civilizime, më i vjetri është ai i Egjiptit, pra, mund të themi se burimi kryesor i masonerisë është Egjipti i Lashtë. (Më lart pamë se lidhja kryesore mes traditave pagane dhe masonëve modernë ishin templarët.)



Në këtë pikë është e domosdoshme të kujtojmë se Egjipti i Lashtë ishte një nga shembujt, të cilit i janë referuar më së shumti si sistem ateist, ashtu sikurse tregohet edhe nga Zoti në Kur'an. Ai është prototip i vërtetë i një sistemi të lig. Shumë ajete tregojnë për faraonët që qeverisën Egjiptin dhe qarqet e ngushta të tyre, për egërsinë, padrejtësinë, ligësinë dhe teprimet e tyre. Për më tepër, egjiptianët ishin një popull i i pabindur. Ata e pranonin në heshtje sistemin e faraonëve të tyre dhe besonin në zotat e tyre të shpikur.

Pavarësisht nga kjo, masonët thonë se origjina e tyre është nga Egjipti i Lashtë dhe e shikojnë si një civilizim për t'u lavdëruar. Në një artikull të botuar në *"Mimar Sinan"*, lavdërohen tempujt e Egjiptit të Lashtë si *"burim i mjeshtërisë masone"*:

**... Egjiptianët themeluan Heliopolisin (qytetin e diellit) dhe Memfisin dhe sipas legjendës masone, këto dy qytete ishin burime të dijes dhe shkencës, apo siç theksojnë masonët "Drita e Madhe".** Pitagora, i cili vizitoi Heliopolisin, kishte shumë për të thënë rreth tempullit. Tempulli i Memfisit ku ai ishte trajnuar, kishte domethënie historike. **Në qytetin e Tebës kishte shkolla të avancuara. Pitagora, Platoni dhe Ciceroni ishin pranuar si masonë në këto qytete.**<sup>63</sup>

Shkrimet masone nuk e lavdërojnë Egjiptin e Lashtë vetëm në terma të përgjithshme; ata i lavdërojnë dhe shprehin simpati për faraonët që sundonin në atë sistem mizor. Në një artikull tjetër nga revista *"Mimar Sinan"*, thuhet:

**Detyra themelore e faraonit ishte të gjente Dritën.** Lartësimi i Dritës së Fshehur në mënyrën më të gjallë dhe më të fuqishme... **Ashtu siç po përpiqemi ne masonët që të ndërtojmë Tempullin e Solomonit, në të njëjtën mënyrë përpiqeshin edhe egjiptianët e lashtë të ndërtonin Ehramin, apo Shtëpinë e Dritës.** Ceremonitë që kryheshin në tempujt e Egjiptit të Lashtë ndaheshin në disa shkallë. Këto shkallë kishin dy ndarje: e vogla dhe e madhja. Shkalla e vogël kishte tre ndarje: të parën, të dytën dhe të tretën dhe pas këtyre

fillonin shkallët e mëdha.<sup>64</sup>

Nga kjo mund të shihet se “drita” për të cilën kërkonin faraonët e Egjiptit të Lashtë dhe masonët ishte e njëjta. Kjo, gjithashtu, mund të interpretohet si sugjerim se Masoneria është një përfaqësim modern i filozofisë së faraonëve egjiptianë. Natyra e kësaj filozofie demaskohet nga Zoti në Kur’an, ku faraoni dhe njerëzit e tij vlerësohen si: “...ata janë një popull i devijuar”, (Kur’an 27: 12).

Në disa ajete të tjera, sistemi ateist i Egjiptit përshkruhet në këtë mënyrë:

Ndërsa faraoni thirri popullin e vet e tha: "O popull im, a nuk është i imi pushteti i Egjiptit (i Misirit) dhe i këtyre lumenjve që rrjedhin nën pallatin tim, a nuk po shihni?" Pra, unë jam më i mirë se ky qyqar që mezi flet! Përse nuk i janë vënë atij byzylykë nga ari, ose të kenë ardhur bashkë me të engjëjt shoqërues? Dhe ashtu ai e frikësoi popullin e vet, e ata e respektuan, por ata ishin vërtet popull i shkatërruar. (Kur’an 43: 51-54)

## **SIMBOLET E EGJIPTIANËVE TË LASHTË NË LOZHAT MASONIKE**

Një nga çështjet më të rëndësishme që vendos lidhjen mes Egjiptit të Lashtë dhe masonëve janë simbolet e tyre.

Simbolet janë shumë të rëndësishme në Masoneri. Masonët ua zbulojnë anëtarëve të vet kuptimin e vërtetë të filozofisë së tyre nëpërmjet alegorisë. Një mason, që avancohet etapë pas etape, përgjatë 33 shkallëve të hierarkisë masonike, mëson kuptimet e reja për secilin simbol në çdo etapë. Në këtë mënyrë, anëtarët zhyten gradualisht në thellësitë e filozofisë masonike.

Në një artikull, të revistës “*Mimar Sinan*”, përshkruhen funksionet e simboleve të tyre:

Të gjithë e dimë se **Masoneria i shpreh idetë dhe idealet e veta me**



**anë të simboleve dhe rrëfimeve, pra alegorive.** Këto rrëfime kthehen në vitet e para të historisë. Madje mund të themi se ato shtrihen deri tek legjendat prehistorike. Në këtë mënyrë, Masoneria ka treguar lashtësinë e idealeve të saj dhe ka fituar një burim të pasur simbolesh.<sup>65</sup>

Konceptet e egjiptianëve të lashtë për këto simbole dhe legjenda janë ndër më të shquarat dhe nisin që nga vitet më të hershme të historisë. Kudo në lozhat masonike dhe shpesh në publikimet e tyre mund të gjenden vizatime të piramidave, sfinksave dhe hieroglifëve. Në një artikull të revistës *“Mimar Sinan”*, për burimet e lashta të Masonerisë, theksohet:

Nëse e zgjedhim Egjiptin e Lashtë si “më të lashtin” nuk besoj se gabohemi. Përveç kësaj, gjëja e cila, që në fillim na tërheq vëmendjen, është **fakti se ceremonitë, shkallët dhe filozofia e gjetur në Egjiptin e Lashtë janë shumë të ngjashme me ato të masonerisë.**<sup>66</sup>

Përsëri, një artikull tjetër, në *“Mimar Sinan”*, i titulluar *“Origjinat shoqërore dhe qëllimet e Frankmasonerisë”*, thuhet:


Në kohët e lashta në Egjipt, ceremonitë e pranimit në Tempullin e Memfisit zgjasnin shumë dhe kryheshin me vëmendjen dhe madhështinë më të madhe, gjë që tregon shumë ngjashmëri me ceremonitë masone.<sup>67</sup>

Le të shqyrtojmë disa shembuj të lidhjes ndërmjet Egjiptit të Lashtë dhe Masonerisë.

## PIRAMIDA NËN SY

Simboli më i njohur mason gjendet në **vulën** e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por gjithashtu edhe në kartmonedhën një-dollarëshe. Në këtë vulë gjendet një gjysmë-piramidë mbi të cilën qëndron një sy brenda një trekëndëshi. Ky sy brenda trekëndëshit është simboli që vazhdimisht gjendet në lozhat masonike dhe në të gjitha publikimet e tyre. Një numër i madh shkrimesh që shqyrtojnë






Modern Masonry preserved Ancient Egyptian philosophy and uses symbols to give it expression. In the above photograph of a lodge, the Pharaoh's image on the front of the altar is an example of this symbolism.









At the entrance of the Grand Masonic Lodge in Washington D. C. there are two Ancient Egyptian sphinxes.



Above, left and below: Representations of Masonic temples





A depiction of the Ancient Egyptian city of Memphis. The Masons regard this city, with its numerous pagan temples, as the "source of light."



këtë çështje të Masonerisë e theksojnë këtë fakt.

Piramida nën syrin brenda trekëndëshit tërheq relativisht pak vëmendje. Sidoqoftë, kjo piramidë është jashtëzakonisht domethënëse dhe të sqaron për kuptimin e filozofisë masonike. Një autor amerikan, Robert Hieronimus, shkroi një tezë doktrinale mbi vulën e Shteteve të Bashkuara, në të cilën ai dha disa informacione shumë të rëndësishme. Titulli i tezës së Hieronimusit ishte **“Një analizë historike e anës së prapme të vulës së famshme amerikane dhe lidhja e saj me ideologjinë e psikologjisë humaniste”**. Teza e tij tregon se themeluesit e Amerikës, që fillimisht e adoptuan vulën, ishin masonë, të cilët përkrahnin filozofinë humaniste. Lidhja e kësaj filozofie me Egjiptin e Lashtë simbolizohet nga piramida e vendosur në qendër të vulës. Kjo piramidë është një përfaqësim i **piramidës së Keopsit, varrezës më të madhe të faraonëve**.<sup>68</sup>

## **KUPTIMI MASONIK I YLLIT GJASHTËCEPËSH**

Një simbol tjetër shumë i njohur masonerisë është ylli gjashtëcepësh, i formuar nga mbivendosja e dy trekëndëshave. Ky është gjithashtu një simbol tradicional i çifutëve, që sot gjendet në flamurin e Izraelit. Është i njohur fakti se profeti Solomon e ka përdorur, për herë të parë, si vulë këtë simbol. Kështu, ylli gjashtëcepësh është një vulë e një profeti, pra një simbol hyjnor.

Por masonët kanë një koncept të ndryshëm për këtë. Ata nuk e pranojnë yllin gjashtëcepësh si simbol të profetit Solomon, por si një simbol të paganizmit të Egjiptit të Lashtë. Një artikull me titull **“Alegoria dhe simbolet në ritualet tona”**, botuar në **“Mimar Sinan”**, tregon për një varg faktesh interesante në lidhje me këtë çështje:

Një trekëndësh barabrinjës me tre cepa i baraslarguar nga një tjetër tregon se këto vlera janë të barasvlershme. Ky simbol, i adoptuar nga masonët që njihet si Ylli i Davidit, është një gjashtëkëndësh i formuar



## THE EYE AND THE PYRAMID

Among the most important Masonic symbols taken from Ancient Egypt is the pyramid with an eye within a triangle. The pyramid on the Great Seal of the USA (left) is the great pyramid of Cheops. The eye is a frequent symbol on Ancient Egyptian engravings. (bottom)



nga mbivendosja e një trekëndëshi barabrinjës mbi një tjetër. Sot ai njihet si simbol i çifutëve dhe gjendet në flamurin e Izraelit. **Por në të vërtetë, origjina e këtij simboli është në Egjiptin e Lashtë...** Kjo emblemë u krijua së pari, nga Kalorësit Templarë të cilët filluan ta përdornin si simbol dekorimi mbi muret e kishave të tyre. Kjo ndodhi për shkak se ata ishin të parët që zbuluan në Jeruzalem disa fakte të rëndësishme të krishtërimit. Pasi templarët u asgjësuan, kjo emblemë filloi të përdorej në sinagoga. Por në Masoneri ne pa dyshim, e përdorim këtë simbol në kuptimin universal që ai kishte në Egjiptin e Lashtë. Në këtë aspekt, ne kemi kombinuar bashkë dy forca të rëndësishme. Nëse fshini bazat e sipërme dhe të poshtme të dy trekëndëshave barabrinjës, do të zbuloni këtë simbol të rrallë të cilin e njihni shumë mirë.<sup>69</sup>

Në të vërtetë, ne duhet t'i interpretojmë në këtë mënyrë të gjitha simbolet masonike të lidhura me Tempullin e Solomonit. Siç është shpallur në Kur'an, Solomoni ishte një profet i bekuar mbi të cilin disa dëshirojnë të shpifin. Në një ajet kur'anor, Zoti thotë: **“E ndoqën atë që i thoshin djajtë në kohën e sundimit të Sulejmanit (Solomonit). Por Sulejmani nuk ishte i pafë, por djajtë ishin të pafë,... (Kur'an 2:102)**

Masonët e kanë adoptuar këtë ide të gabuar, që gabimisht i atribuohet profetit Solomon. Për këtë arsye, ata i japin atij një vend të rëndësishëm në doktrinat e tyre. Në librin e tij *“Komploti okult”*, historiani amerikan Michael Howard, thotë se, që nga mesjeta, Solomoni (larg qoftë) është konsideruar nga njerëz të ndryshëm injorantë, si një magjistar dhe si një nga ata i cili



One of Masonry's most important symbols is the six-pointed star.



The six-pointed star is the seal of a Prophet and a Divine symbol. However, Masons interpret it according to the pagan beliefs of Ancient Egypt.



futi disa ide pagane në judaizëm.<sup>70</sup>

Howard shpjegon se masonët e konsiderojnë tempullin e Solomonit si një “tempull pagan” dhe për këtë shkak ky tempull është i një rëndësie të veçantë.<sup>71</sup>

Ky imazh i rremë, i trilluar kundër profetit Solomon, që ishte një shërbëtor i devotshëm dhe i bindur i Zotit, tregon origjinën e vërtetë të Masonerisë.

## SHTYLLA E DYFISHTË


Një pjesë e domosdoshme e dekorit të një lozhe masonike është Shtylla e Dyfishtë në hyrje. Mbi to janë shkruar fjalët “Jachin” dhe “Boaz”, në imitim të dy shtyllave në hyrjen e tempullit të Solomonit. Por në fakt kjo nuk shihet nga masonët si një memorial për Solomonin, por ata janë një shprehje e hamendësimeve të tyre të gabuara kundër tij. Origjina e këtyre shtyllave, përsëri, na dërgon prapa në Egjiptin e Lashtë. Në artikullin me titull “Alegoria dhe simbolet në ritualet tona”, në revistën “Mimar Sinan”, shkruhet kështu:

Për shembull në Egjipt, Horusi dhe Seti ishin arkitektë binjakë dhe mbajtës të qiellit. Madje gjithashtu edhe Bakusi në Tebë. **Dy shtyllat në lozhat tona e kanë origjinën në Egjiptin e Lashtë.** Njëra nga shtyllat ishte në jug të Egjiptit, në qytetin e Tebës, ndërsa tjetra ishte në veri, në Heliopolis. Në hyrjen e tempullit Amenta, kushtuar Ptahut, zotit kryesor të Egjiptit, ishin dy shtylla si në tempullin e Solomonit. Në mitet e vjetra, që ka të bëjë me diellin, përmenden dy shtyllat, të quajtura inteligjenca dhe fuqia, të ngritura para portës së hyrjes për në përjetësi.<sup>72</sup>

## TERMINOLOGJIA EGJIPTIANE E LOZHAVE

Në librin e tyre “Çelësi i Hiramit”, autorët masonë britanikë, Christopher Knight dhe Robert Lomas, tërheqin vëmendjen për sa i





Various Masonic symbols: The double column, the eye, and the compass and the square.





përket rrënjëve të Masonerisë në Egjiptin e Lashtë. Një çështje interesante që ata zbulojnë në librin e tyre është, se fjalët e përdorura në ceremoninë, në të cilën masoni ngrihet në shkallën Mjeshtër mason, janë:

*Ma'at-neb-men-aa, Ma'at-ba-aa.*<sup>73</sup>

Knight dhe Lomas shpjegojnë se këto fjalë që janë përdorur në shumicën e kohës pa ua ditur kuptimin, janë fjalë nga Egjipti i Lashtë dhe duan të thonë:

“I madh është Mjeshtër Masoni i vendosur i Frankmasonerisë, i madh është shpirti i Frankmasonerisë.”<sup>74</sup>


Autorët theksojnë se fjala “ma’at” ka kuptimin e “ndërtuesit të murit” dhe përkthimi më i përafërt është “Masoneria”.

Kjo do të thotë se masonët modernë, mijëra vjet më vonë, e ruajnë ende gjuhën e Egjiptit të Lashtë në lozhat e tyre.

## “FLAUTI MAGJIK” I MOXARTIT

Një ndër prodhimet më interesante të Masonerisë është “Flauti magjik”, një opera e mirënjohur e kompozitorit, W.A.Moxart. Moxarti ishte mason dhe është fakt i njohur se shumë pjesë të kësaj opere përmbajnë mesazhe masonike. Çështje interesante është se në këto mesazhe janë të lidhura ngushtë me paganizmin e Egjiptit të Lashtë. “Mimar Sinan” e shpjegon kështu këtë çështje:

**Tashmë dihet që ka një lidhje të qartë mes Egjiptit të Lashtë dhe ritualeve masonike.** Pavarësisht nga përpjekjet e atyre që tentuan ta interpretojnë “Fyellin magjik” si “një rrëfim për Lindjen e largët”, në të vërtetë, në themelet e saj gjenden ritualet egjiptiane. Janë zotat dhe perëndeshat



Wolfgang Amadeus Mozart

e tempujve egjiptianë që kanë ndikuar në krijimin e karaktereve të “Flautit magjik”.<sup>75</sup>

### OBELISQET

Një simbol i rëndësishëm i masonerisë, i cili dikur ishte edhe një element me rëndësi në arkitekturën e egjiptianëve të lashtë, është **obelisku**. Obelisku është një kullë e gjatë vertikale, me një piramidë në majën e saj. Obelisqet, ku ishin gdhendur hieroglifet të Egjiptit të Lashtë, kanë qenë të varrosur nën tokë me shekuj, derisa u zbuluan në shekullin XIX dhe më pas u zhvendosën në qytete të ndryshme perëndimore si New York, Londër dhe Paris. Obelisku më i madh u dërgua në SHBA. Eksporti u organizua nga masonët. Kjo për shkak se si obelisqet ashtu dhe figurat e lashta egjiptiane të gdhendura në ta, siç pohonin masonët, ishin me të vërtetë simbolet e tyre. “Mimar Sinan” e thekson këtë gjë për obeliskun 21-metër të lartë në New York:

Shembulli më i mrekullueshëm i përdorimit simbolik të arkitekturës është monumenti i quajtur “**gjilpëra e Kleopatërës**”, që iu dha si dhuratë Shteteve të Bashkuara më 1878 nga guvernatori egjiptian Ismail. Tani ky monument gjendet në Central Park. Sipërfaqja e tij është e mbuluar me simbole masonike. Ky monument, është ngritur fillimisht në shekullin XVI para Krishtit, në hyrje të një tempulli të zotit Diell, një qendër pranimit në Heliopolis.<sup>76</sup>


### LEGJENDA E IZISIT- VEJUSHËS

Një ide e rëndësishme simbolike në Masoneri është ajo e vejushës. Masonët e quajnë veten fëmijët e vejushës dhe pikturat e vejushës duken shpesh nëpër publikimet tyre. Cila është origjina e kësaj ideje? Kush është kjo vejushë?

Kur shqyrtojmë burimet masone, shohim se simboli i vejushës, si origjinë rrjedh nga një legjendë egjiptiane. Kjo është një ndër legjendat më të rëndësishme të miteve të Egjiptit të Lashtë: “Historia e Ozirisit



dhe Izisit. Ozirisi ishte zot i pjellorisë dhe Izisi ishte gruaja e tij. Sipas legjendës, Ozirisi qe viktimë e një krimi për pasion dhe si pasojë e kësaj Izisi mbeti e ve. Në këtë mënyrë, vejusha masonike është Izisi. Një



An Ancient Egyptian depiction of Isis.

**Remains from Ancient Egypt: Monuments of pharaohs with an obelisk rising in front of them in the Valley of the Kings.**



artikull në “Mimar Sinan”, e shpjegon këtë çështje në këtë mënyrë:

Legjenda e Ozirisit- Izisit është temë e shumë artikujve e predikimeve dhe është legjenda më e afërt mes miteve të egjiptianëve të lashtë me Masonerinë. Testi për t’u bërë prift në tempullin e Izisit është vetë riti i pranimit në Maseri. Do të ishte e mërzitshme të ripërsëritej. Atje, drita ishte një nga elementet më të rëndësishme: “në mënyrë që të varroset në errësirën e Lindjes, dielli i mëngjesit

fillon të bjerë poshtë pas mesditës dhe merr detyrën nga Ozirisi çdo ditë, sikurse Horusi që në mënyrën më të shkëlqyer zuri vendin e babait të tij të vvarë. Prandaj, “vejusha”, fëmijët e së cilës jemi ne, nuk është askush tjetër përveç gruas së Ozirisit, vejushës Izis.<sup>77</sup>

Pra siç shohim, Masoneria, e cila e përshkruan veten si të themeluar mbi bazat e arsyes dhe shkencës, në të vërtetë është një doktrinë mitologjike, përplot me besime supersticioze.



An Ancient Egyptian depiction of Isis.

## KOMPASI DHE KATRORI

Nga simbolet më të njohura të Masonerisë është kompas i mbivendosur në një katror. Kur, masonët pyeten për këtë, ata thonë se ky simbol paraqet konceptin e shkencës, rregullin gjeometrik dhe mendimin racional. Megjithatë, kompas dhe katrori, në të vërtetë

kanë një kuptim krejtësisht të ndryshëm.

Këtë e mësojmë nga një libër i shkruar nga njëri prej masonëve më të mëdhenj të të gjitha kohërave. Në librin e tij “Morale dhe dogma”, Albert Pike shkruan si vijon për simbolin e kompasit dhe katrorit:

katrori... është një simbol natyral dhe i përshtatshëm për tokën...

Figura hermafrodite është simbol i natyrës së dyfishtë që u është dhënë perëndive në lashtësi, si gjenerues dhe prodhues: Brahmit dhe Majas në mesin e arianëve dhe si Ozirisi dhe Izisi në mesin e egjiptianëve. Duke qenë se Dielli ishte mashkull, Hëna ishte femër.<sup>78</sup>

Kjo do të thotë se kompasit dhe katrori, simboli më i njohur i Masonerisë, është një simbol i paganizmit arian dhe datojnë që nga Egjipti i Lashtë, apo para ardhjes së krishtërimin. Në paragrafin e cituar nga Pike, hëna dhe dielli janë simbole të rëndësishme në lozhat masonike, por ata nuk janë gjë tjetër veçse reflektim i besimeve të kota të këtyre shoqërive të lashta pagane që adhuronin hënën dhe diellin.

## FILOZOFIA PAGANE E MASONERISË

Deri më tani kemi mësuar se origjina e Masonerisë qëndron mbi një doktrinë pagane, që shtrihet pas në Egjiptin e Lashtë dhe se kuptimi i vërtetë i koncepteve dhe simboleve të saj është i mistershëm. Për këtë arsye, Masoneria është në konflikt me fetë monoteiste. Ajo është humaniste, materialiste dhe evolucioniste. Historiani amerikan, Michael Howard e shpjegon këtë sekret, që u zbulohet tërësisht vetëm masonëve të shkallës më të lartë:

Pse duhet të krishterët të jenë kaq kritikë ndaj Frankmasonerisë...?...

Përgjigja e kësaj pyetje qëndron në “sekretet” e Frankmasonerisë. Nëse këto sekrete do të ishin lehtësisht të disponueshme për publikun e gjerë, padyshim, që përmbajtja e tyre do të kuptohej nga ata që nuk kanë dijeni për doktrinën e okultizmit dhe fesë së lashtë. Në fakt vihet në dyshim nëse shumë nga anëtarët e zakonshëm të lozhave e kuptojnë apo jo se çfarë përfaqësojnë sekretet e tyre. Në





qarqet e brendshme të Masonerisë, në mesin e atyre që kanë arritur shkallët e larta, ka masonë që e kuptojnë se janë trashëgimtarë të një tradite të lashtë para-kristiane, të transmetuar që nga kohërat e paganizmit.<sup>79</sup>

Kur shikojmë shkrimet masone turke, kuptojmë se masonët e shkallës më të lartë kanë në zotërim dijen, që e mbajnë fshehur nga vëllezërit e tjerë. Mjeshtër masoni Nexhdet Egeran shpjegon se çfarë mendojnë masonët e shkallës më të lartë për këtë çështje:

Disa masonë e kuptojnë Masonerinë vetëm si një lloj gjysmë feje, gjysmë institucioni bamirës vëllazëror, ku ata mund të krijojnë marrëdhënie të këndshme shoqërore dhe t'i trajtojnë ato në varësi të rrethanave. Të tjerë mendojnë se qëllimi i Masonerisë është vetëm, që t'i bëjë më të mirë njerëzit e mirë. Të tjerë akoma, mendojnë se




**Albert Pike and a Masonic medallion produced in his memory.**

Masoneria është një vend për të ndërtuar karakterin. Me pak fjalë, ata të cilët nuk dinë të lexojnë, të shkruajnë gjuhën e shenjtë të Masonerisë, apo të kuptojnë domethënien e simboleve dhe alegorive, mendojnë në këtë mënyrë apo në ndonjë mënyrë tjetër të ngjashme. **Por për një numër të vogël masonësh që kanë mundur të futen thellë në të, Masoneria dhe qëllimet e saj janë mjaft të ndryshme.** Masoneri do të thotë një dituri e zbuluar, një nismë dhe një fillim. Do të thotë të lësh anash një mënyrë të vjetër jetëse dhe të hysh në një jetë të re dhe të qetë fisnike... Përtej simbolizmit elementar dhe themelor të Masonerisë ekzistojnë një seri shpalljesh që na ndihmojnë për të hyrë në një jetë të brendshme më të lartë dhe për të mësuar të fshehtat e ekzistencës sonë. Pra, është kjo jetë e brendshme dhe hyrja në të, që e bën të mundur arritjen e Iluminizmit (Ndriçimit të mendjes) të Masonerisë. Vetëm atëherë bëhet e mundur, që të mësohet natyra dhe kushtet e përparimit dhe evolucionit.<sup>80</sup>

Ky paragraf nënvizon, se edhe pse disa masonë të shkallëve më të





The compass and square depicted with the eagle, one of Ancient Egypt's most important symbols.

ulëta mendojnë se Masoneria është organizatë shoqërore dhe bamirëse, në të vërtetë ajo ka të bëjë me të fshehtat e ekzistencës së njeriut. Kështu pra, pamja e jashtme e Masonerisë si organizatë shoqërore dhe bamirëse, është në të vërtetë një maskë për të fshehur filozofinë e organizatës. Në realitet, Masoneria është një organizatë që synon t'iu imponojë sistematikisht, anëtarëve të saj si dhe pjesës tjetër të shoqërisë, një filozofi specifike.

Siç thamë në fillim, elementi bazë i kësaj filozofie, i cili është përhapur nga kulturat pagane, veçanërisht ato të Egjiptit të Lashtë, është materializmi.

## **MATERIALIZMI NË BURIMET MASONE GABIMI I MATERIES ABSOLUTE**

Masonët e ditëve të sotme, ashtu si edhe faraonët, priftërinjtë dhe klasat e tjera të Egjiptit të Lashtë, besojnë në përjetësinë dhe në jo



krijueshmërinë e materies dhe, se jashtë kësaj materie të pajetë, qeniet e gjalla erdhën në jetë nga rastësia. Në shkrimet masone mund të lexojmë të dhëna të hollësishme të këtyre gabimeve themelore të filozofisë materialiste.

Në librin e tij "Frymëzime nga Frankmasoneria", mjeshtri mason Selami Isindag, shkruan për filozofinë e pastër materialiste të Masonerisë:

Gjithë hapësira, atmosfera, yjet, natyra, të gjitha qeniet e gjalla dhe jo të gjalla përbëhen nga atomet. Qeniet njerëzore s'janë asgjë më tepër veçse një koleksion atomelesh që ndodh spontanisht. Një ekuilibër në përçimin e elektricitetit mes atomeve siguron ekzistencën e qenieve të gjalla. Kur ky ekuilibër shkatërrohet (nuk ka më elektricitet në atome) ne vdesim, i kthehemi tokës dhe transformohemi në atome. Kështu pra, ne kemi ardhur nga materia dhe energjia dhe prapë do të kthehemi në materie dhe energji. Bimët i përdorin atomet tona dhe të gjitha qeniet e gjalla, përfshirë kwtu edhe njerwzit, i përdorim bimët. Çdo gjë është bërë nga e njëjta substancë. Por për shkak, se truri ynë ka evoluar më shumë se i të gjitha kafshëve të tjera, është shfaqur vetëdija. Nëse shikojmë rezultatet e psikologjisë eksperimentale, shohim se përjetimet tona psikike të trefishta të emocioneve-mendjes-vullnetit janë rezultat i funksionit të ekuilibruar të qelizave të kores së trurit dhe hormoneve...

**Shkenca ekzakte pranon se asgjë nuk vjen në ekzistencë nga hiçi, dhe asgjë nuk do të shkatërrohet. Si rezultat, mund të arrihet në përfundimin se njerëzit nuk duhet të jenë falënderues apo të varur ndaj asnjë fuqie. Gjithësia është një tërësi energjie pa fillim dhe pa mbarim. Çdo gjë që lind nga kjo tërësi energjie, evoluon dhe vdes, por nuk zhduket kurrë plotësisht. Gjërat ndryshojnë dhe transformohen. Në të vërtetë nuk ka gjëra të tilla si vdekja apo humbja; ekziston vetëm ndryshimi, transformimi dhe riformimi i vazhdueshëm. Por nuk është e mundur që kjo çështje e madhe dhe**





The materialist theories in Masonic literature are no different from those found in the writings of materialist ideologues such as Marx, Engels and Lenin.

kjo fshehtësi e gjithësisë, të shpjegohet me anën e ligjeve shkencore. Shpjegimet jashtë-shkencore janë përshkrime imagjinare, dogma dhe besime të kota. **Sipas shkencës ekzakte dhe arsyes, shpirti nuk ekziston i pavarur nga trupi.**<sup>81</sup>

Pikëpamje të njëjta me këto mund të gjesh edhe në librat e mendimtarëve materialistë si K. Marx, F. Engels, V. I. Lenin, G. Politzer, C. Sagan dhe J. Monod. Të gjithë këta e kanë pranuar mitin bazë materialist se gjithësia ka ekzistuar gjithmonë, se materia është gjëja e vetme absolute që ekziston, se njerëzit janë të përbërë nga materia dhe se nuk kanë shpirt, se materia evoluon jashtë dhe brenda vetvetes dhe se jeta ka lindur rastësisht. Është e drejtë të përdoret shprehja **“mit”** sepse, në kundërshtim me pretendimin e Isindagut se “këto procese janë rezultat i shkencës ekzakte dhe arsyes”, të gjitha

këto pikëpamje janë hedhur poshtë nga zbulimet shkencore në gjysmën e dytë të shekullit XX. Për shembull, teoria e Big Bengut, e pranuar si e vërtetë në qarqet shkencore, tregon shkencërisht se gjithësia u krijua nga hiçi para miliona vjetësh. Ligjet e termodinamikës tregojnë se materia nuk ka aftësi të vetëorganizohet dhe se ekuilibri dhe rregulli në univers janë rezultat i një krijimi të vetëdijshëm. Me paraqitjen e strukturës së jashtëzakonshme tek qeniet e gjalla, biologjia vërteton ekzistencën e një Krijuesi, me fjalë të tjera Zotit, i Cili krijoi gjithçka. (Për informata më të hollësishme, shih librat e autorit Harun Yahya: *“Krijimi i universit”*, *“Gjunjëzimi i evolucionit”* dhe *“Përgënjeshtrimi i evolucionit”*.)

Në artikullin e tij Isindag vazhdon të shpjegojë se në fakt masonët janë materialistë dhe si rrjedhojë edhe ateistë. Ata e përdorin konceptin e *“Arkitektit të Madh të Universit”*, duke iu referuar evolucionit të materies:

Dëshiroj të prek shkurtimisht disa parime, mendime të adoptuara nga masonët: Sipas Masonerisë, jeta fillon nga një qelizë e vetme, që ndryshon, transformohet dhe evoluon në një qenie njerëzore. Natyra, shkak, qëllimi, apo kushtet e këtij fillimi nuk janë të njohura. **Jeta lind nga kombinimi i materies dhe i energjisë, që ripërsëritet vazhdimisht.** Nëse ne e pranojmë *“Arkitektin e Madh të Universit”*, si një parim sublim, një horizont pafund të mirësisë dhe bukurisë, kulmi i evolucionit, etapa e tij më e lartë dhe ideali drejt të cilit orvaten qeniet njerëzore dhe në qoftë se ne nuk e personalizojmë atë, mund të shpëtojmë nga dogmatizmi.<sup>82</sup>

Siç e shohim, një nga parimet themelore të filozofisë masonike është se **gjërat lindin nga materia dhe kthehen në materie.** Një aspekt interesant i kësaj pikëpamje është se masonët nuk e konsiderojnë këtë filozofi si të veçantë vetëm për veten e tyre, por dëshirojnë që t'i përhapin këto ide në të gjithë shoqërinë. Isindag vazhdon:

Masoni i përgatitur me këto parime dhe doktrina e pranon detyrën



**për t'i edukuar njerëzit... dhe për t'i udhëzuar ata me parimet e arsyes dhe shkencës ekzakte.** Në këtë mënyrë, Masoneria iu drejtohet njerëzve. **Ajo punon në emër të njerëzve pavarësisht nga njerëzit.**<sup>83</sup>

Këto fjalë shfaqin dy aspekte të rolit dallues të Masonerisë në shoqëri:

1. Nën maskën e shkencës ekzakte dhe arsyes, Masoneria tenton t'i imponojë pjesës tjetër të shoqërisë filozofinë materialiste në të cilën ajo beson (d.m.th. mitin e Egjiptit të Lashtë).

2. Masonët tentojnë ta bëjnë këtë pavarësisht nga njerëzit. Pra, edhe nëse një shoqëri beson tek Zoti dhe nuk dëshiron ta pranojë filozofinë materialiste, Masoneria tregohet e paepur në përpjekjet e saj për t'ua ndryshuar pikëpamjet njerëzve në lidhje me këtë botë, pa pëlqimin e tyre.

Ekziston një çështje e rëndësishme tek e cila duhet të drejtojmë vëmendjen: terminologjia që përdorin masonët është mashtruese. Në shkrimet e tyre, veçanërisht në ato, të cilat i drejtohen pjesës tjetër të shoqërisë, masonët përdorin një gjuhë të qëllimshme, për ta shfaqur filozofinë e tyre si të padëmshme, inteligjente dhe tolerante. Një shembull i kësaj është citati i mësipërm nën nocionin e **“për t'i edukuar njerëzit... dhe për t'i udhëzuar ata me parimet e arsyes dhe shkencës ekzakte”**. Në të vërtetë, filozofia masonike nuk ka të bëjë fare me “shkencën dhe arsyen”. Ajo ka të bëjë me një mit të dalë mode, që nuk qëndron nga aspekti shkencor. Qëllimi i Masonerisë nuk është që t'i udhëzojë njerëzit. Masonët tentojnë t'ua imponojnë qëllimisht njerëzve filozofinë e tyre. Kur ata shprehen se janë të vendosur që ta bëjnë këtë pavarësisht nga njerëzit, shohim se ata nuk janë tolerantë, por shfaqin pikëpamje totalitare.

## **MOHIMI I EKZISTENCËS SË SHPIRTIT DHE BOTËS SË PËRTEJME**

Si pjesë e besimit të tyre materialist, masonët nuk pranojnë ekzistencën e shpirtit të njeriut dhe e mohojnë tërësisht idenë e botës së përtejme. Pavarësisht nga kjo, në shkrimet masone ndonjëherë për të vdekurit thuhet se kanë "kaluar në përjetësi" apo shprehje të tjera të ngjashme shpirtërore. Kjo mund të duket kontradiktore, por nuk është, pasi në të vërtetë të gjitha referimet e masonerisë ndaj pavdekshmërisë së shpirtit janë simbolike. Revista "Mimar Sinan", në një artikull të titulluar "Pas vdekjes në Frankmasoneri", bie dakord me këtë çështje:

Në mitin e Mjeshtër Hiramit, masonët e pranojnë ringjalljen pas vdekjes në një mënyrë simbolike. Kjo ringjallje tregon se e vërteta gjithmonë triumfon mbi vdekjen dhe errësirën. **Masoneria nuk i jep asnjë rëndësi ekzistencës së një shpirtit të ndarë nga trupi. Në Masoneri, ringjallja pas vdekjes është që t'u lësh trashëgimi njerëzve disa punë shpirtërore apo materiale.** Kjo e bën një qenie njerëzore të pavdekshme. Ata që kanë qenë të aftë ta bëjnë emrin e tyre të pavdekshëm në këtë jetë të shkurtër mashtruese, janë ata njerëz që kanë qenë të suksesshëm. Ne, këta njerëz që i kanë bërë emrat e tyre të pavdekshëm, i konsiderojmë, si njerëz që e kanë shpenzuar gjithë mundin e tyre si për bashkëkohësit ashtu edhe për gjeneratat që do të vijnë pas tyre, për t'i bërë njerëzit të lumtur dhe për të siguruar për ta një botë më njerëzore.

Qëllimi i tyre është që të zgjojnë impulset njerëzore që ndikojnë në jetët e tyre ... Qeniet njerëzore që kërkojnë pavdekësi gjatë shekujve mund ta arrijnë atë përmes punës që bëjnë, shërbimeve që ata kryejnë dhe ideve që prodhojnë. Kjo do t'i japë kuptim jetëve të tyre. Siç shpjegonte Tolstoi: "atëherë parajsja do të vendosej këtu në tokë dhe





Masons believe in materialism and reject the idea of life after death. Sometimes the concept of life after death appears in Masonic texts, but, as in the myth of Hiram depicted here (left), what is meant by it is the continuation of the memory of a person's name in this world.

njerëzit do të arrinin të merrnin më të mirat e mundshme".<sup>84</sup>

Për të njëjtën temë, mjeshtri mason Isindag shkruan:

**PËRMBAJTJA E ÇDO GJËJE:** Masoneria e kupton këtë si energji dhe materie. Ata thonë se çdo gjë ndryshon etapë pas etape dhe kthehet prapë në materie. Shkencërisht, kjo përkufizohet si vdekje. Misticizmi në këtë çështje, pra besimi se, nga dy forcat prej të cilave është i përbërë një njeri: shpirti dhe trupi, **trupi do të vdesë ndërsa shpirti jo, se shpirtrat do të kalojnë në botën e shpirtrave dhe vazhdojnë ekzistencën e tyre atje derisa të kthehen në një trup tjetër kur t'i urdhërojë Zoti, nuk përshtatet me idetë e ndryshim -**

**transformimit të pranuar nga Masoneria.** Idetë e Masonerisë në lidhje me këtë çështje mund të shprehen në këtë mënyrë: **“Pas vdekjes tënde, të vetmet gjëra që do të mbeten nga ti dhe nuk do të vdesin, janë kujtimet e moshës së pjekurisë dhe asaj që ke arritur të bësh.”** Ky mendim është një lloj mënyre filozofike e të menduarit e bazuar në principet e shkencës ekzakte dhe arsyes. Besimi fetar nuk pajtohet me principet e shkencës ekzakte për sa i përket pavdekshmërisë së shpirtit dhe ringjalljes pas vdekjes. Masoneria, principet e veta të të menduarit i ka marrë nga sistemet e shkencave ekzakte dhe racionale. Kështu që, për këtë çështje filozofike, ajo ka një mënyrë të të menduarit dhe të shpjeguarit të ndryshëm nga feja.<sup>85</sup>

Refuzimi i ringjalljes pas vdekjes dhe kërkimi i pavdekësisë në trashëgiminë e kësaj bote... Edhe pse masonët e prezantojnë këtë ide, si në përputhje me shkencën moderne, ajo në të vërtetë, është një mit që besohej nga ateistët që në vitet e hershme të historisë njerëzore. Kur’ani thotë se njerëzit që nuk besonin në Zot **“ndërtuan ndërtesa të shkëlqyeshme duke shpresuar se do të jetojnë përgjithmonë.”** Hudi (paqja qoftë mbi të), një nga profetët e së shkuarës, e paralajmëroi popullin e Adit kundër kësaj injorance, siç shkruhet më poshtë:

**Kur vëllai i tyre, Hudi u tha: "A nuk frikësoheni?"**

**Unë për ju jam i dërguar besnik.**

**Andaj, keni frikë (dënimit të) All-llahut dhe më dëgjoni mua.**

**Unë nuk kërkoj për këtë ndonjë shpërblim prej jush, shpërblimi është vetëm prej Zotit të botëve.**

**A në çdo bregore ngrini ndonjë shtëpi (ndërtesë) sa për lojë?**

**Dhe a i ndërtoni pallatet e fortifikuara që të jeni përgjithmonë?**

**E kur rrëmbeni, rrëmbeni mizorisht.**

**Pra, kijeni frikë All-llahun dhe më dëgjoni mua! (Kur’an 26:124-131)**

Gabimi që bënë këta njerëz të pafe, nuk ishte ndërtimi i godinave





të bukura. Edhe muslimanët, gjithashtu, i japin rëndësi artit. Duke e përdorur atë, ata përpiqen të zbukurojnë botën. Ndryshimi qëndron tek qëllimi. Muslimani interesohet për artin deri në atë shkallë sa të shprehë bukurinë dhe nocionet estetike që Zoti u ka dhënë qenieve njerëzore. Ndërsa njerëzit e pafe gabohen kur e konsiderojnë artin si një rrugë për në pavdeksi.

## **MOSPAJTIMI SHKENCOR I MOHIMIT TË SHPIRTIT**

Mohimi që i bëjnë masonët ekzistencës së shpirtit dhe pretendimi i tyre se vetëdija njerëzore përbëhet nga materia, nuk përputhet me shkencën. Përkundrazi, zbulimet moderne shkencore tregojnë se vetëdija njerëzore nuk mund të reduktohet në nivelin e materies dhe se ajo nuk mund të shpjegohet në aspektin e funksioneve të trurit.

Një shqyrtim i kësaj literature tregon se shkencëtarët nuk kanë arritur në ndonjë përfundim, si rezultat i përpjekjeve të tyre për ta reduktuar vetëdijen deri në nivelin material të trurit, pavarësisht përpjekjeve të tyre të shumta të bazuara në besimin materialist dhe përfundimisht shumë prej tyre kanë hequr dorë. Sot, shumë studiues janë të mendimit se vetëdija njerëzore vjen nga një burim i panjohur, përtej neuroneve të trurit, molekulave apo atomeve që i formojnë ato.

Pas shumë vitesh studimi, njëri nga këta studiues, Wilder Penfield, arriti në përfundimin se ekzistenca e shpirtit është një fakt i pamohueshëm:

Pas shumë vite përpjekjesh për shpjegimin e mendjes, vetëm në bazë të funksionimit të trurit, kam arritur në përfundimin se është shumë më e thjeshtë (madje të themi më llogjike) që dikush të adoptojë hipotezën se qenia jonë përbëhet nga dy elemente bazë [truri dhe mendja (apo shpirti)] ...sepse duket se është i sigurt fakti, që do të jetë e pamundur të shpjegohet vetëdija vetëm në bazë të funksionimit të



neuroneve brenda trurit... **jam i detyruar të zgjedh propozimin, se qenia jonë shpjegohet në bazë të dy elementeve themelore (truri dhe mendja, apo trupi dhe shpirti).**"<sup>86</sup>

Ajo që i shtyn shkencëtarët drejt këtij përfundimi është fakti se vetëdija nuk mund të përshkruhet kurrë vetëm në bazë të faktorëve materialë. Truri i njeriut është si një kompjuter i jashtëzakonshëm, në të cilin përmbliidhen dhe përpunohen informatat nga pesë shqisat tona. Por, ky kompjuter nuk e ka sensin e "vetvetes"; ai nuk mund të mendojë, të ndjejë apo t'i konceptojë ndjenjat që pranon. Fizikanti i shquar anglez, Roger Penrose, në librin e tij "*Mendja e re e perandorit*", shkruan:

**Por cila është ajo që përcakton identitetin personal e një personi të caktuar? A mos janë atomet që përbëjnë trupin e tij? A varet identiteti i tij nga veçantia e elektroneve, protoneve dhe e grimcave të tjera nga të cilat përbëhen atomet?**

Ekzistojnë të paktën dy arsye se përse përgjigja ndaj këtyre pyetjeve është mohuese. Së pari, në trupin e çdo qenie të gjallë ekziston një qarkullim i vazhdueshëm i materies. Kjo zbatohet veçanërisht në qelizat e trurit të njeriut, pavarësisht nga fakti se pas lindjes së njeriut nuk prodhohen më qeliza të reja të trurit. Shumica e atomeve në çdo qelizë të gjallë (përshirë këtu edhe qelizat e trurit) - dhe në fakt, praktikisht gjithë materiali i trupit tonë - ndërrohen disa herë gjatë jetës. Arsyeya e dytë vjen nga fizika kuantike ...Nëse një elektron në trurin e një personi do të zëvendësohej me një elektron të njëjtë (siç zëvendësohet një tullë me një tjetër), atëherë edhe gjendja e sistemit do të ishte krejtësisht e njëjtë siç ishte më parë, thjesht e padallueshme! E njëjta gjë vlen edhe për protonet dhe grimcat e tjera, si dhe për atomet e molekulat në tërësi, etj. **Nëse e gjithë përbërja materiale e një personi do të zëvendësohej me grimcat përkatëse, si tullat e shtëpisë, praktikisht mund të themi se në të vërtetë, në strukturë nuk ndodh kurrfarë ndryshimi.**<sup>87</sup>




Penrose thotë qartë se, nëse të gjitha atomet e njeriut do të zëvendësoheshin me atome tulla, cilësitë që e bëjnë një qenie njerëzore të ndërgjegjshme, do të mbeteshin plotësisht të njëjta. Ose mund të mendojmë të kundërtën. Nëse do të zëvendësoheshin grimcat e atomeve të trurit me atome tulla, ata nuk do të mund të ishin të vetëdijshëm.

Shkurtimisht, ajo që e bën qenien njerëzore njeri nuk është një cilësi materiale. Ajo është cilësi shpirtërore dhe është e qartë se burimi i saj ekziston pavarësisht nga materia. Në konkluzionin e librit të tij, Penrose pohon:

Vetëdija më duket se është një fenomen i rëndësishëm. Unë thjesht nuk mund ta besoj se është diçka që ekziston “rastësisht” nga një llogaritje e komplikuar. Ajo është një fenomen me të cilën bëhet e njohur edhe ekzistenca e universit.<sup>88</sup>

Atëherë, cila është pikëpamja e materialistëve nën dritën e këtyre zbulimeve? Si mund të pretendojnë materialistët se qeniet njerëzore përbëhen vetëm nga materia dhe se një njeri me inteligjencë, ndjenja, mendime, memorie dhe shqisa, është krijuar rastësisht nga atomet e pajeta dhe të pavetëdijshme? Si mund të mendojnë që një proces i tillë është i mundshëm?

Këto pyetje shqetësojnë të gjithë materialistët. Por, në lidhje me këto tema, shkrimet masonike përmbajnë ide edhe më kurioze sesa çdo gjë tjetër e gjetur në shkrimet e materialistëve. Kur i shohim këto shkrime, mund të kuptojmë qartë se pas filozofisë materialiste qëndron “adhurimi i materies”.



**Prof. Penrose maintains that materialism can never account for the human mind.**

## MATERIALIZMI MASONIK: HYJNIZIMI I MATERIES

Është e domosdoshme që të kuptohet qartë se çfarë është filozofia materialiste: Ata që e përqafojnë këtë filozofi besojnë se rregulli madhështor, dhe ekuilibri i universit dhe i miliona llojeve të qenieve të gjalla në botë, përfshirë këtu edhe qeniet njerëzore, u shfaqën vetëm nga aktiviteti i atomeve që përbëjnë materien. Me fjalë tjera, ata besojnë se atomet e pajeta dhe të pavetëdijshme janë krijuese. (Sigurisht Zoti është përtej kësaj).

Pa marrë parasysh se sa moderne mund të duket kjo ide, në të vërtetë, ajo është rishfaqja e një besimi që ka ekzistuar që në etapat e parë të historisë: **idhujtarisë**. Ata që adhuronin idhujt besonin se statujat apo idhujt që ata adhuronin kishin shpirt dhe fuqi. Me fjalë të tjera, ata ia atribuonin vetëdijen dhe fuqinë e madhe materies së pajetë dhe të pavetëdijshme. Padyshim që kjo është e pakuptimtë. Në Kur'an, Zoti i referohet paganizmit irracional. Në tregimet për pejgamberët, natyra false e besimeve pagane theksohet në veçanti. Për shembull, në një ajet kuranor tregohet se Ibrahim (a.s) e pyet babanë e tij, **"O babai im, pse adhuron atë që as nuk dëgjon, as nuk sheh, e prej të cilit nuk ke kurrfarë dobie?"** (Kur'an, 19:42). Është e qartë se, të hyjnizosh materien e pajetë, e cila as nuk mund të shohë e as të dëgjojë dhe që nuk ka kurrfarë fuqie, është vërtet qesharake.

Materialistët janë shembuj modernë të idhujtarëve. Ata nuk adhurojnë statujat apo idhujt prej guri apo druri, por besojnë në idenë se materia është pjesë përbërëse e të gjitha trupave dhe mendojnë se kjo materie ka fuqi, inteligjencë dhe njohuri të paskajshme. Shkrimet masonike kanë disa gjëra interesante që flasin në lidhje me këtë çështje, pasi masonët e pranojnë haptazi këtë besim pagan, i cili është edhe esenca e materializmit. Në një artikull në revistën *"Mimar Sinan"*, shkruhet:



Në mënyrë që një objekt material të vijë në jetë, atomet duhet të vendosen së bashku sipas një rregulli të caktuar. Forca që shkakton këtë organizim është shpirti që zotëron çdo atom. Pasi çdo shpirt është një vetëdije, çdo send i krijuar është vetëdije inteligjente. Dhe çdo gjë e krijuar ka të njëjtin nivel inteligjence. Një njeri, një kafshë, një baktere dhe një molekulë kanë të gjitha të njëjtën shkallë inteligjence.<sup>89</sup>

Nga këto pohime vërejmë se çdo atom ka inteligjencë dhe vetëdije. Shkrimtari mason, nëpërmjet këtij deklarimi, propozon se çdo gjë ka vetëdije, për shkak të atomeve që zotëron, dhe duke qenë se ai e mohon ekzistencën e shpirtit të njeriut, ai e konsideron njeriun si një masë atomesh, njësoj si një kafshë apo një molekulë e pajetë.

Sidoqoftë, e vërteta është kjo: materia e pajetë (atomi) nuk ka shpirt, vetëdije apo inteligjencë. Ky është një fakt i provuar si nëpërmjet vëzhgimit ashtu edhe me anë të eksperimentimit. Vetëm qeniet e gjalla kanë vetëdije dhe ajo është rezultat i “shpirtit” që Zoti u ka dhuruar atyre. Prej gjithë qenieve të gjalla, njerëzve u është dhuruar shkalla më e lartë e vetëdijes, pasi ata zotërojnë një shpirt të veçantë, të cilin ua ka dhuruar Zoti.

Me fjalë të tjera, ndryshe nga ç’besojnë masonët, vetëdija nuk gjendet në materien e pajetë, por në qeniet që kanë shpirt. Por, në mënyrë që të pranojnë ekzistencën e Zotit, masonët i drejtohen besimit qesharak që ua atribuon “shpirtin” atomeve.

Ky besim materialist, i përqaftuar nga masonët, është një shprehje e re e besimit pagan, e quajtur “**animizëm**”, që supozon se çdo gjë materiale në natyrë (shkëmbinjtë, malet, era, uji, etj.) ka shpirtin dhe vetëdijen e vet. Filozofi grek Aristoteli e ndërthuri këtë besim me materializmin (besimin se materia është absolute dhe nuk është e krijuar) dhe madje edhe sot, atribuimi i vetëdijes të gjërave të pajeta – që është thelbi i materializmit – është bërë një lloj paganizmi bashkëkohor.



Shkrimet masone janë plot me tregime interesante në lidhje me këtë besim. Në një artikull në *“Mimar Sinan”*, të titulluar *“Rruga e së vërtetës”*, shkruhet:


**Nëse pranojmë hierarkinë animiste d.m.th se shpirti ekziston në atome**, se një molekulë drejton shpirtin në një atom, se një qelizë drejton shpirtin në një molekulë, se një organ drejton shpirtin në një qelizë, a nuk është shpirti kryesor, që e drejton tërë trupin, zot i të gjithë këtyre shpirtrave të vegjël? <sup>90</sup>

Kjo doktrinë e rreme dhe primitive bën që masonët të besojnë se ekuilibri dhe rregulli në univers vendoset nga materia e pajetë. Po ashtu, në *“Mimar Sinan”*, u botua një artikull në lidhje me zhvillimet gjeologjike globale. Ai thekson:

Ky dëmtimi sipërfaqësor ndodh në mënyrë aq delikate sa që mund të themi se **gjendja aktuale e jetës është formuar si rezultat i kësaj inteligjence të fshehur në magmë**. Nëse nuk do të ishte kështu, uji nuk do të mbledhej nëpër zbrazëtira dhe toka do të mbulohej krejtësisht nga ai. <sup>91</sup>

Në një artikull tjetër, në revistën *“Mimar Sinan”*, thuhet se qelizat e para të gjalla dhe qelizat që u shumuan më vonë nga ato, ishin të

**Materialism believes in the creative ability of lifeless and unconscious matter. In other words, it turns matter into an idol. Masons believe that atoms have spirit and openly admit to their belief in such a superstition.**






Pagans of bygone ages worshipped idols made of stone. Today's pagans idolize matter.

ndërgjegjshme, kishin bërë një plan dhe e kishin zbatuar atë:

Fillimi i jetës në tokë ndodhi kur lindi qeliza e parë. Kjo qelizë e vetme menjëherë filloi të lëvizte e nën një impuls jetik dhe me të vërtetë këmbëngulës, u nda më dysh dhe vazhdoi përgjatë kësaj rruge ndarjeje të pafundme. Por këto qeliza të ndara nuk e kuptonin qëllimin e endjes së tyre, dhe si t'i frikësoheshin kësaj endjeje, nën



A relief from the pagan civilization of Mesopotamia.





drejtimin e një vetë-ruajtjeje instiktive të fuqishme, ata filluan të bashkëpunonin me njëra-tjetrën, u bashkuan dhe punuan në harmoni të plotë demokratike dhe vetëflijimi për krijimin e organeve vendimtare për jetën.<sup>92</sup>

Por, në kundërshtim me atë që thuhet në këtë citim, në qelizën e gjallë nuk ka vetëdije. Besimi i kësaj nuk është gjë tjetër veçse një besëtytni. Përsëri, siç shihet në citimin e mësipërm, me qëllim që të mohohet ekzistenca dhe vepra krijuese e Zotit, masonët iu atribuojnë veti absurde atomeve, molekulave dhe qelizave, siç janë inteligjenca, aftësia për planifikim, vetëflijimi e madje edhe “harmonia demokratike”. Ashtu sikurse është e pakuptimtë të thuhet për krijimin e një pikturë në vaj se “ngjyrat u organizuan vetvetiu së bashku sipas një plani dhe vazhduan të funksionojnë në mënyrë demokratike dhe në harmoni”, ashtu janë të pakuptimta edhe pretendimet e masonëve për origjinën e jetës.

Një shprehje e zakonshme e parimeve supersticioze të Masonerisë dhe materializmit të tyre është termi “**Nëna natyrë**”. Ne e ndeshim këtë shprehje në filma, dokumentarë, libra, revista e madje edhe në reklama. Kjo shprehje përdoret për të shprehur besimin se materia e pajetë që përbën natyrën (azoti, oksigjeni, hidrogjeni, karboni, etj.) ka një fuqi të vetëdijshme dhe se ajo i ka krijuar vetë njerëzit dhe të gjitha qeniet e gjalla. Kjo legjendë nuk është e bazuar në eksperimente apo arsyetime logjike, por ka për qëllim që t’i bindë njerëzit përmes përhapjes në masë të doktrinaeve të tyre. Qëllimi është që njerëzit të harrojnë Zotin, Krijuesin e vërtetë dhe t’i kthehen paganizmit, ku “natyra” konsiderohet si krijues.

Masoneria përpiqet që t’i japë formë këtij besimi, ta forcojë e ta përhapë atë, dhe i përkrah të gjitha forcat shoqërore që bëhen aleatë të saj. Në një artikull në *Mimar Sinan*, të titulluar “Idetë për konceptin dhe evolucionin e solidaritetit nga pikëpamja shkencore”, flitet për



“harmoninë misterioze që nëna natyrë ka vendosur” dhe theksohet se kjo është baza e filozofisë humaniste të Masonerisë. Më tutje, thuhet se masoneria do t’i përkrahë ato lëvizje që e përqafojnë këtë filozofi:

Kur ajo merret në konsideratë nga pikëpamja materiale e marrjes dhe dhënies në botën e qenieve të gjalla, mes mikrobeve të dobishme që jetojnë në tokë dhe brenda nesh, tek të gjitha bimët, kafshët dhe qeniet njerëzore ekziston një **harmoni e misterishme e urdhëruar nga nëna natyrë, dhe ato vazhdimisht janë të angazhuara në një solidaritet organik**. Dëshiroj që të pohoj edhe njëherë se Masoneria do të përkrahë çdo lloj lëvizje psiko-sociale që i dedikohet mirëqenies, paqes, sigurisë dhe lumturisë, shkurtimisht, çdo lëvizje që është në rrugën e humanizmit dhe bashkimit universal të njerëzimit, qofshin mjete apo vepra që çojnë përpara idealet e saj.<sup>93</sup>

“Mjetet dhe veprat” më të rëndësishme “që çojnë përpara idealet e Masonerisë” janë të bazuara në teorinë e evolucionit – përkrahja moderne e materializmit dhe humanizmit.

Në kapitullin vijues do të shohim më nga afër teorinë e evolucionit, që nga koha e Darvinit e deri tek propaganda moderne evolucioniste dhe do të zbulojmë marrëdhëniet e fshehta të Masonerisë me gabimin më të madh shkencor të të gjitha kohërave.

# -V-

## RISHQYRTIMI I TEORISË SË EVOLUCIONIT

*F*emi në vitin 1832...

Anija "Beagle" po lundron përgjatë Atlantikut të pafund. Ajo duket si çdo anije e zakonshme udhëtarësh apo si anije transporti, por udhëtimi i saj ka si mision kryerjen e zbulimeve, që do të zgjasë me vite. Duke u nisur nga Anglia, ajo do të kalojë tërë oqeanin dhe do të arrijë në brigjet e Amerikës Jugore.

"Beagle", një anije që deri atëherë ishte një anije e panjohur, u nis për një udhëtim pesëvjeçar.


Ai që do ta bënte këtë anije të famshme, ishte udhëtari që gjendej në të, Charles Robert Darwin, një natyralist 22-vjeçar. Ai, në të vërtetë, nuk kishte studiuar biologjinë por kishte qenë student teologjie në

Universitetin e Cambridge-it.

Edhe pse arsimimi i këtij të riu në teologji ishte gjithëpërfshirës, koha në të cilën ai jetoi, ishte e ndikuar thellë nga mendimet materialiste. Në të vërtetë, një vit para se të nisej në rrugëtimin e tij me Beagle, ai kishte hequr dorë nga një numër rregullash themelore të krishtërimin.

Darvini 22-vjeçar, i interpretoi të gjitha zbulimet e bëra në këtë udhëtim sipas mendësisë materialiste. Ai u përpoq të sqaronte krijimin e qenieve të gjalla, që ai hulumtonte pa iu referuar krijimit hyjnor. Ai i zhvilloi këto ide përgjatë viteve pasuese dhe përfundimisht, pas përpunimit të tyre botoi teorinë e tij. Kjo teori u propozua më 1859, në librin e tij “Origjina e llojeve”, e cila nuk u prit mirë nga bota intelektuale e shekullit XIX edhe pse ajo do të siguronte të ashtuquajturën bazë shkencore që ateizmi kishte kërkuar të gjente me shekuj.

**The theory of evolution is not an original discovery of Darwin's. He did nothing more than re-apply an old superstitious philosophy.**



A ishte teoria e evolucionit zbulim original i Darvinit? A u zhvillua kjo teori pa ndihmën e askujt tjetër përveç Darvinit, teori e cila i hapi udhë njërit prej mashtrimeve më të mëdha në historinë e njerëzimit?

Në të vërtetë, Darvini, nuk bëri asgjë tjetër, veçse korrigjoi një ide, bazat e së cilës ishin ngritur më herët.

## **MITI I EVOLUCIONIT, NGA GREQIA E LASHTË DERI NË EUROPËN MODERNE**

Thelbi i teorisë së evolucionit të Darvinit është vlerësimi se nën kushte krejtësisht natyrore, materia jo e gjallë lindi spontanisht qeniet e para të gjalla, dhe pastaj nga ato, përsëri nën të njëjtat kushte, të gjitha llojet e tjera u zhvilluan thjesht rastësisht. Me fjalë të tjera, teoria e evolucionit propozoi ekzistimin e një sistemi vetëekzistues, i cili ka organizuar vetveten pa krijues, duke sjellë në jetë spontanisht qeniet e gjalla. Ideja se natyra e organizon vetveten pa krijues u quajt “natyralizëm”.

Teoria e natyralizmit është absurde, po aq sa ideja se një bibliotekë mund të formohet vetvetiu pa shkrimtarë. Pothuajse, që nga etapat e para të historisë, kjo ide është mbrojtur nga mendimtarë të shumtë, që janë bazuar vetëm në mendimin e tyre filozofik dhe ideologjik dhe ajo u adoptua nga shumë qytetërimë.

Natyralizmi lindi dhe lulëzoi në shoqëritë pagane siç ishin Egjipti dhe Greqia e Lashtë. Por, me përhapjen e krishtëritimit, kjo filozofi pagane u braktis gjerësisht dhe filloi të dominonte ideja se Zoti e krijoi gjithë natyrën dhe universin. Në mënyrë të ngjashme, kur Islami u përhap në Lindje, idetë e natyralizmit dhe besimet pagane, si zoroastrianizmi dhe shamanizmi, u zhdukën dhe u pranua fakti i krijimit nga Zoti.

Megjithatë, filozofia natyraliste vazhdoi të ekzistojë në fshehtësi.







HARUN JAHJA (ADNAN OKTAR)

Ajo u ruajt nga shoqëritë sekrete dhe u shfaq përsëri, nën rrethana më të përshtatshme. Në botën e krishterë, siç përmendëm edhe në fillim të këtij libri, natyralizmi ishte ruajtur nga masonët, si dhe nga shoqëritë e tjera sekrete që pasonin shembullin e tyre. Revista turke, me emrin 'Mason', e botuar për anëtarët e rendit, na jep këtë informacion të rëndësishëm:

Ata që arritën tek zbulimet e reja në botën e fenomeneve dhe ndodhive natyrore, pa e marrë në konsideratë ekzistencën e Zotit, ishin të detyruar që t'i mbanin zbulimet vetëm për vete. Kërkimet u bënë fshehurazi, kështu që edhe ata që u angazhuan në kërkime të ngjashme, duhet t'i mbanin marrëdhëniet e tyre të fshehta. Fshtësia që kërkohet gjatë rrjedhës së këtyre projekteve të ndërmarra, bëri të nevojshme përdorimin e disa shenjave dhe simboleve të ndryshme.<sup>94</sup>

Ajo që nënkuptohet këtu me "zbulimet e reja" është një kuptim i shkencës nga pikëpamja natyraliste, një teori që nuk e pranon ekzistencën e Zotit. Kjo qasje e shtrembëruar ndaj studimeve shkencore u zhvillua fshehurazi në shoqëritë sekrete, të cilat përdornin shenja dhe simbole për këtë

**The theory of materialist evolution was developed by the pagan philosophers in Ancient Greece.**

qëllim dhe në këtë mënyrë, u hodhën rrënjët e Masonerisë.

Një ndër këto të ashtuquajtura shoqëri sekrete, përgjegjëse për mbjelljen e farës së Masonerisë, ishte rendi Rose Cross (Rosikrusian), një lloj pike bashkuese mes templarëve dhe masonëve. Ky rend, i dëgjuar për herë të parë në shekullin XV, krijoi një shtim të madh të alkimisë, veçanërisht në Europë, ku për anëtarët e tij mendohej se zotëronin njohuri sekrete. Por trashëgimia më e rëndësishme e rendit Rose Cross të ditëve të sotme është filozofia natyraliste dhe ideja e evolucionit, që është pjesë e saj. Revista 'Mason' thotë se rrënjët e Masonerisë shtrihen tek templarët dhe rosikrusianët, duke theksuar filozofinë e mëvonshme evolucioniste:

Masoneria teorike apo organizata bashkëkohore e Masonerisë është themeluar nga shoqëritë mesjetare të ndërtimit, të cilave iu referohemi si Masoneria Vepruese. Por, ata që sollën elementet bazë teorike të këtij themelimi, ishin anëtarët e organizatave të caktuara, që studiuuan sistemet e fshehta prehistorike dhe njohuritë që ato përmbanin. Më të rëndësishmet nga këto organizata ishin templarët dhe rosikrusianët...

Nuk dihet se kur dhe si u themelua rendi i rosikrusianëve. Gjurmët e para datojnë në Europën e shekullit XV, por është e qartë se rendi është shumë më i vjetër. Në ndryshim nga templarët, **interesi themelor i rosikrusianëve ishte shkenca**. Anëtarët e tij angazhoheshin së tepërmi në alkimi... **Karakteristika më e rëndësishme e anëtarëve të tij ishte fakti se ata besonin se çdo etapë e zhvillimit ishte një etapë e procesit të evolucionit**. Për këtë shkak, ata vendosën natyralizmin në bazën e filozofisë së tyre dhe u bënë të njohur si "natyralistët".<sup>95</sup>

Një organizatë tjetër masonike që e zhvilloi idenë e evolucionit nuk ishte në Perëndim, por ishte një rend tjetër masonik i themeluar në Lindje. Mjeshtri i madh Selami Isindag, na siguron informacionin në vijim, në një artikull të titulluar "*Masoneria dhe ne, nga themelimi i saj e*





The first to promote the theory of evolution in modern Europe were members of the Masonic society known as the Rosicrucians. Above: the symbol of the Rosicrucians.



*deri më sot'':*

**Në botën islame, Masoneria kishte homologun e vet që quhej Ikhwan as-Safa' (Vëllazëria e dëlirësisë).** Kjo shoqatë u themelua në Basra, në kohën e Abasidëve dhe botoi një enciklopedi me 54 vëllime të mëdha. 17 prej tyre kanë të bëjnë me shkencën natyrore dhe **përmbajnë shpjegime shkencore që ngjasojnë shumë në ato të Darvinit. Ato arritën të depërtonin deri në Spanjë dhe patën ndikim të madh në mendimin perëndimor.**<sup>96</sup>

Megjithëse u zhvillua në botën islame, kjo shoqëri e distancoi veten nga parimet themelore islame. Ajo u ndikua nga filozofia e Greqisë së Lashtë, e cila shprehej me format e një simbolizmi sekret. Isindag vazhdon:

Kjo shoqëri ishte me origjinë nga sekti Ismailije dhe qëllimi themelor i tij, ishte krijimi i një dogme fetare të kuptueshme përmes shpjegimeve simbolike dhe alegorike. **Filozofia e saj ishte ndikuar nga mendimtarët grekë, Pitagora dhe Platoni.** Për të hyrë në këtë shoqëri sekrete, personi së pari, joshej nga udhëzimet mistike e më vonë **spastrohej nga besimet dhe dogmat e kota fetare.** Më pas, ai njihej më nga afër me metodat filozofike dhe simbolike. Personi që pranohej, pasi kalonte përmes "stazhit" fillestar, ndonjëherë duhej që të kalonte ushtrimet e ideve neo-platonike, e pastaj ai mund të fillonte me kimi, astrologji dhe numerologji - shkenca për kuptimin e numrave. Por e gjithë kjo njohuri mbahej sekret dhe u jepej vetëm atyre që mendohej se e meritonin. Kështu, zanafilla e Masonerisë bazohet në këto themele. Disa nga kuptimet simbolike të këtyre elementeve nuk ishin në kundërshtim me shkencën dhe llogjikën prandaj edhe kanë mbijetuar në vende të ndryshme, në ritualet tona të sotme.<sup>97</sup>

Fjalët e cituara më lart, "spastrimi nga besimet dhe dogmat e kota" nënkuptojnë se nismat e filozofisë masonike, kishin synim të mohonin plotësisht fenë. Kjo është mënyra sesi e përkufizon masoni



Isidag fenë. Po kështu kemi vënë re se shprehja “dogma dhe besimet e kota” është një eufemizëm i veçantë i filozofisë masonike. Duhet të pranohet se Masoneria apo ndonjë grup tjetër materialist, që shpreh ide tepër antifetare pa asnjë arsytim logjik, mbështetet vetëm në propagandë dhe sugjestion. Meqenëse ata nuk mund ta dënojnë fenë në mënyrë racionale, ata mbështeten vetëm tek metodat e sugjestionit dhe fjalët e përzgjedhura, në mënyrë që të krijojnë një efekt të veçantë psikik.

Nga citati i mësipërm mësojmë se Ikhwan as-Safa', një shoqëri në botën islame, paralele me Frankmasonerinë, kryente aktivitete shumë të ngjashme me Masonerinë moderne. Metoda që përdorte ajo ishte përqafimi i filozofisë pagane, që bie në kundërshtim me fenë e vërtetë, për të shprehur këtë filozofi me anën e simboleve dhe për ta prezantuar gradualisht këtë filozofi të fshehtë tek anëtarët e vet.

Në historinë islame ka mendimtarë të ndryshëm që, në këtë mënyrë, e larguan veten nga Islami dhe që ranë nën ndikimin e miteve materialiste dhe evolucioniste të Greqisë së Lashtë. Fakti se kjo shkollë mendimi, të cilën dijetari i madh islam Gazaliu e përgënjeshtroi dhe e refuzoi me forcë në veprat e tij, kishte karakter masonik, sigurisht hedh paksa dritë mbi këtë çështje. Në veprën e tij *Al-Munqidh min al-Dalal (Shpëtimi nga lajthitja)*, Gazaliu e kritikoi drejtpërsëdrejti shoqërinë *Ikhwan as-Safa'*, duke shpjeguar se ajo kishte përqafuar një filozofi të degjeneruar, të ndikuar nga Greqia e Lashtë. Po ashtu në veprën e tij të titulluar *Fedail-ul-Batinniyye*, ai demonstroi zvetënimet e mësimëve të sektit Ismailije, të cilit i përkiste edhe *Ikhwan as-Safa'*-s.

## ILUMINIZMI DHE SHFAQJA E MITIT TË TEORISË SË EVOLUCIONIT

Idetë materialiste dhe evolucioniste të adoptuara nga organizatat





The symbol shown above is used in Masonic lodges, and is a Rosicrucian symbol (the rose and the cross) combined with a Masonic symbol (the compass and square).



masone, siç ishin Rosikrusianët apo *Ikhwan as-Safa'*, që shpreheshin fshehurazi dhe shumë shpesh edhe simbolikisht, filluan të bëheshin gjithmonë e më të hapura, pasi fuqia shoqërore e Kishës në Europë erdhi duke u dobësuar. Si rezultat, këto mësimë pagane, që kishin qëndruar të fshehura për rreth 1.000 vjet, për shkak të dominimit politik dhe intelektual të krishtërimin, u përhapën përsëri në mesin e mendimtarëve europianë të shekujve XVII dhe XVIII.

Periudha në të cilën idetë materialiste dhe evolucioniste fituan përkrahje të gjerë në shoqërinë europiane, dhe ndikuan në distancimin e saj nga feja, njihet si Iluminizëm. Sigurisht, ata që e zgjodhën këtë term (d.m.th. ata që e karakterizuan këtë ndryshim të ideve pozitivisht, si një dalje në dritë) ishin udhëheqësit e këtij devijimi. Ata e cilësuan etapën e mëparshme si "Epoka e errët" dhe fajësuan fenë për këtë, duke pohuar se Europa u ndriçua kur ajo iu kthye laicizmit dhe iu largua fesë. Kjo perspektivë e rreme dhe e njëanshme, ende edhe sot, është një ndër mekanizmat themelore propaganduese të atyre që e kundërshtojnë fenë.

Është e vërtetë që krishtërimi mesjetar ishte pjesërisht "i errët", me besëtytni e fanatizëm, dhe shumica e këtyre janë spastruar në epokën pas-mesjetare. Në fakt, Iluminizmi nuk i solli dhe aq shumë rezultate pozitive Perëndimit. Rezultati më i rëndësishëm i Iluminizmit, që ndodhi në Francë, ishte Revolucioni Francez, që e ktheu vendin në një det gjaku. Sot, literatura e ndikuar nga Iluminizmi e lavdëron Revolucionin Francez; megjithëse ai i kushtoi shumë Francës dhe shkaktoi konflikte shoqërore që zgjatën deri në shekullin XX. Analiza e Revolucionit Francez dhe e Iluminizmit, sipas mendimtarit të famshëm britanik, Edmund Burke, është mjaft domethënëse. Në librin e tij "*Reflektime mbi Revolucionin në Francë*", botuar më 1790, ai kritikoi Iluminizmin dhe frytin e tij: Revolucionin Francez. Sipas mendimit të tij, kjo lëvizje shkatërroi vlerat themelore,



Edmund Burke, *Reflections on the French Revolution* adlı kitabında, Fransız Devrimi'nin ve Aydınlanma'nın yıkıcı etkisini ortaya koydu.

që mbanin shoqërinë të bashkuar, siç ishte feja, morali dhe struktura e familjes, dhe i hapi rrugën terrorit dhe anarkisë. Përfundimisht, ai e konsideronte Iluminizmin, si “lëvizje shkatërruese të mendjes njerëzore”.<sup>98</sup>

Udhëheqësit e kësaj lëvizje shkatërruese ishin masonët. Volteri, Dideroi, Monteskje dhe mendimtarët e tjerë antifetarë, që përgatitën rrugën për revolucionin, ishin masonë. Masonët ishin miq të ngushtë me jakobinët, që ishin udhëheqësit e Revolucionit. Kjo i kishte shpënë disa historianë në mendimin se është e vështirë të bëhet një dallim mes Jakobinizmit dhe Masonerisë në Francë, në këtë periudhë. (*Shih librin Rendi i ri masonik, nga Harun Yahya.*)

Gjatë Revolucionit Francez u tregua një armiqësi e madhe ndaj fesë. Shumë klerikë u dërguan në gijotinë, kishat u shkatërruan dhe për më tepër, kishte nga ata që dëshironin ta çrrënjosnin krejtësisht krishtërimin dhe ta zëvendësonin me një fe të devijuar, pagane dhe simbolike, të quajtur “Feja e arsyes”. Udhëheqësit e Revolucionit u bënë gjithashtu, viktimat të kësaj çmendurie. Çdonjëri prej tyre, më në fund po humbiste kokën në gijotinën, në të cilën më parë kishte prerë shumë koka njerëzish. Edhe në ditët e sotme, shumë francezë vazhdojnë të pyesin nëse, revolucioni, ka qenë një gjë e mirë apo jo. Ndjenja antifetare e Revolucionit Francez u përhap nëpër Evropë dhe si rezultat, shekulli XIX u bë një ndër periudhat më të guximshme dhe më agresive të propagandës antifetare. Në këtë mënyrë, ky proces mundësoi që idetë materialiste dhe evolucioniste, të cilat kishin shekuj



**Revolution: France was turned into a sea of blood.**

që operonin në fshehtësi përmes përdorimit të simboleve, të shfaqeshin përsëri në popull.

Materialistët, si Didëro dhe Baron d'Holbach, ngritën flamurin antifetar dhe miti i evolucionit nga Greqia e Lashtë u prezantua në botën shkencore.

## **ERASMUS DARVINI**

Ata që në përgjithësi mendohet të jenë themeluesit e teorisë së evolucionit janë biologu francez Jean Lamark dhe ai anglez, Charles Darwin. Sipas tregimit klasik, Lamarku e propozoi i pari teorinë e evolucionit, por ai bëri një gabim, pasi e themeloi atë mbi "trashëgiminë e tipareve të fituara". Më vonë, Darvini propozoi një



Voltaire, Diderot and the "Encyclopedists": The Masonic leaders of the Enlightenment and the fierce opponents of religion.






teori të dytë, të bazuar mbi seleksionimin natyror.

Megjithëse, këtu duhet të përmendim edhe emrin e një teoricieni tjetër, i cili luajti një rol të rëndësishëm në origjinën e teorisë së evolucionit: ai ishte Erasmus Darvini, gjyshi i Charles Darvinit.

Erasmus Darvini ishte bashkëkohës i Lamarkut, në shekullin XVIII. Duke qenë fizikant, psikolog dhe poet, ai njihej si autoritet. Biografi i tij, Desmond King-Hele, e ka quajtur atë edhe si anglezi më i madh i shekullit XVIII.<sup>99</sup> Por, Erasmus Darvini kishte një jetë shumë të errët private.<sup>100</sup> Ai njihej kryesisht edhe si një nga natyralistët më të shquar. Siç thamë në fillim, natyralizmi është një pikëpamje që nuk e pranon faktin, se qeniet e gjalla i ka krijuar Zoti. Në të vërtetë, kjo pikëpamje, e cila është e afërt me materializmin, ishte pika nismëtare e teorisë së evolucionit të Erasmus Darvinit. Në vitet 1780-të dhe '90-të, ai zhvilloi bazat themelore të teorisë së evolucionit, sipas të cilave të gjitha qeniet e gjalla rrjedhin nga një paraardhës i vetëm, i përbashkët, rastësisht dhe sipas ligjeve të natyrës. Ai e bëri hulumtimin e tij në një kopësht botanik me një sipërfaqe prej 8 akrësh (3.23 hektarësh), që e kishte ndërtuar vetë dhe aty kërkoi dëshmitë që do të provonin idenë e tij. Ai e shpjegoi teorinë e tij në dy libra, të titulluar: "*Tempulli i natyrës*" dhe "*Zoonomia*". Përveç kësaj, më 1784, me qëllim që të përhapte idetë e tij, ai themeloi një shoqatë që u njoh si 'Shoqata Filozofike'.



Erasmus Darwin, Charles Darwin's grandfather was a "Master Mason."



Erasmus Darwin's book *Zoonomia*, in which he laid the foundations for the theory of evolution.

Vite më vonë, Charles Darvini do të trashëgonte idetë e gjyshit të tij dhe planin bazë për propozimin e teorisë së tij të evolucionit. Teoria e tij u përpunua në bazë të strukturës së themeluar nga gjyshi i tij, ndërsa 'Shoqata Filozofike' u bë një nga përkrahësit më të zjarrtë të teorisë së tij.<sup>101</sup>

Pra me pak fjalë, Erasmus Darvini ishte pionieri i vërtetë i teorisë, të cilën ne e njohim si teoria e evolucionit dhe që është propaganduar në të gjithë botën në 150 vitet e fundit.

Ku e zbuloi Erasmus Darvini idenë e evolucionit? Nga vinte interesi i tij për këtë çështje?

Pas një kërkimi gjithëpërfshirës për të gjetur përgjigjen e kësaj pyetjeje, zbuluam faktin interesant se Erasmus Darvini ishte mason. Ai nuk ishte një mason i zakonshëm, por një nga mjeshtrat e shkallës më

të lartë në organizatë.

Ai ishte kryesuesi Lozhës së famshme Canongate në Edinburg, Skoci.<sup>102</sup> Përveç kësaj, ai kishte lidhje të ngushta me masonët jakobinë të cilët ishin organizatorët e Revolucionit Francez dhe me iluministët, qëllim kryesor i të cilëve ishte edukimi me armiqësi ndaj fesë.<sup>103</sup> Pra, Erasmus Darvini ishte një emër i rëndësishëm në organizatat evropiane masonike antifetare.

Erasmusi e edukoi me të njëjtën frymë djalin e tij, Robertin (babain e Charlesit), i cili gjithashtu ishte anëtar i një lozhe masonike.<sup>104</sup> Për këtë arsye, Charles Darvini i ka trashëguar mësimet masonike, si nga babai, ashtu edhe nga gjyshi i tij.

Erasmus Darvini shpresonte se i biri i tij, Roberti, do ta zhvillonte dhe do ta publikonte teorinë e tij. Por do të ishte nipi i tij, Charles, ai i cili do të merrte përsipër këtë. Edhe pse me vonesë, *“Tempulli i natyrës”* i Erasmus Darvinit u ripunua më në fund nga Charles Darvini. Pikëpamja e Darvinit nuk kishte peshën e një teorie shkencore; ajo s’ishte gjë tjetër veçse një shprehje e doktrinës natyraliste, që pranonte se natyra ka fuqi krijuese.

## MASONËT DHE FILOZOFIA NATYRALISTE

Teoria e seleksionimit natyral, që ne pandehnim se ishte kontribut i veçantë i Darvinit, ishte një teori e parashtruar më parë nga shumë shkencëtarë të tjerë. Por, shkencëtarët që i përkisnin periudhës para Darvinit, nuk e përdorën teorinë e seleksionimit natyral si një argument kundër krijimit. Përkundrazi, ata e panë atë si një mekanizëm të prodhuar nga Krijuesi për mbrojtjen e gjallesave nga dëmtimet e trashëguara. Ashtu sikurse Karl Marksi, mori konceptin idealist të Hegelit për *“dialektikën”* dhe e shndërroi atë që t’i përshtatej filozofisë së tij, po ashtu edhe Darvini e mori teorinë e seleksionimit natyror nga shkencëtarët kreacionistë dhe e përdori në



atë mënyrë që t'i përshtatej idesë së natyralizmit.

Prandaj, kontributi personal i Darvinit në formulimin e darvinizmit nuk duhet të stërmadhohet. Konceptet filozofike që ai përdori ishin zbuluar nga filozofët e hershëm të natyralizmit. Nëse nuk do ta kishte propozuar Darvini teorinë e evolucionit, atë do ta kishte propozuar dikush tjetër. Në të vërtetë, një teori shumë e ngjashme me të tijën u propozua në të njëjtën periudhë nga një shkencëtar tjetër natyralist anglez, i quajtur Alfred Russell Wallace dhe ishte kjo arsyeja që Darvini u ngut ta botonte *Origjinën e llojeve*.


Përfundimisht, Darvini u shfaq në skenë kur në Europë kishte filluar një luftë e gjatë për të shkatërruar besimin tek Zoti dhe feja, me qëllim që t'i zëvendësonin ata me filozofinë natyraliste dhe me një model humanist për jetën e njeriut. Forca më e rëndësishme pas kësaj lufte nuk ishte ky apo ai mendimtar, por organizata e Masonerisë, në të cilën bënin pjesë shumë mendimtarë, ideologë dhe udhëheqës politikë.

Ky fakt është pranuar dhe është shprehur nga disa të krishterë të asaj kohe. Papa Leo XIII, udhëheqësi i katolikëve në botë, më 1884 nxori botimin me titull *Humanum Genus*, në të cilën ai bëri disa deklarata të rëndësishme për Masonerinë dhe aktivitetet e saj. Ai shkruante:

Në këtë kohë, përkrahësit e së keqes duket se janë mbledhur sëbashku, për të luftuar me vrull të madh, të udhëhequr apo të ndihmuar nga një shoqatë e organizuar fuqishëm dhe e shtrirë gjerësisht, e quajtur **Frankmasoneria**. Duke mos i fshehur më qëllimet e tyre, ata tani janë duke u ngritur haptazi kundër Vetë Zotit.

... nga ç'kemi treguar shumë qartë më lart, qëllimi i tyre përfundimtar është përmbysja e plotë e gjithë asaj që rendi politik dhe fetar i botës apo mësimet e krishtera kanë prodhuar si dhe t'i zëvendësojnë ato me "një strukturë të re të gjërave që janë në





Alfred Russel Wallace and Charles Darwin

**pajtim me idetë e tyre, themelet dhe ligjet e të cilave do të përpiloheshin vetëm e vetëm nga natyralizmi.”<sup>105</sup>**

Fakti i rëndësishëm, që Leo XIII konstaton në citatin e mësipërm, është përpjekja për të shkatërruar krejtësisht vlerat morale që jep feja. Ajo që Mazoneria u përpoq të arrinte me ndihmën e darvinizmit ishte, të prodhonte një shoqëri të degjeneruar moralisht, që nuk do të njihnte asnjë ligj hyjnor, që nuk do t’i frikësohej Zotit dhe që do të ishte e prirë për të bërë çdo lloj krimi. Ky lloj modeli shoqëror, është ai që nënkuptohet nga fraza e mësipërme “një strukturë të re të gjërave që janë në pajtim me idetë e tyre, themelet dhe ligjet e të cilave do të përpiloheshin vetëm e vetëm nga natyralizmi”.

Masonët, duke menduar se darvinizmi do t’u shërbente për arritjen e synimeve të tyre, luajtën një rol të madh në shpërndarjen e tij në masat e gjera. Menjëherë pas botimit të teorisë së Darvinit, rreth saj u formua një grup vullnetarësh propagandistë, ku më i njohuri prej tyre ishte Thomas Huxley që quhej ndryshe edhe “bulldogu” i




Papa XIII. Leo

Darvinit. Huxley “përkrahja e flaktë darviniste e të cilit ishte faktor i vetëm dhe përgjegjës për pranimin e tij të shpejtë”<sup>106</sup> ia tërhoqi vëmendjen botës për teorinë e evolucionit, në debatin e mbajtur në muzeun e Universitetit të Oxfordit, të cilin ai e zhvilloi me peshkopin e Oxfordit, Samuel Wilberforce më 30 qershor 1860.

Përkushtimi i madh i Huxley-it për përhapjen e idesë së evolucionit, së bashku me lidhjet e tij institucionale, u soll në dritë

sipas fakteve të mëposhtme: Huxley ishte anëtar i Shoqërisë Mbretërore, një prej institucioneve më prestigjioze shkencore dhe, sikurse gati të gjithë anëtarët e këtij instituti, ai ishte mason senior.<sup>107</sup> Anëtarët e tjerë të Shoqërisë Mbretërore i dhanë Darwinit një përkrahje të rëndësishme, para dhe pas botimit të librit.<sup>108</sup> Kjo shoqatë masone e pranoi Darwinin dhe darvinizmin deri në atë nivel, sa që përveç shpërblimit me çmimin Nobel, medalja e Darwinit i jepej çdo vit si çmim nderi, një shkencëtar i denjë për t'u nderuar.



Thomas Huxley, a fanatical supporter of Darwin.

Shkurtimisht, Darvini nuk vepronte i vetëm. Që nga momenti kur u propozua teoria e tij, ai pati përkrahjen e klasave dhe grupeve shoqërore, bërthama e të cilave ishte e përbërë nga masonët. Në librin e tij 'Marksizmi dhe Darvinizmi', mendimtari marksist Anton Pannekoek shkruan për këtë fakt të rëndësishëm dhe përshkruan përkrahjen që i është dhënë Darwinit nga ana e "borgjezisë", pra, nga klasa e pasur kapitaliste evropiane:

Është e njohur nga të gjithë, që marksizmi, për rëndësinë dhe pozitën e vet, i detyrohet vetëm rolit që pati në luftën proletare të klasave... Megjithatë, në realitet, nuk është vështirë të shihet se, edhe darvinizmit i është dashur të nënshtrohet ndaj të njëjtave përvoja, si marksizmi. Darvinizmit nuk është vetëm një teori abstrakte, e cila u miratua nga bota shkencore pas diskutimit dhe testimin e tij në një mënyrë thjesht objektive. Jo, menjëherë pasi u shfaq, darvinizmi

**pati mbrojtësit e vet entuziastë dhe kundërshtarët e zjarhtë.**  
...Darvinizmi, gjithashtu, luajti rol në luftën klasore, dhe se i ka borxh këtë rol që i përhap aq shpejt dhe kishte mbrojtës entuziastë dhe kundërshtarë të vrerosur.

**Darvinizmi i shërbeu borgjezisë, si mjet në luftën e saj kundër klasës feudale, kundër fisnikërisë, të drejtave të klerit dhe lordëve feudalëve...** Ajo çfarë dëshironte borgjezia ishte të shpëtonte nga kopetencat e rregullave të vjetra sunduese që zinin rrugën e tyre... Me ndihmën e fesë, priftërinjtë kishin mundur që nëpërmjet meshave të tyre të tregoheshin të gatshëm për t'iu kundërvënë kërkesave të borgjezisë...

Shkenca natyrore u bë një armë kundër besimit dhe traditës. Shkenca dhe ligjet e reja shkencore, që u zbuluan, avancuan më tej. Këto ishin armët me të cilat luftonte borgjezia...

Darvinizmi u shfaq në kohën e duhur. Teoria e Darvinit, që pohon se njeriu është pasardhës i një kafshe më të ulët, i shkatërroi krejtësisht themelet e dogmës së krishterë. Është për këtë shkak, që **sapo u shfaq darvinizmi, borgjezia filloi të punojë me zell të madh.**


... Në këto rrethana, edhe debatet shkencore ishin të mbushura me zellin dhe pasionin e luftës së klasave. Për këtë arsye, shkrimet që u shfaqën pro dhe kundër Darvinit patën karakterin e polemikave shoqërore, pavarësisht nga fakti se ata mbajnë emrat e autorëve shkencorë...<sup>109</sup>

Megjithëse Anton Pannekoek, për shkak se mendonte sipas aspektit të analizës klasore marksiste, e përkufizon forcën që përhapte darvinizmin si "borgjezi", e cila kishte si funksion luftën e organizuar kundër fesë. Kur ne e shqyrtojmë këtë çështje nën dritën e më shumë dëshmive historike, shohim se brenda borgjezisë ekzistonte një organizatë që e përdorte darvinizmin për të ushtruar luftën e saj kundër fesë. Kjo organizatë ishte Masoneria.

Ky fakt është i qartë si nga faktet historike ashtu edhe nga burimet







Darwin's theory seemed plausible to some due to the primitive level of scientific knowledge and meager evidence in the nineteenth century.

masonike. Një ndër këto burime është një artikull nga mjeshtri mason Selami Isindag, i titulluar “Pengesat në zhvillimin e diturisë dhe Masoneria”, i cili u botua më 1962 në *Buletinin vjetor të lozhës së madhe turke për masonët e lirë dhe të pranuar*. Në fillim të këtij artikulli, Isindag përsërit pretendimet klasike të masonëve se feja është një legendë e shpikur nga njerëzit dhe se monoteizmi bie në kundërshtim me arsyen dhe shkencën. Më vonë, ai përshkruan nxitësin e vërtetë të luftës kundër fesë, të fshehur në maskën e “shkencës”:

Do të vërehet se në luftën për përhapjen e diturisë, **masonët kanë qenë pjesëmarrës në çdo nivel**. Arsyeya për këtë është se Masoneria, në çdo periudhë, ka qenë gjithmonë e udhëhequr nga arsyeya, njohuria dhe pjekuria, d.m.th. nga mençuria. Që kur është themeluar, ajo ka luftuar kundër besëtytnive dhe mitit.<sup>110</sup>

Por, në të vërtetë, feja nuk është “besëtytni dhe mit”, siç pohojnë masonët; përkundrazi ajo është baza e besimit materialist, natyralist dhe evolucionist që ata përkrahnin. Dëshmia më e qartë e këtij fakti

janë idetë e tyre të vjetëruara dhe përsëritja, nga ana e tyre, e besimeve të kota të qytetërimeve të vjetra pagane të Egjiptit dhe Greqisë, që u bënë të pavlefshme nga zbulimet e shkencës bashkëkohore.

Një krahasim i fakteve shkencore në lidhje me origjinën e jetës dhe i besimeve masonike do të ishte i mjaftueshëm për të arritur në një përfundim për sa i përket këtij fakti.

## **TEORIA MASONIKE E ORIGJINËS SË JETËS**

Siç deklaram në fillim, teoria e evolucionit mbron pretendimin se qeniet e gjalla nuk janë krijuar, por se ato u lindën dhe u zhvilluan rastësisht, sipas ligjeve natyrore. Që kjo teori të testohet shkencërisht është e domosdoshme që të shikohet secila etapë e këtij procesi të supozuar dhe të shqyrtohet nëse ka qenë e mundur që ky proces të ketë ndodhur në të kaluarën. Hapi i parë i këtij procesi është supozimi i kushteve brenda të cilave materia jo e gjallë ka mundur të shndërrohet në një organizëm të gjallë.

Para se t'i shqyrtojmë këto kushte, duhet që të përmendim ligjin që në biologji njihet si ligji i Pasteurit: "Jeta rrjedh nga jeta." Kjo do të thotë se një organizëm i gjallë mund të lindë vetëm nga një organizëm tjetër i gjallë. Për shembull, gjitarët lindin nga nënat e tyre. Shumë lloje të tjera lindin nga vezët, që fillimisht ka qenë tek nëna. Bimët rriten nga fara. Organizmat njëqelizorë, si bakteret për shembull, ndahen dhe shumohen.

Askush, asnjëherë nuk ka parë diçka të kundërt. Gjatë gjithë historisë, askush nuk ka qenë dëshmitar i lindjes së një qenieje të gjallë nga një qenie jo e gjallë. Natyrisht, në Egjiptin dhe në Greqinë e Lashtë e po ashtu edhe në Mesjetë ka pasur njerëz që e kanë menduar një gjë të tillë: p.sh. egjiptianët besonin se bretkosat lindnin nga balta e Nilit, besim që u përcoll nga filozofët e Greqisë së Lashtë, një prej të cilëve ishte Aristoteli. Në Mesjetë besohej se minjtë vinin nga hambarët e



grurit. Sidoqoftë, të gjitha këto besime u vërtetuan se ishin pjellë e injorancës dhe përfundimisht, në eksperimentin e tij të famshëm në vitet e 1860-ta, Pasteuri dëshmoi se madje edhe bakterja, si forma më e thjeshtë e jetës, nuk ka ardhur në jetë pa paraardhës, që dëshmon se është e pamundur që gjërat e pajeta të prodhojnë jetë.

Por, teoria e evolucionit mbështetet mbi këtë pamundësi, pasi ajo pohon se qeniet e gjalla u lindën dhe u zhvilluan pa ndërmjetësimin e ndonjë krijuesi dhe kjo kërkon që, në etapën e parë të këtij skenari të propozuar, qeniet e gjalla të krijoheshin rastësisht.

Darvini u përpoq që ta përshkruante shkurtimisht origjinën e jetës, për të cilën ai dinte pak, kur thoshte se jeta do të duhej të jetë paraqitur fillimisht “në një pellg të vogël dhe të ngrohtë”,<sup>111</sup> por evolucionistët që e pasuan atë u shqetësuan rreth shtjellimit të mëtejshëm të çështjes. Sidoqoftë, përpjekjet e bëra gjatë shekullit XX, për arritjen e një shpjegimi evolucionist të origjinës së jetës, rezultuan vetëm me thellimin e tyre në qorrsohak. Pavarësisht nga fakti se evolucionistët nuk ishin në gjendje që të jepnin as dëshminë më të vogël shkencore për lindjen e jetës nga materia e pjetë, ata madje, nuk mundën të jepnin as edhe një shpjegim teorik, kjo për shkak se edhe struktura e



**Because of the rudimentary scientific understanding of his day, Aristotle proposed certain mythical explanations still accepted today in Masonic literature.**

organizmit më të thjeshtë të gjallë është shumë komplekse. Edhe matematikisht është e pamundur që përbërësit themelorë të qelizës, si proteinat, ADN-ja apo ARN-ja, të formohen rastësisht, e aq më pak qeliza.

Vetëm fakti se probabiliteti i lindjes së jetës rastësisht është zero dëshmon ekzistencën e një rregulli, apo me fjalë të tjera, dëshmon faktin e krijimit. Në lidhje me këtë çështje, astronomi dhe matematikani i famshëm anglez, Fred Hoyle, ka bërë këtë koment:

Në të vërtetë, një teori e tillë (se jeta është krijuar nga një Qenie Inteligjente) është aq e qartë saqë dikush mund të pyesë se përse nuk është pranuar në suaza edhe më të gjëra, duke qenë se është aq e vetëkuptueshme. Arsyet janë më tepër psikologjike sesa shkencore.<sup>112</sup>

Kjo “arsye psikologjike” që përmend Hoyle është gatishmëria dhe insistimi i evolucionistëve për të refuzuar, para kohe, çdo rezultat që i dërgon ata drejt pranimit të ekzistencës së Zotit dhe kushtëzimin e tyre ndaj kësaj.

Në veprat tona, duke u përqendruar në pavlefshmërinë e teorisë së evolucionit, kemi cituar shumë pohime të këtij fakti nga evolucionistët dhe kemi shqyrtuar hipotezat irracionale që ata kanë propozuar verbërisht vetëm e vetëm që të mos pranojnë ekzistencën e Zotit. Në këtë pikë, ne do ta përqendrojmë vëmendjen tonë në lozhat masonike me qëllim që të shohim pikëpamjet e tyre për këtë çështje. Ndërkohë që është shumë evidente se “jeta ka lindur nga një Krijues i mençur”. Çfarë mendojnë masonët lidhur me këtë çështje?

Mjeshtri mason, Selami Isindag, në librin e tij dedikuar publikut masonik, të titulluar “*Rruga e evolucionit*” (*Evrin Yolu*), e shpjegon krijimin e materies në këtë mënyrë:

Karakteristika më e rëndësishme e shkollës së parimeve tona morale është se ne nuk largohemi nga parimet e logjikës dhe nuk hyjmë në të panjohurat e teizmit, në domethënien e sekreteve dhe dogmave. Mbi këtë bazë, ne vlerësojmë se paraqitja e parë e jetës filloi në kristale, në



kushte që sot nuk mund t'i dimë dhe t'i zbulojmë. Qeniet e gjalla u lindën sipas ligjit të evolucionit dhe u përhapën ngadalë mbi tokë. Si rezultat i evolucionit, qeniet e sotme njerëzore u krijuan dhe u zhvilluan më shumë se kafshët e tjera, si nga vetëdija, ashtu edhe nga inteligjenca.<sup>113</sup>

Vlen të theksohet lidhshmëria ndërmjet shkakut dhe pasojës të sugjeruar në citatin e mësipërm: Isindag thekson se karakteristika më e rëndësishme e Masonerisë është se ata e refuzojnë teizmin, d.m.th. besimin tek Zoti. E menjëherë pas kësaj, ai pohon se “mbi këtë bazë” jeta u lind në mënyrë spontane nga materia jo e gjallë dhe më vonë ka ndodhur evolucioni, rezultat i të cilit ishte shfaqja e qenieve njerëzore.

Vërehet se Isindag nuk sjell prova shkencore që e vërtetojnë teorinë e evolucionit. (Fakti që nuk ka prova shkencore është paraprirë nga fjalët pa peshë se këto fakte “sot nuk mund t'i dimë dhe t'i zbulojmë”). E vetmja mbështetje që ka Isindag për teorinë e evolucionit është mospranimi i teizmit nga masonët.

Me fjalë të tjera, masonët janë evolucionistë, pasi ata nuk e pranojnë ekzistencën e Zotit. Kjo është arsyeja e vetme që ata janë evolucionistë.

Në themelimin e “Këshillit të Madh Turk”, organizuar nga masonët turq të shkallës së 33-të, skenari i evolucionit u deklarua përsëri dhe refuzimi i kreacionizmit nga masonët u shpjegua me këto fjalë:

Jeta organike lindi në një periudhë shumë të hershme, sipas një procesi inorganik. Qelizat u bashkuan në grupe për të prodhuar organizmat shumëqelizorë. Më vonë, buroi inteligjenca dhe u lindën njerëzit. Por prej nga? Ne vazhdimisht e pyesim veten: - A ishte nga fryma e Zotit sipër baltës së paformë? **Ne e refuzojmë shpjegimin për një krijim të tillë anormal; një lloj krijimi që përjashton njeriun.** Që nga koha që ka filluar të ekzistojë jeta dhe prejardhja e saj, po të ndjekim vijën filogjenetike dhe të kërkojmë, do të kuptojmë



## THE MASONS' FALSE SUPPORT OF HAECKEL

When we look at Masonic literature, apart from their blind attachment to the theory of evolution, we are struck by its profound ignorance. For example, when we examine Turkish sources, we see that evolutionist claims that were proved false in the first quarter of the twentieth century are still defended passionately. One of these is the story of Haeckel and his theory on embryos mentioned nearly in all Masonic publications.

The story is about a German biologist by the name of Ernst Haeckel, who was a close friend and supporter of Charles Darwin, and one of the most prominent supporters of the theory after Darwin's death. In order to establish the validity of the theory, Haeckel examined the embryos of various living things, and proposed that they all resembled one another and that each undergoes a miniature process of evolution before birth. To support this claim, he drew a number of comparisons between different embryos, by means of which he persuaded many of the validity of the theory of evolution in the first half of the twentieth century.

As we mentioned, Masonic sources place great importance on this embryology thesis, which is termed "ontogeny recapitulates phylogeny." Master Naki Cevad Akkerman, in an article entitled "The Concept of Truth and the Principles of Masonry" in *Mimar Sinan*, calls this thesis a "law," that is, he raises it to the rank of undisputable scientific fact. He writes:

*...We will consider a very important natural law. This is the formula proposed by Haeckel, "ontogeny recapitulates phylogeny." If we take a human being as an example, the meaning of the law is as follows: The morphological changes and changes in the order and function of the organs that a human being undergoes, from the first cellular formation in his mother's womb, until he is born and during his life until he dies, is nothing more than a recapitulation of the changes that he has undergone since the beginning, from his initial cellular formation in earth and in water until today.<sup>1</sup>*

Master Mason Selami Isindag also places great importance on Haeckel's theory. In an article entitled "Masonic Doctrines" he writes "In his experiments, Darwin proved that various species of animals first developed from a single cell and later from a single species." Then he adds:

*Haeckel made studies supporting all these experimental findings. He believed that the most basic animal, the Monera, became an organic living thing from inorganic material elements. He demonstrated that there was a unity at the basis of everything. This Monism is a combination of matter and spirit. These are two aspects of the substance that forms their basis. What Masonry believes is in conformity with these scientific and experimental findings.<sup>2</sup>*

In another Masonic text Haeckel is referred to as a "great scholar," and his thesis that "ontogeny recapitulates phylogeny" is claimed as proof of the theory of evolution.<sup>3</sup>

However, the Ernst Haeckel that Masons believe to be a great scholar was an imposter who deliberately falsified scientific discoveries, and the thesis they accept as a "law" (ontogeny recapitulates phylogeny) is one of the greatest deceptions in the history of science.



Haeckel

This deception is found in the drawings of embryos made by Haeckel. In order to demonstrate the similarity between the embryos of human beings, chickens, rabbits, salamanders, which in reality shared no such resemblance to each other, he falsified the drawings. In some cases, he took the organs out of the embryos, in other cases he added organs. Moreover, he altered the actual size of the embryos in an attempt to show them as all the same size. In short, Haeckel conducted this falsification in order to fabricate evidence where there otherwise was none. The reputable science journal by the name of *Science* contained an article in its September 5 1997 edition that stated: "In reality...even closely related embryos such as those of fish vary quite a bit in their appearance and developmental pathway...It (Haeckel's drawings) looks like it's turning out to be one of the most famous fakes in biology."<sup>4</sup>

Interestingly, this deception has long been recognized for many years. Haeckel's drawings were shown to be falsifications already in his own lifetime (1910), with he himself admitted to it. In an article published in *American Scientist* we read: "Surely the biogenetic law is as dead as a doornail... As a topic of serious theoretical inquiry it was extinct in the twenties..."<sup>5</sup>

In spite of this, evolutionists continued to use these drawings for decades with the sole intention of deceiving the masses who had no knowledge of the topic.

There is only one reason why Masons regard Haeckel's theory as a proof for the theory of evolution, and think of him as a great scholar: The Masons' dedication to the theory of evolution is not based on their passion for knowledge and truth, as they claim, but, on the contrary, out of ignorance.

1 Naki Cevad Akkerman, *Mimar Sinan*, No. 1, p.13

2 Selami Isindag, *Masonluk Öğretileri, Masonluktan Esinlenmeler (Inspirations from Freemasonry)*, Istanbul, p.137

3 Selami Isindag, *Din Açısından Mason Öğretisi (Masonic Doctrine According to Religion)*, Akasya Tekamül Mahfili Publications, p.10

4 Elizabeth Pennisi, "Haeckel's Embryos: Fraud Rediscovered," *Science*, September 5, 1997

5 Keith S. Thompson, "Ontogeny and Phylogeny Recapitulated," *American Scientist*, vol. 76, p.273

dhe mësojmë se ekziston një mekanizëm që e shpjegon këtë vepër të madhe, dhe ky mekanizëm është një akt “kërcimi”. Duhet të besojmë se ishte një fazë zhvillimi në të cilën aktiviteti ishte tepër i madh, gjë që bëri që jeta, në një moment të veçantë, të kalonte nga një fazë në një fazë tjetër.<sup>114</sup>

Këtu është lehtë që të dallohet fanatizmi masonik. Kur shkrintari thotë se ata “e mohojnë atë lloj krijimi që e përjashton njeriun”, ai përsërit dogmën themelore të humanizmit, se “njeriu është krijesa më e lartë që ekziston,” duke treguar se masonët mohojnë çdo mënyrë tjetër shpjegimi. Kur ai thotë “një krijim anormal”, ai nënkupton ndërhyrjen e Zotit në krijimin e qenieve të gjalla, duke e mohuar apriori këtë mundësi. (Sidoqoftë, ajo çfarë është me të vërtetë anormale është se masonët pranojnë pa kurrfarë eksperimenti apo vrojtimi: besimi jologjik se materia jo e gjallë lindi dhe krijoi rastësisht jetën në tokë, duke përfshirë edhe njerëzit.) Mund të vërehet se sipas shpjegimeve masonike nuk ka sugjerim apo dëshmi shkencore. Masonët nuk thonë: “Ja ku është dëshmia për evolucionin dhe për këtë shkak ne e mohojmë krijimin.” Ata vetëm janë verbëruar nga një fanatizëm filozofik.

Publikimet masonike insistojnë në këtë doktrinë. Mjeshtri mason Selami Isindag pohon se **“përveç natyrës nuk ka forcë tjetër që na udhëheq dhe që është përgjegjëse për mendimet dhe veprat tona.”** Ai menjëherë shton **“jeta filloi nga një qelizë dhe arriti nivelin e tanishëm si rezultat i ndryshimeve dhe evolucioneve të ndryshme.”**<sup>115</sup> Më vonë, ai tregon në mënyrë të përmbledhur se çfarë do të thotë teoria e evolucionit për masonët:

Nga pikëpamja e evolucionit, njerëzit nuk janë të ndryshëm nga kafshët. Në formimin dhe evolucionin e njeriut nuk kanë ndikuar forca të tjera, përveç atyre të cilave iu janë nënshtuar edhe kafshët.<sup>116</sup>

Ky pohim tregon qartë arsyen se përse masonët i japin rëndësi kaq të madhe teorisë së evolucionit. Qëllimi i tyre është, që të mbrojnë



idenë se njerëzit nuk janë krijuar dhe ta paraqesin filozofinë e tyre humaniste si filozofi me themel. Dhe metoda e vetme që mund të përdornin masonët për të mohuar idenë se njerëzit u krijuan nga Zoti është teoria e evolucionit. Pra, është për këtë arsye që masonët e çdo lloj kategorie, besojnë në teorinë e evolucionit dhe përpiqen ta përhapin atë në shoqëri.

Kjo tregon se masonët, që i akuzojnë vazhdimisht ata që besojnë në Zot si njerëz dogmatikë, janë vetë dogmatikë.

## **DOGMATIZIMI DHE TRADICIONALIZIMI MASONIK**

Dogmatizëm do të thotë që të përkrahet verbërisht dhe me këmbëngulje një pikëpamje, për vlefshmërinë e të cilës nuk ka asnjë dëshmi, për shkak të një predispozicioni të veçantë psikologjik. Një dogmatist nuk hulumton apo rishqyrton atë në të cilën beson, pa marrë parasysh se a ka apo jo dëshmi për të. Ai e pranon atë tërësisht dhe i përmbahet asaj me çdo kusht.

Masonët dhe grupet e tjera antifetare përdorin vazhdimisht termin “dogmatik”, duke iu referuar atyre që i besojnë Zotit. Sot hasim shumë shpesh këtë lloj akuze. Për shembull, në një diskutim mbi teorinë e evolucionit, ana evolucioniste me siguri se do t’i akuzonte ata që nuk e pranojnë këtë teori, si dogmatikë, ndërsa veten do ta deklaronin si shkencëtarë, duke thënë se shkencëtarët nuk shfaq interes për “dogmat”.


Sidoqoftë, kjo akuzë është false. Besimi në ekzistimin e Zotit dhe në atë se Ai i krijoi të gjitha qeniet është një fakt i provuar nga shumë dëshmi racionale dhe shkencore. Në natyrë ekziston një ekuilibër, një rregull dhe organizim shumë i madh dhe është e qartë se këto janë krijuar në mënyrë inteligjente dhe me një qëllim të caktuar.

Për këtë arsye, Kur’ani i thërret njerëzit që të zbulojnë shenjat e





Masonry is the continuation of narrow-minded traditionalism. Modern Masonry maintains the same superstitious beliefs that their "brothers" have defended uncritically for centuries.



Zotit dhe i fton ata që të vrasin mendjen për këtë ekuilibër, rregull dhe organizim. Në shumë ajete i urdhëron ata që të mendojnë për dëshmitë në qiell dhe në tokë, të cilat flasin për ekzistencën e Zotit. Këto dëshmi të përmendura në Kur'an nuk janë fenomene vetëm të një ekuilibri dhe rregulli në gjithësi, por edhe përshtatja e botës për jetën e njeriut, struktura e bimëve dhe e kafshëve, veçoritë e mrekullueshme të trupit të njeriut, si dhe cilësitë shpirtërore të qenieve njerëzore, të cilat janë vërtetuar të gjitha nga shkencat moderne. (Më shumë detaje mund të gjejmë në librat e Harun Yahya-s: "Allahu njihet përmes arsyes", "Krijimi i universit", "Përgënjeshtrimi i Darwinizmit", "Për ata që kuptojnë" dhe "Dizajni në natyrë").

Për më tepër, dogmatizmi është cilësi e atyre që refuzojnë të vrasin mendjen për këto gjëra, dhe e mohojnë Zotin që të mbrojnë pikëpamjen se universi ekziston vetvetiu sipas vullnetit të vet dhe se qeniet e gjalla dolën në jetë rastësisht. Masonët janë shembulli konkret i një pikëpamjeje të tillë. Pavarësisht nga fakti se dëshmitë për ekzistencën e Zotit janë të qarta, ata parapëlqejnë që t'i injorojnë dhe t'i refuzojnë ato në favor të filozofisë humaniste dhe materialiste.

Në Kur'an, Zoti i referohet atyre që kanë një mendësi të tillë:

**A nuk e dini ju se All-llahu nënshtroi për të mirën tuaj çka në qiej e çka në tokë dhe plotësoi ndaj jush të mirat e Tij të dukshme e të fshehta, e megjithatë ka prej njerëzve që polemizojnë për çështjen e All-llahut, duke mos pasur as dituri, duke mos qenë as të udhëzuar dhe duke mos pasur as libër të ndritshëm.**

**Dhe kur atyre u thuhet: "Pasoni atë që e shpall All-llahu" ata thonë: "Jo, ne ndjekim atë që gjetëm te prindërit tanë!" E edhe sikur djalli t'i kishte thirrur ata në dënimin e zjarrtë! (Kur'an, 31:20-21)**

Këto ajete tregojnë se të pafetë, edhe pse i shohin dëshmitë e Zotit, "prapë diskutojnë për Zotin", që do të thotë se ata angazhohen në luftë kundër fesë së Tij. Arsyeja për këtë është se këta njerëz të pafë pasojnë atë që iu kanë lënë baballarët e tyre, pra kjo tregon se ata janë zhytur në





An expression of Masonry's traditionalism: symbols that have not changed for centuries.





The rules that have been accepted as Masonry's constitution have been preserved unchanged for centuries.



**një tradicionalizëm të verbër.**

Dukshëm, tradicionalizmi e përkufizon shumë mirë historinë dhe filozofinë e Masonerisë, siç e kemi parë që nga fillimi i këtij libri.

Në të vërtetë, tradicionalizmi është një fjalë që e përshkruan shumë bukur Masonerinë, pasi Masoneria nuk është asgjë tjetër veçse një “organizatë traditash”, që i ka rrënjët thellë në shoqëritë pagane të mijëra viteve më parë. Ajo ndjek verbërisht traditat e Egjiptit të Lashtë, të faraonëve dhe magjistarëve të tyre, të filozofëve materialistë të Greqisë së Lashtë, hermeticistëve, kabalistëve, templarëve, rosikrusainëve dhe masonëve para tyre.

Është me rëndësi që ky tradicionalizëm të njihet më nga afër. Në lozhat moderne masonike, legjendat, simbolet dhe fjalët, që janë ende në përdorim, janë të vjetra me mijëra vjet. Pavarësisht nga fakti se gati të gjithë masonët kanë një nivel të lartë edukimi dhe janë në pozitë më të larta të shoqërisë, ata organizojnë ceremoni në të cilat marrin në duar shpata të praruara dhe kafka, mermërisin fjalë në gjuhën e lashtë egjiptiane duke qëndrojnë pranë shtyllave të modelit të tempujve të Egjiptit të Lashtë në paraskena të argjendta, me doreza të bardha e për më tepër me disa kostume të çuditshme dhe bëjnë betime të forta. Nëse ndonjë person, që nuk ka fare njohuri për Masonerinë, futet në lozhat e tyre, ai, me siguri, do të mendonte se është në shesh-xhirimin e ndonjë komedie dhe nuk ndoshta nuk do të mund të mbante dot të qeshurën kur t’i shihte masonët gjatë kohës së ceremonisë së pranimit, me sy të mbyllur me shami, me litar rreth fytit duke ecur rreth e rrotull me një këmbë të zbatshur. Por masonët, duke jetuar në një botë sekrete, i konsiderojnë këto ceremoni të çuditshme, si shumë normale dhe gjejnë kënaqësi psikike në atmosferën mistike të lozhave të tyre. Pas këtyre ceremonive, ata ulen dhe bisedojnë me njëri-tjetrin mbi besimin e tyre se “atomet kanë shpirt dhe bashkohen që të formojnë organizmat e gjalla”, se “bota e mban ekuilibrin e saj nga inteligjenca e fshehur në

magmë”, apo se “nëna natyrë na ka krijuar neve shumë mirë”, si dhe mite të tjera. Kjo maskaradë prezantohet vetëm që të ruhet tradita dhe është aq e paarsyeshme dhe aq e habitshme se si sistemi i tillë i ideve mund të jetë ende gjallë dhe të vazhdojë të mbrohet.

Lidhja e verbër e masonëve pas traditës së tyre tregon qartë rëndësinë e madhe që ata i japin idesë së “pikës së referimit”. Pika e referimit është një vend apo objekt që simbolizon diçka që ka rëndësi apo domethënie historike. Në gjuhën masonike, pikat e referimit janë rregullat që janë transmetuar pa u ndryshuar që nga themelimi i organizatës. Pse ato nuk u ndryshuan? Masonët ofrojnë një përgjigje interesante lidhur me këtë pyetje. Një artikull i botuar në “*Mimar Sinan*” më 1992, thotë:

Pikat e referimit të Masonerisë janë ligje shumë të vjetra që **janë transmetuar nga mosha në moshë dhe nga gjenerata në gjeneratë. Askush nuk e di kur janë shfaqur për herë të parë dhe askush nuk ka të drejtë që t’i ndryshojë apo t’i anulojë ato.** Ato janë ligje të shkruara dhe të pashkruara të shoqërisë. Ligjet e pashkruara mund të mësohen vetëm nga ritualet dhe ritet në lozha. Ekzistojnë gjashtë ligje të shkruara që mund të gjenden me titullin “Detyrimet e frankmasonit”, të botuara për herë të parë në Kushtetutën e Anglisë, më 1723.<sup>117</sup>

Le t’i studiojmë këto fjalë më nga afër: Ekziston një organizatë e quajtur Masoneri. Anëtarët e kësaj organizate për shekuj me radhë kanë ndjekur një numër ligjesh që nuk dihet nga e kanë prejardhjen. Përveç kësaj, ata janë mjaft të bindur se askush nuk i ka ndryshuar këto ligje. Askush prej tyre nuk merr guximin që të pyesë pse i zbatojnë këto ligje!... Dhe, për hir të zbatimit të këtyre ligjeve, ata janë të gatshëm që të injorojnë zbulimet shkencore dhe përfundimet e tyre logjike. A mund të thuhet se kjo është një shoqëri që ndjek rrugën e “arsyes” dhe “shkencës”?

Pjesa tjetër e artikullit të cituar më lart, konstaton fjalë për fjalë se





një mason duhet që t'iu bindet ligjeve pa pyetur për to:

Sipas mendimit tim, pika e referimit është një pjesë aq e vjetër e masonerisë, **për origjinën e së cilës nuk kam qenë kurrë kureshtar** as në lozhë, as në aktivitetin tim si frankmason. Nuk mund ta ndihmoj veten duke bërë analizën e asaj se pse ndihem kështu, por ndjej se nëse struktura e Frankmasonerisë nuk ndryshohet ajo do të zgjasë... **Unë jetoj me të pa bërë ndonjë përpjekje të veçantë.** <sup>118</sup>

Si mundet që një organizatë, pasuesit e së cilës besojnë dhe pajtohen me ligje, për origjinën e të cilave nuk shfaqin aspak kureshtje, të konsiderohet si e arsyeshme?...

Sigurisht, pohimi i masonëve se ata janë të arsyeshëm dhe shkencorë është krejtësisht i zbrazët. Sikurse materialistët e tjerë, edhe masonët, pavarësisht faktit se ata përdorin vazhdimisht termat e arsyes dhe shkencës, këmbëngulin për mbrojtjen e një filozofie e cila nuk ka përkrahje logjike apo shkencore dhe largohen nga faktet që ka zbuluar shkenca. Në thelb, ajo çfarë i dërgon masonët në një lajthitje të tillë, apo që me të vërtetë i ka magjepsur, është lidhja e verbër me traditën e tyre.

Kjo tregon se mësimi i Masonerisë është mashtrues. Ajo i largon njerëzit nga besimi i tyre tek Zoti, duke i bërë ata që të besojnë në besëtytni, duke ndjekur ligje boshe, mite dhe legjenda të kota. Ajo që thotë Kur'ani për paganët e Sebe`as, të cilët e braktisën Zotin dhe filluan të adhurojnë diellin, vlen gjithashtu edhe për Masonerinë: **“Madje e takova atë dhe popullin e saj se adhuronin diellin e jo Allahun, po djalli ua kishte hijeshuar atë veprim të tyre dhe i kishte shmangur prej rrugës së drejtë, andaj ata nuk gjejnë udhëzim.”** (Kur'an, 27:24). Masonët e mohuan fenë e Zotit dhe e zëvendësuan atë me një doktrinë të vjetër që ata e ndërlikojnë me simbole të praruara dhe me elemente mistike.

Përveç kësaj, atyre nuk iu mjaftoi vetëm mohimi i Zotit, por ata u angazhuan në luftë kundër fesë së Tij për një kohë të gjatë.



# -VI-

## LUFTA MASONE KUNDËR FESË

*F*illimisht, ekzistenca e Masonerisë u shpall zyrtarisht në Angli, më 1717. Para kësaj date, kjo organizatë kishte qenë e përhapur, së pari, në Angli dhe pastaj në Francë e në pjesë të tjera të Europës. Ajo u bë vendtakimi kryesor për kundërshtarët e fesë. Shumë masonë europianë takoheshin nëpër lozhat e tyre, duke shpallur veten si “mendimtarë të lirë,” gjë me të cilën ata tregonin se i mohonin fetë hyjnore. Në artikullin me titull “Etapat e para të Masonerisë”, të botuar në revistën “Mimar Sinan” thuhet: **“Vendi ku masonët takoheshin që të kërkonin të vërtetën jashtë kishës u bë strehë e tyre.”**<sup>119</sup>

Ky grup jo vetëm që e shihte të vërtetën jashtë fesë, por ai, gjithashtu, ushqente një antipati të madhe ndaj saj. Për këtë arsye, organizata u bë shumë shpejt një qendër e fuqishme që e çoi Kishën, sidomos Kishën katolike, në një gjendje të pavolitshme. Ky konflikt mes Masonerisë dhe Kishës vazhdoi të rritej, duke lënë shenjat e tij në Europën e shekujve XVIII dhe XIX. Në gjysmën e dytë të shekullit XIX,

Masoneria filloi të përhapej edhe në vendet e tjera jashtë Europës dhe, në çdo vend ku u shfaq, u bë qendra e diskutimeve filozofike dhe aktivitete antifetare.

Një artikull me titull “Politika dhe Frankmasoneria”, që u botua në revistën “Mimar Sinan”, përmban këtë tekst që flet për luftën kundër fesë:

Duke mos qenë një parti politike, **Frankmasoneria u organizua në fillim të shekullit XVIII si një institucion shoqëror me një shtrirje ndërkombëtare, e përshtatur me rrymat politike dhe shoqërore.** Me qëllim që të ndihmonte sektet në orvatjet e tyre për të praktikuar liritë fetare, Frankmasoneria u angazhua në luftën kundër fuqisë dhe ndikimit të klerit, duke u përpjekur që të arrinte qëllimin e vetëm të saj, për të përmbysur fuqinë dhe ndikimin e kishës tek njerëzit. Për këtë arsye, më 1738 dhe 1751, ajo u shpall si e pafé nga Papa... Në vendet, ku u miratuan parimet e lirisë fetare, Frankmasoneria ishte një shoqëri sekrete dhe mistike vetëm si emër. Në këto vende ku ajo edhe injorohej edhe inkurajohej, masonët mblodhën anëtarë nga klasa e mesme e shoqërisë si dhe zyrtarë të lartë që kishin kohë dhe mjete, ndërsa në krye të organizatave të tyre ata vendosën zyrtarët udhëheqës të shtetit. Në vendet jugore, ku çdokush duhej të ishte katolik, **ata mbajtën karakterin e tyre si të fshehtë, të jashtëligjshëm dhe si organizatë revolucionare që i bindej ligjit.** Në këto vende, të rinjtë me karakter mendimi të lirë dhe zyrtarët e pakënaqur me administrimin e qeverisë, filluan të hynin në lozhat masonike dhe kështu **filluan planet revolucionare, që u drejtuan kundër këtyre regjimeve në Spanjë, Portugali dhe Itali, të cilat ishin nën dominimin e Vatikanit.**<sup>120</sup>

Nuk ka dyshim se shkrimtari mason këtu përdor një gjuhë që e favorizon organizatën e vet, kur thotë se Masoneria po lufton një luftë kundër dominimit të kishës. Por, kur e shqyrtojmë çështjen më nga afër, shohim se në shumë vende “dominimi” i njëjtë ishte i volitshëm

për regjimet e themeluara, apo të mbështetura nga masonët. Prandaj, mund ta dallojmë shumë lehtë se pohimi i Masonerisë se po lufton kundër “dominimit” është vetëm pretendim apo shtirje. Edhe pse Kisha, i kishte ruajtur idetë skolastike dhe zakonet shtypëse, pavarësisht nga fakti se Krishtërimi u shtrembërua, armiqësia e Masonerisë ndaj saj nuk bazohej në këtë, por në urrejtjen ndaj traditës monoteiste.

Mjafton që të shihet struktura e Masonerisë dhe ritet e ceremonitë e saj për ta kuptuar këtë çështje.

### **MODELI I NJË LOZHE MASONIKE: “KLUBI I ZJARRIT TË FERRIT”**

Një nga gjërat që duhet shqyrtuar me qëllim që të kuptohet se si ka qenë e organizuar Masoneria në shekullin XVIII dhe se cilat ishin synimet e saj, është ekzaminimi i shoqatave të ndryshme sekrete masonike, që u paraqitën në atë kohë. Një shoqatë e tillë ishte “Klubi i zjarrit të ferrit”, e cila ishte aktive në Angli në mesin e shekullit XVIII. Struktura masone e këtij klubi dhe karakteri i tij antifetar dhe pagan, përshkruhet nga shkrimtari Daniel Willens, në artikullin e tij “Klubi i zjarrit të Ferrit: Seksi, politika dhe feja në Anglinë e shekullit XVIII”. Ja disa fragmente interesante nga ky artikull, i botuar në *Gnosis*, një gazetë që merret me traditat e brendshme të Perëndimit:

Në netët me hënë të plotë, gjatë sundimit të mbretit anglez George III, anëtarë shumë të fuqishëm të qeverisë së tij, intelektualë të rëndësishëm dhe artistë me ndikim mund të shiheshin duke lundruar me gondola në lumin Thames deri tek një kishë e rrënuar afër West Wycombe. Atje, nën tingëllimat kumbuese të kabanave të manastireve të ç’shenjtëruara, ata të veshur me mantele murgjish, kënaqeshin me çdo mënyrë shturjeje të mundshme, duke arritur kulmin me celebrimin e Meshës së Zezë, mbi...një grua fisnike të shturur, duke u udhëhequr nga famëkeqi Sir Francis Dashwood.



Ritet e tyre djallëzore përfundonin me, rrethin e brendshëm që do të pezullonte komplotin e sundimit të Perandorisë Britanike.

Kjo “shoqatë mëkatore”, siç quhej, e stilizonte veten me veçori gotike, **“Murgjit e Shën Francisit të Medmenham-it,”** edhe pse ata u përjetësuan në bazë të epitetit të tyre të popullarizuar **“Klubi i zjarrit të Ferrit”**. Në ato kohëra thashethemesh, kishte më shumë spekulime për aktivitetet e tmerrshme të shoqatës dhe më 1765, Charles Johnstone botoi një roman me titull “Chrysal, ose Aventurat e një Guineje”, për të cilin besohej gjërësisht se demaskonte sekretet e “murgjve të Medmenham-it”... paraardhësi më i rëndësishëm i murgjve është ‘Klubi i zjarrit të Ferrit’, i themeluar rreth vitit 1719, në Londër, nga Philipi, Duka i Whartonit (1698-1731). **Wharton ishte një politikan i shquar liberal, frankmason, dhe ateist që kërkonte ta bënte qesharake çështjen e fesë duke drejtuar hapur tubime festive me kostume solemne “Satanike”... dhe Wharton përparoi duke u bërë mjeshtër i madh mason i Lozhës së Madhe të Londrës më 1722...**

Më 1739, Dashwood gjatë rrugës së kthimit për në shtëpi u ndal në Firence që të vizitonte Abbe Nicolinin dhe ky ishte vendi ku u takua me zonjën Mary Wortley Montagu-n... e cila do t’i bashkëngjitej përfundimisht... Dashwoodit në Divan Club... Për fat të keq, gjërat nuk po shkonin mirë për Frankmasonerinë në Itali. Papa Clementi XII, kohët e fundit, kishte botuar In Eminentis Apostolatus Specula, duke ndërsyer inkuizicionin kundër lozhave. Në fillim të viteve 1740, papa vdiq dhe Dashwoodi shkoi në Romë për të mbledhjen e fshehtë ku do të vendosej për papën e ri. Atje, ai u maskua me shaka si Kardinal Ottiboni, njëri ndër persekutorët kryesorë të masonëve, dhe e satirizoi atë publikisht me një ritual përqeshës dhe të ndyrë.. “Dhoma e kapitullit” është çelësi për të kuptuar aktivitetet e murgjve. Orenditë e saj mbeten ende të panjohura dhe si pasojë, mënyra e përdorimit të tyre mbetet një mister. Autorët




sensacionalistë supozojnë se ishte një faltore satanike, edhe pse duket më e arsyeshme të arrihet në përfundimin se ajo shfrytëzohej për ceremoni masonike. John Wilkes, një anëtar i rëndësishëm i qarkut të Medmenhamit, që nuk u bë mason dhe më pas u nda nga grupi i tij, ankohet në një artikull, ku e diskrediton një ish shokun e tij duke thënë : “Asnjë sy laik nuk ka guxuar që të depërtojë në misteret e Eleusinianit anglez të dhomës së kapitullit, ku murgjit janë grumbulluar në të gjitha rastet solemne, ku janë kryer ritet më sekrete dhe ku pijet alkoolike janë derdhur me madhështi përpara BONA DEA-s”... Horace, djali i Sir Robert Walpole, njëri ndër armiqtë më të mëdhenj politik të Dashwoodit dhe sigurisht i pamësuar me abaci, përqeshej: **“Pa marrë parasysh se çfarë ishin doktrinat e tyre, praktikimi i tyre ishte rigorozisht pagan: Bacchusi dhe Venusi ishin zotat që ata iu sakrifikoheshin publikisht më së shumti; si dhe nimfat dhe fuçitë e mëdha që vendoseshin në sfondet e festimeve të kësaj kishe të re, e informonin mjaft rrethin për kompleksin e këtyre eremitëve”...**

Lista e anëtarësisë së murgjve të Medmenham-it nuk ekziston më, por edhe nëse ka ekzistuar ndonjëherë, emrat më kryesorë që besohet të kenë qenë, përfshirë këtu edhe vëllain e Dashwoodit, janë: John Dashwood-King, John Montagu, Earli nga Sandwichi; John Wilkes; George Bubb Dodington, Baron Melcombe; Paul Whitehead; dhe një grup zotërinjsh më të vegjël lokalë dhe profesionistë... d.m.th. **një grup njerëzish që mjaftonin për të krijuar skandal në sytë e publikut.**

Çështja kryesore që Dashwoodi vazhdonte të ushtronte, ishte çështja e fesë... Një interpretim më të sofistikuar e gjejmë të përmbledhur tek thashethemet e magjisë seksuale, librit kabalist të abacisë, shëmbëllimit të vazhdueshëm të Harpokrateve, lidhjes së parëndësishme të Dashwoodit me Rendin Masonik të Tempullit, dhe natyrisht motoja Telemike në abacinë e Medmenhamit që del në





A depiction of strange ceremonies in an eighteenth century Masonic lodge.

përfundimin se 'Klubi i Zjarrit të Ferrit' ishte një manifestim më i hershëm i "Crowleyanity"-së. **Një qasje më e qartë do të nxjerrë në pah kontaktet masonike të Dashwoodit dhe arrihet në një përfundim, me sa duket të saktë, se "dhoma e kapitujve" ishte një tempull masonik.**<sup>121</sup>

Arsyeja për përfshirjen e këtij citati të gjatë është, që të krijohet një ide për atmosferën, në të cilën zhvillohej Masoneria e shekullit XVIII dhe për ndikimin që kishte pasur ajo tek njerëzit. Masoneria lindi si një organizatë tërheqëse sekrete dhe interesante. Kundërshtimi që u bëhej besimeve të përgjithshme të shoqërisë, u jepte një lloj kënaqësie psikike anëtarëve të saj. Karakteristikë themelore e riteve masonike, siç u cek edhe në citatin e mësipërm, ishte shenjtërimi i simboleve dhe koncepteve pagane, në vend të koncepteve tradicionale të feve monoteiste. Në këtë mënyrë, ata që bëheshin masonë dhe ia kthenin shpinën krishterizmit, bëheshin paganë, megjithëse nuk ishte e domosdoshme që të adoptohej paganizmi si besim, por së paku kjo shprehej me adoptimin e simboleve të tij.

Sidoqoftë, Masonerisë nuk mjaftohej vetëm me praktikimin e ceremonive të çuditshme, por ajo ndiqte një strategji që planifikonte për ta larguar Europën nga fetë hyjnore dhe ta joste atë në paganizëm. Në paragrafin e ardhshëm do të shqyrtojmë disa çaste të veçanta të historisë evropiane, nga një vend në tjetrin dhe do të ndjekim gjurmët e kësaj lufte masonike kundër religjionit. Vendi i parë që duhet të shqyrtojmë është Franca.

## **LUFTA KUNDËR RELIGJIONIT NË FRANÇË**

Në veprat më të hershme kemi shqyrtuar rolin e rëndësishëm që Masoneria luajti në Revolucionin Francez. Një numër i madh filozofësh të Iluminizmit, posaçërisht ata me pikëpamje më të forta antifetare, ishin masonë. Jakobinët, të cilët përgatitën skenën e





revolucionit dhe që u bënë ndër udhëheqësit kryesorë, ishin masonë.

122

Roli që luajtën masonët në revolucion pranohet nga një “agjent provokator”, i quajtur **konti Cagliostro**. Cagliostro u arrestua nga inkuizicioni më 1789, dhe gjatë marrjes në pyetje, pranoi disa fakte të rëndësishme. Ai filloi me deklarinimin se masonët kishin planifikuar një zinxhir revolucionesh në të gjithë Evropën. Ai tha se qëllimi kryesor i masonëve ishte që të shkatërronin papatin apo që të merrnin pushtetin. Në rrëfimin e tij, Cagliostro pranoi gjithashtu se bankierët çifutë i kishin përkrahur financiarisht të gjitha këto aktivitete revolucionare dhe se paratë e çifutëve kishin luajtur gjithashtu një rol të rëndësishëm në Revolucionin Francez.<sup>123</sup>


Revolucioni Francez ishte në parim, një revolucion kundër fesë. Në përpjekjet e vendosura të revolucionarëve, për të heqin qafe klerin e gjithashtu edhe aristokracinë, shumë klerikë u vranë, institutet fetare u rrënuan dhe vend-adhurimet u shkatërruan. Jakobinët dëshironin që ta shkatërronin krejtësisht krishtërizmin dhe ta zëvendësonin me një besim pagan, të cilin ata e quajtën “religjion i arsyes”. Por, brenda një kohe të shkurtër, ata e humbën kontrollin mbi revolucionin, kështu që Franca u gjend në një kaos total.

Misioni i Masonerisë në atë vend nuk mbaroi vetëm me revolucionin. Kaosi, që erdhi si rezultat i revolucionit, u eliminua me ardhjen në pushtet të Napoleonit. Por ky stabilitet nuk zgjati shumë.

Ambiciet e Napoleonit për të sunduar tërë Evropën, bënë që sundimit të tij t’i vinte fundi. Më pas, konflikti në Francë vazhdoi mes monarkistëve dhe revolucionarëve. Më 1830, 1848 dhe 1871, ndodhën edhe tri revolucione të tjera. Më 1848, u themelua “Republika e dytë”; më 1871 u themelua “Republika e tretë”.

Masonët ishin shumë aktivë gjatë periudhës të trazirave. Qëllimi i tyre kryesor ishte që të dobësonin Kishën dhe institucionet e saj fetare,





An illustration of an eighteenth century French Masonic lodge.





të zhvleftësonin vlerat fetare dhe ndikimin e ligjeve të saj në shoqëri. Gjithashtu masonët kishin si qëllim edhe shfuqizimin e edukimi fetar. Masonët e shikonin **“antiklerizmin”** si qendër të aktiviteteve të tyre shoqërore dhe politike.

*Enciklopedia katolike* jep informata të rëndësishme për misionin antifetar të **Grand Orientit**, siç njihet masoneria franceze:

Nga dokumentet zyrtare të masonerisë franceze, kryesisht nga “Buletini” zyrtar dhe “Compte-rendu” të Grand Orientit **është provuar se të gjitha masat antiklerike të aprovuara në parlamentin francez ishin dekretuar më herët në lozhat masonike dhe ishin zbatuar nën udhëheqjen e Grand Orientit**, qëllim të cilin ata e kishin pranuar, i cili synonte të kishte kontrollin mbi çdo gjë dhe mbi çdokënd në Francë. “ – Në kuvendin e 1898 unë thashë ”,- thekson deputeti Massé, zëdhënësi zyrtar i kuvendit më 1903, “ - se është detyra më e lartë e frankmasonerisë që të ndërhyjë çdo ditë e më shumë në luftërat politike dhe laike.” **“Suksesi (në luftën antiklerike), i detyrohet në masë të madhe frankmasonerisë, për shkak të shpirtit, programit dhe metodave të saj që kanë triumfuar.”** “Nëse do të themelohej Blloku, ky do t’i ishte borxhli frankmasonerisë dhe disiplinës së mësuar në lozha...” **“Neve na nevojitet të jemi syçelë dhe mbi të gjitha na nevojitet besimi i ndërsjellë, për të përfundojmë punën tonë, pasi ajo akoma nuk ka përfunduar.** Kjo punë, e dini... lufta antiklerike, ende vazhdon. Republika duhet të largohet nga kongregacionet fetare, duke i fshirë ato nga faqja e dheut me një goditje të fuqishme. Sistemi i masave të gjysmuara është gjithkund i rrezikshëm; kundërshtari duhet që të asgjësohet vetëm me një goditje.”<sup>124</sup>

*Enciklopedia katolike* vazhdon vlerësimin e luftës së masonerisë franceze kundër religjionit:

Në të vërtetë, të gjitha reformat masonike “antiklerike” që u bënë në Francë që nga viti 1877, reforma të tilla si: laicizmi i arsimit, masat



kundër shkollave private të krishtera dhe shoqatave bamirëse, mbyllja e urdhrave fetare si dhe grabitja e pronave kishtare, arritën **kulmin duke shfaqur haptas një riorganizim anti-katolik dhe jofetar** të shoqërisë njerëzore, jo vetëm në Francë, por në **të gjithë botën**. Në këtë mënyrë masoneria franceze, si bartëse standarde e gjithë frankmasonerisë, pretendon që të inagurojë periudhën e artë të republikës universale masonike, duke përfshirë në vëllazërinë masonike të gjithë njerëzit dhe të gjitha kombet. “ - Triumfi Galilean, - ” tha kryetari i Grand Orientit, senatori Delpech, më 20 shtator 1902, “ - ka zgjatur njëzet shekuj. Por tani i ka ardhur koha që të vdesë... Kisha katolike, e themeluar sipas mitit Galilean, filloi të kalbet me shpejtësi, pikërisht ditën kur u themelua Shoqata masonike.”<sup>125</sup>

Me fjalën “galilean” masonët nënkuptojnë Jezusin, pasi sipas Ungjillit, Jezusi ishte lindur në rajonin palestinez të Galilesë. Prandaj, urrejtja e masonëve ndaj kishës është shprehje e urrejtjes së tyre ndaj Jezusit dhe ndaj të gjitha feve monoteiste. Ata mendojnë se e kanë shkatërruar efektin e feve hyjnore me filozofitë materialiste, darviniste dhe humaniste, që ata i themeluan në shekullin XIX dhe se e kthyen Evropën në paganizmin e parakrishterë.

Kur u shqiptuan këto fjalë, më 1902, në Francë u miratuan një varg ligjesh që e zgjeruan shtrirjen e kundërshtarëve të fesë. 3.000 shkolla fetare u mbyllën dhe u ndalua arsimimi fetar në shkolla. Shumë klerikë u arrestuan, disa u dëbuan dhe ata që besonin filluan të konsideroheshin si qytetarë të rendit të dytë. Për këtë arsye, më 1904, Vatikani i prishi të gjitha marrëdhëniet diplomatike me Francën, por kjo nuk e ndryshoi qëndrimin e këtij vendi. Ky qëndrim i kushtoi Francës qindra mijëra jetë francezësh kundër ushtrisë gjermane gjatë Luftës së Parë Botërore, para se arroganca e vendit të zbutej dhe ai të fillonte të pranonte prapë rëndësinë e vlerave shpirtërore.

Siç pohohet në *Enciklopedinë katolike*, lufta kundër fesë, që nga Revolucioni Francez e deri në shekullin XX, ishte bërë nga “masat

antiklerike të aprovuara në parlamentin francez” që “ishin dekretuar më herët në lozhat masonike dhe ishin zbatuar nën udhëheqjen e Grand Orientit”.<sup>126</sup> Ky fakt bëhet i qartë nga shkrimet masonike. Për shembull, një citat i një botimi turk të “Fjalimit të bërë nga vëllai Gambetta, më 8 korrik 1875, në lozhën Clémente Amitié”, thotë:

Ndërkohë që spektri reaksionar kërcënonte Francën dhe doktrinën fetare e idetë e prapambetura kaluan në ofensivë kundër parimeve dhe ligjeve moderne, në gjirin e organizatave industriale dhe largpamëse, siç ishte masoneria që i përkushtohej parimeve të vëllazërisë, ne gjetëm forcën dhe shpëtimin në luftën kundër pohimeve ekstravagante të kishës, ekzagjerimeve të saj qesharake dhe teprimeve të rëndomta... Duhet të jemi të kujdesshëm dhe të vazhdojmë luftën. Në mënyrë që të themelojmë idetë e rendit njerëzor dhe të përparojmë, ne duhet të qëndrojmë në atë mënyrë që mburojat tona të mos thyhen.<sup>127</sup>

Vërehet se literatura masonike i paraqet në mënyrë të vazhdueshme idetë e veta si “largpamëse”, ndërsa njerëzit fetarë i akuzon si “të prapambetur”. Sidoqoftë, kjo është vetëm një lojë fjalësh. Termi “spektri reaksionar” i përmendur në citimin e mësipërm, është diçka që e kundërshton gjithashtu edhe fetarët e sinqertë, por masonët e shfrytëzojnë këtë, me qëllim që të përgënshetrojnë fenë e vërtetë, në tentativë për t’i larguar njerëzit nga ajo. Përveç kësaj, duhet të theksohet përsëri se filozofia materialiste-humaniste e përqaftuar nga masonët është me të vërtetë supersticioze dhe me ide të prapambetura, një vazhdimësi e civilizimeve pagane të Egjiptit dhe Greqisë së Lashtë.

Prandaj, shprehjet që përdorin masonët si “ largpamje” dhe “ prapambetje” nuk kanë bazë në realitet. Në të vërtetë, kjo është e pabazë për shkak se konflikti mes masonëve dhe fetarëve nuk është asgjë më tepër se përjetësimi i konfliktit mes dy ideve që kanë ekzistuar që nga etapat e hershme të historisë. Ishte feja ajo që shpalli



fillesat e ideve se: njerëzimi ishte krijuar me vullnetin e Zotit dhe se njerëzit janë të obliguar që ta adhurojnë Atë. Kjo është e vërteta. Ideja e kundërt, se njerëzit nuk janë të krijuar, por jetojnë një jetë të kotë dhe pa qëllim, është propozuar nga ata që e mohojnë ekzistencën e Zotit. Kur të kuptohet në mënyrë të drejtë kjo gjë, mund të shihet se përdorimi sipërfaqësor i termave “prapambetje” dhe “largpamësi” nga ana e masonëve nuk ka bazë.

Me përdorimin e termit “përparim”, masonët kërkojnë që të shkatërrojnë fenë. *Enciklopedia katolike konstaton:*

Këto mendohet të jenë bazat parimore (të Frankmasonerisë):

**Të shkatërrojë** në mënyrë radikale, me persekutim të hapur apo me një sistem jo të sinqertë dhe hileqar ndaj Kishës ndarjen mes saj dhe Shtetit, **gjithë ndikimin shoqëror** të Kishës dhe **të fesë**, që me përcmim e kanë quajtur “klerikalizëm”, dhe sa të jetë e mundur, **të shkatërrojë** Kishën dhe çfarë është e vërtetë.... që sipas tyre është një **fembinjerëzore, që nuk është gjë tjetër më shumë se një kult i paqartë i atdheut dhe njerëzimit.**

Të laicizojë apo të heqë fenë me një sistem jo të sinqertë dhe hileqar “Asektarizmi “ (heqja e sekteve), në gjithë jetën publike dhe private dhe mbi të gjitha të laicizojë arsmimin dhe edukimin e masave. “Ansektarizmi”, siç është kuptuar nga partia e Grand Orientit, “Asektarizmi” është **një sekt antikatolik e madje edhe antikrishter, ateist, pozitivist, apo edhe gnostik**, me pamjen e asektarizmit. Liria e mendimit dhe e vetëdijes së fëmijëve duhet të zhvillohet sistematikisht tek fëmijët e shkollës dhe duhet të mbrohet, sa më shumë që të jetë e mundur, kundër të gjitha ndikimeve turbulluese, jo vetëm nga Kisha dhe nga priftërinjtë, por, gjithashtu, edhe nga prindërit e vetë fëmijëve, nëse është e nevojshme, madje edhe me mjete detyruese morale dhe fizike. **Partia e Grand Orientit** e konsideron atë si rrugë të domosdoshme dhe si mënyrë shumë të sigurt për **krijimin përfundimtar të republikës universale**



shoqërore...<sup>128</sup>

Mund të vërehet se Masoneria ka aktivizuar një program, nën emrin e “çlirimit të shoqërisë”, qëllimi i të cilit është çrrënjësja e fesë, një program që ende po kompletohet. Këtë nuk duhet ta ngatërrojmë me modelin që përpiqet të sigurojë mundësi për secilin qytetar që të praktikojë fenë e vet lirshëm, pa marrë parasysh përcaktimin fetar. Ose më mirë, modeli i parashikuar nga Masoneria është një model që bën lavazhin e trurit, i modeluar për ta hequr plotësisht fenë nga shoqëria si dhe nga mendja e individëve dhe, nëse është e nevojshme, për t’i persekutuar ithtarët e saj.

Në çdo vend që është themeluar, Masoneria përpiqet që ta aktivizojë këtë program, sipas një mënyre që pajtohet me kulturën dhe kushtet që dominojnë në atë vend.

Një vend i tillë është Gjermania.

### **FUSHATA ANTIFETARE NË GJERMANI: “KULTURKAMPF”**

Para 150 vjetëve, Gjermania nuk ekzistonte fare. Territori që tani njihet si Gjermani përfshinte një numër principatash. Më e madhja ishte Prusia, që përfshinte pjesën lindore të Gjermanisë së sotme dhe një pjesë të madhe të Polonisë. Në 1860, Prusia filloi t’i përvetësonte shtetet e tjera të vogla gjermane dhe më 1871 themeloi Perandorinë Gjermane. Udhëheqësi i këtij shteti të ri ishte kryeministri i Prusisë dhe Kancelar i Perandorisë së re gjermane, Otto von Bismark.

Bismarku ishte një burrë shteti i suksesshëm, sidomos në politikën e jashtme, por nuk pati sukses në punët e brendshme të shtetit. Një ndër arsytet e këtij mospjesë ishte një grup i vogël intelektualësh, të njohur si “Liberalët kombëtarë”, të ngjashëm me antiklerikët francezë, që adoptuan një politikë antifetare. Në mënyrë që të arrihej bashkimi i Gjermanisë, liberalët kombëtarë besonin se







Otto von Bismarck

është e domosdoshme që t'i largonin njerëzit nga çdo sens i bashkimit jashtë kufijve të tyre dhe e panë marrëdhënien mes një të tretës së popullatës dhe Papës Katolik si pengesën më të madhe për këtë. I inkurajuar nga liberalët, Bismarku u përfshi në fushatën antikatolike të quajtur *Kulturkampf*, apo "lufta kulturore". **Kjo u përshkrua si lufta për të kontrolluar mendjen e gjermanëve.**<sup>129</sup>

Gjatë *Kulturkampf*it, katolikët, posaçërisht në jug të Gjermanisë, iu

nënshtruan tiranisë. Më 1872, në pajtim me ligjin që u aprovua, të gjithë priftërinjtë jezuitë të vendit u rrethuan brenda një nate të vetme dhe institutet e tyre u konfiskuan. Në pajtim me “ligjin e majit” të aprovuar më 1873, të gjithë priftërinjtë që punonin në qeveri u pushuan nga puna. Kishës iu ndalua përzjerja në të gjitha çështjet që kishin të bënin me martesat dhe arsimin, si dhe u kufizuan predikimet. Një numër kryepeshkopësh u arrestuan dhe 1300 kisha mbeten pa priftërinj. Por, për shkak se këto taktika shkaktuan një reagim të fortë në mesin e katolikëve të këtij vendi kundër qeverisë, *Kulturkampf* u zbut. Bismarku i injoroi sugjerimet e liberalëve kombëtarë, të cilët e përzien atë në këtë fushatë dhe, dalëngadalë, e tkurri pak nga pka *Kulturkampf-in* dhe më në fund, e pezulloi krejtësisht. Gjithë kjo fushatë rezultoi me ushtrimin e tiranisë ndaj katolikëve të devotshëm gjermanë dhe ajo shkatërroi sensin për mirëqenien sociale të vendit. Sot, shumë historianë besojnë se kjo fushatë ishte një dështim që shkatërroi sensin gjerman të sigurisë shoqërore. Përveç kësaj, pas Gjermanisë, vala e këtij *Kulturkampf-i* përfshiu edhe Austrinë, Zvicrën, Belgjikën dhe Holandën, duke shkaktuar tension të madh shoqëror në këto vende.

Duhet përmendur se ishin intelektualët masonë ata që e joshën Bismarkun në këtë politikë. *Enciklopedia katolike* thotë:

Por ata (masonët), pa dyshim, e çuan më tutje lëvizjen me të cilën Prusia u bë gradualisht shteti udhëheqës i Gjermanisë, e konsideruar nga ata si “përfaqësues dhe mbrojtës i evolucionit modern” kundër “ultramontanizmit”, “fanatizmit” dhe “uzurpimeve papnore”. <sup>Ata gjithashtu nxitën Kulturkampf-in.</sup> Juristi dhe masoni i njohur, mjeshtri i madh Bluntschli, ishte një ndër propaganduesit më të shquar në këtë konflikt; ai gjithashtu nxiti Kulturkampf-in zvicëran... Frankmasonët gjermanë bënë përpjekje të palodhshme për të patur ndikim bindës në tërë jetën e kombit, në përputhje me parimet masonike, duke mbajtur vazhdimisht një Kulturkampf të heshtur. Mjetet kryesore që



ata përdorën, ishin bibliotekat e popullarizuara, konferencat, bashkimet e shoqatave dhe institucioneve të ngjashme dhe krijimi aty ku ishte e nevojshme, edhe i institucioneve të reja, përmes të cilave shpirti masonik përhapej nëpër popull.<sup>130</sup>

Kështu pra, pavarësisht nga fakti se *Kulturkampf*-i u ndalua zyrtarisht nga Bismarku, ai u vazhdua nga masonët, si një fushatë propagande e vazhdueshme antifetare drejtuar shoqërisë në



When the Nazis came to power, an anti-religious campaign, worse than that of Bismarck, was initiated.

përgjithësi. Frytet më të hidhura të kësaj lufte u poqën në vitet 1920: nazistët, të cilët synuan ta kthenin popullin gjerman në besimin pagan parakrishterë, fituan fuqi gradualisht dhe më 1933 erdhën në pushtet. Një ndër aksionet më të rëndësishme të nazizmit ishte startimi i *Kulturkampf-it* të dytë kundër autoriteteve fetare. Komentuesi amerikan Elbridge Colby shpjegon se “nazistët hapën një *Kulturkampf* të ri kundër kishës katolike, duke i burgosur priftërinjtë dhe duke i shkarkuar nga puna peshkopët; sidoqoftë, ndryshe nga viti 1874, Hitleri iu kundërvu gjithashtu edhe protestantëve.”<sup>131</sup>

Shkurtimisht, aktivitetet e nisura nga masonët për të distancuar shoqërinë nga feja, i dhanë jetë njëres nga diktaturat më brutale në historinë e njerëzimit, Rajhut nazist, duke e zhytur botën në Luftën e Dytë Botërore, gjatë së cilës e humbën jetën 55 milion njerëz.

## LUFTA KUNDËR FESË NË ITALI

Një vend tjetër ku u evidentuan aktivitetet masonike, ishte Italia.

Deri më 1870, territori italian ishte i pushtuar nga disa shtete të vogla, të mbetura që nga koha e feudalizmit. Më i rëndësishmi ishte Shteti Papnor. Ky shtet, me qendër në Romë, nën sundimin e Papës, kontrollonte një pjesë të madhe të Italisë qendrore. Masonët në Itali u themeluan si pjesë shtesë e masonëve francezë dhe filluan të ushtronin ndikim në Itali që nga fillimi i shekullit XIX. Ata dëshironin që të shkatërronin Shtetin Papnor dhe ta çrrënjosnin krejtësisht autoritetin e Kishës. Autori i librit “*Kisha romane katolike dhe esnafi*” mjeshtri frankmason Alec Mellor, shkruan: “Në Itali, origjina e lozhave jo të rregullta ishte kryesisht me natyrë politike; ata e hutuan Masonerinë me luftën kundër fuqisë së përkohshme të Papës.”<sup>132</sup>

Masoneria e filloi luftën kundër fesë në Itali me mjetet e një shoqërie tjetër sekrete që ajo vetë e themeloi dhe e kishte nën kontroll. Kjo shoqëri njihej me emrin “**Carbonari**”.




Kjo shoqëri, që së pari u paraqit në Napoli, në fillim të shekullit XIX, e mori emrin nga qymyrxhinjtë. Ashtu sikurse masonët që përdornin emblemën e muratorëve dhe i shprehnin idetë e tyre me simbole, ashtu edhe karbonarët adoptuan emblemën e qymyrxhinjve. Por, shoqëria kishte objektiva të mëtejshme. Anëtarët e shoqërisë e panë të udhës që të nisin një program politik, së pari në Itali, e pastaj edhe në Francë, për të shkatërruar ndikimin e Kishës, për të vendosur një qeveri të re dhe për t'i bërë laike të gjitha institucionet shoqërore.



A publication of Italian Masonry.

Lidhja mes Masonerisë dhe shoqërisë Karbonari është e dukshme. Masonët u bënë automatikisht anëtarë të shoqatave Karbonari; në të vërtetë, që nga momenti që iu bashkëngjitën shoqërisë, ata fituan shkallën e mjeshtrit. (Nga ana tjetër, për anëtarët e tjerë të shoqërisë Karbonari ishte e domosdoshme që të kalonin një proces të gjatë trajnimi para se të arrinin në këtë shkallë). Dy kardinalë, të quajtur Consalvi dhe Pacca lëshuan më 15 gusht 1814 një urdhër, ku i akuzuan masonët dhe karbonarët për organizimin e një ndërhyrjeje politiko - shoqërore dhe për nxitjen e armiqësisë ndaj fesë.

Kjo akuzë tregoi, se me të vërtetë anëtarët e “Karbonarit” kishin organizuar kryengritje të armatosura dhe manipulime politike. Një



**Giuseppe Mazzini and Count di Cavour: two Master Masons who brought the Papal State to an end.**

kryengritje e armatosur u organizua nga karbonarët në Macerata, më 25 qershor 1817, por u shtyp nga forcat e sigurimit të Shtetit të Papës.

Më 1820, karbonarët organizuan kryengritje revolucionare kundër Kishës dhe rendit publik në Spanjë dhe Napoli dhe më 1821 në Piemont. Është fakt i pranuar se “Karbonari” u themelua nga masonët që u angazhuan në aktivitetet paralele revolucionare me ta. Pas revolucionit të korrikut në Francë, më 1830, organizata e humbi influencën e vet dhe gradualisht u zhduk. Në Itali, ajo u bashkua me lëvizjen “Italia e re”, themeluar nga Giuseppe Mazzini.

Mazzini, një ateist i njohur, kishte luftuar për vite kundër Shtetit të Papës dhe Kishës dhe, më në fund, u bë një mason i rangut së lartë. Më vonë ai do të bëhej edhe themelues i Unionit Italian. Me përkrahjen e dy masonëve të tjerë të shquar, Giuseppe Garibaldi dhe Count di Cavour, ai themeloi Unionin Italian, më 1870 dhe i vendosi kufijtë e Shtetit të Papës brenda kufijve të sotëm. Më pas, vendi hyri në një proces nëpërmjet të cilit Italia u distancau së tepërmi nga feja. Kjo bëri

**Masonic propaganda depicting Garibaldi as a great hero.**

që të përgatitej terreni për diktaturën fashiste të Mussolinit në vitet 1920.

Shkurtimisht mund të themi se Mazzini, Garibaldi dhe Cavour ishin tre udhëheqësit më të

shquar që kryenin funksione të rëndësishme në luftën kundër fesë në Evropë. Mazzini nuk ishte vetëm lider politik në luftën kundër fesë, por ai luante gjithashtu edhe rolin e një ideologu. Motoja e tij “çdo popull, një shtet” ishte shkëndija që ndezi kryengritjet e pakicave, që u bënë shkaktare për rrënimin e perandorive multietnike, siç ishte ajo e Austro-Hungarisë dhe ajo Osmane. Ky slogan i Mazzinit i largoi njerëzit nga ndjenja e tyre për vëllazërinë fetare; ajo ishte një thirrje që i drejtoi ata drejt konfliktit etnik me njëri-tjetrin dhe i inspiroi ata që të “ndiznin në zemrat e tyre euforinë” (Kur’an 48:26).

Dëshmia që tregon se kjo u arrit nga masonët, më saktë nga masonët e rangut të lartë, është sigurisht domethënëse. Sipas informacionit, nga publikimi i lozhës “10.000 frankmasonët e famshëm”, Mazzini u ngrit brenda lozhës masonike dhe disa vjet më vonë, më 1867, u zgjodh si mjeshtër mason i Grand Orientit Italian. Më 1949, në



ceremoni e zbulimit të statujës të Mazzinit në Romë, 3.000 masonë përkujtuan me nderime mjeshterin e tyre të madh. Garibaldi, dora e djathtë e Mazzinit, arriti shkallën e 33-të të Këshillit Suprem italian në 1863 dhe në 1864 u zgjodh si mjeshtër mason italian. Në përkujtim të këtij mjeshtër masoni, një lozhë e lidhur me “luginën” e Nju Jorkut me numër 542, mban emrin e tij.

## **AXHENDA E REVOLUCIONEVE MASONIKE NË RUSI**

Përveç Italisë, gjurmët e aktiviteteve revolucionare masonike mund të gjenden edhe në shumë vende të tjera të Evropës. Në *Enciklopedinë katolike* thuhet: “Në ... lëvizjet e mëvonshme revolucionare në Francë, Itali, Spanjë, Portugali, Amerikën Qendrore dhe Jugore, pretendohet se trupat masonike, pak a shumë, kanë marrë pjesë,... Në Rusi, gjithashtu, Frankmasoneria më në fund u shfaq si “komplot politik” i klubeve të organizuara masonike në të gjithë vendin.”<sup>133</sup>

Komploti në Rusi është veçanërisht interesant.

Masoneria erdhi në këtë vend në pjesën e dytë të shekullit XVIII dhe u përhap ndërmjet intelektualëve. Megjithëse u paraqit thjesht me pamjen e një klubi kulturor, në lozhat e tyre diskutohej për idetë antifetare dhe antiqeveritare të vendeve të tjera europiane. Të parët që e vërejtën këtë gjë ishin priftërinjtë e Kishës ortodokse. Ata ia dërguan këto informata Carit Aleksandër I-rë, që kishte marrëdhënie të mira me Kishën Ortodokse, duke i shpjeguar komplotin e masonëve, që do të përmbyste regjimin e Carit. Si reagim, Cari shpalli një ligj më 1822, për mbylljen e të gjitha lozhave masonike në vend dhe ai e shpalli organizatën si të paligjshme. Pavarësisht nga kjo, Cari nuk ia doli dot që t’i eliminonte masonët; ata thjesht kaluan në ilegalitet.

Tri vjet pasi Car Aleksandri I-rë i nxori lozhat jashtë ligjit, ai u





sëmur dhe vdiq. Atë e pasoi Cari Nicholas I-rë. Emërimi i tij u shoqërua me shumë paqartësi dhe intriga dhe kjo gjë e çoi vendin në një situatë kaotike. Individë të caktuar, që dëshironin të stabilizonin



**Renowned writer Pushkin was among the Masons who organized the Mason-perpetrated coup attempt in Russia.**

situatën duke e përmbysur regjimin, kishin planifikuar një goditje befasuese kundër Carit të ri. Ata kishin shumë përkrahës në ushtri. Një numër njerëzish të besueshëm ushtarësh revolucionarë, së bashku me një numër civilësh, marshuan më 14 dhjetor 1825 brenda pallatit të Carit, në St. Petersburg, në kryeqytetin e Rusisë së atëhershme. Mes revolucionarëve dhe forcave të Carit u zhvilluan luftime të armatosura, ku revolucionarët u mundën. Ky grup u quajt "Decemristët" (dhjetoristët), sipas muajit kur ata filluan revolucionin. Udhëheqësit e këtij grupi u arrestuan dhe pesë prej tyre u varën.

Decemristët nuk ishin tjetër veçse masonët... Oficerët, intelektualët dhe shkrimtarët që përbënin grupin ishin pjesëtarë të lozhave, që Car Aleksandri I-rë i kishte shpallur të paligjshme tri vjet më parë. Njëri ndër këta masonët revolucionarë ishte edhe shkrimtari i njohur Count Pushkin.<sup>134</sup>

Projekti i Decemristëve dështoi, por masonët nuk hoqën dorë nga përpjekjet e tyre për të përmbysur Carin. Masonët luajtën gjithmonë një rol të rëndësishëm në këto grupe të organizuara në shekullin XIX dhe në çerekun e parë të shekullit XX, kundër regjimit të Carit. Më 1917, në Revolucionin e Shkurtit, lideri Alexander Kerensky dhe të gjithë përkrahësit e ngushtë të tij ishin masonë.<sup>135</sup> Gjithashtu shumica e qeveritarëve të rinj ishin masonë.<sup>136</sup> Kontributi i vetëm që i dha historisë qeveria jetëshkurtër e Kerenskyt ishte dorëzimi i vendit Leninit, udhëheqësit bolshevik.

## **MASONERIA E SHEKULLIT XX: E HESHTUR DHE E LARGËT**

Duhet të përmendim se ajo kemi shqyrtuar deri tani, që lidhej me aktivitetet e masonëve në vende të tilla siç janë: Franca, Gjermania, Italia dhe Rusia, tregon qartë se synimi i Masonerisë ishte revolucioni politiko-shoqëror. Masoneria dëshironte që të vendoste një rend të ri,



në të cilin institutet fetare dhe besimi fetar do të zhdukeshin. Për këtë qëllim ajo tentoi që t'i përmbyste monarkitë që e përkrahnin fenë. Në shumë vende evropiane, lozhat masonike ku planifikoheshin krimet, kryengritjet, vrasjet, komplotet politike dhe politikantë antifetare, u bënë qendra ku grumbulloheshin kundërshtarët e fesë. Pas gjithë këtyre aktiviteteve që kanë ndodhur, duke filluar që nga Revolucioni Francez më 1789 e deri në shekullin XX, në një shkallë të madhe apo të vogël, ndihet ndikimi i Masonerisë.

Sipas historianit anglez Michael Howard, lozhat masonike i përqendruan përpjekjet e tyre, në pjesën e dytë të shekullit XIX, në përmbysjen e dy perandorive të mbetura: atë austro-hungareze dhe ruse dhe ato ishin të afta t'ia arrinin qëllimit të tyre, si rezultat i Luftës së Parë Botërore.

Me fjalë të tjera, në fillim të shekullit XX, Masoneria i kishte arritur në një masë të madhe synimet e veta të revolucionit politiko - shoqëror.


Prandaj, shekulli XX nuk ishte shekull i revolucioneve masonike. Masonët, duke menduar se nuk kishin ndonjë pengesë për t'u përballur, preferonin që vetëm ta përhapnin filozofinë e tyre, në vend të kurdisjes së komplotëve politike. Ata e përhapën në popull filozofinë masonike nën maskën e shkencës, apo nëpërmjet artit, medias, literaturës, muzikës dhe nëpërmjet të gjitha metodave të tjera të kulturës popullore. Masonët nuk synonin që nëpërmjet kësaj propagande t'iu zhduknin fetë hyjnore me një revolucion të menjëhershëm; ata dëshironin që ta arrinin këtë brenda një periudhe afatgjate dhe dëshironin që t'i fusnin të gjithë njerëzit pak nga pak në filozofinë e tyre.

Një mason amerikan e përmbledh kështu këtë synim:

**Frankmasoneria e kryen punën në heshtje, por puna e saj është si një lum i thellë, që të shtyn qetësisht drejt oqeanit.**<sup>137</sup>

Prifti i lartë J.W. Taylor, nga Georgia, SHBA, bën një komentim





## STRANGE RITES IN THE TEMPLE OF HUMANISM

Masons want to make the whole world a "temple." But, the temple they envision is not the temple of true religion but of humanism. Their dream is of a perverted world in which humanity is idolized, where people have completely rejected true religion, and the evolutionist philosophy is regarded as the only true philosophy.

In a Masonic text, a strange ceremony organized for this intention is described:

Today, one universal religion is coming into being, slowly as it may be, that can satisfy consciousness in its full meaning... Parallel to this universal religion a morality will be established commensurate with a world-view... Such a religion will unite human beings in the universe. This is MASONRY. This religion will be passed from heart to heart. The temples of this religion will be temples of humanity. Among the hymns sung in this temple may be Beethoven's 9th Symphony, the most noble musical composition that ever sprang from the human spirit....

Instead of the meat and blood of a bull in the ceremonies of Mithras, we celebrate this birth by eating bread and drinking red wine. Here we unite in a common faith that has the character of a communion. In a new year, I want to baptize this holy struggle of ours and bring it to an end: Eat one more piece of bread, brothers, you are the missionaries of this religion, let those saints who share this bread be friends. Brothers, to be blood brothers, take another sip of flame from your wine glass. (*Mason*, Year: 29, No.40-41, 1981, pp. 105-107)



interesant në lidhje me këtë çështje:


Braktisja e temave të vjetra dhe formimi i të reja jo gjithmonë lind nga shkaqet e menjëhershme, që përcakton bota, por ato **janë kulminacion i parimeve që përpunohen në mendjen e njerëzve për shumë vite**, derisa më në fund, në kohën e duhur dhe rrethanat e volitshme, ngjallin të vërtetën e fjetur... duke i entuziazmuar të gjithë me një arsyetim të zakonshëm dhe të fuqishëm dhe duke i shkundur popujt si një njeri i vetëm deri në arritjet e përfundimeve të mëdha. Me këtë princip punon edhe Instituti i Frankmasonerisë, që e shpërndan ndikim e vet në botë. Ai punon qetë dhe fshehtë, por depërton në të gjitha poret e shoqërisë **dhe ata që i pranojnë favorët e shumta të saj tregojnë frikë-respekt ndaj arritjeve të saj të mëdha, por nuk mund të thonë se nga e kanë origjinën.**<sup>138</sup>


Sipas revistës *Voice*, botuar nga Lozha e Madhe (Grand Lodge) në Çikago: **“Kështu, e heshtur, por e sigurt dhe në vazhdimësi, ajo (Masoneria) ndërtohet në fabrikën e madhe të shoqërisë njerëzore”.**<sup>139</sup> Ky “ndërtim brenda fabrikës së madhe” do të ndodhë kur bazat e filozofisë masonike: materializmi, humanizmi dhe darvinizmi, të imponohen në shoqëri.

Aspekti më interesant i kësaj strategjie të heshtur dhe të largët është ai, të cilin masonët e zbatojnë, por pothuajse asnjëherë nuk e tregojnë se po bëhet në emër të Masonerisë. Ata punojnë pas identiteteve, pas titujve të tjerë dhe në pozita të ndryshme, por ata imponojnë në shoqëri një filozofi të zakonshme, që e kanë adoptuar nga Masoneria. Njëri ndër mjeshtër masonët turq, Halil Mulkus, e sqaron këtë çështje në një intervistë të disa viteve më parë:

Masoneria si Masoneri nuk bën asgjë. Masoneria udhëheq individë. Individët e trajnuar këtu dhe masonët që kontribuojnë për prodhimin e zhvillimit intelektual janë në shkallë të ndryshme të karrierës së tyre, në vendet ku ata jetojnë nëpër botë. Ata janë rektorë universitetesh, profesorë, ministra shteti, mjekë, drejtorë spitalesh,

The materialist-humanist dogma espoused by the Masons has brought great suffering upon humanity in the twentieth century. World War Two cost 55 million people their lives. This photograph of a fallen soldier, whose face was shattered by a bomb near Stalingrad, is just one example of the great human suffering that was created by "humanist" ideologies.





avokatë etj. Në çdo vend ku punojnë, ata janë të zellshëm në përhapjen e ideve masonike në shoqëri, gjë për të cilën ata janë trajnuar.<sup>140</sup>

Sidoqoftë, këto ide, që Masoneria i studion dhe përpiqet që t'i indoktrinojë vazhdimisht në shoqëri nuk janë asgjë tjetër, ashtu siç e pamë në kapitujt e mëparshëm, veçse **mashttrim**. Filozofia masonike buron nga mitet e Egjiptit dhe Greqisë së Lashtë. Etja e tyre për t'i transmetuar këto mite në shoqëri, të mbështjella me ambalazhin e shkencës dhe arsyes, i bën masonët të mashtrojnë kështu veten dhe të tjerët. Ky është roli i "**Frankmasonerisë globale**", në kohën e globalizmit.

Rezultati i këtij mashtrimi është shumë i dëmshëm. Programi për distancimin e masave nga feja, i aplikuar nga masonët në shekujt XVIII dhe XIX, u dha jetë ideologjive neo-pagane si **racizmi** dhe **fashizmi**, si dhe ideologjive laike dhe të dhunshme si **komunizmi**. Përhapja e darvinizmit social, i cili i quante njerëzit kafshë që luftojnë për ekzistencë dha rezultate brutale në pjesën e dytë të shekullit XIX dhe në shekullin XX. Lufta e Parë Botërore ishte vepër e liderëve europianë, të cilët sipas sugjerimeve të Darvinit, e konsideronin luftën dhe gjakderdhjen si domosdoshmëri biologjike. Gjatë asaj lufte, vdiqën 10 milion njerëz për hiçgjë. Lufta e Dytë Botërore që erdhi më pas, ku vdiqën rreth 55 milion njerëz, ishte po ashtu vepër e totalitarizmit, sikurse ishin fashizmi dhe komunizmi, që ishin rezultat i farës së mbjellë të laicizmit militant, nga masonët. Gjatë shekullit XX, të gjitha luftërat shkatërruese në botë, konfliktet, mizoritë, padrejtësitë, shfrytëzimi, uria dhe degradimi moral, në parim, ishin produkte të ideologjive dhe filozofive jofetare. (Për më shumë detaje, shih librin e Harun Yahya-s: *Fatkeqësitë që darvinizmi i solli njerëzimit*)

Shkurtimisht, filozofia e Masonerisë dështoi. Nuk mund të ndodhte ndryshe, pasi kjo filozofi nuk është një ligj hyjnor.





Historikisht, paganët që e kanë mohuar fenë e Zotit, duke preferuar mitologjinë e tyre tradicionale dhe fenë e paraardhësve të tyre, kanë ndjekur rrugën e shkatërrimit. Frankmasoneria, që është një manifestim bashkëkohor i këtij paganizmi, po e tërheq gjithë botën dhe vetveten drejt shkatërrimit.

Kjo është arsyeja se përse njerëzit duhet që të ruhen nga kjo fatkeqësi, duke e mposhtur atë që Bediuzzaman Said Nursi-u, një dijetar i famshëm musliman, e cilëson si “sëmundja e quajtur materializëm dhe natyralizëm” dhe në këtë mënyrë të ruhet feja tek popujt e botës.



# PËRFUNDIM

**M**asoneria ka qenë një ndër fenomenet më interesante në dy shekujt e kaluar. Natyrisht, ajo ka tërhequr vëmendjen për shkak të karakterit të saj të mbyllur, të rezervuar dhe mistik. Në të njëjtën kohë, u shfaq edhe një antipati ndaj Masonerisë; ajo tenton ta prezantojë veten si një “institucion i parrezikshëm mirëbërës”. Ndërkohë që kundërshtimet e forta ndaj Masonerisë janë rritur si rezultat i pohimeve kontradiktore të organizatës.

Sidoqoftë, ajo që duhet bërë për t’iu kundërvënë Masonerisë nuk është adoptimi i një programi të verbër antimason, por duhet të dallohet dhe të tregohet pavlefshmëria e filozofisë së mbrapshtë, që kjo organizatë përqafoi dhe ia imponon njerëzimit.

Dijetari i madh musliman, Bediuzzaman Said Nursi, i shpjegon në një paragraf pikat kryesore të një detyre të tillë:

Lindja e tanishme tiranike e filozofisë natyraliste dhe materialiste do të forcohet gradualisht dhe do të përhapet deri në Ditën e Gjykimit me mjetet e filozofisë materialiste, duke arritur deri në atë shkallë, sa që do të mohojë Zotin...<sup>141</sup>.



Si kundërpërgjigje duhet të tregojmë se çfarë mashtrimi i madh dhe irracional është ky dhe siç shpallet në Kur'an, provat e ekzistencës së Zotit duhet të bëhen të njohura.

Kjo është mënyra se si duhet të zhvillohet lufta intelektuale kundër Masonerisë. Gjëja më e rëndësishme që duhet bërë, është që të zhvlerësohet dhe të mposhtet filozofia masonike. Është e një rëndësie të madhe që të shkatërrohet ndikimi i ideve të kësaj organizate, e cila në mënyrë të heshtur dhe nga larg aplikon fushata propaganduese në popull, i distancon njerëzit nga feja e tyre, i largon ata nga besimi i tyre dhe i dërgon tek mitet materialiste, humaniste dhe darviniste. Është e qartë që një filozofi e rrëzuar nga ana ideologjike, nuk mund të zgjasë për shumë kohë. Përveç kësaj, është gjithashtu e domosdoshme që t'u flitet njerëzve për ekzistencën e Zotit, për Njësinë e Tij dhe për të vërtetën e fesë dhe t'u tregohet atyre rruga e vërtetë në dritën e fakteve shkencore. Në të vërtetë, kjo nuk duhet të shikohet vetëm si luftë kundër Masonerisë, sepse kjo ka gjithashtu për qëllim që të shpëtojë edhe vetë masonët, meqenëse ata e kanë mashtruar veten. Një ajet në Kur'an që flet për popullin jobesimtar të Adit dhe Themudit vlen edhe për rastin e masonëve: **“Djali ua pat zbukuruar veprat e tyre duke i shmangur nga e vërteta, edhe pse e shihnin atë.” (Kur'an 29:38)**

Qëllimi është që t'u tregohet e vërteta të gjithë njerëzve, duke përfshirë edhe masonët, me qëllim që ata të largohen nga gabimi i tyre. Duhet të bëhet e qartë se shkenca, të cilën masonët e përdorën për të mbështetur filozofinë e tyre në dyqind vitet e kaluara, tani është kthyer kundër tyre. Teoria e evolucionit, që siguronte mbështetjen për materializmin, ka qenë në rënie e sipër që nga vitet 1970. Të dhënat e fosileve i mohojnë qartë pretendimet e kësaj teorie, duke zbuluar se llojet u shfaqën menjëherë dhe plotësisht të formuara, pa ndonjë “paraardhës evolutiv”. Biokimia, që studion aspektet e imta të qenieve të gjalla, ka demonstruar shembuj mahnitës të krijimit, që nuk mund të



shpjegohen në kushtet e shkaqeve natyrore. Krahasimet gjenetike kanë treguar se llojet që supozohet të jenë të afërm, sipas “pemës së jetës” së Darvinit, në të vërtetë janë shumë të ndryshëm përsa i përket përbërjes gjenetike. Shkenca ka provuar pavlefshmërinë e teorisë së evolucionit, fakt ky që nuk mund të fshihet më gjatë nga evolucionistët. Është e domosdoshme që të përdoren dëshmitë që ka sjellë shkenca dhe të informohet njerëzimi për pavlefshmërinë e filozofisë materialiste-humaniste.

Masoneria ka qenë e aftë për disa kohë, që me anën e metodave të efektshme propaganduese, t’i bënte njerëzit që t’i pranonin idetë e saj të rreme. Tregimi i të vërtetës dhe të ndihmuarit e njerëzve në pranimin e kësaj të vërtete, është gjë edhe më e lehtë.

Kur muslimanët ta marrin përsipër këtë detyrë, me lejen e Zotit, shpallja në vijim mund të bëhet edhe manifest: “Përkundrazi, Ne të pavërtetën e godasim me të vërtetën dhe ajo (e vërteta) triumfon mbi të, ndërsa ajo (gënjeshtria) zhduket.” (Kur’an 21: 18)

Prandaj, shekulli XXI nuk do të jetë shekulli i “Frankmasonerisë globale”, siç shpresojnë masonët, por do të jetë shekulli i moralit islam.

---

**(Engjëjt) Thanë: "Ti je i Patëmeta,  
ne nuk kemi dije tjetër  
përveç atë që na e mësove Ti.  
Vërtet, Ti je i Gjithëdijshmi, i Urti!"  
(Kur'an 2: 32)**

---



## BIBLIOGRAFIA

- 1 *World Book Encyclopedia*, "Crusades," Contributor: Donald E. Queller, Ph.D., Prof. of History, Univ. of Illinois, Urbana-Champaign, World Book Inc., 1998
- 2 *Geste Francorum, or the Deeds of the Franks and the Other Pilgrims to Jerusalem*, trans. Rosalind Hill, London, 1962, p.91, (emphasis added)
- 3 August C. Krey, *The First Crusade: The Accounts of Eye-Witnesses and Participants*, Princeton & London, 1921, p.261, (emphasis added)
- 4 August C. Krey, *The First Crusade: The Accounts of Eye-Witnesses and Participants*, Princeton & London, 1921, p.262
- 5 Michael Baigent, Richard Leigh, *The Temple and the Lodge*, London, Corgi Books, 1990, pp. 78-81
- 6 Nesta H. Webster, *Secret Societies And Subversive Movements*, Boswell Publishing Co., Ltd., London, 1924, Chapter 3
- 7 For this thesis about Freemasonry, see. John J. Robinson, *Born in Blood: The Lost Secrets of Freemasonry*, New York, M. Evans & Company, 1989
- 8 Ender Arkun, "Masonların Dusunce Evrimine Katkısına Kısa Bir Bakış" (A Short Look at the Contribution of Freemasonry to the Evolution of Thought), *Mimar Sinan*, 1990, No. 77, p.68, (emphasis added)
- 9 Teoman Biyikoglu, "Tampliyeler ve Hurmasonlar" (Templars and Freemasons), *Mimar Sinan*, 1997, No.106, p.11, (emphasis added)
- 10 Teoman Biyikoglu, "Tampliyeler ve Hurmasonlar" (Templars and Freemasons), *Mimar Sinan*, 1997, No.106, p.9, (emphasis added)
- 11 Teoman Biyikoglu, "Tampliyeler ve Hurmasonlar" (Templars and Freemasons), *Mimar Sinan*, 1997, No.106, p.19, (emphasis added)
- 12 Christopher Knight and Robert Lomas, *The Hiram Key*, Arrow Books, 1997, p.37
- 13 G. Delaforge, *The Templar Tradition in the Age of Aquarius*; Christopher Knight, Robert Lomas, *The Hiram Key*, p.37, (emphasis added)
- 14 C. Wilson, *The Excavation of Jerusalem*, Christopher Knight, Robert Lomas, *The Hiram Key*, p.38
- 15 Murat Ozgen Ayfer, *Masonluk Nedir ve Nasildir?* (What is Freemasonry and What is it Like?), Istanbul 1992, pp.298-299, (emphasis added)
- 16 Gougenot des Mousseaux in *Le Juif, La Judaïsme et la Judaïsation des Peuples Chrétiens*, 2nd edition, 1886, p. 499
- 17 Nesta H. Webster, *Secret Societies And Subversive Movements*, Boswell Publishing Co., Ltd., London, 1924; p.9
- 18 Theodore Reinach, *Histoire des Israélites*, p.221, and Salomon Reinach, *Orpheus*, p.299, (emphasis added)
- 19 Fabre d'Olivet, *La Langue Hébraïque*, 1815, p.28, (emphasis added)

- 20 *Mason Dergisi* (The Journal of Freemasonry), No. 48-49, p.67, (*emphasis added*)
- 21 Christopher Knight, Robert Lomas, *The Hiram Key*, Arrow Books, London, 1997, p.131, (*emphasis added*)
- 22 Christopher Knight, Robert Lomas, *The Hiram Key*, Arrow Books, London, 1997, p. 131
- 23 Richard Rives, *Too Long in the Sun*, Partakers Pub., 1996, pp. 130-31
- 24 Murat Ozgen Ayfer, *Masonluk Nedir ve Nasildir?* (What is Freemasonry?), Istanbul, 1992, pp. 298-299
- 25 Nesta H. Webster, *Secret Societies And Subversive Movements*, Boswell Publishing Co., Ltd., London, 1924, (*emphasis added*)
- 26 Nesta H. Webster, *Secret Societies And Subversive Movements*, Boswell Publishing Co., Ltd., London, 1924; Theodore Reinach, *Histoire des Israélites*, p. 221, Salomon Reinach, *Orpheus*, p. 299, (*emphasis added*)
- 27 Lance S. Owens, *Joseph Smith and Kabbalah: The Occult Connection, Dialogue: A Journal of Mormon Thought*, Vol. 27, No. 3, Fall 1994, pp. 117-194
- 28 Lance S. Owens, *Joseph Smith and Kabbalah: The Occult Connection, Dialogue: A Journal of Mormon Thought*, Vol. 27, No. 3, Fall 1994, pp. 117-194, (*emphasis added*)
- 29 Eliphaz Lévi, *Histoire de la Magie*, p. 273; Nesta H. Webster, *Secret Societies And Subversive Movements*, Boswell Publishing Co. Ltd., London, 1924
- 30 Umberto Eco, *Foucault's Pendulum*, Translated from the Italian by William Weaver, A Helen and Kurt Wolff Book, Harcourt Brace Jovanovich, Publishers, p. 450, (*emphasis added*)
- 31 For further information, see, John J. Robinson, *Born in Blood: The Lost Secrets of Freemasonry*, New York: M. Evans & Company, 1989
- 32 *Encyclopaedia Judaica*, vol. 10, p. 759.
- 33 *Encarta® World English Dictionary* © 1999 Microsoft Corporation. Developed for Microsoft by Bloomsbury Publishing Plc.
- 34 Lamont, *The Philosophy of Humanism*, 1977, p. 116
- 3  
5  
<http://www.jjnet.com/archives/documents/humanist.htm>
- 36 Henry Margenau, Roy Abraham Vargesse, *Cosmos, Bios, Theos*. La Salle IL, Open Court Publishing, 1992, p. 241
- 37 Patrick Glynn, *God: The Evidence, The Reconciliation of Faith and Reason in a Postsecular World*, Prima Publishing, California, 1997, p. 61
- 38 <http://www.garymcleod.org/2/johnd/humanist.htm>
- 39 Malachi Martin, *The Keys of This Blood: The Struggle for World Dominion Between Pope John Paul II, Mikhail Gorbachev, and the Capitalist West*, New York, Simon & Schuster, 1990, pp. 519-520, (*emphasis added*)
- 40 Malachi Martin, *The Keys of This*



Blood, p. 520

41 Malachi Martin, *The Keys of This Blood*, pp. 521-522

42 Dr. Selami Isindag, Sezerman Kardes V, *Masonluktan Esinlenmeler* (Inspirations from Freemasonry), Istanbul1977, p. 73, (*emphasis added*)

43 Dr. Selami Isindag, Sezerman Kardes VI, *Masonluktan Esinlenmeler* (Inspirations from Freemasonry), Istanbul1977, p. 79, (*emphasis added*)

44 Mimar Sinan, 1989, No. 72, p. 45, (*emphasis added*)

45 *Selamet Mahfilinde Uc Konferans* (Three Conferences in Safety Society), p. 51, (*emphasis added*)

46 Manly P. Hall, *The Lost Keys of Freemasonry*, Philosophical Research Society; 1996, pp. 54-55

47 J. D. Buck, *Mystic Masonry*, Kessinger Publishing Company, September 1990, p. 216, (*emphasis added*)

48 "Masonluk Iddia Edildigi Gibi Gizli Bir Tesekkul mudur?" (Is Freemasonry a Secret Organization as It is Claimed to be?) (Mim Kemal Oke, *Turk Mason Dergisi* (The Turkish Mason Magazine), No. 15, July 1954, (*emphasis added*)

49 Franz Simecek, *Turkiye Fikir ve Kultur Dernegi E. ve K. S. R. Sonuncu ve 33. Derecesi Turkiye Yuksek Surasi*, 24. Konferans, (Turkish Society of Idea and Culture, 33rd degree, Turkey Supreme Meeting, 24th conference), Istanbul, 1973, p. 46, (*emphasis added*)

5

<http://www.mason.org.tr/uzerine.html>, (*emphasis added*)

51 Dr. Selami Isindag, *Ucuncu Derece Rituelinin Incelenmesi* (The Examination of the Third Degree Ritual), Mason Dernegi (Masonic Society) Publications: 4, Istanbul, 1978, p. 15, (*emphasis added*)

52 Harun Yahya, *Komunizm Pusuda* (Communism in Ambush), Vural Publishing, Istanbul, April 2001, p. 25

53 Moiz Berker, "Gercek Masonluk" (Real Freemasonry), *Mimar Sinan*, 1990, No. 77, p. 23, (*emphasis added*)

54 Dr. Selami Isindag, Sezerman Kardes IV, *Masonluktan Esinlenmeler* (Inspirations from Freemasonry), Istanbul1977, p. 62, (*emphasis added*)

55 Dr. Selami Isindag, *Masonluktan Esinlenmeler* (Inspirations from Freemasonry), Istanbul 1977, pp. 145-146, (*emphasis added*)

56 Dr. Selami Isindag, "Olumlu Bilim-Aklin Engelleri ve Masonluk" (Positive Science-The Obstacles of Mind and Freemasonry), *Mason Dergisi*, year 24, No. 25-26 (December 76-March 77), (*emphasis added*)

57 Ibrahim Baytekin, *Ayna* (Mirror), Ocak 1999, No: 19, p.4, (*emphasis added*)

58 Dr. Selami Isindag, *Masonluk Ustune* (On Freemasonry), *Masonluktan Esinlenmeler* (Inspirations from Freemasonry), Istanbul1977, p. 32, (*emphasis added*)

59 Christopher Knight, Robert Lomas, *The Hiram Key*, Arrow Books, London, 1997, p. 131, (*emphasis added*)

0



- 60 Dr. Selami Isindag, Kurulusundan Bugune Masonluk ve Bizler (Freemasonry and Us: From Its Establishment Until Today), *Masonluktan Esinlenmeler* (Inspirations from Freemasonry), Istanbul 1977, pp. 274-275, (*emphasis added*)
- 61 Dr. Selami Isindag, Sezerman Kardes VII, Masonlukta Yorumlama Vardir Ama Putlastirma Yoktur (There is No Idolization in Freemasonry but Interpretation), *Masonluktan Esinlenmeler* (Inspirations from Freemasonry), Istanbul 1977, p. 120, (*emphasis added*)
- 62 Celil Layiktez, "Masonik Sir, Ketumiyet Nedir? Ne Degildir?" (Masonic Secret, What is Secrecy?), *Mimar Sinan*, 1992, No. 84, pp. 27-29, (*emphasis added*)
- 63 Dr. Cahit Bergil, "Masonlugun Lejander Devri" (The Lejander Age of Freemasonry), *Mimar Sinan*, 1992, No. 84, p. 75, (*emphasis added*)
- 64 Oktay Gok, "Eski Misirda Tekris" (Initiation in Ancient Egypt), *Mimar Sinan*, 1995, Vol. 95, pp. 62-63, (*emphasis added*)
- 65 Dr. Cahit Bergil, "Masonlugun Lejander Devri" (The Lejander Age of Freemasonry), *Mimar Sinan*, 1992, No. 84, p. 74, (*emphasis added*)
- 66 Resit Ata, "Çile: Tefekkur Hucesi" (Ordeal: Reflection Cell), *Mimar Sinan*, 1984, No. 53, p. 61, (*emphasis added*)
- 67 Rasim Adasal, "Masonlugun Sosyal Kaynaklari ve Amaclari" (The Social Origins and Aims of Freemasonry), *Mimar Sinan*, December 1968, No. 8, p. 26
- 68 Robert Hieronimus, *America's Secret Destiny: Spiritual Vision and the Founding of a Nation*, Vermont, Destiny Books, 1989, p. 84, (*emphasis added*)
- 69 Koparal Çerman, "Rituellerimizdeki Allegori ve Semboller" (Allegory and Symbols in our Rituals), *Mimar Sinan*, 1997, No. 106, p. 34
- 70 Michael Howard, *The Occult Conspiracy: The Secret History of Mystics, Templars, Masons and Occult Societies*, 1st ed., London, Rider, 1989, p. 8
- 71 Michael Howard, *The Occult Conspiracy: The Secret History of Mystics, Templars, Masons and Occult Societies*, 1st ed., London, Rider, 1989, p. 9
- 72 Koparal Çerman, "Rituellerimizdeki Allegori ve Semboller" (Allegory and Symbols in our Rituals), *Mimar Sinan*, 1997, No. 106, p. 38, (*emphasis added*)
- 73 Christopher Knight ve Robert Lomas, *The Hiram Key*, p. 188
- 74 Christopher Knight ve Robert Lomas, *The Hiram Key*, p. 188
- 75 Orhan Tanrikulu, "Kadinin Mason Toplumundaki Yeri" (The Woman's Place in Masonic Society), *Mimar Sinan*, 1987, No. 63, p. 46
- 76 Koparal Çerman, "Rituellerimizdeki Allegori ve Semboller" (Allegory and Symbols in



- our Rituals), *Mimar Sinan*, 1997, No. 106, p. 39, (*emphasis added*)
- 77 Resit Ata, "Bir Fantezi: Mitoloji'den Masonluga" (A Fantasy: From Mythology to Freemasonry), *Mimar Sinan*, 1980, No. 38, p. 59, (*emphasis added*)
- 78 Albert Pike, *Morals and Dogma*, Kessinger Publishing Company, October 1992, p. 839
- 79 Michael Howard, *The Occult Conspiracy: The Secret History of Mystics, Templars, Masons and Occult Societies*, 1st ed., London, Rider, 1989, pp. 2-3, (*emphasis added*)
- 80 Previous Master Mason Enver Necdet Egeran, *Gercek Yuzuyle Masonluk* (Freemasonry Unveiled) , Basnur Press, Ankara, 1972, pp. 8-9, (*emphasis added*)
- 81 Dr. Selami Isindag, *Masonluktan Esinlenmeler* (Inspirations from Freemasonry), Istanbul 1977, p. 189, (*emphasis added*)
- 82 Dr. Selami Isindag, *Masonluktan Esinlenmeler* (Inspirations from Freemasonry), Istanbul 1977, p. 190, (*emphasis added*)
- 83 Dr. Selami Isindag, *Masonluktan Esinlenmeler* (Inspirations from Freemasonry), Istanbul 1977, pp. 189-190, (*emphasis added*)
- 84 Hasan Erman, "Masonlukta Olum Sonrasi" (After Death in Freemasonry), *Mimar Sinan*, 1977, No. 24, p. 57
- 85 Dr. Selami Isindag, *Masonlugun Kendine Ozgu Bir Felsefesi Var Midir, Yok Mudur?* (Does Freemasonry Have an Original Philosophy or Not?), *Masonluktan Esinlenmeler* (Inspirations from Freemasonry), Istanbul 1977, p. 97, (*emphasis added*)
- 86 Wilder Penfield, *The Mystery of the Mind: A Critical Study of Consciousness and the Human Brain*, Princeton, New Jersey, Princeton University Press, 1975, p. 80, (*emphasis added*)
- 87 Roger Penrose, *The Emperor's New Mind*, Penguin Books, 1989, pp. 24-25, (*emphasis added*)
- 88 Roger Penrose, *The Emperor's New Mind*, Penguin Books, 1989, p. 448
- 89 Onur Ayangil, "Yeni Gnose" (New Gnosis), *Mimar Sinan*, 1977, No. 25, p. 20, (*emphasis added*)
- 90 Enis Ecer, "Gercegin Yolu" (The Path of the Truth), *Mimar Sinan*, 1979, No. 30, p. 29, (*emphasis added*)
- 91 Faruk Erengul, "Evrende Zeka" (Intelligence in the Universe), *Mimar Sinan*, 1982, No. 46, p. 27, (*emphasis added*)
- 92 Albert Arditti, "Hurriyet-Disiplin-Dinamizm-Statizm" (Freedom-Discipline-Dynamism-Statism), *Mimar Sinan*, 1974, No. 15, p. 23
- 93 Naki Cevad Akkerman, "Bilimsel Acidan Dayanisma Kavrami ve Evrimi Uzerine Dusunceler II" (Thoughts About The Concept and the Evolution of Solidarity from the Scientific Point of View II), *Mimar Sinan*, 1976, No. 20, p. 49, (*emphasis added*)
- 94 *Mason Dergisi* (Journal of Freemasonry), No. 48-49, p. 67

- 95 *Mason Dergisi* (Journal of Freemasonry), No. 48-49, p. 67, (*emphasis added*)
- 96 Dr. Selami Isindag, Kurulusundan Bugune Masonluk ve Bizler (Freemasonry and Us: From Its Establishment Until Today), *Masonluktan Esinlenmeler* (Inspirations from Freemasonry), Istanbul 1977, pp. 274-275, (*emphasis added*)
- 97 Dr. Selami Isindag, Kurulusundan Bugune Masonluk ve Bizler (Freemasonry and Us: From Its Establishment Until Today), *Masonluktan Esinlenmeler* (Inspirations from Freemasonry), Istanbul 1977, pp. 274-275
- 98 Pocock, in; Edmund Burke, *Reflections on the Revolution in France*, ed. J. G. A. Pocock, Indianapolis: Hackett Publishing Company, 1987, pp. 33-38
- 99 Desmond King-Hele, *Doctor of Revolution: The Life and Times of Erasmus Darwin*, Faber & Faber, London, 1977, p. 361
- 100 Henry Morris, *The Long War Against God*, p. 178
- 101 William R. Denslow, *10,000 Famous Freemasons*, vol. I. Macoy Publishing & Macoy Supply Co., Inc. Richmond, Virginia, 1957, p. 285
- 102 William R. Denslow, *10,000 Famous Freemasons*, vol. I. Macoy Publishing & Macoy Supply Co., Inc. Richmond, Virginia, 1957, p. 285
- 103 Henry Morris, *The Long War Against God*, p. 198. Order of the Illuminati, which was founded in Bavaria, Germany in 1776 was a kind of a Masonic lodge. The founder of the Illuminati, Dr. Adam Weishaupt, was a Jew. He enumerated the goals of the Order as follows: 1- To abolish all monarchies and regular governments, 2- To abolish the personal property and inheritance, 3- To abolish the family life and the marriage institution and to establish a communal education system for children, 4- To abolish all religions. (see, Eustace Mullins, *The World Order: Our Secret Rulers*, p. 5; Lewis Spence, *The Encyclopedia of the Occult*, p. 223)
- 104 Henry Morris, *The Long War Against God*, Master Books, April 2000, p. 198
- 105 Pope Leo XIII, *Humanum Genus*, "Encyclical on Freemasonry," promulgated on April 20, 1984. (*emphasis added*)
- 106 Henry Morris, *The Long War Against God*, p. 60
- 107 For Huxley's Masonry, see (Albert G. Mackey. "Charles Darwin and Freemasonry." *An Encyclopedia of Freemasonry*, New York: The Masonic History Company, 1921, Vol. III.) Royal Society or with the full name The Royal Society of London for The Improvement of Natural Knowledge was founded in 1662. All the members of the society were all Masons without an exception. See, John J. Robinson, *Born in Blood*,



- p. 285
- 108 For the support Royal Society gave to Darwinism, see Henry Morris, *The Long War Against God*, pp. 156-57
- 109 Anton Pannekoek, *Marxism And Darwinism*, Translated by Nathan Weiser. Transcribed for the Internet by Jon Muller, Chicago, Charles H. Kerr & Company Co-operative Copyright, 1912 by Charles H. Kerr & Company, (*emphasis added*) (<http://www.marxists.org/archive/pannekoek/works/1912-dar.htm>)
- 110 Dr. Selami Isindag, "Bilginin Gelismesinde Engeller ve Masonluk" (Obstacles in the Development of Knowledge and Freemasonry), 1962 Annual Bulletin of the Turkish Grand Lodge of Free and Accepted Masons p. 44, (*emphasis added*)
- 111 Francis Darwin, *Life and Letters of Charles Darwin*, Vol.II, from Charles Darwin to J. Do Hooker, March 29, 1963
- 112 Fred Hoyle, Chandra Wickramasinghe, *Evolution from Space*, p.130, (*emphasis added*)
- 113 Dr. Selami Isindag, *Evrin Yol* (The Way of Evolution), Istanbul1979, p. 141, (*emphasis added*)
- 114 P. M. Giovanni, *Turkiye Fikir ve Kultur Dernegi E. ve K. S. R. Sonuncu ve 33. Derecesi Turkiye Yuksek Surasi*, 24. Conference (The Turkish Society of Idea and Culture, 33rd degree, Turkey Supreme Meeting, 24th conference), Istanbul, 1973, p. 107, (*emphasis added*)
- 115 Dr. Selami Isindag, Sezerman Kardes VI, *Masonlukta Esinlenmeler* (Inspirations from Freemasonry), Istanbul 1977, p. 78, (*emphasis added*)
- 116 Dr. Selami Isindag, "Masonluk Ogretileri" (Masonic Doctrines), *Masonlukta Esinlenmeler* (Inspirations from Freemasonry), Istanbul 1977, p. 137
- 117 Tanju Koray, *Mimar Sinan*, 1992, No: 85, p. 46, (*emphasis added*)
- 118 Tanju Koray, *Mimar Sinan*, 1992, No: 85, p. 49, (*emphasis added*)
- 119 Neset Sirman, "Masonlugun ilk Devirleri" (The First Periods of Masonry), *Mimar Sinan*, 1997, No. 104, p. 41, (*emphasis added*)
- 120 Naki Cevad Akkerman, "Politika ve Masonluk" (Politics and Freemasonry), *Mimar Sinan*, September 1968, No. 7, pp. 66-67
- 121 Daniel Willens "The Hell-Fire Club," *Gnosis*, no.24, Summer 1992, (*emphasis added*)
- 122 For the relationship of Enlightenment and French Revolution with Masonry, see Harun Yahya, *Yeni Masonik Duzen* (New Masonic Order), pp. 203-215
- 123 Michael Howard, *The Occult Conspiracy*, p. 69
- 124 Comptendru Gr. Or., 1903, Nourrisson, "Les Jacobins," 266-271; *The Catholic Encyclopedia*, "Masonry (Freemasonry),"NewAdvent, (<http://www.newadvent.org/cathen/09771a.htm>), (*emphasis added*)
- 125 *The Catholic Encyclopedia*,



- "Masonry (Freemasonry)," *New Advent*, (<http://www.newadvent.org/cathen/09771a.htm>), (*emphasis added*)
- 126 *The Catholic Encyclopedia*, <http://www.newadvent.org/cathen/09771a.htm#VIII>
- 127 Nur Safa Tekyeliban, "Taassuba Karsi Mucadele" (Struggle Against Bigotry): From the Speech of Brother Gambetta made on July 8, 1875 in Clémente Amitié Lodge," *Dogus Kolu Yilligi: Ankara Dogus Mahfili Çalismalari* (Dogus Branch Yearbook: Ankara Dogus Society Studies), 1962, Kardes Press, Ankara, 1963, p. 19
- 128 *The Catholic Encyclopedia*, "Masonry (Freemasonry)," *New Advent*, (<http://www.newadvent.org/cathen/09771a.htm>), (*emphasis added*)
- 129 Louis L. Synder and Ida Mae Brown, *Bismarck and German Unification*, New York, 1966, pp. 90-91, (*emphasis added*)
- 130 *The Catholic Encyclopedia*, "Masonry (Freemasonry)," *New Advent*, (<http://www.newadvent.org/cathen/09771a.htm>), (*emphasis added*)
- 131 Elbridge Colby, "In Hitler's Shadow: The Myth of Nazism's Conservative Roots," *In Bad Faith?: Politics and Religion at Harvard*, October 13, 1999
- 132 Alec Mellor, *The Royal Arch Mason*, Spring 1972
- 133 *The Catholic Encyclopedia*, "Masonry (Freemasonry)," *New Advent*, (<http://www.newadvent.org/cathen/09771a.htm>)
- 134 Michael Howard, *The Occult Conspiracy*, p. 105
- 135 Stephen Knight, *The Brotherhood: The Explosive Expose of the Secret World of the Freemasons*, HarperCollins, 1985, p.33
- 136 Daniel Ligou, *Dictionnaire de la Franc-Maçonnerie*, p.1064
- 137 *The Catholic Encyclopedia*, "Masonry (Freemasonry)," *New Advent*, (<http://www.newadvent.org/cathen/09771a.htm>), (*emphasis added*)
- 138 *The Catholic Encyclopedia*, "Masonry (Freemasonry)," *New Advent*, (<http://www.newadvent.org/cathen/09771a.htm>), (*emphasis added*)
- 139 *Voice*, Chr. 1889, II, 257 sq.; *The Catholic Encyclopedia*, "Masonry (Freemasonry)," *New Advent*, (<http://www.newadvent.org/cathen/09771a.htm>), (*emphasis added*)
- 140 "Masonluk Gucunu Yitiriyor mu?" (Is Freemasonry Losing its Power?), *Nokta*, October 13, 1985, vol. 40, p. 30
- 141 Bediuzzaman Said Nursi, *Letters*, 15th Letter, The Meaning of Your Fourth Question, The Second Current (<http://www.bediuzzaman.org/letters/let15d.html>)



# MASHTRIMI I EVOLUCIONIT

**N**ë ditën e sotme, ka njerëz të cilët jetojnë një jetë tejte të largët prej Zotit dhe të cilët madje refuzojnë besimin dhe mohojnë ekzistencën e Zotit për qëllime të tyre vetjake. Për shkak të verbërisë së tyre dhe të guximit të pamend të tyre, ata përpiqen të ndikojnë tek të tjerët dhe t'i largojnë ata nga udha e Zotit. Ata kanë parashtruar një varg të tërë idesh kundërthënëse dhe ideologji të shtrembëruara me anën e të cilave ta arrijnë këtë. Njëra prej këtyre është teoria e evolucionit.

## **DËSHIMI IDEOLOGJIK I DARVINIZMIT**


Aspekti i Darwinizmit që e ndalon atë të jetë një pretendim interesi vetëm për botën shkencore dhe e bën atë me një rëndësi të madhe për shoqërinë si tërësi është dimensionimi i tij ideologjik. Përgjigja që ai jap në pyetjen se si u krijuan gjallesat, duke përfshirë njerëzimin, e bën Darwinizmin bazën e një numri filozofish, botëkuptimesh dhe ideologjish politike.

Këtu, ne do të marrim parasysh raportin në mes të Darwinizmit dhe filozofisë materialiste. Filozofia materialiste, apo “materializmi,” është një sistem i të menduarit që shkon prapa në kohë deri në Greqinë e vjetër. Materializmi mbështetet në supozimin se materia është e vetmja gjë që ekziston. Sipas filozofisë materialiste, materia ka ekzistuar gjithmonë dhe



do të vazhdojë të ekzistojë përgjithmonë. Pra sipas kësaj filozofie, asgjë nuk ekziston përtej materies.

Natyrisht, materializmi pasqyrohet gjithashtu në arenën politike, me komunizmin që zë vendin kryesor në këtë drejtim. Karl Marksi (1818-83) dhe Fridrih Engelsi (1820-95), të konsideruar si themelues të komunizmit, ishin poashtu themelues të materializmit dialektik. Sidoqoftë, komunizmi nuk është asgjë më tepër se filozofi materialiste e përshtatur për shkencat shoqërore nga Marksi dhe Engelsi.



Çarlls Darwin

Komunizmi sot konsiderohet si një ideologji e hedhur në plehrat e historisë, ndonëse e vërteta është se ai ende ka ndikim të jashtëzakonshëm. Efektet shkatërrimtare të kësaj ideologjie ende mund të ndihen në shumë vende.

Këtu Darwinizmi fiton rëndësi të madhe. Pasiqë Darwinizmi apo teoria e evolucionit pohon se gjallesat nuk u krijuan por erdhën në jetë rastësisht, është pranuar gjerësisht prej ideologjive materialiste dhe është pranuar si “bazë themelore” e komunizmit në veçanti. Të gjithë ideologët kryesor komunist kanë pranuar teorinë fjalë për fjalë dhe kanë bazuar ideologjitë e tyre në të.

Për shembull, në një letër dërguar Fridrih Engelsit në vitin 1860, Karl Marksi thot për librin e Darvinit se “Ky është libri i cili përmban bazën e historisë së natyrës për pikëpamjen tonë.”<sup>12</sup> Në një letër tjetër në vitin që pasoi, tani të dërguar Ferdinand Lasalit (1825-64), Marksi thot: “Libri i Darvinit është shumë i rëndësishëm dhe më shërben si bazë e shkencës natyrore për luftën e klasave në histori.”<sup>13</sup> Ngjashëm Mao Ce Tunj, themeluesi i komunizmit Kinez, haptazi deklaroi se “Themelet e socializmit Kinez mbështeten në Darvinin dhe në teorinë e evolucionit.”<sup>14</sup>

Pra lufta intelektuale kundër komunizmit duhet t’i drejtohet filozofisë materialiste dhe, prandaj, teorisë së evolucionit. Është poashtu



e qartë se pranimi i gjerë i teorisë së evolucionit në shoqëri do të ushqej edhe më tej materializmin si edhe komunizmin.

### **DËSHTËMI SHKENCOR I DARVINIZMIT**

Teoria e evolucionit, edhe pse është një doktrinë që i ka fillimet në Greqinë e lashtë, u përqaftua gjerësisht në shekullin e nëntëmbëdhjetë. Zhvillimi më i rëndësishëm që e bëri teorinë temën kryesore të botës së shkencës ishte botimi në vitin 1859 i librit Origjina e Llojeve të Çarlls Darvinit. Në këtë libër, ai doli me pretendimin se llojet e ndryshme në tokë nuk janë krijuar veç e veç, por rrjedhin nga një stërgjysh i përbashkët dhe kanë ndryshuar nga njëra-tjetra nëpërmjet ndryshimeve të vogla me kalimin e kohës. Teoria e Darvinit nuk mbështetet në asnjë zbulim shkencor konkret, siç e pranoi edhe ai vet, ajo ishte vetëm një “supozim”. Veç kësaj, ashtu siç e pranoi Darvini në kapitullin e gjatë të librit të tij të titulluar “Vështirësitë e Teorisë”, teoria dështoi përballë një sërë çështjesh vendimtare.

Darvini mbështeti të gjitha shpresat e tij në zbulimet e reja shkencore, të cilat shpresonte që do të zgjidhnin këto vështirësi. Mirëpo, në kundërshtim me atë që ai shpresonte, zbulimet shkencore zgjeruan përmasat e këtyre vështirësive. Disfata e darvinizmit përballë shkencës mund të përmbledhet në tre tituj kryesorë:

- 1) Teoria nuk arrin të shpjegoj se si ka zënë fill jeta në tokë.
- 2) Nuk gjendet asnjë zbulim shkencor që tregon se “mekanizmat e evolucionit” të propozuara nga kjo teori, posedojnë asnjë force evoluese.
- 3) Të dhënat fosile provojnë pikërisht të kundërtën e ideve të parashtruara nga kjo teori.

Në këtë pjesë, do të shtjellojmë në vija të përgjithshme këto tri çështje themelore:

### **PENGESA E PARË E PAKAPËRCYESHME:**

#### **ZANAFILLA E JETËS**

Teoria e evolucionit pretendon se të gjitha speciet rrjedhin nga një qelizë e vetme e shfaqur në Tokën primitive 3.8 miliardë vjet më parë. Si



është e mundur që një qelizë e vetme të ndërtojë miliona specie të gjalla e të komplikuar dhe, nëse me të vërtetë ka ndodhur diçka e tillë, përse nuk gjendet asnjë gjurmë në të dhënat fosile janë disa nga pyetjet në të cilat teoria nuk është në gjendje të jap përgjigje. Por në fillim, duhet të pyetemi: Si u krijua kjo “qelizë e parë”?

Meqë teoria e evolucionit e mohon krijimin dhe çfarëdo ndërhyrje të mbinatyrshme, ajo supozon se “qeliza e parë” është shfaqur rastësisht pa asnjë projektim, planifikim apo rregullim, përbrenda ligjeve të natyrës. Sipas kësaj teorie, materia e pajetë duhet të ketë krijuar rastësisht qelizën e gjallë. Por kjo hipotezë bie ndesh me ligjet më të pakundërshtueshme të biologjisë.

### **“JETA RRJEDH NGA JETA”**

Darvini, në librin e tij, nuk ka folur kurrë mbi zanafillën e jetës. Koncepti primitiv shkencor në periudhën kur jetoi ai supozonte se gjallesat zotërojnë një konstrukt shumë të thjeshtë. Sipas teorisë së krijimit të rastësishtme që besohet në mesjetë, lëndët e pajetë/inorganike, duke u bashkuar, mund të formojnë një qenie të gjallë. Në atë periudhë ishte shumë i përhapur mendimi se insektet formoheshin nga tepricat e ushqimeve, ndërsa minjtë nga gruri. Për të provuar diçka të tillë janë bërë eksperimente nga më të çuditshmet: Një leckë e ndotur me pak grurë mbi të, në një anë, ndërsa në anën tjetër një shkencëtar, duke pritur që pas një kohe të formoheshin minj.

Gjithashtu mendohej se shfaqja e krimbave në një copë mishi ishte dëshmi e krijimit të vetvetishëm/spontan. Por më vonë do të kuptohej se ata krimba nuk formoheshin vetvetiu në mish, por nga larvat e padukshme për syrin që silleshin nga mizat.

Madje edhe kur Darvini shkroi librin Origjina e Llojeve, besimi se bakteret formoheshin nga materia e pajetë ishte një gjë e pranuar gjerësisht në botën e shkencës.

Por vetëm 5 vite pas botimit të librit të Darvinit, Lui Paster shpalli përfundimet e arritura pas shumë studimeve dhe eksperimenteve të gjata që rrëzuan plotësisht krijimin spontan, i cili përbënte gur-themelin e





teorisë së Darvinit. Në ligjëratën e tij triumfale në Sorbonë në vitin 1864, Pasteri tha: “Kurrë më nuk do të rimarr veten krijimi spontan prej grushtit vdekjeprurës të dhënë nga ky eksperiment i thjeshtë.”<sup>142</sup>

Mbrojtësit e teorisë së evolucionit i kundërshtuan për një kohë të gjatë zbulimet e Pasterit. Mirëpo shkenca, e cila po përparonte duke nxjerrë në dritë ndërtimin kompleks të qelizës së organizmit të gjallë, e përforcoi edhe më tepër pavlefshmërinë e pretendimeve mbi krijimin e rastësishëm të jetës.

### **PËRPIEKJET E PAFRYTSHME TË SHEKULLIT NJËZET**

Evolucionisti i parë, i cili u mor me çështjen e zanafillës së jetës në shekullin e njëzet ishte biologu i njohur rus Aleksandër Oparin, i cili u mundua të provonte, me anë të një sërë tezash të hedhura nga vetë ai në vitet 1930, se qeliza e gjallë mund të krijohej rastësisht. Por këto punime do të dilnin të pasuksesshme dhe Oparin do të detyrohej ta bënte këtë rrëfim:

Mirëpo, fatkeqësisht, çështja e zanafillës së qelizës përbën ndoshta pikën më të errët të gjithë studimit të evolucionit të organizmave.<sup>143</sup>

Pasuesit evolucionist të Oparinit u munduan të bënin eksperimente për të gjetur një zgjidhje për këtë çështje. Më i njohuri nga këto eksperimente ishte ai që u ndërmor në vitin 1953 nga kimisti amerikan Stenli Miler, i cili, duke bashkuar gazrat, që ai pretendonte se kishin ekzistuar në atmosferën primitive në një ambient eksperimental dhe duke i ekspozuar ato ndaj një burimi të jashtëm energjie, Milleri formoi disa molekula organike (aminoacide) të pranishme në strukturën e proteinave.

Mezi kishin kaluar disa vite para se të zbulohej se ky eksperiment, i cili atëherë u paraqit si një hap i rëndësishëm në emër të evolucionit, ishte i pavlefshëm, sepse atmosfera e përdorur në këtë eksperiment ishte shumë më e ndryshme nga kushtet reale të Tokës.<sup>144</sup>

Pas një periudhe të gjatë heshtjeje, Milleri pranoi se atmosfera e përdorur nga ai nuk ishte reale.<sup>145</sup>

Të gjitha përpjekjet evolucioniste që u ndërmorën gjatë shekullit të





Biologu francez Lui Paster

njëzet për të shpjeguar zanafillën e jetës përfunduan pa sukses. Xhefri Bada, gjeokimisti i njohur nga Instituti Skrips i San Diegos, në një artikull të botuar në vitin 1998 në revistën "Earth (Toka)", pranon këtë fakt:

*Sot, duke e lënë pas shekullin e njëzet, akoma përballemi me problemin më të madh të pazgjidhur që kishim kur hymë në shekullin e njëzet: Si zuri fill jeta në tokë?<sup>146</sup>*

### **NDËRTIMI I NDËRLIKUAR I JETËS**

Shkaku kryesor që çështja mbi zanafillën e jetës ka hyrë në një dilemë të tillë është se madje ata organizma të gjallë që mendohej të jenë më të thjeshtat kanë ndërtim jashtëzakonisht të ndërlikuar. Qeliza e një gjallese është shumë më e ndërlikuar se të gjitha produktet teknologjike që ka arritur të prodhojë njeriu. Sot, madje edhe në laboratorët më të përparuara të botës, duke bashkuar materie kimike organike, nuk do të mund të arrijmë kurrë të përfitojmë një qelizë të vetme.

Kushtet që nevojiten për formimin e një qelize janë aq të shumta sa kurrë nuk mund të shpjegohen me rastësi. Probabiliteti që proteinat, njësia bazë e qelizës, të sintetizohen rastësisht është 1 në  $10^{950}$  (për një proteinë mesatare me 500 aminoacide). Në matematikë probabilitetet më të vogla se  $10^{50}$  konsiderohen të pamundura.

Molekula e ADN-së përmban informacionet gjenetike si një bankë informacionesh me kapacitet të pabesueshëm. Nëse do ta hidhnim në letër informacionin që përfshin ADN-ja e njeriut, do të krijohej një bibliotekë me 900 volume enciklopedike me nga 500 faqe secili.

Në këtë pikë shfaqet një dilemë shumë interesante: ADN-ja mund ta kopjoj/përsëris vetveten vetëm me ndihmën e disa proteinave të specializuara (enzimave). Mirëpo, sinteza e këtyre enzimave mund të realizohet vetëm me anë të informacionit të koduar në ADN. Pasi që ato



të dyja janë të varura nga njëra tjetra, ato duhet të ekzistojnë në të njëjtën kohë për kopjim/përsëritje. Kjo e sjellë skenarin se jeta ka zënë fill vetvetiu në një rrugë pa krye. Prof. Lesli Orgel, një evolucionist me reputacion nga Universiteti i San Diegos në Kaliforni, e pranon këtë fakt në botimin e revistës Scientific American të Shtatorit të vitit 1994:

*Është krejtësisht e pamundshme që proteinat dhe acidet nukleike, duke qenë të dyja komplekse për nga ndërtimi, të jenë krijuar vetvetiu në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë. Po ashtu duket e pamundshme ta kemi një rën pa tjetrën. Dhe kështu, në shikim të parë, njeriut do t'i duhej të vjen në përfundimin se, në të vërtetë, jeta kurrë nuk ka mundur të zë fill me anë të mjeteve kimike.*<sup>147</sup>



Biologu rus  
Aleksandër Oparin

Padyshim, nëse është e pamundur që jeta të ketë zënë fill nga shkaqet natyrore, atëherë duhet të pranohet se jeta u “krijua” në mënyrë të mbinatyrshme. Ky fakt zhvlerëson në mënyrë të qartë teorinë e evolucionit, qëllimi kryesor i së cilës është të mohoj krijimin.


## MEKANIZMAT IMAGJINARË TË EVOLUCIONIT

Çështja e dytë e rëndësishme që e bën teorinë e Darvinit të pavlefshme është se të dy konceptet e paraqitura nga kjo teori si “mekanizma të evolucionit”, u kuptua se në të vërtetë nuk zotërojnë asnjë forcë evoluese.

Darvini e mbështeti hipotezën e tij në tërësi në mekanizmin e “seleksionimit natyror.” Rëndësia që i jepte këtij mekanizmi mund të kuptohet fare lehtë edhe nga titulli i librit të tij: Origjina e Llojeve nëpërmjet seleksionimit natyror”...

Seleksionimi natyror pohon se ato gjallesa që janë më të fuqishme dhe që i përshtaten më mirë kushteve natyrore të vendbanimeve të tyre do të mbijetojnë në luftën për jetë. P.sh., në një kope sorkadhesh që kërcënohet prej kafshëve të ndryshme grabitqare, do të mbijetojnë





I gjithë informacioni për gjallesat është i ruajtur në molekulën e ADN-së. Kjo mënyrë jashtëzakonisht efikase e ruajtjes si e vetme është dëshmi e qartë se jeta nuk lindi rastësisht, por është konstruktuar në mënyrë të qëllimshme, apo, më mirë të themi, është krijuar në mënyrë të mrekullueshme.

vetëm ato sorkadhe që vrapojnë më shpejt. Kështu që kopeja e sorkadheve do të përbëhet nga individët më të fortë dhe më të shpejtë. Mirëpo, sigurisht që ky mekanizëm nuk mund të shkaktojë evoluimin e sorkadheve e t'i kthejë në një lloj tjetër gjallese, për shembull, në kuaj.

Për këtë arsye, mekanizmi i seleksionimit natyror nuk zotëron asnjë forcë evoluese. Edhe Darvini ishte i ndërgjegjshëm për këtë realitet, ndaj në librin e tij Origjina e Llojeve u detyrua të pohonte:

*Seleksionimi natyror s'mund të bëjë asgjë përderisa nuk shfaqen dallime dhe ndryshime të dobishme individuale.* <sup>148</sup>

### **NDIKIMI I LAMARKUT**

Si mund të formoheshin këto ndryshime të dobishme? Darvini, kësaj pyetjeje u mundua t'i përgjigjej nga këndvështrimi i të kuptuarit primitiv të shkencës së asaj kohe. Sipas biologut francez Shevalie Lamark (1774-1829), i cili ka jetuar para Darvinit, gjallesat ia përcollën brezit pasardhës të gjitha ndryshimet fizike, të cilat kishin fituar gjatë jetës së tyre. Ai pohonte se këto cilësi, të cilat u akumuluan nga një brez në tjetrin, bënë



që të formohen specie të reja. Për shembull, ai pohonte se gjirafat evoluuan nga antilopat gjatë përpjekjeve të tyre për të arritur gjethet e pemëve të larta, qafat e tyre u zgjatën nga njëri brez në tjetrin

Edhe Darvini ka dhënë shembuj të ngjashëm. Në librin e tij Origjina e Llojeve, për shembull, ai thotë se disa arinj për të gjetur ushqim në thellësi të detit me kohë u shndërruan në balena.<sup>149</sup>

Por zbulimet e Gregor Mendelit (1822-1884) të ligjeve të trashëgimisë, të cilat u saktësuan nga shkenca e gjenetikës, e cila lulëzoi në shekullin e njëzet, hedhën poshtë plotësisht legjendën e përcjelljes së karakteristikave të fituara në brezat pasardhës. Kështu, u vërtetua përfundimisht se seleksionimi natyror ishte një mekanizëm joefektiv.

### **NEO-DARVINIZMI DHE MUTACIONET**

Për të gjetur një zgjidhje, darvinistët nxorën në dritë “Teorinë Sintetike Moderne”, apo siç njihet ndryshe Neo-Darvinizmin, në fund të viteve 1930. Neo-Darvinizmi shtoi mutacionet, të cilat janë shtrembërime të formuara në gjenet e gjallesave për shkak të faktorëve të tillë të jashtëm si rrezatimi apo gabimet në përsëritje, si “shkaqe të ndryshimeve të dobishme” përveç mutacionit natyror.

Modeli, i cili edhe sot e ruan vlerën në emër të evolucionit, është Neo-Darvinizmi. Sipas kësaj teorie miliona gjallesa në botë u formuan si rezultat i një procesi me anën e të cilit organe të shumta komplekse të këtyre organizmave (p.sh., veshët, mushkëritë dhe krahët) iu nënshtruan “mutacioneve,” domethënë çrregullimeve gjenetike. Por ekziston një fakt i prerë shkencor që plotësisht e hedh poshtë këtë teori: Mutacionet nuk i zhvillojnë gjallesat, përkundrazi, ato janë gjithmonë të dëmshme.

Arsyeja për këtë është shumë e thjeshtë: ADN-ja zotëron një ndërtim shumë të ndërlikuar dhe çdo ndikim spontan mbi këtë molekulë, mund vetëm t’i shkaktojë dëm asaj. Gjeneticisti amerikan B. G. Ranganathan e shpjegon këtë fakt si në vazhdim:

*Së pari, mutacionet e vërteta janë shumë të rralla në natyrë. Së dyti, shumica e mutacioneve janë të dëmshme pasi që janë të rastësishme, më parë se ndryshime*



*të rregullta në strukturën e gjeneve; çfarëdo ndryshimi i rastësishëm në një sistem tejet të rregullt do të ndikojë për të keq, jo për të mirë. Për shembull, nëse një tërmet do të dridhte një ndërtim tejet të rregullt siç është një ndërtesë, do të ndodhte një ndryshim i rastësishëm në kornizën e ndërtesës, i cili sipas të gjitha gjasave, nuk do të ishte një përmirësim.* <sup>150</sup>

Nuk çudit fakti se deri më sot nuk është vëzhguar asnjë rast i ndonjë mutacioni të dobishëm, domethënë, i cili është parë të zhvilloj kodin gjenetik. Është vërtetuar se të gjitha mutacionet janë të dëmshme. Është kuptuar se mutacioni, i cili është paraqitur si një “mekanizëm i evolucionit,” është në të vërtetë një dukuri gjenetike që dëmton gjallesat dhe i lë të gjymtuara. (Efekti më i zakonshëm i mutacionit në qeniet njerëzore është kanceri.) Natyrisht, një mekanizëm shkatërrues nuk mund të jetë “mekanizëm evolutiv.” Seleksionimi natyror, në anën tjetër, “s’ mund të bëjë asgjë i vetëm,” siç e pranoi edhe Darvini. Ky fakt na tregon se nuk ekziston ndonjë “mekanizëm evolutiv” në natyrë. Pasi që nuk ekziston asnjë mekanizëm evolutiv, asnjë proces i tillë i imagjinuar i quajtur “evolucion” nuk ka mundur të ndodhë.

### **TË DHËNAT FOSILE: ASNJË GJURMË E FORMAVE KALIMTARE**

Të dhënat fosile janë treguesi më i qartë se skenari që sugjerohet nga teoria evolucionit nuk ka ndodhur kurrë.

Sipas kësaj teorie, të gjitha gjallesat kanë evoluar nga një paraardhës. Një specie, e cila ekzistonte më parë, me kalimin e kohës, u shndërrua në diçka tjetër dhe të gjitha speciet u krijuan në këtë mënyrë. Me fjalë të tjera, ky transformim u zhvillua gradualisht gjatë një periudhe të gjatë prej qindra miliona vjetësh.

Po të kishte qenë kështu, lloje të shumta kalimtare duhej të kishin ekzistuar dhe jetuar brenda kësaj periudhe të gjatë transformimi.

Për shembull, disa krijesa gjysmë peshk-gjysmë zvarranik duhej të kishin jetuar në të kaluarën të cilat kishin fituar disa tipare zvarranikësh, përveç tipareve të peshkut të cilat ato tashmë i kishin. Apo duhej të kishin ekzistuar disa zvarranik-zogj, të cilët fituan disa tipare të zogjve përveç tipareve të zvarranikëve që ato tashmë i kishin. Meqë këto gjallesa do të



duhej të kishin ekzistuar në një periudhë kalimtare, gjallesat duhet të kenë qenë të gjymtuara dhe me një sërë të metash. Evolucionistët, këto qenie imagjinare që besojnë të kenë jetuar në të kaluarën, i quajnë “forma kalimtare”.

Nëse me të vërtetë do të kishin ekzistuar gjallesa të tilla në të kaluarën, atëherë do të duhej të kishte me miliona dhe madje miliarda sosh për nga numri dhe llojlojshmëria. Ajo që është më me rëndësi, mbetjet e këtyre qenieve të çuditshme do të duhej të haseshin në të dhënat fosile. Darvini, në librin Origjina e Llojeve, këtë fakt e shpjegon kështu:

*Nëse teoria ime është e vërtetë, atëherë forma kalimtare të panumërta që lidhin speciet e të njëjtit grup, duhet të kenë ekzistuar sigurisht... Si rrjedhim, provat për ekzistencën e tyre të mëparshme do të mund të gjendeshin vetëm në mbetjet fosile.” 151*



Mutacionet – ndërprerjet apo zëvendësimet që ndodhin në molekulën e ADN-së – janë rezultat i ndikimeve të jashtme si rrezatimi apo veprimi kimik. Ky djalosh Vietnamez që ka pësuar mutacion është viktimë e armës bërthamore.

## **SHPRESAT E VENËTURA TË DARVINIT**

Mirëpo, edhe pse janë bërë shumë kërkime intensive për të gjetur fosilet që nga mesi i shekullit të nëntëmbëdhjetë në mbarë botën, ende nuk është gjetur asnjë formë kalimtare. Të gjitha fosilet, në kundërshtim me atë që shpresonin evolucionistët, tregojnë se jeta në Tokë u shfaq rastësisht, krejt papritur dhe plotësisht e formuar.

Një paleontolog i njohur britanik, Derek V. Ager, edhe pse një evolucionist, e pranon këtë realitet:

*Problemi ynë është ky: Tek analizojmë me hollësi të dhënat fosile në nivelin e klasave apo llojeve, hasim gjithmonë e më tepër jo evolucion gradual, por*



*shpërthim të papritur të një lloji në llogari të një tjetri.* <sup>152</sup>

Me fjalë të tjera, te fosilet e gjetura, të gjitha llojet e gjallesave shfaqen papritmas dhe në formën e tyre të përfunduar, pa asnjë formë të ndërmjetme në mes. Kjo është pikërisht e kundërta e supozimeve të Darvinit. Për më tepër, kjo është një provë shumë e fortë që gjallesat janë krijuar. I vetmi shpjegim që një specie e gjallë të shfaqet papritmas e plotë dhe pa paraardhës nga i cili të ketë evoluar është se ajo u krijua. Kjo e vërtetë është pranuar po ashtu nga biologu i mirënjohur evolucionist Douglas Futuyuma:

*Krijimi dhe evolucioni janë dy shpjegimet e vetme që mund të bëhen rreth origjinës së qenieve të gjalla. Krijimi dhe evolucioni, në mes tyre, shter shpjegimet e mundshme për zanafillën e gjallesave. Organizmat ose janë shfaqur në tokë të zhvilluara plotësisht, ose jo. Në rast se nuk janë zhvilluar gradualisht, ato duhet të jenë zhvilluar nga specie që kanë ekzistuar më parë me anë të ndonjë procesi modifikimi. Në rast se janë shfaqur plotësisht të zhvilluara, ato me të vërtetë duhet të jenë krijuar nga ndonjë intelekt i plotfuqishëm.* <sup>153</sup>

Fosilet tregojnë se qeniet e gjalla u shfaqën në Tokë të formuara plotësisht dhe në gjendje të përkryer. **Me fjalë të tjera “origjina e llojeve,” në kundërshtim me supozimin e Darvinit, nuk është evolucioni, por krijimi.**

### **PËRRALLA E EVOLUCIONIT TË NJERIUT**

Çështja që trajtohet më shpesh nga mbrojtësit e teorisë së evolucionit është prejardhja e njeriut. Mendimi darvinist mbi këtë çështje thotë se qeniet njerëzore moderne që jetojnë sot kanë evoluar nga disa krijesa të ngjashme me majmunët. Gjatë kësaj periudhe të supozuar, e cila mendohet të ketë filluar rreth 4-5 milionë vjet më parë, pretendohet se kanë jetuar “forma kalimtare” midis njeriut modern dhe të parëve të tij. Ka katër “kategoritë” bazë në gjithë këtë skenar të imagjinuar:

1. Australopiteku
2. Homo habilis
3. Homo erectus
4. Homo sapiens





Evolucionistët i japin emrin “*Australopitek*” (që do të thotë “majmuni i jugut”), të ashtuquajturit paraardhës të parë të njeriut të ngjashëm me majmunët. Këto qenie të gjalla nuk janë në fakt asgjë tjetër, përveçse një specie e zhdukur majmuni. Kërkimet e shumta të Lordit Solli Cukerman dhe Profesorit Çarlis Oksnard, dy anatomistë me famë botërore nga Anglia dhe SHBA-ja, rreth mbetjeve të australopitekëve tregojnë se këto qenie i përkisnin një lloji të majmunit të zhdukur dhe se nuk kishin asnjë ngjashmëri me qeniet njerëzore.<sup>154</sup>

Evolucionistët e quajnë fazën tjetër të evolucionit njerëzor “*homo*,” domethënë “njeri”. Sipas këtij pretendimi, qeniet e gjalla të serisë “*homo*” ishin më të zhvilluara se *australopitekët*. Evolucionistët i vendosën fosilet e këtyre krijesave të ndryshme pranë njëra-tjetrës me një renditje të caktuar dhe përpiluan një plan imagjinar evolucioni. Ky plan është imagjinar, sepse faktikisht asnjë lidhje evolucionare mes këtyre klasave të ndryshme nuk është provuar. Ernst Majër, njëri prej mbrojtësve më të rëndësishëm të teorisë së evolucionit në shekullin e njëzet në librin e tij Një argument i gjatë pohon se: “në veçanti (enigmat) historike si zanafilla e jetës apo e Homo sapiensit, janë tejet të vështira dhe mund madje t’i bëjnë ballë një shpjegimi përfundimtar të kënaqshëm.”<sup>155</sup>



Fosili 150-200-milion-vjeçar i pilivesës (epoka e Jurasikut të vonshëm) nuk dallon nga llojet e pilivesës që jetojnë sot.



Teoria e evolucionit pretendon se gjallesat gradualisht evoluojnë prej njëjës tek tjetra. Mirëpo, të dhënat fosile, tregojnë në mënyrë të qartë se ky është një pohim i rrejshëm. Për shembull, në Periudhën Kambrike, rreth 550 milionë vite më parë, me dhjeta gjallesa plotësisht të veçanta u shfaqën papritur. Këto qenie të gjalla të vizatuara në foton më lartë kanë struktura shumë komplekse. Ky fakt, të cilit literatura shkencore i referohet si "Shpërthimi Kambrik" është dëshmi e qartë e krijimit.

Kur konturojnë zinxhirin *Australopitek* > *Homo Habilis* > *Homo Erektus* > *Homo Sapiens*, evolucionistët nënkuptojnë se këto specie kanë qenë paraardhëse të njëra-tjetrës. Mirëpo, zbulimet më të fundit të paleoantropologëve tregojnë se *Australopiteku*, *Homo Habilis* dhe *Homo Erektus* kanë jetuar në të njëjtën periudhë në pjesë të ndryshme të botës.<sup>156</sup>

Për më tepër, një segment i caktuar njerëzish i klasifikuar si *Homo Erektus* ka jetuar deri në kohërat moderne. *Homo sapiens*, Neandertalët dhe *Homo Sapiens Sapiens* (njeriu modern) kanë bashkëjetuar në të njëjtin rajon.<sup>157</sup>

Kjo, sigurisht, provon përfundimisht se këto specie nuk ishin paraardhëse të njëra-tjetrës. Stefën Xhej Gould, njëri prej paleontologëve të universitetit të Harvardit, megjithëse është evolucionist, e shpjegon qorrssokakun në të cilin gjendet teoria darviniste në këtë mënyrë:

*Çfarë i ndodhi shkallës sonë, nëse bashkekzistojnë tri linja hominide (A. Afrikanus, Robust Australopitekët robust (shtatmëdhenj) dhe H. Habilis) që nuk rrjedhin nga njëra-tjetra? Për më tepër, asnjë nga të tre nuk shfaq ndonjë tendencë evolutive gjatë qëndrimit të tyre në tokë.*<sup>158</sup>

Me pak fjalë, i gjithë skenari i evolucionit njerëzor që po mbahet gjallë me ndihmën e vizatimeve të ndryshme të krijesave imagjinare “gjysmë-majmun-gjysmë-njeri”, që shfaqen në media apo libra shkollorë, domethënë, sinqerisht, me anë të metodave propagandistike, s’janë gjë tjetër veçse një mit pa asnjë bazë shkencore.

Lordi Solli Cukerman, një nga shkencëtarët më të njohur dhe më të spikatur të Mbretërisë së Bashkuar, e ka studiuar këtë çështje për vite me radhë dhe ka kryer një punë kërkimore 15-vjeçare mbi fosilet e *Australopitekut*. Edhe pse evolucionist, ai arriti në përfundimin se, në të vërtetë, nuk ekziston asnjë pemë gjenealogjike midis majmunit dhe njeriut.

Cukerman gjithashtu bëri një “spektër interesant të shkencave”, duke i radhitur ato nga ato që ai i konsideronte si më shkencoret tek ato që i konsideronte si më joshkencoret. Sipas spektrit të Cukermanit, më “shkencoret,” duke marrë parasysh mbështetjen e tyre në argumente, janë shkenca e fizikës dhe kimisë. Më pas vijjnë shkencat biologjike dhe

pastaj shkencat shoqërore. Në fund fare, në pjesën që konsiderohet të jetë si pjesa më “joshkencore”, radhitet “perceptimi jashtë-shqisor” – konceptet si telepatia dhe shqisa e gjashtë – dhe në fund të fundit u vendos “evolucioni i njeriut”. Cukerman shpjegon kështu arsyetimin e tij:

*Më pas zhvendosim regjistrin e të vërtetës objektive në drejtim të atyre fushave të shkencës të konsideruara si shkencë biologjike, si p.sh. perceptimi jashtë-shqisor apo interpretimi i historisë së fosileve të njeriut, ku për (evolucionistin) besnik gjithçka është e mundur – dhe ku besimtari i zjarrtë (i evolucionit ndonjëherë është në gjendje të besojë shumë gjëra kontradiktore në të njëjtën kohë. 159*

Siç shihet, evolucioni njerëzor nuk është gjë tjetër veçse një përmbledhje e “disa interpretimeve të paragjykuara të fosileve të zhvarrosura prej njerëzve të caktuar, të cilët ndjekin verbërisht teorinë e tyre.

### **TEKNOLOGJIA E SYRIT DHE VESHIT**

Një çështje tjetër që mbetet pa përgjigje nga teoria e evolucionit është cilësia e shkëlqyer e perceptimit të syrit dhe veshit.

Para se të kalojmë te syri, le t’i përgjigjemi shkurtimisht pyetjes “Si shohim ne?” Rrezet e dritës që vijnë nga një objekt, bien në retinën e syrit duke dhënë një imazh të përmbysur të objektit. Këtu, këto rreze drite transformohen në sinjale elektrike nga qelizat dhe pastaj përcillen në një zonë të vogël në pjesën e prapme të trurit, ku ndodhet “qendra e shikimit”. Këto sinjale elektrike perceptohen në këtë qendër të trurit si imazh pas një sërë procesesh. Le të mendojmë pak, duke u bazuar në këto njohuri teknike.

Truri është i izoluar tërësisht nga drita. Kjo do të thotë se pjesa e brendshme e trurit është në errësirë të plotë dhe drita nuk arrin atje. Qendra e shikimit është një vend në errësirë të plotë ku nuk hyn kurrë dritë. Ka mundësi që të jetë vendi më i errët që ekziston. Megjithatë, ne shikojmë një botë të ndritshme plot dritë në këtë errësirë të plotë.

Imazhi i formuar në sy është kaq i mprehtë dhe i qartë, sa që as teknologjia e shekullit njëzet nuk ka arritur ta realizojë. Për shembull, shikoni librin që jeni duke e lexuar, duart me të cilat e mbani atë dhe



# PAVËRTETË

Paraqitjet  
imagjinare të  
qenieve 'primitive'  
njerëzore shpeshherë  
përdoren në historitë e  
paraqitura nga gazetat dhe  
revistat që janë pro-  
evolucionit. I vetmi burim i  
këtyre historive, të bazuara në  
këto paraqitje imagjinare, janë  
fantazitë e autorëve të tyre. E  
megjithatë evolucioni ka  
përjetuar një disfatë të tillë  
përballë fakteve shkencore sa  
që gjithnjë e më pak raporte  
lidhur me evolucionin  
paraqiten tani në revistat  
shkencore.



pastaj ngrini kokën dhe shikoni përreth. A keni parë ndonjëherë një imazh të tillë të mprehtë e të qartë si ky në ndonjë vend tjetër? Edhe ekrani më i zhvilluar i televizorit i prodhuar nga prodhuesi më i fuqishëm i televizorëve në botë nuk mund të sigurojë një imazh aq të mprehtë për ju. Ky është një imazh tre-dimensional, me ngjyra dhe jashtëzakonisht i pastër. Për vite të tëra, mijëra inxhinierë janë përpjekur të prodhojnë një televizor tre-dimensional, i cili mund të arrijë cilësinë e shikimit të syrit. Ata kanë arritur të shpikin një sistem TV tre-dimensional, por ai nuk mund të shihet pa vendosur një palë syze speciale 3-D. Për më tepër, bëhet fjalë vetëm për një tre-dimensional artificial. Sfondi është më i mjegulluar, ndërsa plani i parë duket sikur është dekor prej letre. Asnjëherë s'ka qenë e mundur të arrihet një imazh me cilësinë e syrit. Edhe në kamera apo në televizor, ka një humbje të cilësisë së imazhit.

Evolucionistët pretendojnë se mekanizmi që prodhon këtë imazh të

mprehtë e të qartë është formuar krejt rastësisht. Nëse dikush do t'ju thoshte se televizori në dhomën tuaj është formuar si rezultat i bashkimit të rastësishëm të miliona atomeve, çfarë do të mendonit ju? Si mund ta bëjnë atomet atë që mijëra njerëz s'e bëjnë dot?

Nëse një pajisje që prodhon një imazh më primitiv se syri nuk mund të jetë formuar rastësisht, atëherë është shumë e qartë që edhe syri apo imazhi që shikohet prej tij nuk mund të jenë krijuar rastësisht. E njëjta gjë vlen edhe për veshin. Veshi i jashtëm i kap tingujt dhe i drejton te veshi i mesëm, i cili ia përcjell veshit të brendshëm duke i përforcuar ato. Veshi i brendshëm ia dërgon valët zanore trurit, duke i kthyer në sinjale elektrike. Ashtu si me shikimin, procesi i dëgjimit përfundon në qendrën e dëgjimit në tru.

Ajo që thamë për syrin është e vërtetë edhe për veshin. D.m.th. truri është i izoluar nga tingujt, ashtu si është i izoluar edhe nga drita: asnjë tingull nuk mund të depërtojë brenda. Prandaj, s'ka rëndësi sa zhurmë ka jashtë, brenda trurit mbizotëron një qetësi absolute. Megjithatë edhe tingujt më të mprehtë perceptohen nga truri.

Nëpërmjet trurit tonë, i cili është i izoluar nga tingujt, ne dëgjojmë simfoninë e ekzekutuar nga një orkestër apo zhurmat në një vend të mbushur plot me njerëz. Megjithatë, nëse bëhet një matje ekzakte e nivelit të tingujve në trurin tonë në këto momente, do të kuptonim se një qetësi absolute mbizotëron aty.

Ashtu si në rastin e imazhit, dekada të tëra përpjekjesh kanë kaluar për të krijuar dhe riprodhuar tinguj sa më të afërt me origjinalin. Rezultatet e këtyre përpjekjeve janë regjistruer e zërit, sistemet HI-FI dhe sistemet e ndryshme për kapjen e tingujve. Pavarësisht nga teknologjia e përparuar dhe përpjekjet e mijëra inxhinierëve e ekspertëve, nuk është përfituar asnjë tingull që të ketë të njëjtën mprehtësi dhe qartësi si tingulli që kapet nga veshi. Mendoni për sistemet HI-FI të cilësisë më të lartë të prodhuar nga kompania më e madhe e industrisë së muzikës. Edhe në këto pajisje, kur regjistrohet zëri, humbet një pjesë e cilësisë. Kur ndizni një HI-FI gjithmonë dëgjoni një zhurmë të lehtë para se të fillojë muzika. Veshi i njeriut asnjëherë nuk e kap një tingull të shoqëruar me



zhurmë; ai e kap tingullin pikërisht ashtu siç është, i mprehtë e i qartë. Kështu ka qenë gjithmonë që nga krijimi i njeriut.

Deri më sot, asnjë aparat vizual apo regjistruer i bërë nga njeriu nuk ka qenë aq i ndjeshëm dhe i suksesshëm në marrjen e të dhënave shqisore si syri dhe veshi. Mirëpo, përse i përket të pamurit dhe të dëgjuarit, një e vërtetë shumë më madhështore qëndron pas gjithë kësaj.

### **KUJT I TAKON NDËRGJEGJJA QË SHEH DHE DËGJON NË BRENÐI TË TRURIT?**

Kush shikon një botë joshëse në trurin tonë, dëgjon simfonitë dhe cicërimën e zogjve dhe ndien aromën e trëndafilut?

Nxitjet që vijnë prej syve, veshëve dhe hundës së një personi shkojnë në tru si impulse nervore elektro-kimike. Në librat e biologjisë, fiziologjisë dhe biokimisë, mund të gjeni shumë hollësi për mënyrën se si ky imazh formohet në tru. Mirëpo, kurrë nuk do të mund të ndesheni me faktin më të rëndësishëm: Kush i pranon këto impulse nervore elektro-kimike si imazhe, tinguj, aroma dhe ngjarje shqisore në tru? Ekziston një ndërgjegje në tru që i pranon gjithë këto pa ndier ndonjë nevojë për një sy, vesh apo hundë. Kujt i takon kjo ndërgjegje? Natyrisht se nuk u takon nervave, shtresës yndyrore dhe neuroneve që e përbëjnë trurin. Kjo është arsyeja pse darvinistët-materialist, të cilët besojnë se gjithçka përbëhet prej materies, nuk mund të japin përgjigje në këto pyetje.

Sepse kjo ndërgjegje është shpirti i krijuar prej Allahut, i cili nuk ka nevojë as për syrin për të shikuar imazhet dhe as për veshin për t'i dëgjuar tingujt. Për më tepër, nuk ka nevojë për trurin për të menduar.

Çdo njeri që e lexon këtë fakt të qartë shkencor do të duhej të mendonte thellë për Allahun e Gjithëfuqishëm dhe të ketë frikë dhe të kërkoj strehim tek Ai, sepse Ai ngjesh tërë gjithësinë në një vend plotësisht të errët prej disa centimetrave kub në një formë tre-dimensionale, me ngjyra, me hije dhe të ndritshme.

### **NJË BESIM MATERIALIST**

Informacioni që kemi paraqitur deri tani tregon se teoria e evolucionit



është një pretendim që bie hapur në kundërshtim me faktet shkencore. Pretendimi i teorisë në lidhje me prejardhjen e jetës është në kundërshtim me shkencën, mekanizmat e evolucionit të propozuara nga kjo teori nuk kanë asnjë forcë evolutive, dhe fosilet tregojnë se format kalimtare nuk kanë ekzistuar kurrë. Prandaj, teoria e evolucionit duhet të hidhet poshtë si një ide joshkencore. Në këtë mënyrë shumë ide, si modeli i gjithësisë me qendër Tokën, janë nxjerrë jashtë agjendës së shkencës gjatë historisë.

Por teoria e evolucionit vazhdon të mbahet me vendosmëri në listën e teorive shkencore. Disa njerëz madje përpiqen t'i paraqesin kritikën në adresë të saj si "sulm ndaj shkencës". Po pse ndodh kjo gjë?

Arsyeja për këtë situatë të krijuar është se për disa njerëz të cilët u përkasin disa qarqeve të caktuara, teoria e evolucionit është shndërruar në një besim dogmatik të domosdoshëm. Këto qarqe kapen fort pas filozofisë materialiste dhe ndikohen nga Darwinizmi, i cili për ta është shpjegimi i vetëm materialist për natyrën.

Nganjëherë ata e pranojnë hapur këtë. Riçard Levontin, gjenetist i famshëm nga universiteti i Harvardit dhe në të njëjtën kohë një evolucionist i njohur pranon se është "së pari materialist, pastaj



Krahasuar me kamerat dhe pajisjet për regjistrimin e zërit, syri dhe veshi janë shumë më kompleks, shumë më të suksesshëm dhe posedojnë konstruksion shumë më superior se këto produkte të teknologjisë së lartë.



shkencëtar”:

*Nuk është puna se metodat dhe institucionet e shkencës në njëfarë mënyre na detyrojnë të pranojmë një shpjegim material për botën, por përkundrazi, ne jemi të detyruar nga përkrahja jonë arbitrare e kauzës materialiste të krijojmë një aparat hetimi dhe një sërë konceptesh që japin shpjegime materiale, edhe nëse janë kundër intuitës, pa marrë parasysh se sa të mjegullta janë për të panisurën. Për më tepër, materializmi është absolut, kështu që ne nuk mund të lejojmë të dalë në skenë një Qenie Hyjnore.* <sup>160</sup>

Këto fjalë janë deklarata të qarta se Darwinizmi është një dogmë e mbajtur gjallë për hir të lidhjes me filozofinë materialiste. Sipas kësaj dogme asgjë nuk ekziston përveç materies. Prandaj, ajo predikon se materia e pajetë dhe e pavetëdijshe krijoi jetën. Ajo këmbëngul se miliona specie të gjalla, (si zogjtë, peshqit, kafshët, insektet, pemët, lulet, balenat dhe qeniet njerëzore) u shfaqën si pasojë e bashkëveprimit të materies si shiut, rrufeve dhe kështu me radhë prej materies së pajetë. Ky besim është në kundërshtim të plotë si me arsyen ashtu edhe shkencën. Por darvinistët vazhdojnë të mbrojnë këtë besim me qëllim që “të mos lejojnë daljen në skenë të një Qenie Hyjnore.”

Kushdo që nuk e shikon prejardhjen e gjallesave me paragjykim materialist do ta kuptojë këtë të vërtetë të qartë: të gjitha gjallesat janë rezultat i krijimit të një Krijuesi, i Cili zotëron fuqi, dije dhe inteligjencë superiore. Ky Krijues është Allahu, i Cili krijoi tërë gjithësinë nga asgjëja, i Cili e konstruktoi atë në mënyrën më të përkryer dhe u dha formë të gjitha gjallesave.

## **TEORIA E EVOLUCIONIT: MAGJIA MË E FUQISHME NË BOTË**

Çdo njeri i lirë prej paragjykimit dhe ndikimit të çfarëdo ideologjie të caktuar, që përdor arsyen dhe logjikën e tij apo të saj, do të kuptojë qartë se besimi në teorinë e evolucionit, i cili na përkuqton besëtytnitë e shoqërive pa dijeni të shkencës apo qytetërimit, është plotësisht i pamundshëm.

Siç u shpjegua më lartë, ata që besojnë në teorinë e evolucionit mendojnë se disa atome dhe molekula të hedhura në një fuçi të madhe do





**Një njeri që e shikon një fokë e percepton atë në trurin e tij. Në mënyrë të ngjashme, në trurin e tij ai i shqyrton dhe ekzaminon tiparet e kësaj krijese që ai e sheh në trurin e tij. Gjërat që mëson ai i zbulojnë atij përsosmërinë e krijimit të Allahut dhe superioritetin e urtësisë dhe diturisë së Tij.**

të mund të krijonin profesorë dhe studentë universiteti që janë në gjendje të mendojnë dhe gjykojnë; shkencëtarë si Ajnshtajni dhe Galileo; artistë si Hemfri Bogart, Frenk Sinatra dhe Luçano Pavaroti; si edhe antilopa, drurë limoni dhe karafila. Për më tepër, pasi që shkencëtarët dhe profesorët të cilët besojnë në këto gjepura janë njerëz të shkolluar, është krejtësisht e arsyeshme të flitet për këtë teori si për “magjinë më të fuqishme në histori.” Asnjëherë më parë asnjë besim apo ide tjetër nuk ua ka larguar aftësinë e të gjykuarit të njerëzve, nuk ka pranuar t’i lejojë ata të mendojnë me mençuri dhe me arsye dhe ua ka fshehur të vërtetën sikur ata t’i kishin sytë e lidhur. Kjo është një verbëri madje edhe më e keqe dhe më e pabesueshme se adhurimi i Zotit të Diellit Ra nga egjiptianët, adhurimi i totemeve në disa pjesë të Afrikës, adhurimi i Diellit nga populli i Sabës, adhurimi i idhujve që kishin mbaruar me duart e tyre nga ana e fisit të Profetit Ibrahim (paqja qoftë mbi të) apo adhurimi i Viçit të Artë nga ana e popullit të Profetit Musa (paqja qoftë mbi të).



Në të vërtetë, Allahu ka theksuar këtë mungesë arsyeje në Kuran. Në shumë vargje, Ai zbulon se mendjet e disa njerëzve do të jenë të mbyllura dhe se ata do të jenë të pafuqishme të shohin të vërtetën. Disa nga këto vargje jepen në vazhdim:

Sa për ata që mohojnë, njësoj është, i paralajmërove apo nuk i paralajmërove - ata nuk besojnë. Allahu i ka vulosur zemrat e tyre, ndërsa në veshët dhe sytë e tyre kanë mbulesë; ata i pret një dënim i madh. (Sure Bekare: 6-7)

...Ata kanë zemra me të cilat nuk kuptojnë. Ata kanë sy me të cilët nuk shohin. Ata kanë veshë me të cilët nuk dëgjojnë. Ata janë si kafshët, bile edhe më të humbur! Ata janë të pavetëdijshëm. (Sure A'raf: 179)

Edhe sikur Ne t'u hapnim atyre një derë në qiell dhe të ngjiteshin vazhdimisht lart në të (e të shihnin engjëjt e fshehtësitë), ata vetëm do të thoshin: "Neve na janë ndalë sytë (të parët). Jo, ne jemi njerëz të magjepsur. (Sure Hixhr: 14-15)

Fjalët nuk mund ta shprehin se sa është e habitshme se si kjo magji ka arritur të mbajë një komunitet aq të gjerë në skllavëri, t'i largojë njerëzit nga e vërteta dhe të mos ndërpritet për 150 vjet. Është e kuptueshme se një apo disa njerëz do të mund të besonin në skenarë dhe pohime të pabesueshme përplot marrëzi dhe mungesë arsyeje. Mirëpo, "magjia" është shpjegimi i vetëm i mundshëm për njerëzit në mbarë botën që besojnë se atomet e pavetëdijshme dhe të pajetë papritur vendosën të bashkohen dhe të formojnë një gjithësi që funksionon me një sistem të organizimit, rregullit, arsyes dhe vetëdijes së përkryer; një planet të quajtur Tokë me të gjitha veçoritë e saj të përshtatura në mënyrë aq të përkryer për jetën; dhe gjallesat përplot sisteme të panumërta komplekse.

Në të vërtetë, Kurani rrëfen ngjarjen e Profetit Musa dhe Faraonit për të treguar se disa njerëz të cilët përkrahin filozofitë ateiste në të vërtetë ndikojnë tek të tjerët me anë të magjisë. Kur iu tha Faraonit për fenë e vërtetë, ai i tha Profetit Musa të ndeshet me magjistarët e tij. Kur Musai e bëri këtë, ai u tha atyre që të tregojnë aftësitë e tyre të parët. Vargjet pasojnë:

"Hidhni ju!" – u përgjigj ai. Kur magjistarët hodhën shkopinj të tyre,



**i magjepsën sytë e njerëzve, i frikësuan ata dhe shfaqën një magji të madhe. (Sure A'raf: 116)**

Siç kemi vënë re, magjistarët e Faraonit ishin në gjendje të mashtrojmë çdo njeri, përveç Musait dhe atyre të cilët i besuan atij. Mirëpo, dëshmia e tij zhduki magjinë, apo “gëlltiti atë që ata kishin sajuar,” siç përshkruhet në ajet.

**Atëherë Ne i kumtuam Musait: “Hidhe shkopin tënd!” - dhe ai filloi të gëlltiste gjithçka që trilluan ata. Në këtë mënyrë, doli në shesh e vërteta dhe dështoi ajo që kishin bërë ata. (Sure A'raf: 117-118)**

Siç kemi vënë re, kur njerëzit e kuptuan se ata u magjepsën dhe se ajo që panë ishte vetëm një iluzion, magjistarët e Faraonit humbën gjithë besueshmërinë e tyre. Edhe në ditët tona, përveç nëse ata të cilët, nën ndikimin e një magjie të ngjashme, besojnë në këto pretendime qesharake nën maskën e tyre shkencore dhe kalojnë jetët e tyre duke i mbrojtur ato, i braktisin besimet e tyre paragjykuese, ata po ashtu do të poshtërohen kur e vërteta e plotë shfaqet dhe magjia priset. Në të vërtetë, Malkolm Magerixh, një filozof ateist dhe përkrahës i evolucionit, pranoi se ishte i brengosur pikërisht nga kjo perspektivë:

*Unë personalisht jam i bindur se teoria e evolucionit, posaçërisht shtrirja e zbatimit të saj, do të jetë njëra prej shakave më të mëdha në librat e historisë në të ardhmen. Brezat e ardhshëm do të çuditen se si një hipotezë aq jo bindëse dhe e dyshimtë ka mundur të pranohej me naivitetin e pabesueshëm që ajo posedon. <sup>161</sup>*

Se e ardhmja nuk është larg: Përkundrazi, njerëzit së shpejti do ta shohin se “rasti” nuk është hyjni dhe do të shikojnë prapa në teorinë e evolucionit si në mashtrimin më të keq dhe magjinë më të tmerrshme në botë. Ajo magji tashmë ka filluar të ngrihet me shpejtësi prej shpatullave të njerëzve në mbarë botën. Shumë njerëz që e shohin fytyrën e saj të vërtetë po pyeten me habi se si është e mundur që të jenë kapluar prej saj.



*HARUN JAHJA (ADNAN OKTAR)*

- 142 Sidney Fox, Klaus Dose, *Molecular Evolution and The Origin of Life*, W.H. Freeman and Company, San Francisco, 1972, p. 4.
- 143 Alexander I. Oparin, *Origin of Life*, Dover Publications, New York, 1936, 1953 (reprint), p. 196.
- 144 "New Evidence on Evolution of Early Atmosphere and Life", *Bulletin of the American Meteorological Society*, vol 63, November 1982, pp.1328-1330.
- 145 Stanley Miller, *Molecular Evolution of Life: Current Status of the Prebiotic Synthesis of Small Molecules*, 1986, p. 7.
- 146 Jeffrey Bada, *Earth*, February 1998, p. 40
- 147 Leslie E. Orgel, "The Origin of Life on Earth", *Scientific American*, vol. 271, October 1994, p. 78.
- 148 Charles Darwin, *The Origin of Species by Means of Natural Selection*, The Modern Library, New York, p. 127.
- 149 Charles Darwin, *The Origin of Species: A Facsimile of the First Edition*, Harvard University Press, 1964, p. 184.
- 150 B. G. Ranganathan, *Origins?*, Pennsylvania: The Banner Of Truth Trust, 1988, p. 7.
- 151 Charles Darwin, *The Origin of Species: A Facsimile of the First Edition*, Harvard University Press, 1964, p. 179.
- 152 Derek A. Ager, "The Nature of the Fossil Record", *Proceedings of the British Geological Association*, vol 87, 1976, p. 133.
- 153 Douglas J. Futuyma, *Science on Trial*, Pantheon Books, New York, 1983. p. 197.
- 154 Solly Zuckerman, *Beyond The Ivory Tower*, Toplinger Publications, New York, 1970, pp. 75-94; Charles E. Oxnard, "The Place of Australopithecines in Human Evolution: Grounds for Doubt", *Nature*, vol 258, p. 389.
- 155 "Could science be brought to an end by scientists' belief that they have final answers or by society's reluctance to pay the bills?" *Scientific American*, December 1992, p. 20.
- 156 Alan Walker, *Science*, vol. 207, 7 March 1980, p. 1103; A. J. Kelso, *Physical Anthropology*, 1st ed., J. B. Lipincott Co., New York, 1970, p. 221; M. D. Leakey, *Olduvai Gorge*, vol. 3, Cambridge University Press, Cambridge, 1971, p. 272.
- 157 Jeffrey Kluger, "Not So Extinct After All: The Primitive Homo Erectus May Have Survived Long Enough To Coexist With Modern Humans," *Time*, 23 December 1996.
- 158 S. J. Gould, *Natural History*, vol. 85, 1976, p. 30.
- 159 Solly Zuckerman, *Beyond The Ivory Tower*, p. 19.
- 160 Richard Lewontin, "The Demon-Haunted World," *The New York Review of Books*, 9 January 1997, p. 28.
- 165 Malcolm Muggeridge, *The End of Christendom*, Grand Rapids: Eerdmans, 1980, p. 43.